

POZITA PENALO – JURIDIKE E TË MITURVE SI SUBJEKT AKTIV NË KRIMINALITET

Antoneta Gjolenë

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Juridike, profili “Penale”, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: PhD. Mirgen Prenc

Numri i fjalëve: 60.962

Tiranë, 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Antoneta Gjolena

ABSTRAKT

Kriminaliteti tek të miturit, është një fenomen shqetësues për shoqërinë shqiptare, por dhe mbarë shoqërinë në botë. Duke marrë shkas nga përmasat, gjithmonë e më shumë në rritje të këtij fenomeni, mendojmë të trajtojmë në mënyrë të detajuar, të gjithë elementët përbërës të kësaj forme të shprehjes e zhvillimit të kriminalitetit, në aspektin kriminologjik dhe penologjik.

Objekt i këtij punimi do të jenë: Evoluimi i sistemit të drejtësisë për të miturit në Shqipëri, faktorët që i çojnë të miturit në kryerjen e veprave penale, si dhe llojet e veprave penale të kryera nga ana e tyre. Një trajtesë të veçantë do të kenë dhe aspekte të përgjegjësisë penale të të miturve, mosha për përgjegjësinë penale dhe qëndrimet në lidhje me kufirin e kësaj moshe. Po aq rëndësi do ti kushtohet procedimit penal të të miturve me trajtime teorike dhe problematika të ndryshme të praktikës, e deri te garancitë e veçanta procedurale. Një vend të rëndësishëm do të zërë sistemi i dënimeve dhe masat edukuese dhe ato mjekësore, dënimet alternative, në ndihmë të rehabilitimit të miturve të përfshirë në krime, si dhe efikasiteti i politikave penitenciare që shteti shqiptar ndërmerr ndaj të miturve. Studimi do të fokusohet gjithashtu dhe në paraqitjen e qasjeve të ndryshme që kanë studiues të njohur, si dhe do të ketë dhe një trajtesë krahasimore me vendet e zhvilluara, duke argumentuar dhe qëndrimin tonë në lidhje me çështjet objekt studimi.

Analizat e bëra në këtë temë synojnë t'ju vijnë në ndihmë, të gjithë subjekteve të përfshirë në sistemin e drejtësisë penale, hulumtuesëve të kësaj fushe, si dhe të gjithë personave të interesuar, që të marrin informacione adekuate me qëllim, njohjen, luftimin dhe parandalimin e këtij fenomeni që po shqeteson shoqërinë në të gjithë botën.

Fjalë kyçe: kriminalitet, të mitur, krime, drejtësi penale, efikasitet, faktore kriminogjen

DEDIKIM

Një njeriu tepër të shtrenjtë dhe të veçantë të jetës time babait tim.

FALENDERIMET

Falënderimi dhe mirënjohja ime e sinqertë u drejtohet te gjithë atyre personave që u bënë pjesë e këtij studimi.

Së pari dëshiroj të shpreh mirënjohjen time ndaj pedagogut udhëheqës, Z. Mirgen Prence i cili me shumë profesionalizëm dhe përkushtim më ka orientuar në çdo hap të këtij punimi.

Falënderime të veçanta i drejtoj të gjithë stafit drejtues të shkollës doktorale të Universitetit European të Tiranës

Shpreh vlerësim dhe mirënjohje të veçantë për Prof.Asoc.Dr. Arbr Agalliu për gjithë mbështetjen dhe mirëkuptimin e tij.

Dhe në fund dëshiroj të falënderoj familjen time, në veçanti Xhoelin dhe Amelën për kohën dhe përkushtimin e munguar.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Deklarata e autorësisë.....	I
Abstrakt.....	II
Dedikim.....	III
Falenderime.....	IV
Tabela e përmbajtjes.....	V
Lista e shkurtimeve.....	X
Lista e tabelave.....	166

KREU I : HYRJE DHE BAZIMI TEORIK

1. Hyrje.....	1
2. Objektivat dhe qëllimi i studimit.....	3
3. Pyetje kërkimore dhe hipotezat e studimit.....	4
3.1. Hipotezat e studimit.....	4
4. Metodologjia dhe metodat e kërkimit shkencor.....	5
5. Rëndësia e studimit.....	7
6. Permbledhja dhe strukturimi i studimit.....	8

KREU II: TË DREJTAT E FËMIJËVE SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

2.1 Një vështrim i përgjithshëm historik për trajtimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.....	12
2.2 Mbrojtja dhe trajtimi juridiko penal i të drejtave të fëmijëve në legjislacionin shqiptar.....	15
2.2.1. Të drejtat e të fëmijëve në të drejtën zakonore.....	15
2.2.2. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve sipas Kodit Penal mbretëror.....	18
2.2.3. Trajtimi juridik i të drejtave të fëmijëve sipas Kodit Penal në vitet 1952-1953.....	22
2.2.4. Të drejtat e fëmijëve sipas Kodit Penal të vitit 1977.....	23

2.2.5. Ndryshimet legislative pas viteve 1990. Një vështrim i shkurtër.....	25
---	----

KREU III: INSTRUMENTET JURIDIK NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E TË MITURVE. ANALIZ JURIDIKE - PENALE

3.1. Rëndësia dhe zbatueshmëria e akteve ndërkombëtare dhe evropiane në legjislacionin tonë të brendshëm.....	32
3.2. Të drejtat e të miturve në instrumentet e OKB-së.....	33
3.2.1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) (1948;.....	34
3.2.2. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e New York-t miratuar në 20.11.1989 dhe protokolle e saj shtesë	36
3.2.3. Konventa Kundër Torturës dhe Vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, çnjerëzor a Degradues ratifikuar me ligjin nr. 7727 datë 30.6.1993.....	41
3.2.4. Rregullat standard minimum të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të miturit (1985).....	42
3.2.5. Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës 1990).....	44
3.2.6. Rregullat Standard Minimum të Kombeve të Bashkuara lidhur me masat e mos-arrestimit (Rregullat e Tokios 1990).....	44
3.2.7. Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e kriminalitetit e të rinjve (Udhëzimet e Riadit 1990).....	45
3.3. Mbrojtja të drejtave të të miturve në aktet juridike të Këshillit të Europës.....	46
3.3.1. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).....	47
3.3.2. Karta Sociale Evropiane (E Rishikuar).....	50
3.3.3. Konventa Evropiane mbi Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve.....	51
3.3.4. Konventa Evropiane “Për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve dhe Trajtimeve Çnjerëzore apo Degraduese”	53
3.3.5. Konventa Evropiane “Për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht” ratifikuar me Ligjin nr. 8724 datë 26.12.2000.....	55
3.3.6. Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar” e ratifikuar me Ligjin nr. 8499, datë 10.6.1999.....	56
3.3.7 Konventa e Këshillit të Evropës “Për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 8498, datë 10.6.1999)	57

3.3.8. Konventa E Këshillit Të Evropës “Për Vlefshmërinë Ndërkombëtare Të Gjykrimeve Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 9068, datë 15.5.2003.....	58
3.3.9. Konventa e Këshillit të Evropës “Për Transferimin e Procedimeve në Çështjet Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 8497, datë 10.6.1999.....	58
3.3.10. Rekomandimi Cm/Rec 2008 (11) i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Rregullat Evropiane, për të dënuarit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve ose masave.....	59
3.4. Të drejtat e të miturve në instrumentet e Bashkimit Europian.....	60
3.4.1. Traktati i Lisbonës.....	61
3.4.2. Karta e të drejtave themelore të BE-së.....	63
3.4.3. Direktiva e Këshillit Ekonomik dhe Social (2005).....	64
3.5. Kuadri ligjor shqiptar për garantimin e të drejtave të fëmijëve.....	65
3.5.1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.....	65
3.5.2. Kodi i munguar i të drejtave të fëmijëve.....	66
3.5.3. Ligji nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”.....	68
3.6. Përafrimi i legjislacionit vendas me <i>acquis communautaire</i>	70

KREU IV: PËRGJEGJËSIA PENALE. FAKTORËT QË NDIKOJNË NË KRIMINALITET. INSTITUCIONET QË ADMINISTROJNË DREJTËSINË E TË MITURIVE

4.1.Përkufizimi ligjor i termit “fëmijë”, mosha për përgjegjësi penale sipas legjislacionit shqiptar.....	73
4.2.Struktura e kriminalitetit tek të miturit dhe veprat penale më të përhapura.....	75
4.3.Faktorët e brendshëm që ndikojnë në rritjen e kriminalitet tek të miturit.....	80
4.3.1 Personaliteti i të miturit.....	81
4.3.2. Karakteri i të miturit.....	82
4.4. Faktorët e jashtëm që ndikojnë në rritjen e kriminalitet tek të miturit.....	82
4.4.1 Mjedisi familjar.....	82
4.4.2. Mjedisi Shkollor.....	84
4.4.3. Mjedisi shoqëror.....	86
4.4.4. Migrimi i brendshëm.....	87
4.4.5. Mjetet e informimit.....	87

4.5. Institucionet që administrojnë drejtësinë e të miturive në Shqipëri.....	89
4.5.1. Roli i Ministrisë së Drejtësisë në hartimin e politikave për të drejtat e të miturve në Shqipëri.....	89
4.5.2. Institucioni i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve....	90
4.5.3. Të drejtat e të miturve në sistemin gjyqësor në Shqipëri.....	92
4.5.4. Roli i Prokurorisë në hetimin e të miturve në konflikt me ligjin penal.....	94
4.5.5. Të miturit në raport me policinë e shtetit dhe policinë gjyqësore.....	95
4.5.6. Rëndësia e ekzistencës së Avokatit të të miturve.....	96
4.5.7. Institucionet me karakter ndëshkues dhe edukues të vuajtjes së dënimit.....	97

KREU V: ASPEKTET PROCEDURALE DHE MASAT QË PARASHIKOHEN NË LEGJISLACIONIN BASHKËKOHOR PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN PENAL

5.1.Aspektet procedurale që ofrojnë mbrojtje ndaj të miturve.....	98
5.1.1. Procedura e ndalimit dhe e arrestimit të të miturve.....	99
5.1.2. Trajtimi ligjor i të miturve në rastet e paraburgimi.....	105
5.1.3. Garancitë ligjore në procesin gjyqësor ndaj të miturve.....	107
5.1.4. Procedura e marrjes në pyetje e të miturve.....	110

KREU VI: MASAT LIGJORE QË PARASHIKOHEN NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN PENAL. EKSPERIENCA E DISA VENDEVE TË RAJONIT

6.1. Llojet e sanksioneve penale që parashikohen nga legjislacioni ndaj të miturve...	112
6.1.1. Dënimi me burgim.....	112
6.1.2. Dënimi me gjobë.....	115
6.1.3. Masat edukuese dhe mjekësore.....	117
6.2. Disa nga alternativat e dënimit.....	128
6.2.1. Gjysëmliria.....	130
6.2.2. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë.....	131
6.2.3. Qëndrimi në shtëpi.....	135
6.2.4. Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik.....	137
6.2.5. Lirimi me kusht.....	139
6.3. Krahasim me legjislacionet dhe eksperiencat e disa vendeve të rajonit.....	142

6.3.1. Legjislacioni francez.....	142
6.3.2. Legjislacioni italian.....	147
6.3.3. Legjislacioni kosovar.....	150

KREU VII: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

7.1. Konkluzionet.....	156
7.2. Rekomandimet.....	163
Bibliografia.....	172

LISTA E SHKURTIMEVE

AP	Avokati i Popullit
BE	Bashkimi Evropian
CRC	Komiteti për të Drejtat e Fëmijës
CPT	Komiteti për Parandalimin e Torturës i Këshillit të Evropës
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DMDBD	Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Personave të Veçantë
IEV	Penale Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale
KNDF	Komiteti Ndërmisor për të Drejtat e Fëmijës
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
MKPT	Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
MD	Ministria e Drejtësisë
MB	Ministria e Brendshme
MPÇSSHB	Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MTKRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
NDF	Nënseksioni për të Drejtat e Fëmijëve
OJF	Organizata jo Fitimprurëse
PKZMSA	Plani Kombëtar i Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
RSH	Republika e Shqipërisë

SKF	Strategjia Kombëtare për Fëmijët
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SPAK	Strategjia e Personave me Aftësi të Kufizuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
UNDP	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

KREU I : HYRJE DHE BAZIMI TEORIK

1. Hyrje

Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës aktualisht përbën një nga sfidat me të cilat përballlet shoqëria. Përfshirja e të miturve në strukturat kriminale ka ardhur duke u rritur, kjo sepse shumë grupe kriminale kanë përdorur të miturit për të realizuar synimet e tyre kriminale, nisur dhe nga shfrytëzimi i hapësirave ligjore në lidhje me legjislacionin e të miturve. Zhvillimet ekonomike dhe transformimet e mëdha që ka pësuar shoqëria kanë ndikuar në rritjen e fenomenit të kriminalitetit të të miturve. Numri i veprave penale të kryera nga të miturit në Shqipëri pas viteve 90 ka ardhur në rritje si pasojë e mungesës së masave social-ekonomike në drejtim të familjeve dhe mungesës së referimit të sistemit ligjor kombëtar.

Në kuadër të luftës kundër kriminalitetit të të miturve janë bërë ndryshime të shumta legjislative por vazhdon të jetë ende një sfidë realizimi i ndryshimeve institucionale të cilat do të çonin në zbatimin me efikasitet të normave ligjore. Në këtë pjesë të drejtësisë penale ndërthuren shumë struktura dhe shumë çështje që kanë të bëjë me legjislacionin mbi të miturit. Të tilla janë strukturat përgjegjëse për zbatimin e tij, strukturat e ndihmës mbështetëse të administratës publike, strukturat përgjegjëse për integrimin social të tyre, rehabilitimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktimë dhe strukturat përgjegjëse për parandalimin e kryerjes së veprës penale dhe sigurimi i rendit publik gjatë administrimit të drejtësisë.

Analizimi i drejtësisë penale për të mitur përbën një sipërmarrje të vështirë nisur nga fakti që drejtësia e të miturve lidhet direkt me kriminalitetin e të miturve, i cili është një faktor vendimtar për të ardhmen e shoqërisë. Pjesë e analizës së sistemit të drejtësisë së të miturve është dhe studimi i shumë disiplinave që ndihmojnë në evidentimin e shkaqeve dhe burimeve të kriminalitetit si e vetmja mënyrë për hartimin e strategjive parandaluese dhe restauruese. Po kështu, pjesë e analizës është dhe studimi sa më i detajuar dhe i mbështetur në argumente objektive i të gjithë komponentëve të sistemit të drejtësisë si studimi i legjislacionit përkatës, udhëzimeve dhe rekomandimeve të partnerëve ndërkombëtarë, vendimmarrjes së institucioneve vendase duke pasur si qendër të studimit interesin më të lartë të fëmijës.

Shqipëria aktualisht është në fazën e plotësimit të kriterëve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe ka bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e legjislacionit për të miturit duke u munduar të ketë në qendër të vëmendjes interesin me të lartë të fëmijës. Kështu pas viteve 90 në legjislacionin shqiptar u integruan një sërë konventash ndërkombëtare dhe rajonale si Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Karta Sociale Europiane, Konventa Europiane mbi Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve, Konventa e Pekinit mbi të drejtat e fëmijës “Rregullat standarte minimum të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të miturit e vitit 1985, Konventa Europiane për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve dhe Trajtimeve Çnjerëzore apo Degraduese”, Konventa Evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht” ratifikuar me Ligjin nr. 8724 datë 26.12. 2000, Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar” , ratifikuar me Ligjin nr. 8499, datë 10.6.1999, Konventa e Këshillit të Evropës “Për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale” ratifikuar me Ligjin nr. 8498, datë 10.6.1999, Konventa E Këshillit Të Evropës “Për Vlefshmërinë Ndërkombëtare Të Gjyqimeve Penale” ratifikuar me Ligjin nr. 9068, datë 15.5.2003 etj.

Ratifikimi i këtyre konventave ndërkombëtare i solli shtetit shqiptar një sërë detyrimesh për zbatimin e tyre duke u përpjekur të përmirësonin ndër të tjera edhe legjislacionin që lidhej me të miturit në përgjithësi dhe me drejtësinë penale për të mitur në veçanti. Përpos përpjekjeve ligjore Shqipëria vazhdon të jetë në sfidë të vazhdueshme me institucionet përkatëse dhe shoqërinë të cilët janë ende pasiv në luftimin e dukurisë së kriminalitetit të të miturve. Drejtësia për të mitur shërben edhe si një etalon për matjen e standardeve të drejtësisë në përgjithësi, për rrjedhojë secili nga komponentët duhet të japë kontributin e vet në përsosjen e këtij sistemi duke nxjerrë në pah pikat e dobëta në mënyrë që të përmirësohen sa më shpejt e sa më mirë. Kështu nëpërmjet analizimit të fenomenit të kriminalitetit të të miturve synohet trajtimi i pozitës juridike të të miturit dhe evidentimi i faktorëve kriminologjen . Drejtësia në përgjithësi dhe ajo e të miturve në veçanti janë gjithnjë në proces evoluimi dhe përmirësimi në përputhje me standartet ndërkombëtare të parashikuara për të drejtat e të miturve, të cilat në plan të parë kanë interesin më të lartë të fëmijës, parim ky që duhet të udhëheqë në çdo moment edhe legjislacionin tonë.

2. Objektivat dhe qëllimi i studimit

Në sistemin tonë ligjor dhe social fëmijët janë kategoria me vulnerabël në konflikt me ligjin. Në këto kushte nevojitet një sistem ligjor më “miqësor” me të drejtat e të miturve dhe me integrimin, kjo sepse kriminaliteti i të miturve ndikon drejtpërdrejt në shoqëri. Për rrjedhojë administrimi i drejtësisë për të miturit ende është në proces zhvillimi. Nëpërmjet këtij studimi kemi si synim të evidentojmë vakuumin dhe problemet me të cilat haset sot sistemi ynë ligjor. Evidentimi i situatës aktuale të kriminalitetit në Shqipëri dhe i faktorëve të cilat ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e tij përbëjnë një avantazh në lidhje me zhvillimin e drejtësisë për të miturit. Me anë të këtij punimi kemi si objektiv :

1. Analizimi i situatës aktuale mbi kriminalitetin e të miturve.
2. Identifikimi dhe analizimi i faktorëve nxitës të kriminalitetit tek të miturit
3. Evidentimi i masave të ndërruara nga shteti shqiptar për luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit tek të miturit.
4. Evidentimi i vakuumeve ligjore në lidhje me drejtësinë e të miturve.
5. Identifikimi i veprimeve dhe masave që duhet të ndërmerren nga shteti ynë për luftimin dhe parandalimin e këtij fenomeni që po shqetëson shoqërinë.

Qëllimi i këtij studimi është gjithashtu të propozojë edhe disa rekomandime të zbatueshme për të gjithë aktorët e përfshirë në hartimin dhe në zbatimin e e legjislacionit, me qëllim minimizimin e kriminalitetit tek të miturit si një fenomen me influencë negative për shoqërinë, duke pasur primare mbrojtjen dhe interesin më të lartë të fëmijës.

Sot ende nuk jemi të sigurt që sistemi aktual dhe ai që do të vijojë në të ardhmen janë sisteme të mira dhe ato të duhurat që do të ndikojnë në parandalimin e fëmijëve në realizimin e veprave penale. Kjo për faktin që sfidat që na paraqiten janë të pafundme dhe të paparashikueshme, por ajo që është e rëndësishme është që sistemi në çdo fazë, duhet ti përgjigjet sa më mirë, më shpejt dhe me kosto sa më të ulët kërkesave të të sotmes dhe perspektivave të së ardhmes në mënyrë që në sistemin ligjor të prevalojë interesi më i lartë i fëmijëve.

3. Pyetje kërkimore dhe hipoteza e studimit

Një hulumtim shkencor ka në strukturën e tij të inkorporuar pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura për qëllimin e studimit. Pyetjet kërkimore shërbejnë për kanalizimin e studimit dhe evidentimin e rëndësisë së tij. Në këtë punim trajtohet në mënyrë të detajuar fenomeni i kriminalitetit të të miturve duke bërë një analizë e kuadrit ligjor dhe zbatimit të tij ndaj të miturve, autorë të veprave penale. Pyetjet kërkimore që janë ngritur në këtë punim janë në funksion të analizimit të studimit tonë lidhur me kriminalitetin dhe reformave ligjore që duhet të ndërmerren për uljen e përfshirjes së të miturve në vepra të ndryshme penale. Në këtë punim jemi përpjekur që t'i japim përgjigjeve të mëposhtme:

- Cili është përkufizimi i të miturit dhe kur fillon përgjegjësia penale e tyre?
- Cilët janë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në rritjen e kriminalitetit nga të miturit?
- A parashikon legjislacioni shqiptar një trajtim të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të të miturve?
- Cilat janë aktet ndërkombëtare dhe rajonale që janë integruar në sistemin e brendshëm për mbrojtjen e të drejtave të të miturve?
- A i përmbush legjislacioni shqiptar të gjitha detyrimet që vijnë nga aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të miturve?
- Cilat janë problematikat që has legjislacioni shqiptar penal për të miturit në zbatimin e tij në praktik?
- A gëzojnë mbrojtje të posaçme të miturit që vuajnë dënimet penale në institucionet përkatëse me kuadrin ligjor ekzistues?
- A disponon sistemi ynë i drejtësisë institucione në përputhje me standardet ndërkombëtare për vuajtjen e dënimit nga të miturit?
- Cilat janë ndryshimet që duhen bërë në legjislacionin shqiptar për të ofruar një standard mbrojtje më të lartë për të miturit?

3.1.Hipotezat e studimit

Hipoteza e studimit është pjesë e pandarë e strukturës së tij, mungesa e të cilës do të cenonte arkitekturën e punimit doktoral. Hipoteza është një element i rëndësishëm

i hulumtimit shkencor e cila shërben për evidentimin e problematikave dhe të zgjidhjeve të mundshme që mund të ofrohen. Në këto kushte studimi ynë mbështetet në disa hipoteza të rëndësishme.

HIPOTEZA I: Legjislacioni ynë në lidhje me zbatimin e të drejtave të të miturve, në përputhje me parashikimet ndërkombëtare, prezantohet i plotë por i copëzuar. Disponojmë ende një legjislacion sektorial në lidhje me të drejtat e të miturve si kategoria më vulnerabile dhe e rëndësishme e shoqërisë.

HIPOTEZA II: Nevojitet një Kod i Drejtësisë për të Miturit i cili do të parashikonte rregullat procedurale dhe do të ofronte një mbrojtje për të miturit në të gjitha instancat e sistemit gjyqësor, duke parashikuar dispozitat që rregullojnë llojet e dënimit si dhe masat për ekzekutimin e dënimit paraqesin gjithashtu një rëndësi relevante.

HIPOTEZA III: Krijimi i institucioneve adekuate për mbrojtjen e të drejtave të të miturve duke garantuar që sistemi penal në Shqipëri të shikohet në mënyrë integrale dhe multidisiplinore. Shërbimet sociale, arsimore, policia e shtetit, shërbimi i provës, e prokuroria duhet të bashkëpunojnë jo vetëm në parandalimin, por edhe në përcaktimin e masave restauruese më të përshtatshme për fëmijët në konflikt me ligjin dhe sidomos për rehabilitimin e tyre.

4. Metodologjia dhe metodat e kërkimit shkencor

Metodologjia dhe metodat e kërkimit shkencor përbëjnë një nga shtyllat më të rëndësishme mbi të cilat ndërtohet studimi. Përdorimi i tyre është esencial në një hulumtim dhe përfaqëson një reflektim të logjikshëm të analizës shkencore të projektit daktoral. Studimi ynë ka në fokus trajtimin e konceptit të të miturit, fillimin e përgjegjësisë penale, evidentimin e faktorëve që çojnë në përfshirjen e tyre në aktivitetet kriminal dhe trajtimin e kontekstit ligjor. Për të arritur objektivat e këtij studimi kemi kombinuar disa prej metodave shkencore me të përdorura, si:

Metoda historike. Përdorimi i kësaj metode synon krijimin e një panorame të plotë të mënyrës së trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin penal, duke shqyrtuar për këtë qëllim ngjarjet juridike të cilat kanë hedhur dritë dhe kanë trajtuar këtë kategori subjektsh në etapa të ndryshme të zhvillimit të së drejtës shqiptare. Nëpërmjet kësaj

metode duam të evidentojmë se të miturit kanë gëzuar një status ligjorë të veçantë që në fillimet e krijimit të dënimeve penale dhe të legjislacioneve përkatëse.

Me anë të metodës historike kemi grumbulluar fakte të ndryshme të shpërndara në kohë të ndryshme, duke nxjerrë në pah përparësitë e periudhave të ndryshme kohore me qëllim evidentimin dhe konsolidimin e vlerave dhe standardeve të arritura, të cilat më pas do të krahasohen me qëllim arritjen e konkluzioneve përfundimtare.

Nëpërmjet përdorimit të *metodës sintezo-analitike* kam analizuar elementët e veçantë teorikë e doktrinarë të drejtësisë për të miturit në përgjithësi dhe të të miturve në konflikt me ligjin penal në veçanti, të cilët të shqyrtuara në planë të veçantë dhe të përgjithshme do të ndihmojnë në mbledhjen, ballafaqimin dhe në sintezën e informacionit të të dhënave. Kjo përbën metodën themelore në të cilën do të bazohet punimi.

Përdorimi i *metodës krahasuese* synon ballafaqimin e të dhënave të grumbulluara ndërmjet tyre dhe me ato të sistemeve të drejtësinë për të miturit të vendeve të tjera. Kjo metodë do të ndihmojë për të arritur konkluzione të qarta për avantazhet e aplikimit të instrumenteve ndërkombëtare për të mbrojtur të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin.

Metoda hulumtuese e përdorur në studim përfshin procesin e mbledhjes së materialeve në format e shkruara dhe elektronike. Hulumtimi është një proces që ka shoqëruar gjithashtu fazën e sistemimit të zërave bibliografikë në funksion të finalizimit të këtij punimi. Në analizimin e këtij fenomeni janë shfrytëzuar të dhënat e Ministrisë së Drejtësisë rreth numrit të të miturve të përfshirë në veprimtari kriminale si dhe llojeve të veprave penale të kryera nga këta të fundit.

Metoda e analizës së legjislacionit. Kjo metodë përfshin analizën e legjislacionit vendas dhe të huaj në fushën e kriminalitetit të të miturve dhe të mbrojtjes së të drejtave të tyre. Përdorimi i kësaj metode konsiston në analizën dispozitave ligjore e Kushtetuese, instrumenteve apo akteve ndërkombëtare që kanë në fokus trajtimin e të drejtave të të miturve dhe luftën ndaj kriminalitetit he rolin në uljen e tij.

Ky punim është rezultat i përdorimit të metodave primare dhe sekondare. Kështu, për të grumbulluar të dhënat primare janë shfrytëzuar të gjitha burimet institucionale në arkivat dhe të dhënat zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, të Ministrisë së Brendshme, të Prokurorisë së Përgjithshme sigurisht dhe Legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Të dhënat dytësore të përdorura në funksion të analizave, konkluzioneve dhe rekomandimeve janë marrë nga literatura bashkëkohore vendase dhe e huaj në fushën e trajtimit të kriminalitetit të të miturve.

5. Rëndësia e studimit

Aktualisht mbrojtje e të drejtave të fëmijëve përbën një prioritet të sistemit tonë të drejtësisë dhe një sfidë për shoqërinë. Rritja e numrit të të miturve të përfshirë në vepra të ndryshme penale është një tregues që sistemi ligjor ka dështuar në përdorimin e mekanizmave të tij. Në një analizë të shkaqeve kryesore që i çon fëmijët në konflikt me ligjin konstatojmë që ka një rol të rëndësishëm mungesa e masave social-ekonomike në drejtim të familjeve. Gjithashtu mungesa e një sistemi referimi kombëtar dhe lokal ka sjellë një situatë problematike. Në sistemin tonë social dhe ligjor fëmijët janë kategoria me vulnerable në konflikt me ligjin. Në këto kushte nevojitet një sistem ligjor më miqësor me të drejtat e të miturve dhe me integrimin e tyre në shoqëri. Mosfunksionimi i strukturave përgjegjëse për integrimin social të të miturve, mungesa e institucioneve të mirëfillta për rehabilitimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, mungesa e strukturave përgjegjëse për parandalimin e kryerjes së veprave penale janë disa nga problematikat kryesore të sistemit tonë ligjor.

Edhe pse vitet e fundit në Shqipëri janë hedhur hapa pozitive në përjasjen e legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtarë të garantuara në aktet ndërkombëtare ende ka mungesa në instrumentet ligjorë për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe në fokusin e duhur për ri-integrimin e tyre përmes edukimit, trajnimit dhe punësimit. Studimi ka si prioritet evidentimin e nevojës për garantim dhe respektim me efektivitet në zbatimin e të drejtave të fëmijëve, në nivelin më të lartë të arritshëm, në sistemet e drejtësisë së një vendi. Për të realizuar këtë gje nevojitet një sistem drejtësie i aksesueshme, e përshtatur sipas moshave, e

shpejtë, e fokusuar në nevojat dhe të drejtat e fëmijëve. Kjo përfshin të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të drejtën për pjesëmarrje dhe për të kuptuar procedurat, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, si dhe të integritetit dhe dinjitetit.

6. Përmbledhja dhe strukturimi i studimit

Fëmijët janë shtresa më vulnerabël e shoqërisë për shkak të papjekurisë fizike dhe intelektuale, dhe meritojnë vëmendje të veçantë nga ana e shtetit në veçanti dhe e shoqërisë në përgjithësi. Mbrojtja e familjes si bërthama e shoqërisë përbën një ndër synimet e një shteti demokratik i cili e konsideron uljen e kriminalitetit i prioritet për mbrojtjen e qytetarëve të tij. Në këto kushte mbrojtja e familjes dhe krijimi i strukturave shtetërore për trajtimin e të miturve dhe veçanërisht të atyre në konflikt me ligjin penal përbenë synimin e përmirësimit të drejtësisë penale.

Drejtësia penale për të miturit është një fushë komplekse e të drejtës ku ndërthuren jo vetëm çështjet e të miturve në konflikt me ligjin por edhe strategjitë parandaluese dhe mbrojtëse që ofron shteti dhe shoqëria sepse fëmijët janë fytyra e të ardhmes së një shteti. Mënyra e trajtimit dhe mbrojtja e fëmijëve nga shteti është tregues i shkallës së emancipimit dhe evoluimit të tij dhe shoqërisë. Njëkohësisht mënyra e trajtimit dhe mbrojtja e tyre sot do jetë edhe pasqyrimi i të ardhmes së shoqërisë. Shqipëria pasi ratifikoi një sërë konventash që lidhen drejt për drejt me të drejtat e fëmijëve, mori përsipër detyrimin për përmirësimin e jetës së tyre ku përfshihen e drejta për arsim, kujdes shëndetësor, standard të duhur jetese dhe është e detyruar që të ofrojë një mbrojtje akoma më të madhe për shtresën e të miturve në konflikt me ligjin penal ku përfshihen fëmijët e marginalizuar të e të lënë në harresë. Politikat shtetërore nuk duhet të jenë të fokusuara vetëm tek rregullimi dhe përmirësimi i drejtësisë penale, por duhet të hartojnë strategji afatgjata për parandalimin e kriminalitetit tek të miturit.

Arsimimi, edukimi me respektin ndaj ligjit dhe mbrojtja nga abuzimet apo braktisja është një nga rrugët më të suksesshme për uljen dhe parandalimin e kriminalitetit të të miturve. Mbyllja e të miturve në institucione të vuajtjes së dënimit në fakt nuk është rruga e duhur për uljen e kriminalitetit të fëmijëve. Atje ata marrin eksperiencë negative që lënë gjurmë të thella në personalitetin e tyre dhe në vend që të

dalim të rehabilituar në fakt ata marginalizohen akoma më shumë dhe braktisen tërësisht nga shoqëria. Shpesh herë ndodh që fëmijëve t'u mohohet liria për vepra shumë të vogla dhe kostoja që marrin nga dënimet penale është në fakt shumë e madhe. Në ditët e sotme vërehet një tendencë në rritje të kriminalitetit të të miturve dhe vazhdon të rritet numri i veprave penale madje dhe shumë të dhunshme që kryhen nga subjekte të mitur.

Punimi është konceptuar në mënyrë analitike duke përdorur metodën e përshkallëzimit, me deduksion, nga e përgjithshmja tek e posaçmja. Fillimisht janë analizuar elementët e konceptit fëmijë dhe kriminalitetit tek fëmijët në përgjithësi, pastaj është bërë dallimi dhe analiza e kriminalitetit të të miturve duke marrë në analizë problematikat e hasura në procedurat me të mitur. Nga pikëpamja sistematike tema do të ndahet në shtatë krerë. Në mënyrë të përmblodhur po pasqyroj përmbajtjen e çdo kreu.

Kreu i parë trajton aspektin hyrës dhe bazën metodologjike të studimit mbi të drejtat e të miturve. Analiza e këtij kreu bazohet në informimin e përgjithshëm në lidhje me objektin e studimit ku në fokus të tij janë mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe marrja e masave ligjore për të minimizuar pjesëmarrjen e të miturve në strukturat kriminale. Në këtë kre trajtohet rëndësia e studimit, kufizimet e tij, pyetjet kërkimore dhe hipotezën kryesore dhe hipotezat e tjera mbi bazën e të cilës është ngritur studimi. Themelet e projektit janë mbështetur tek metodologjia dhe llojet e metodave mbi të cilat është bazuar studimi.

Kreu i dytë trajton evoluimin e legjislacionit shqiptar në lidhje me të drejtat e fëmijëve. Në këtë pjesë trajtohen disa nga etapat legjislative më të rëndësishme në Shqipëri. Merren në analizë parashikimet ligjore në harmoni me zhvillimin kulturor të vendit në periudha të ndryshme të historisë tonë. Pasqyrohet trajtimi juridik që i bëhej të miturve në të drejtën zakonore. Në vazhdimësi trajtohet mbrojtja ligjore që u ofrohej të miturve gjatë periudhës së mbretërisë duke përfshirë të drejtat e fëmijëve në Kodin Penal mbretëror. Evidentojmë mbrojtjen e të drejtave të të miturve gjatë periudhës 1952 deri në vitin 1977. Ardhja e demokracisë pas viteve 90 solli një dimension më të gjerë të trajtimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në vendin tonë, ku si një prioritet i rëndësishëm ishte dhe përafrimi i legjislacionit ton me atë të vendeve të tjera evropiane.

Në kreun e tretë trajtohen instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve, veçanërisht për fëmijët në konflikt me ligjin penal. Kështu pas viteve 90 në legjislacionin shqiptar u integruan një sërë konventash ndërkombëtare dhe rajonale. Ndër konventat më të rëndësishme me karakter ndërkombëtar të miratuar nga OKB-ja është Konventa e Pekinit mbi të drejtat e fëmijës “Rregullat standart minimum të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të miturit e vitit 1985. OKB-ja ka miratuar edhe një sërë rregulloresh të rëndësishme si: Rregullorja e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria e vitit 1990 (Rregullat e Havanës), Rregullorja për Standardet Minimum të Kombeve të Bashkuara lidhur me masat e mos-arrestimit e vitit 1990 (Rregullat e Tokios) dhe Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e kriminalitetit e të rinjve e vitit 1990 (Udhëzimet e Riadit). Në kuadër të integritetit evropian janë ratifikuar një sërë konventash të miratuara nga Këshilli i Europës si Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Karta Sociale Europiane, Konventa Europiane mbi Ushtimin e të Drejtave të Fëmijëve, Konventa Europiane për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve dhe Trajtimeve Çnjerëzore apo Degraduese”, Konventa Evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht” ratifikuar me Ligjin nr. 8724 datë 26.12. 2000, Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar”, ratifikuar me Ligjin nr. 8499, datë 10.6.1999, Konventa e Këshillit të Evropës “Për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale” ratifikuar me Ligjin nr. 8498, datë 10.6.1999, Konventa e Këshillit të Evropës “Për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 9068, datë 15.5.2003, Konventa e Këshillit të Evropës “Për Transferimin e Procedimeve në Çështjet Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 8497, datë 10.6.1999 dhe Rekomandimi Cm/Rec 2008 (11) i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Rregullat Evropiane, për të dënuarit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve. Në kuadër të akteve të miratuara nga Bashkimi Europian janë tashme pjesë e sistemit tonë ligjor Direktiva për drejtësinë për të miturit të miratuara në Vjenë në vitin 1997 dhe Direktiva e Këshillit Ekonomik dhe Social e miratuar në vitin 2005.

Në kreun e katërt trajtohet koncepti fëmijë dhe kriminaliteti tek të miturit. Pjesë e këtij kreu është analiza në mënyrë të detajuar e shkaqeve dhe faktorëve që prodhojnë kriminalitet tek të miturit. Faktorët që ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes të të miturve në kriminalitet ndahen në faktorë të brendshëm dhe faktorë të jashtëm. Kështu si pjesë e

faktorëve të brendshëm janë personaliteti dhe karakteri i të miturit. Ndërsa si faktorë të jashtëm klasifikohen mjedisi familjar, shkolla si faktor kriminogjen, mjedisi shoqëror, migrimi , mjetet e informimit, mosha për përgjegjësi penale, veprat penale më të përhapura tek të miturit dhe gjendja dhe struktura e kriminalitetit tek të miturit. Evidentimi i këtyre faktorëve dhe analizimi i tyre na ndihmon në realizimin e një strategjie për parandalimin e kriminalitetit të të miturit.

Në kapitullin e pestë trajtohen aspektet procedurale në proceset me të mitur duke analizuar aspektet procedurale që ofrojnë mbrojtje ndaj të miturve si ndalimi/arrestimi i të miturve, trajtimi në rastet e paraburgimit të të miturve, garancitë në procesin gjyqësor ndaj të miturve dhe taktikat e marrjes në pyetje të të miturve. Në këtë kapitull trajtohen dhe sanksionet penale që parashikohen në legjislacionin bashkëkohor për të miturit subjekt aktiv në krim. Sanksionet që parashikohen ndaj të miturve janë dënimi me burgim, dënimi me gjobë , masat edukuese dhe mjekësore. Po kështu, krahas sanksioneve primare legjislacioni ynë parashikon edhe alternativat të dënimit si gjysmëliria, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë, qëndrimi në shtëpi, pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik dhe lirimi me kusht. Gjatë këtij kreu të pasqyrojmë trajtimin e të miturve në rastet e dënimit me burgim dhe risqet e dënimeve me burgim për të miturit – Recidivizmi.

Në kreun e gjashtë kemi një vështrim krahasues me legjislacionet e disa prej shteteve të rajonit dhe të Evropës. Në këtë kre trajtohen në mënyrë krahasimore parashikimet për drejtësinë e të miturve në legjislacionin kosovar, italian e francez duke marrë parasysh aspektet innovative dhe modern të këtyre legjislacioneve.

Në kreun e shtatë jepen konkluzionet dhe rekomandimet e studimit. Pas vështimit analitik të problematikave, kam nxjerrë konkluzionet dhe disa rekomandime të cilat mund të çojnë në përmirësimin e legjislacionit për të miturit në konflikt me ligjin penal dhe të ecurisë së zbatimit të tij.

KREU II: TË DREJTAT E FËMIJËVE SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

2.1.Një vështrim i përgjithshëm historik për trajtimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Zhvillimi i kriminalitetit të të miturve ka ardhur si një trend në rritje, kjo si pasojë e përfshirjes të të miturve në organizata të ndryshme kriminale me qëllim shfrytëzimin e tyre në veprimtarit kriminale. Shfrytëzimi i të miturve për veprimtari të ndryshme kriminale ka sjellë në vëmendje emergjente krijimin e një legjislacioni të përshtatshëm për luftimin dhe parandalimin e këtij fenomeni. Të drejtat e të miturve dhe konfliktet e tyre me ligjin nuk janë fenomene aktuale. Ato kanë ekzistuar që në fazat embrionale të hartimit të legjislacioneve dhe në varësi të periudhave dhe të nevojave të momentin ato kanë pësuar ndryshime pozitive. (Mucchielli,2010,1)

Kriminaliteti i të miturve përbën një nga fenomenet më të rrezikshëm dhe negative të shoqërisë moderne dhe jo vetëm. Kështu, kriminaliteti i të miturve i ka rrënjët që me krijimin e shoqërisë njerëzore. Shoqëria njerëzore në zhvillimin e saj historik i ka trajtuar të miturit në forma dhe mënyra të ndryshme në lidhje me përgjegjësinë për veprën e kryer. Në fillimet e shoqërisë njerëzore, ku ende nuk mund të flitej për ligje dhe norma ligjore, fillimisht përgjegjësia e të miturve ka qenë objektive (Hajdari,2004,37), më vonë me hartimin e normave të para ligjore ajo u shndërrua në përgjegjësi penale.

Të miturit kanë pasur një pozitë juridiko - penale më të lehtë dhe më të favorshme në krahasim me të rriturit për faktin se të miturit nuk kanë arritur pjekurinë e duhur biopsikike. (Salihu, 2005, 423) Kështu, në të drejtën romake përgjegjësia penale e fëmijëve ndahej në tre kategori.

1. Kategoria e parë është *infantil* ku bënin pjesë fëmijët që nuk kishin përgjegjësi penale
2. Kategoria e dytë është *infantiae proximus* ku bënin pjesë fëmijët afër fëmijërisë, dhe këta nuk kishin përgjegjësi penale
3. Kategoria e tretë është ajo e *pubertati proximus* bënin pjesë fëmijët të cilët ishin afër moshës për përgjegjësi penale (Xhafo ,2012, 9).

Pra, në të drejtën romake fëmijët deri në moshën shtatë vjeçare janë konsideruar penalisht të papërgjegjshëm. Kjo për faktin se në këtë moshë fëmija nuk ka arritur ende pjekurinë mendore dhe fizike dhe nuk mund të kuptojë pasojat e shkaktuara nga vepra penale e kryer. (Hajdari, 2002, 38) Përgjegjësi penale kishin personat që kanë arritur pjekurinë mendore dhe fizike, kur kanë mundur të kuptojnë rëndësinë e pasojës së ardhur nga vepra penale që ai ka kryer. Ligji i Dymbëdhjetë Tabelave parashikonte dënime të posaçme për të miturit për veprat penale të vjedhjes dhe dëmtimit të produkteve bujqësore. Dënimet për këto vepra penale ishin sipas vlerësimit të gjykatësit, rrahja ose kompensimi i dëmit. (Kombovski 2006, 1085).

Në periudhën e mesjetës vërejmë që nuk ka dispozita të veçanta që të trajtojnë të drejtat e të miturve dhe të rregullojnë në mënyrë specifike raportin e tyre me ligjin penal. Gjatë kësaj periudhe mund të themi që kemi një trajtim të përgjithshëm juridik të të miturve por nuk ka dispozita të posaçme për të miturit. Kështu, vërejmë që tortura si një nga dënimet më të ashpra ka gjetur një zbatim të ulët te të miturit deri në moshën 14 vjeç. (Salihu, 2005,14) Gjatë periudhës së mesjetës së hershme nuk flitej për përgjegjësi penale për personat nën moshën 12 vjeç, pasi veprat penale të realizuara nga të miturit konsideroheshin si të realizuara nga foshnje dhe përgjegjësia për to binte mbi kujdestarët të cilët kanë paguar dëmin e shkaktuar prej tyre. (Latifi, 1982, 36) Në këtë periudhë mosha për përgjegjësi penale ishte 12 dhe 15 vjeç. (Xhafo,2012,10) Ajo që mund të themi si përfundim për periudhën e mesjetës është se pavarësisht se nuk kanë ekzistuar dispozita të posaçme juridike dhuna dhe tortura ndaj tyre është zbatuar në përmasa më të pakta. (Salihu, 2005, 424).

Rëndësia që ka përgjegjësia penale e të miturve për të përcaktuar raportet e tyre me të drejtësinë penale doli në pah dhe u evidentua në kontekstin e duhur vetëm në shekullin e 18-të dhe shekullin e 19-të. Gjatë kësaj periudhe kishte një tendencë në rritje të mendimeve juridike që e konsideronin ndëshkimin moralisht të gabuar dhe një masë edukimi jo efektive. (Leskoviku, 2010,9) Në këtë periudhë mund të themi që shoqëria mori formën e duhur ligjore dhe pësoi një zhvillim shoqëror të konsiderueshëm, i cili u shoqëroi me rritje të përgjegjshmërisë mbi veprat penale të kryera nga të miturit.

Arritja e këtij niveli të zhvillimit njerëzor solli në vazhdimësi përmirësime të dukshme për sa i përket përmirësimit të legjislacionit në lidhje me të miturit që përfshiheshin në

veprimtari kriminale. Kështu, në fund të shekullit të 18-të pozita penale e të miturve ishte përmirësuar dukshëm në lidhje me përgjegjësinë penale. Një rol të rëndësishëm në këtë periudhë luajti instituti i *discernimentëve*. I pari që aplikoi “*discernimento*”-n ishte Cesare Beccaria (shqyrtimin, botëkuptimin, zgjidhjen) si kriter për dënimin e të miturit prej 12 deri në 14 vjeçar (Latifi, 1982, 36).

Kodi penal i Toskanës i miratuar në vitin 1786 është akti i parë ligjor i hartuar nga Cesare Beccaria, si pjesë e stafit të profesionistëve përgjegjës për krijimin e tij. Ky kod përcaktoi disa kritere të reja në lidhje me moshën për përgjegjësi penale të fëmijëve. Kodi Penal i Toskanës përjashtonte nga përgjegjësia penale fëmijët deri në moshën 12 vjeç. Ndaj të miturve të moshës 12 - 14 vjeç akordoheshin dënime në raste kur ata ishin penalisht të përgjegjshëm, por duke aplikuar masa dënuese më të buta. Ky kod e përjashtonte dënimin me vdekje të të miturit (Hajdari 2004, 40).

Instituti e “*discernimento*” e gjejmë të inkorporuar edhe në kode të tjera penale siç është Kodi Penal Francez i miratuar në vitin 1791, Kodi Penal i Napoleonit dhe në shumë kode të tjera penale të shteteve të Europës. Kodi Penal i Napoleonit i konsideronte të mitur fëmijët deri në moshën 16 dhe parashikonte dënime në rastet kur këta persona ishin penalisht të përgjegjshëm, duke aplikuar masa ndëshkimore më të buta për shkak të moshës së tyre dhe papjekurisë mendore dhe fizike. Në Kodin Penal të Napoleonit përcaktoheshin masa të posaçme penalo-juridike, me qëllim përmirësimin dhe riedukimin e këtyre të fundit, në rastet kur konstatohej se i mituri kishte pasur aftësi për ta kuptuar rëndësinë e veprës penale të kryer. (Hajdari, 2004, 40).

Në shekullin e XX kemi ndikimin të shkollës sociologjike në hartimin e legjislacioneve penale. Në këtë periudhë u rrit rëndësia e përcaktimit të moshës për përgjegjësi penale të të miturve dhe trajtimit të tyre duke ndërmarrë një sërë masash të posaçme ndaj të miturve që kryenin vepra penale. Kështu, konsideroheshin *maxhorenë* (madhorë) personat që kishin mbushur moshën 18 vjeç dhe konsiderohen penalisht të papërgjegjshëm fëmijët të cilat nuk kanë mbushur moshën 14 vjeçare në momentin e realizimit të një vepre penale. Ndërsa prej moshës 14-18 vjeç janë konsideruar të mitur.

Në vitet tridhjetë të shekullit XX, në shumicën e legjislacioneve penale u përqafuan masat edukuese, si lloje të posaçme të sanksioneve penale (Salihu, 2005, 15) “Zhvillimi

i shkencave të mjekësisë, psikologjisë dhe psikiatrisë i hapi rrugë një këndvështrimi të ri në lidhje me kriminalitetin e të miturve, si dhe masave për trajtimin e tyre. Pra, fillon të krijohet një doktrinë e re e masave ndëshkimore e cila ka në thelb të saj interesin e të miturve, të bazuar mbi teorinë e *parents patria* (Xhafo, 2012, 11)

Nevoja për sanksionim të posaçëm të pozicionit të të miturve në raport me drejtësinë penale dhe mbrojtje e të drejtave të tyre solli domosdoshmërisht krijimin e institucioneve të specializuara për trajtimin e tyre. Kështu, thuajse në të gjitha shtetet bashkëkohore janë themeluar gjykatat e posaçme për të miturit të cilat merren me gjykimin e të miturve të përfshirë në veprimtari kriminale, gjithashtu janë krijuar dhe institucionet para gjykatës siç janë policia dhe prokuroria që kanë një rol mjaft të rëndësishëm në aspektin procedural. Në Shqipëri ende nuk ekziston akoma një sistem i tillë gjyqësor, pavarësisht se ka pasur ndryshime dhe përmirësime përsa i përket trajtimit të të miturve që kryejnë vepra penale, por ka ende shumë për të bërë drejt përputhjes me standardët ndërkombëtare për dhënien e drejtësisë për të miturit.

2.2. Mbrojtja dhe trajtimi juridiko penal i të drejtave të fëmijëve në legjislacionin Shqiptar.

2.2.1. Të drejtat e të fëmijëve në të drejtës zakonore

E drejta zakonore përbënë bazën embrionale mbi të cilën u mbështet sistemi i mëvonshëm ligjor. E drejta zakonore shqiptare nuk u krijua nga një sistem legjislator apo nga institucione të mirëfillta ligjore, ajo është një tërësi normash të pashkruara e cila është transmetuar gojarisht brez pas brezi për 500 vjet.¹ E drejta zakonore shqiptare ka shërbyer për rregullimin e marrëdhënieve juridike për një periudhë të gjatë kohore në vendin tonë. (F.Elezi,2-3). E drejta zakonore ka edhe pjesën e saj të “kodifikuar” e cila përbëhet nga kanunet² e ndryshme që kanë funksionuar në disa krahina të Shqipërisë. Ndër kanunet më të rëndësishme si pjesë e të drejtës zakonore do të përmendim :

¹ Shih http://www.academia.edu/8604116/E_Drejta_Zakonore_Shqiptare

² Kanuni është [ligji](#) apo përmblendhje e ligjesh dhe normash të pashkruara, të trashëguara në mënyrë gojore, që pasqyrojnë gjendjen ekonomike-shoqërore të periudhave të kaluara dhe që në kohën e vet mbronin interesat e klasave e të shtresave të caktuara shoqërore, si dhe tërësia e normave të së drejtës zakonore . Prejardhja e termit “Kanun” siç dihet, ka ngjallur diskutime ndërmjet autorëve të ndryshëm

1. Kanuni i Lekë Dukagjinit,³
2. Kanuni i Skënderbeut. (kanuni i Arbrit)
3. Kanuni i Labërisë
4. Disa kanune të tjera

Kanunet e mësipërme konsiderohen si burime kryesore të së drejtës zakonore shqiptare. E drejta zakonore penale, si degët e së drejtës zakonore, është krijuar dhe ka vepruar në truallin shqiptar si e drejtë e pashkruar. E drejta zakonore penale ka qenë e lidhur ngushtë me fenë si pjesë e rëndësishme e shoqërisë së asaj periudhe dhe në bashkëpunim me të ka vepruar për parandalimin e kriminalitetit. (A.Hoxha, 2011,25) Nëpërmjet studimit të së drejtës zakonore shqiptare ne eidentojmë një anë të veçantë të jetës shoqërore të së kaluarës se popullit tonë, kryesisht të zonave malore ku e drejta zakonore ka mbijetuar më gjatë dhe ka vepruar për rregullimin e marrëdhënieve shoqërore.(E. Elezi, 2013:,9) Në periudhën Ilire ndaj të miturve që përfshiheshin në aktivitet kriminale, ka ekzistuar një kujdes i veçantë nga ana e shoqërisë, që më tepër se në elementët ligjore, bazohet në tradita zakonore dhe rregulla shoqërore (Xhafo, 2012, 21) Gjatë kësaj periudhe krahas normave juridike kanë qenë të zbatueshme dhe normat zakonore. Duke qenë se në krahina të tëra malore nuk mundi të hyjë tërësisht ndikimi i administratës turke, vepruan kanunet (Papandile 2000,65) Këta kanune pasqyrojnë normat penale të mbledhura gjatë shekujve për të treguar karakteristikat e kohës në të cilën janë mbledhur. Ato tregojnë zhvillimin ekonomiko-shoqëror, të cilësive e veçorive historike e sociale-shoqërore, kulturore- psikologjike të kohës

Mungesa e pushtetit qendror në zonat malore evidentonte nevojën e përdorimit të normave ligjore si rregullator të marrëdhënieve shoqërore dhe nisur nga ky fakt, gjente zbatim e drejta zakonore shqiptare. Organi gjyqësor në kanunin e Lek Dukagjinit ishte

shqiptarë. At Gjergj Fishta në parathënien dinjitoze të Kanunit të Lekë Dukagjinit shprehet se “rrjedh nga greqishtja e vjetër “Anon” që u përhap edhe në gjuhë të tjera”. Shih <https://sq.wikipedia.org/wiki/Kanuni>
³Kanuni i Lekë Dukagjinit është përmbledhje normash dhe dokesh shqiptare me karakter juridiko-social . Kanuni ka funksionuar si një sistem vetëqeverisës që mbizotëronte në viset e malësive të Shqipërisë së Veriut në kohën kur rajoni sundohej nga [Perandoria Osmane](#). Kanuni ka një rëndësi themelore në historinë e popullit shqiptar sepse konsiderohet si një ndër aktet me të rëndësishme të së drejtës zakonore, por edhe për faktin që aktualisht normat e tij vazhdojnë ende të ushtrojnë një ndikim të ndjeshëm ndër shqiptarët që jetojnë në [Shqipëri](#) dhe [Kosovë](#), si edhe në vendet tjera në të cilat kanë shtegtuar shqiptarët. Shih https://sq.wikipedia.org/wiki/Kanuni_i_Lek%C3%AB_Dukagjinit

Këshilli i Pleqve i cili përbëhej nga krerët e fiseve si dhe nga njerëzit e mençur dhe të ndershëm të asaj kohë. Në normat e pjesës së posaçme të së drejtës zakonore penale sipas Kanuneve, ishin parashikuar disa vepra penale si:

- 1) Veprat penale kundër personit.
- 2) Veprat penale kundër familjes e martesës.
- 3) Veprat penale kundër pronës private
- 4) Veprat kundër kishës
- 5) Vepra penale të tjera.

Në varësi të veprave penale të mësipërme parashikoheshin edhe llojet e dënimeve. Llojet e dënimeve sipas kanuneve ishin

- 1) gjakmarrja
- 2) dënimi me vdekje
- 3) dëbimi
- 4) djegia e shtëpisë
- 5) rrëmbimi i pasurisë etj.

Edhe pse Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe Kanuni i Skënderbeut ishin një tërësi normash të realizuara jo nga persona përgjegjës për hartimin e tyre por nga individ të cilët në bazë të njohurive konsideronin disa veprime si të dëmshme për marrëdhëniet shoqërore, duhet të theksojmë që kanë trajtuar ndër të tjera edhe të drejtat e të miturve. Në lidhje me pozitën juridiko penale të të miturve kanunet përmbajnë pak norma penale për të miturit të cilët kryenin vepra penale, por që janë të rëndësishme për të evidentuar fillimet e trajtimit të tyre në mënyrë të veçantë qysh në krye të herës. Sipas normave të së drejtës zakonore shqiptare subjekt i krimit konsiderohej personi që arrinte moshën e caktuar. (Hajdari, 2004, 43)

Kanunet nuk e përcaktonin moshën për përgjegjësi penale por në mënyrë indirekte linin të kuptohej së ajo fillonte me të ashtuquajturën aftësi për të mbajtur armën. Në kanun përcaktohet se përgjegjësia për veprat e kryera nga të miturit i binte kryefamiljarit. Kështu në Kanunin e Lekë Dukagjinit përcaktohej se *“Fmit, bracet e biramelat, edhë ne u gjeshin me bracni në dorë, dora e huej nuk munda t’i përkasë (nuk*

mùnd t'i rrafë),por do të bahen me dije prîndja, e këta do të përgjigjen per'ta.”⁴. Po kështu, në pikën 774 të këtij kanuni përcaktohet se “Çdo dâm, viedhni e bracni të bame prej fmîsh, bracash e biramelash, po u hetuen, shpija, së cîllës i perkasin, do t'a lajn.”⁵

Disa kanune të tjera bënin përjashtime në lidhje me përcaktimin e moshës për përgjegjësi penale. Kështu në Kanunin e Kastratit të vitit 1882, thuhej se personi merret në përgjegjësi penale për fyerje, nëse ka mbushur moshën 15 vjeç kurse për dëmtimin e mullirit, nëse ka mbushur moshën 12 vjeç (Xhafo, 2012, 22) Kjo nënkupton që personat 12 vjeç në të drejtën zakonore konsideroheshin të papërgjegjshëm edhe pse kjo nuk thuhet shprehimisht. Në lidhje me sanksionimin e dënimeve ndaj të miturve dihet të themi qenë të drejtën zakonore nuk kishte sanksione ndaj të miturve duke qenë se përgjegjësia binte mbi kryefamiljarin. (Sufaj,2012) Duhet marrë në konsideratë fakti që edhe pse në shumë kanune nuk gjenden norma të cilat trajtojnë përgjegjësinë penale për të miturit për shkak të karakterit të fortë social dhe familjar në këto zona, ato kanë ndikuar pozitivisht në shmangien e kriminalitetit të të miturve.

2.2.2. *Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve sipas Kodit Penal mbretëror*

Shqipëria u shpall “Mbretëri demokratike, parlamentare e trashëgueshme” në 1 shtator 1928. Menjëherë pas ndryshimit të regjimit politik u punua për hartimin e akteve të ndryshme ligjore ku ndër to ishte dhe Kodi Penal i cili hyri në fuqi më 1 janar 1928.⁶ Përpara hyrjes në fuqi të KP-së konfliktet ligjore gjen zgjidhje në kodin penal Osman të vitit 1878. (Sufaj, 2012, 11) Kodi penal i shtetit shqiptar është ndërtuar sipas modelit të kodeve penale të shteteve europiane, e konkretisht, duke pasur si model kryesor Kodin penal të Italisë të vitit 1889, si dhe legjislacionin penal të shteteve të tjera të Europës për disa institute që nuk i përmbante Kodi penal i Italisë. (E.Elezi 2013,29)

⁴ Shih pikën 776 të Kanunit të Lekë Dukagjinit

⁵ Shih pikën 774 të Kanunit të Lekë Dukagjinit

⁶ Mbretëria Shqiptare u krijua në vitin 1928 ku kryetari i Republikës Shqiptare Ahmet Zogu u shpall nga parlamenti Zog I, Mbret i Shqiptareve. Mbreti mori nëpërmjet parlamentit të asaj kohe shumë çifligje dhe para por ai i ktheu serish pjesën më të madhe. Shih : https://sq.wikipedia.org/wiki/Mbret%C3%ABria_Shqiptare

Kodi përbënte një risi në fushën ligjore si dhe në procesin shtet formues. Kodi Penal i Mbretërisë krahas veprave penale sanksiononte edhe raportin e të miturve me ligjin penal. (Xhafa. 2012, 23) Kështu, në nenin 1 të këtij kodi parashikohej parimi se *“Askush nuk mund të dënohet për një vepër që ligji nuk e ka parashikuar si krim dhe as të dënohet me dënime që nuk janë caktuar me ligj”*. Dënimet për veprat penale që parashikoheshin në Kodin Penal ishin:

- 1) vdekja,
- 2) burgimi dhe burgimi i përjetshëm,
- 3) internimi
- 4) gjoba e rëndë,
- 5) ndalimi nga ofiqët bublike.

Përpos dënimeve kryesore Kodi Penal parashikonte edhe dënime alternative të cilat aplikoheshin kryesisht të gratë dhe tek të miturit. Kështu, nuk aplikoheshin dënime me vdekje, me burgim të përjetshëm, ndaj personave që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kishin mbushur moshën 15 vjeç. Në rast se i mituri kishte konsumuar një vepër penale e cila parashikon një nga dënimet e mësipërme atëherë prokurori mund të kërkonte trupi gjykues mbylljen e të miturit në një institucion edukimi dhe rehabilitimi, kur ekzistojnë të tilla. Nëse periudha e dënimit të të miturit në institucionin e edukimit do të zgjaste deri në moshën njëzet vjeç, atëherë prokurorit i lindte e drejta që të kërkonte revokimin e vendimit dhe dënimin e tij për pjesën tjetër të dënimit në burg⁷. Kodi Penal parashikonte në nenin 22 të tij që në rastet e dënimit me burgim të lehtë deri në dhjetë ditë për të miturit nën tetëmbëdhjetë vjeç dhe për gratë, nëse ata nuk janë recidivistë, gjykata mund të vendoste vuajtjen e dënimit në banesat e tyre.⁸

Kodi Penal në nenin 27 parashikonte qortimin gjyqësor si një alternativë ndaj dënimit me burgim jo më shumë se një muaj, burgimit të lehtë, dënimit me internim, jo më shumë se tre muaj si dhe të dënimit me gjobë të rëndë, jo më shumë se treqind franga ari. Qortimi gjyqësor do të aplikoheshin në rastet e rrethanave lehtësuese dhe fajtori

⁷ Shih nenin 54 të Kodit Penal të Mbretërisë së Shqipërisë të vitit 1927.

⁸ Shih nenin 22 të Kodit Penal të Mbretërisë së Shqipërisë të vitit 1927.

nuk kishte qenë ndonjëherë i dënuar me parë për ndonjë krim ose kundërvajtje të dënueshme jo më shumë se një muaj burgim.⁹

Përgjegjësia penale sipas Kodit Penale të Mbretërisë fillon në moshën 10 vjeçare. Kështu në nenin 54 të KP-së përcaktohej se përjashtohej nga përgjegjësia penale personi që në kryerjen e krimit nuk kishte mbushur moshën 10 vjeç¹⁰ por jo të miturit që kishin mbushur moshën 15 vjeç dhe ata që nuk kishin aftësi mendore. Për të miturit e grup moshës të 10-15 vjeç të cilët kishin aftësi mendore për të kuptuar rëndësinë e veprës penale kodi penal përcaktonte këto rregulla:

- a. Në vend të ndëshkimit me vdekje ose me burgim të përjetshëm caktohej burgimi nga gjashtë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
- b. Kur ndëshkimi është mbi dymbëdhjetë vjet, jepet dënimi nga tre deri në dhjetë vjet; kur ndëshkimi kalon gjashtë vjet por jo dymbëdhjetë vjet jepej dënimi nga një deri në pesë vjet, në rastet e tjera jepej më pak se gjysma e dënimit e parashikuar.
- c. Dënimet me gjobë zbriteshin me një të tretën
- d. Ndëshkimet me gjobë zbriten në një të dytën¹¹
- e. Këto dënime do të kryheshin në institucione për të miturit¹²

Kodi Penal i mbretërisë për të miturit e moshës 15-18 vjeç parashikonte dënimet si:

- 1) Në vend të ndëshkimit me vdekje ose me burgim të përjetshëm jepej një dënim me burgim nga dymbëdhjetë deri në njëzet vjet.
- 2) Kur ndëshkimi është mbi dymbëdhjetë vjet, jepet dënimi nga gjashtë deri në dymbëdhjetë; në rast se dënimi i kalon tre vjet por jo dymbëdhjetë vjet jepet dënimi nga tre deri në gjashtë vjet, në rastet e tjera ndëshkimi zbritët deri në gjysmën.
- 3) Ndëshkimeve me gjobë u zbritët një e treta.
- 4) Në rastet e heqjes së lirisë personale të miturit vendoseshin në institucione përmirësimi. (kodi penal neni 56)

⁹ Shih nenin 27 të Kodit Penal të Mbretërisë së Shqipërisë të vitit 1927.

¹⁰ Shih nenin 54 të Kodit Penal të Mbretërisë së Shqipërisë të vitit 1927.

¹¹ Shih nenin 48 të Kodit Penal të Mbretërisë së Shqipërisë të vitit 1927.

¹² Shih nenin 55 të Kodit Penal të Mbretërisë së Shqipërisë të vitit 1927

Një trajtim i veçantë në këtë kod i bëhej personave shurdh-memec të mitur. Kështu, në nenin 57 të kodit penal përcaktohej se: *“Nuk mund të bëhet ndjekje penale kundër personit shurdh- memec, i cili në kohën kur ka kryer veprën penale nuk ka mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç.”* Bazuar në nenin 57 të KP-së kjo kategori subjektesh të veprave penale do të vuanin dënimin e tyre në një institucion riedukimi ose nën kujdesin e prindërve apo kujdestarit deri sa të mbushnin moshën njëzet e katër vjeç. Në nenin 58 të Kodit Penal për ato persona shurdh- memecë të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kishin mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç, por nuk kishin aftësinë mendore për të kuptuar pasojën nuk ndëshkoheshin. Për këtë kategori nëse dënimi ishte me vdekje, burgim të përjetshëm, dënim me burgim të rëndë apo me burgim jo më pak se një vit do aplikoheshin e njëjta masë duke i vendosur në një institucion riedukimi ose nën kujdesin e prindërve apo kujdestarit deri sa të mbushnin moshën njëzet e katër vjeç. Në rast se këta persona kishin aftësinë për të kuptuar pasojat e ardhura nga vepra penale e kryer atëherë për këta do aplikoheshin masat favorizuese të të miturve normal.¹³

Si konkluzion, Kodi Penal mbretëror solli disa risi pozitive dhe favorizuese për sa i përket trajtimit të të miturve. Kështu Kodi Penal:

- I. bëri klasifikimin dhe grupimin e të miturve përsa i përket grup moshave 10-15 dhe 15-18 vjeç
- II. caktoi moshën për përgjegjësi penale edhe pse ishte një moshë relativisht e ulët (10 vjeç)
- III. ai i përjashtonte nga dënimi me burgim të përjetshëm, burgimi i përjetshëm dhe burgimi i rëndë përjashtoheshin për personat e mitur.
- IV. Një rëndësi të veçantë kishin dispozitat mbi përgjegjshmërinë dhe papërgjegjshmërinë mendore duke bërë favorizimet e duhura.
- V. Mjaft pozitiv ishte përjashtimi nga dënimi dhe vendosja në një institucion riedukimi për personat e mitur nën 15 vjeç.
- VI. Një aspekt mjaft pozitiv i këtij kodi ishte parashikimi i një dispozite të veçantë për të miturit shurdh-memec parashikim i cili solli një rritje të moshës për përgjegjësi penale duke përcaktuar moshën 15 vjeç duke i përjashtuar nga dënimi me burgim.

¹³ Shih nenin 58 të Kodit Penal të Mbretërisë së Shqipërisë të vitit 1927.

Risite e mesipërme ishin të mirëpërcaktuara dhe fare lehtësisht mund të gjenin zbatim në praktikë. Duke i trajtuar të miturit në mënyrë të diferencuar ishte më e lehtë të përmirësoheshin dhe të implementoheshin në shoqëri.

2.2.3. Trajtimi juridik i të drejtave të fëmijëve sipas Kodit Penal në vitet 1952-1953

Periudha e viteve 1952-1953 konsiderohet si periudha e sistemit politik totalitar në Shqipëri, sistem i cili pati një ndikim negativ në lidhje me përmirësimin e legjislacionit penal. Gjatë kësaj periudhe shteti totalitar e përdori drejtësinë penale për të mbrojtur pushtetin dhe për të goditur kundërshtarët politik. Kodi penal i vitet 1952-1953 vazhdoj të kishte si bazë Kodin Penal të vitit 1928 duke u pasuruar me dekrete të veçanta të mëvonshme të cilat do të inkorporoheshin si pjesë e këtij kodi. Kështu, në vitin 1952 hyri në fuqi Kodi Penal i ri i cili vendosi në plan të parë krimet politike – kundër shtetit duke mos sjellë ndonjë risi në fushën e të drejtave të të miturve. (E.Elezi, 2013:32)

Kështu në kodin penal të vitit 1952 përcaktohet se mosha për përgjegjësi penale ishte mosha 14 vjeç. Ky kod parashikonte se mosha për përgjegjësi penale ishte 12 vjeç për krime të veçanta si:

- 1) krimet kundër shtetit,
- 2) vrasja,
- 3) plagosja,
- 4) vjedhja,
- 5) grabitja,
- 6) dëmtimi ose shkatërrimi i pasurisë dhe veprat që mund të shkaktonin përplasjen ose përmbysjen e trenave. (N.Peza, 1968, 29)

Nga analizimi i rasteve të veprave penale të kryera nga të miturit u evidentua se të miturit e moshës 12-14 vjeç nuk realizonin vepra penale kryesisht të influencuar nën ndikimin e të rriturve. Në këto kushte legjislatori i kësaj periudhe vendosi që të hiqej mosha 12 për përgjegjësi penale dhe për të gjitha rastet, në mënyrë të unifikuar të vendosej si moshë për përgjegjësi penale mosha 14 vjeç.

Në vitin 1953 u aprovua me ligjin Nr 1650 datë 30.03.1953 Kodi i procedurës penale të Kuvendit popullor. Ky kod përbëhej nga 364 nene dhe hyri në fuqi në datë 01.06.1953. Kodi i Procedurës Penale i është nënshtruar disa ndryshimeve me ligjin Nr 1776 datë 03.12.1953 dhe me ligjin Nr 2805 datë 04.12.1958, dhe ka qenë në fuqi deri në datë 01.04.1980 (F. Elezi, 2012, 24,). Në këtë Kod u përcaktuan për herë të parë në mënyrë të qartë rregullat procedurale penale që rregullonin procesin penal. Disa nga garancitë procedurale të parashikuara në këtë kod për të miturit ishin:

- a. Gjykimi i çështjes me dyer të mbyllura¹⁴
- b. Garantimi i mbrojtjes së detyrueshme ligjore¹⁵

Në lidhje me arrestin si masë sigurimi Kodi i Procedurës Penale parashikonte që organi që merrte vendimin duhet të kishte në konsideratë moshën e personit si dhe kushtet familjare. Gjatë kësaj periudhe vlen të evidentohet fakti që kemi një interesim progresivisht në rritje të specializimit të strukturave që trajtojnë çështjet e të miturve, të cilat nuk kufizoheshin vetëm në gjykatë, por shtriheshin edhe tek organet e procedimit penal. Ky kod nuk parashikonte rregulla të posaçme përsa i përket marrjes në pyetje të të pandehurve të mitur.

2.2.4. Të drejtat e fëmijëve sipas Kodit Penal të vitit 1977

Me miratimin e Kushtetutës së vitit 1976 pushoi së vepruari Kodi Penal i vitit 1953 i cili veproi deri në vitin 1977¹⁶, për t'i mundësuar veprimin e Kodit të ri Penal të hartuar mbi bazën e dispozitave të Kushtetutës së vitit 1976. Kodi Penal i vitit 1977 përbente një kthesë regressive në legjislacionin shqiptar, duke zëvendësuar parimet kryesore të Kodit Penal të vitit 1952, të cilat përqendroheshin kryesisht tek mbrojtja e pushtetit politik. (E.Elezi.2013:33) Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë përbëhej nga tri pjesë:

- 1) Pjesa e përgjithshme
- 2) Pjesa e posaçme

¹⁴ Shih nenin neni 7 paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale të viti 1953.

¹⁵ Shih nenin neni 58 i Kodit të Procedurës Penale të viti 1953.

¹⁶ Kodi u miratua me Nr. 5591, datë 15.6.1977 dhe hyri në fuqi me 1 tetor 1977.

3) Krimet dhe kundërvajtjet penale

Burimi kryesor ligjor i Kodit penal ishte Kushtetuta e vitit 1976. Nisur nga fakti që Kushtetuta e vitit 1976 ishte tërësisht e politizuar edhe Kodi Penal ishte i politizuar. Kodi Penal iu servir qytetarëve si një akt ligjor me një shkallë të lartë zhvillimi dhe demokratizimi të legjislacionit penal. Në legjislacionin penal, me hartimin e tij, ishte bërë një hap mbrapa në krahasim me Kodin Penal të vitit 1952. Problematikat dhe disavantazhet që solli kodi penal i vitit 1977 ishin si vijon:

- I. Hoqi lirimin para kohe me kusht,
- II. U hoq parashikimi i ndjekjes penale dhe i dënimit për krimet, duke e lënë këtë institut vetëm për kundërvajtjet.
- III. U zgjerua shumë kuptimi i krimeve kundër shtetit, sidomos i tradhtisë ndaj atdheut. (Hoxha,2011,28).
- IV. Kodi Penal ashpërsoi masat dhe llojet e dënimeve penale me qëllim që të goditeshin kundërshtarët politikë të regjimit.¹⁷Në 33 nene të Kodit Penal parashikohej dënimi me vdekje. Kurse dënimi me heqje lirie (burgim) thuajse shoqëronte çdo vepër penale.

Hartimi i këtij kodi mbi bazë të ideologjisë dhe politizimit bëri që ai të konsiderohej në kundërshtim me normat e të drejtës ndërkombëtare, kjo edhe për faktin që dënimet realizohen “si një mjet shtrëngimi me karakter politik e ideologjik i shtetit socialist në luftën kundër klasave” (Xhafo,2012, 34) Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë ka favorizuar pozitën e të miturve në raport me drejtësinë dhe problemet penale. Kështu, sipas këtij kodi mosha për përgjegjësinë penale ishte 14 vjeç. Kodi përjashton nga dënimi me vdekje personat që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kishin mbushur moshën 18 vjeç¹⁸

Në nenin 21 të Kodit Penal përcaktohej se personi që në kohën e kryerjes së veprës penale, nuk kishte mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, nuk mund të dënohej më shumë se sa gjysma e dënimit që kishte parashikuar ligji për veprën penale dhe po në këtë dispozitë thuhej që të miturit dënimin me heqje lirie e vuanin në mjedise të veçanta. Në lidhje me masat edukuese kodi përcaktonte që, masat edukuese duhet të

¹⁷ Shih nenin 33 të Kodit Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të vitit 1977

¹⁸ Shih nenin 21 paragrafi 2 të Kodit Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të vitit 1977

ishin të njëjtat me ato që parashikonte kodi penal i vitit 1952 por me disa ndryshime të vogla të cilat pasqyronin situatën politike e ideologjike të tij. Kështu masat mjekësore të parashikuara në këtë kod ishin:

- I. vendosja e të miturit në një institucion edukimi dhe
- II. lënia e personit për edukim kolektiv dhe organizatave shoqërore¹⁹.

Hapi i parë pozitiv në lidhje me rehabilitimin e personave të mitur që kishin kryer vepra penale ishte hapja e shkollës së riedukimit të të miturve në dhjetor të vitit 1986. Në këtë shkollë do të kryenin dënimin të miturit e moshës 14-18 vjeç, të cilët kishin marrë dënime nga gjykata dhe të miturit nën moshën 14 vjeç të cilët vendoseshin në shkollë me vendim të komisionit të ndjekjes së krimeve pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Programi edukativ që ofronte kjo shkollë ishte arsimimi i detyruar dhe profesional i të miturve dhe organizimi i tyre në punë, kryesisht në bujqësi. Shkolla e riedukimi u mbyll në vitin 1991. (F.Sufaj, 2011, 65).

Kodi përcaktonte si dënime alternative të dënimit me burgim për të miturit riedukimi nëpërmjet punës, gjoba, dhënia e dënimeve plotësues si dënime kryesore. Në nenin 34 të Kodi Penal të miturit të cilët nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç përjashtohen nga dënimi në rastet:

- a. kur, për shkaqe të arsyeshme, nuk ishte në gjendje të kuptonte plotësisht se vepra e tij ishte shoqërisht e rrezikshme;
- b. kur kishte kryer një vepër penale me rëndësi të vogël, duke u ndodhur në gjendje tronditje psikike, nën ndikimin e një tjetri ose në rrethana të rastit;
- c. kur çmohej se masat edukuese ia arrinin qëllimit për edukimin e tij.

Vlen të theksohet fakti që Kodi Penal i viti 1977 bëri disa përpjekje në lidhje me programet riedukuese duke synuar rehabilitimin e të miturit dhe kthimin tij në një individ të dobishëm dhe me rrezikshmëri më të ulët shoqërore.

2.2.5. *Ndryshimet legjislative pas viteve 1990. Një vështrim i shkurtër.*

¹⁹ Shih nenin 28 të Kodit Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të vitit 1977

Përmbysja e shtetit totalitar, kalimi në pluralizmin politik dhe zhvillimet politike, ekonomike, sociale, kulturore që shoqëruan shoqërinë shqiptare dhe shtetin shqiptar pas viteve '90, u reflektuan në mënyrë të drejtpërdrejtë në qëndrime institucionale të caktuara në lidhje me të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të miturve në veçanti. Kështu, pas rënies së regjimit komunist drejtësia shqiptare ishte e papërgatitur për t'u përballur me sfidat e momentit dhe më zhvillimin që kishte marrë kriminaliteti në përgjithësi dhe ai i të miturve në veçanti. E gjendur në këto kushte ishte e domosdoshme reformimi rrënjësor i sistemit të drejtësisë penale. Ky reformim duhet të prekte konkretisht legjislacionin penal e procedural penal, organizimin e sistemit gjyqësor, të prokurorisë, të policisë gjyqësore, avokatisë dhe të institucioneve të vuajtjes së dënimeve (burgjet). (E.Elezi.2013:34)

Reforma në sistemin ligjor në tërësi dhe ajo penale në veçanti solli ndryshime përse i përket trajtimit të veçantë të të miturve duke u bazuar në standardet ndërkombëtare. Fillimi i kësaj reforme në kontekstin e temës sonë konkretizohet me:

- a. Miratimin e dispozitave kushtetuese dhe e paketës mbi të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve dhe
- b. Ratifikimin e Konventës së OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve e dt. 27 shkurt 1992 (F.Sufaj; 2011).

Kodi i ri Penal në lidhje me të drejtat e të miturve dhe trajtimin e tyre penal është hartuar duke marrë në konsideratë nenet e Konventës së OKB mbi të Drejtat e Fëmijës. Miratimi i Kodit Penal dhe i Kodit të Procedurës Penale shënoi një hap të rëndësishëm në drejtësinë shqiptare. Kodi i ri penal u miratua me Ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995 dhe hyri në fuqi në 1 qershor 1995. Kodi solli disa ndryshime në lidhje me trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin. Kështu, në lidhje me moshën për përgjegjësi penale, Kodi penal përcaktoi moshën 14 vjeç për vepra penale dhe 16 vjeç për kundravajtje penale, duke realizuar kështu për herë të parë ndarjen e përgjegjësisë penale në varësi të rëndësisë së veprës penale. Në këtë kod u inkorporuan disa masa të veçanta ndaj të miturve, duke përcaktuar edhe moshën madhore për përgjegjësi penale d.m.th. moshën 18 vjeç. Kështu, u përcaktua që deri në moshën 14 vjeç të miturit konsiderohen fëmijë, kurse prej moshës 14 deri në moshën 18 vjeç të miturit janë penalisht përgjegjës dhe përgjigjen kur veprojnë me vetëdije. (Latifi, 1982, 45)

Legjislacioni penal i kësaj periudhe nuk parashikonte masa ndaj të miturve të moshës 14 vjeç që kryenin vepra penale, as kur një kundravajtje është kryer nga një fëmijë në moshën 15 vjeç. Kjo mund të influencojë që të miturit e kësaj moshe të përfshihen në veprimtari penale dhe të përjashtohen nga përgjegjësia penale. Në lidhje me alternativat e dënimit me burgim që kanë si qëllim shmangien e të miturit nga dënimi me burgim janë bërë ndryshime të rëndësishme. Ligji nr 10023 datë 27.11.2008 reformoi të gjithë sistemin e dënimeve alternative të dënimit me burgim duke e përafruar me kodet penale të vendeve të huaja. (Xhafa,20012,42). Në Kodin Penal të vitit 1995 u parashikuan si dënime alternative

- I. Lirimi me kusht
- II. Qëndrimi në shtëpi

Krahas risive pozitive që solli Kodi i ri Penal ai kishte edhe mangësi në lidhje me aspektin edukues të të miturve të përfshirë në vepra penale. Kështu, krahasuar me kodet penale të mëparshme ku masat edukuese ishin më të shumta, kodi i ri penal ka vetëm një lloj mase edukuese, atë të vendosjes në një institucion edukimi e cila në praktikë nuk gjen zbatim për faktin se këto institucione nuk ekzistojnë në vendin tonë.

Instrumentet ligjore që disponojmë aktualisht janë të hartuara në funksion të mbrojtjes së të drejtave të të miturve dhe rregullimit të pozitës së tyre ligjore para drejtësisë penale. Kështu, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e hartuar në vitin 1998, edhe pse nuk i trajton drejtpërdrejtë mbrojtjen e fëmijëve ajo garanton mbrojtje për çdo qytetar duke përfshirë të rritur dhe të mitur. Në nenin 25 i Kushtetutës përcaktohet se *“askush nuk duhet t’i nënshtrohet torturave, dënimeve apo trajtimeve mizore, çnjerëzore apo poshtëruese”*. Në nenin 54 paragrafi 1 të Kushtetutës sanksionohet e drejta për mbrojtje të veçantë nga shteti, ndërkohë që paragrafi 3 i të njëjtit nen, nënvizon se çdo fëmijë ka të drejtë të mbrohet nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi i tyre për punë.²⁰

²⁰ Shih nenin 51 paragrafi 1.2 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se *“Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. 2. Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesa. 3. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal “.*

Instrumente të tjera ligjore të cilat ofrojnë mbrojtje ndaj të miturve janë Kodi i familjes, Ligji kundër Dhunës në Familje dhe Ligji Nr. 8733, neni 128/b ”Mbi trafikimin e fëmijëve. Pas miratimit të Kushtetutës në vitin 1998 janë miratuar edhe disa ligje të tjera të rëndësishme të cilat kanë kompletuar edhe më shumë kornizën ligjore për të miturit, si ligji nr 8328 datë 16.04.1998 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve dhe të Paraburgosurve”, Ligji 8331 datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale”, ligji nr 8677 datë 02.11.2000 “Për Policinë Gjyqësore”, ligji 8678 datë 14.05.2011 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”.

Ligjet e reja dhanë ndihmesën e tyre që sistemi i drejtësisë për të miturit të ishte gjithmonë e më shumë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në kuadër të këtyre reformave ligjore duhet të përmendim edhe ligjin me nr. 8465 datë 11.03.1999, “Për Ndërmjetësimin dhe Zgjidhjen me Pajtim të Mosmarrëveshjeve” dhe më pas ligjin nr .9090 datë 26. 06.2003 “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” ligj ky që e shfuqizoi të parin, nëpërmjet të cilit është sanksionuar në legjislacionin shqiptar instituti i ndërmjetësimit për çështjet penale.

Një nga risitë që solli Kodi i ri Penal ishte krijimi në gjykata i seksioneve të veçanta, si një nevojë emergjente e evidentuar mbas miratimit të Kodit të Procedurës Penale të vitit 1995. Seksionet që trajtonin çështjet e të miturve u themeluan me dekret të presidentit në gjashtë gjykata të rretheve gjyqësore në vitin 2007 (Leskoviku, 2011,38) Ndër aspektet e tjera të rëndësishme përse i përket trajtimit të të miturve në këtë kod penal është mbrojtja e detyruar ligjore për të pandehurin e mitur i cili nuk ka mbushur moshën 18 vjeç si dhe garantimin e asistencës juridike dhe psikologjike në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me qëllim mos ndërprerjen e procesit edukativ.

Në vitet e fundit kujdesi për mbrojtjen e fëmijëve ka zënë një vend gjithnjë e më të rëndësishëm në politikat shtetërore. Kështu, përveç ligjeve janë hartuar dhe miratuar akte të tjera që trajtojnë mbrojtjen e fëmijëve si fokus kryesor dhe si pjesë të një objekti më të gjerë. Ndër aktet ligjore më të rëndësishme përmendim:

1. Strategjia për Fëmijët dhe Plani i Veprimit për periudhën 2001-2005 dhe 2005-2010

2. Strategjia Kombëtare kundër trafikimit të fëmijëve dhe plani i saj i veprimit 2005-2007
3. Po ashtu në zbatim të Ligjit nr. 10347, datë 4.11.2010. “ Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës” si dhe të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe të të gjithave udhëzimeve dhe rekomandimeve ndërkombëtare, shteti shqiptar ka hartuar Planin e Veprimit për Fëmijët 2012-2015, i cili është miratuar me VKM nr.182, datë 13.03.2012. Planin është hartuar pas Planit Strategjik për Fëmijët për periudhën 2005-2011 (VKM nr 182 datë, 13.03.2012)
4. Draft-Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore 2016 – 2020 që fokusohet gjithashtu për kujdesin e fëmijëve në të gjithë vendin.

Strategjia Kombëtare për Fëmijët dhe Planin e saj i Veprimit janë dokumente që përkufizojnë objektivat strategjike të politikave të qeverisë shqiptare dhe përfshijnë të gjitha masat që ministratë përkatëse duhet të marrin për të realizuar të drejtat e fëmijëve. Këto strategji janë të aplikueshme për parandalimin, mbrojtjen dhe asistencën për fëmijët që gjenden në situatë të ndryshme rreziku. Strukturat shtetërore përgjegjëse për zbatimin e strategjisë dhe garantuese të objektivave të mësipërme janë: Ministria e Arsimit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme, Komiteti Ndërmnistror për të Drejtat e Fëmijëve dhe Sekretariati Teknik për Fëmijët, pjesë e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të të miturve janë Avokati i Popullit i miratuar në vitin 1998 , një sektor për mbrojtjen e fëmijëve i krijuar në vitin 2004 dhe më pas dy zyra rajonale në Korçë dhe në Shkodër. Zyra e Avokatit të Popullit monitoron punën e strukturave shtetërore për zbatimin e Strategjisë nëpërmjet Nënseksionit për të Drejtat e Fëmijëve. Avokati i Popullit është një strukturë e pavarur politikisht neutral, i mandatuar për monitorimin e të drejtave të qytetarëve. Në disa vende të botës dhe të Europës ekziston institucioni i Avokatit të Popullit për fëmijë me një fushë veprimi të gjerë. Disa nga hapat më të rëndësishme që janë bërë përveç përmirësimit të kornizës ligjore është dhe krijimi i një institucioni modern për të miturit në Kavajë, krijimi i seksioneve për të miturit pranë prokurorive të rretheve gjyqësore, të policisë së shtetit dhe po ashtu trajnimin e vazhdueshëm të aktorëve që punojnë në

vendosjen e drejtësisë për të miturit dhe të atyre që punojnë në institucionet penitenciare për të miturit.

Në zhvillimin e reformës ligjore, një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe shoqëria civile. Problemi i kriminalitetit të të miturve është adresuar nga aktorë shtetëror dhe joshetërorë. Strukturat shtetërore kanë administruar kryesisht problemin e kriminalitetit për të miturit duke u përpjekur të ndjekin penalisht të miturit për veprën e kryer, ndërsa aktorët e shoqërisë civile të përfshirë në proces, nuk e injorojnë rëndësinë e ndjekjes së autorëve të veprave penale, por janë përqendruar kryesisht në të drejtat e fëmijëve dhe interesin më të lartë të fëmijës, duke vendosur në këtë mënyrë fëmijën në qendër të projekteve dhe aktiviteteve. Një kontribut të rëndësishëm në këto projekte ka luajtur Klinika Ligjore për të miturit, e krijuar në vitin 2002 si dhe Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA).

Agjencia spanjolle e bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim (AECID) është angazhuar për vënien në zbatim të një programi pilot për trajtimin e të miturve, nëpërmjet kurseve profesionale dhe programeve të individualizuara të trajtimit për të paraburgosurit (Xhafo,2012,) Pra, reforma për drejtësinë e të miturve vitet e fundit ka njohur një progres të madh. Ministria e Drejtësisë është angazhuar në hartimin e një Strategjie të re sektoriale për drejtësinë për të miturit e cila do të ketë për qëllim trajtimin e të gjithave problemeve ligjore që hasin fëmijët në Shqipëri. Vazhdimësia e politikave ekzistuese si dhe hartimi i politikave të reja në fushën e drejtësisë për të mitur synojnë arritjen e disa objektivave strategjike. (Save the children, 2012,20). Një rol vendimtarë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri ka luajtur edhe UNICEF.²¹

Po ashtu rendesi ne kete drejtim ka edhe Draft- Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore 2016 – 2020, qe u prezantua nga Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore. Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë ne kete rast vuri theksin tek masat që ky dikaster ka ndërmarrë për institucionet e përkujdesit të fëmijëve në të gjithë vendin.

²¹ Shih <https://sq.wikipedia.org/wiki/UNICEF>

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë ka hartuar një plan masash, te cilat priten te vihen ne veprim ne periudhen ne vijim²².

²² Plani I veprimit I ndërtuar tashmë përfshin: 1. Ngritjen e një taskforce për kontrollin e të gjithë qendrave publike dhe jopublike për fëmijët. Nga 175 qendra të cilat ofrojnë shërbime shoqërore 64 prej tyre përkujdesen për fëmijët, ndaj kjo taskforce, e cila do të përbëhet nga të gjithë punojësit socialë apo ato që kanë background social në Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Inspektoriatin e Punës dhe Shërbimeve, Shërbimi Social Shtetëror, Agjensinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, Ministrin e Drejtësisë dhe Ministrinë e Arsimit, si dhe te ftuar të gjithë ekspertët e shoqërisë civile, që duan të bëhen pjesë e këtij kontrolli dhe gjithë organizatat që bëjnë pjesë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Ndërkohë. për të 64 njësitë shtetërore publike dhe private që ofrojnë përkujdesje për fëmijët brenda një periudhe dyjavore do të kete një kontroll të plotë nga ky grup pune që do të drejtohet nga Inspektoriatin e Punës dhe i Shërbimeve për te kryer kontroll të performacës së këtyre institucioneve, vlerësim të cilësisë dhe aftësisë të të gjithë personelit të tyre, bazuar në përshkrimin e punës, të miratuar për cdo njësi të përkujdesjes sociale. Do duhet të kryhen intervista psikologjike me të gjithë fëmijët në këto qendra për të kuptuar realisht se ku ndodh dhe çfarë ndodh. Do të vlerësojmë kushtet fizike, në të cilat funksionojnë këto qendra dhe a janë këto kushte në përputhje me kërkesat kur qendrat marrin licënsim për të ushtruar aktivitetin. Do të vlerësojmë mekanizmat e denoncimit të dhunës, abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve, pra do te kërkojmë të kemi një sistem te plotë të evidentimit të rasteve të shkeljes së standarteve në shërbimet e këtyre qendrave. Do të kërkojmë kështu pra që në periudhën dyjavore për qendrat tona të përkujdesit për fëmijët të kemi një raport të plotë, përse I përket realizimit të këtyre 5 pikave shumë të rëndësishme të funksionimit të këtyre qendrave. Po ashtu kjo taskforcë do të ketë pjesë të punës së saj përmirsimin e kuadrit ligjor. 2. Shqyrtimi i përshpejtuar i Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, i cili sanksionon mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës dhe neglizhimit, si dhe ndalon punësimin në qendrat tona të përkujdesit të atyre individëve që kanë të kaluar të lidhur me dhunën ndaj fëmijëve, si dhe raportimin e detyrueshëm të çdo incidenti në këto qendra. Miratimin e ligjit për kujdesin shoqëror, i cili përforcon rolin e Inspektoriatit të Punës së Shërbimit Social Shtetëror, përforcon rolin e bashkive në ofrimin e shërbimeve, krijon bazën e duhur për shërbimin alternativ në vënd të kujdesit rezidencial. Do të kërkojmë në kuadër të paketës ligjore të rishikojmë të gjitha kriteret e licënsimit të qendrave që ofrojnë shërbim social. 3. Përshpejtimin e procedurave të nisura tashmë për De-Institucionalizimin. Shtepitë e Fëmijës apo jetimore nuk janë modeli më i mirë i rritjes së fëmijëve që janë lënë pa kujdes prindëror. Për këtë qëllim do të ngrihen skuadra me ekspertë që do të punojnë pranë cdo institucioni publik për kryerjen e këtij procesi të deinstitutionalizimit. Këto institucione do të çojnë në transformim të plotë të qendrave rezidenciale në qendra të përkujdesit ditor. 4. Vendosjen e kamerave- Do ta kërkojmë me shumë forcë në ambjentet e institucionit të përkujdesit. Megjithatë njohim dhe e pranojmë debatin që ka të bëjë me të drejtat dhe privatësinë e fëmijëve. Por pas rasteve të dhunës dhe ngjarjet e tjera të evidentuara në media në këto institucione, do të konsultohemi me Komisionerin për Mbrojtjen e të dhënave personale, për të pasur mundësinë për një aksion të shpejtë. Të vendosim sistemin e kamerave monitoruse në të gjitha këto institucioneve të përkujdesjes, natyrisht duke ruajtur privatësinë e fëmijëve në ambjentet ku kjo privatësi është e kërkuar me ligj. 5. Takim me të gjithë kryetarët e bashkive, të cilët kanë në menaxhim shtepitë e fëmijëve apo qendra përkujdesi me qëllim angazhimit maksimal të tyre në garantimin e mbrojtjes së fëmijëve dhe përfituesve në këto qendra. Së bashku me kryetarët e bashkive të ndërtojmë një plan strategjik se si do të kemi mundësinë e zgjidhjes së trajnimit dhe monitorimit të familjeve kujdestare që do të mund të marrin fëmijë në përkujdesje. 6. Po ashtu në kuadër të këtij plani pune do të vazhdojmë të kërkojmë bashkëpunim maksimal, me të gjithë përfaqësuesit e mediave. Duke I mbështetur dhe falenderuar për cdo evidentim të shfaqeve të dhunës, kërkojmë të bëhët sa më shumë kujdes në lajmet që jepen në lidhje me fëmijët jetim. Denoncimi I dhunës do të duhet të inkurajohet, por duhet të kemi kujdes në mbrojtje të identitetit të këtyre fëmijëve dhe mos I riviktimizojmë ata ne shoqëri, duke iu përmendur emrat dhe duke iu shfaqur figurat e fëmijëve duke dale ne ekran. 7. Po ashtu do ti kërkonim nga ky takim I Këshillit Kombëtar, kujdes më të madh të të gjithë gjyqësorit shqiptar. Do duhet që edhe në kuadër të reformës në drejtësi të kemi një këndvështrim tjetër karshi këtij raporti me fëmijët, të gjitha këto të nderuar miq anëtar të këtij komisioni mendoj se janë një përgjigje e shpejtë për situatën dhe si për sqarimin e situatës në opinionin public. Por natyrisht duke kërkuar të kemi një kohezion sa më të madh të gjithë aktorëve dhe faktorëve që janë në këtë betejë. Shih per me shume www.

KREU III: INSTRUMENTET JURIDIK NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E TË MITURVE. ANALIZA JURIDIKE - PENALE E TYRE.

3.1. Rëndësia dhe zbatueshmëria e akteve ndërkombëtare dhe evropiane në legjislacionin tonë të brendshëm.

Mbrojtja e të miturve ndaj fenomenit të kriminaliteti dhe hartimi i masave parandaluese të cilat do të minimizonin pjesëmarrjen e tyre në kriminalitet përbën një sfidë për legjislatorin shqiptar. Legjislacioni i vendit tonë është në harmoni dhe i përqasur me standardet ndërkombëtare lidhur me drejtësinë për të miturit. Shteti ynë ka ratifikuar një mori Konventash ndërkombëtare që lidhen me të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti. Këto instrumente ndërkombëtare ku aderohet edhe Shqipëria, janë një pikë referimi për ndërtimin e një sistemi ligjor efikas. Aktet ndërkombëtare ku bën pjesë dhe vendi ynë, janë parashikuar një mori normash juridike që rregullojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në sfera të ndryshme të jetës dhe në marrëdhënie të ndryshme ku ata janë të përfshirë, qoftë në të drejtën penale, familjare, civile, të punës etj.

Instrumentet ndërkombëtare të ratifikuar kanë karakter të fortë detyrues. Ndërsa në normat e karakterit *guidelines*, karakteri detyrues është më pak evident. (Dedaj,2015,10). Por, pavarësisht kësaj, konstatohet se niveli i njohjes së këtyre konventave dhe niveli zbatimit të tyre nga ligjzbatuesit në përgjithësi dhe nga gjyqtarët në veçanti është shumë i ulët. Për ligjzbatuesit, juristët, avokatët e gjyqtarët nuk mjafton vetëm dijenia dhe njohja me këto instrumente nëse kjo njohje nuk shoqërohet me zbatimin e tyre në punën e përditshme. Kushtetuta përcakton si mënyra për zbatimin dhe përdorimin e legjislacionit konvencional:

1. Zbatimin e drejtpërdrejtë i cili lejon të shmanget rregulli kombëtar duke qenë se vetë kushtetuta i ka dhënë këtyre normave një vlerë më të lartë se normat e së drejtës së brendshme.²³
2. Interpretimin e të drejtës kombëtare nën dritën e normave ndërkombëtare.
3. Referimin e të drejtës kombëtare tek normat ndërkombëtare për zgjidhjen e çështjeve të caktuara.

<http://www.sociale.gov.al/al/newsroom/lajme/strategjia-kombetare-per-barazine-gjinore-2016-2020&page=5>.

²³ Shih nenin 122 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

4. Unifikimin e praktikave gjyqësore duke u frymëzuar nga e drejta ndërkombëtare.

Disa instrumente ndërkombëtare kanë karakter detyrues, ndërsa disa të tjera quhen “Ligj i butë” sepse nuk janë detyruese si të parat. Kështu normat ligjore janë detyruese kurse rekomandimet jo. KEDNJ përmban norma me karakter detyrues dhe ka një instrument shumë të fuqishëm që ruan zbatimin e këtyre normave nga shtetet palë, Gjykatën Evropiane të të drejtave të njeriut. Po kështu edhe KDF përmban norma detyruese për zbatim, zbatimin e të cilave nga shtetet palë e monitoron një organizëm i posaçëm i pajisur me kompetenca kontrolli që quhet Komiteti për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Si pjesë e të drejtës tonë të brendshme e drejta ndërkombëtare është një ndër pjesët më të rëndësishme të studimit tonë. Instrumentet ndërkombëtarë që trajtojnë të drejtat e fëmijëve klasifikohen në:

1. Instrumente ndërkombëtare të OKB-së
2. Instrumente të Këshillit të Evropës
3. Instrumente të Bashkimit Evropian.

Ndonëse Shqipëria nuk është vend anëtar i BE, nënshkrimi i MSA-së prodhon një mori detyrimesh në kuadër të përafrimit dhe harmonizimit të legjislacionit dhe të koordinimit të strukturave ligjore. Në vijimësi do të trajtojmë disa nga instrumentet ndërkombëtarë më të rëndësishëm në lidhje me të drejtat e fëmijëve.

3.2. Të drejtat e të miturve në instrumentet e OKB-së

Pas Luftës së Dytë Botërore u ndje nevoja emergjente e krijimit të normave ndërkombëtarë të cilat do të mbronin të drejtat e njeriut në përgjithësi por do të krijonin edhe dispozita konkrete dhe të veçanta për të drejtat e të miturve në veçanti. Pra, shoqëria kishte nevojë të afirmonte dhe mbronte në nivel ndërkombëtar të drejtat e njeriut në tërësinë e tyre. Pas revolucionit industrial, kërkesa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut mori përmasa të mëdha, sepse në fillesat e saj kjo mbrojtje nuk u ofrohej të gjithë shtresave të shoqërisë. (Berghman, 1997:11) Zhvillimet e shumta ekonomike, sociale dhe politike që pësoi shoqëria bëri që të drejtat e njeriut dhe raporti i të miturve

me drejtësinë penale të ndryshonte ndjeshëm duke i bërë ata subjekte të saj. Në këto kushte filluan të miratohen dokumente të karakterit universal detyrues në fushën e njohjes dhe proklamimit të të drejtave të të miturve.

Institucioni më i rëndësishëm i cili ka ofruar një kontribut të lartë në hartimin e disa prej akteve më të rëndësishme ndërkombëtarë është Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Dokumentet ndërkombëtarë që trajtojnë pozitën juridike të të miturve në raport me ligjin penal janë:

1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
2. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e New York-t miratuar në 20.11.1989 dhe protokollet e saj shtesë
3. Konventa Kundër Torturës dhe Vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, çnjerëzor a Degradues ratifikuar me ligjin nr. 7727 datë 30.6.1993.
4. Rregullat standard minimum të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të miturit (1985)
5. Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës 1990)
6. Rregullat Standard Minimum të Kombeve të Bashkuara lidhur me masat e mos-arrestimit (Rregullat e Tokios 1990)
7. Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e kriminalitetit e të rinjve (Udhëzimet e Riadit 1990)

Këto akte do të jene pjesë e analizës sonë të mëposhtme duke trajtuar në mënyrë të detajuar fushën e mbrojtjes që ato ofrojnë për të miturit dhe raportin e tyre me të drejtën tonë të brendshme.

3.2.1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) e vitit 1948

Mosrespektimi dhe përbuzja e të drejtave të njeriut ka çuar drejt akteve barbare, të cilat shpesh herë janë bërë edhe objekt për shkaktimin e luftërave me karakter botëror. Kështu nëse do të kujtojmë periudhën e luftës së dytë botërore njëherësh do të kujtojmë mosrespektimin dhe trajtimin çnjerëzorë që i bëri Hitleri racës hebreje. Kjo masakër konsiderohet si rasti ma flagrant dhe më i rëndë i mosrespektimit të të drejtave të njeriut, dhe e gjendur në këto kushte diplomacia dhe e drejta ndërkombëtarë kishte

nevojë urgjente për një akt me fuqi detyruese për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Për këtë arsye me 10 dhjetor të vitit 1948 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi dhe shpalli Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut e cila u konsiderua si standard i përbashkët arritjeje për të gjithë njerëzit dhe kombet për respektimin e të drejtave të njeriut. (Gutmundur.A ,1999:487)

Asambleja e përgjithshme e OKB-së e shpalli Deklaratën Universale si ideal të përgjithshëm të cilin duhet ta arrijnë të gjithë kombet dhe të të gjithë popujt në mënyrë që secili nga organizmat shoqërorë, duke pasur parasysh këtë deklaratë duhet të përpiqet që me anë të mësimi dhe edukimit të ndihmojë në respektimin e këtyre të drejtave dhe lirive dhe me anë të masave progresive kombëtare e ndërkombëtare të sigurohet njohja dhe zbatimi i tyre i përgjithshëm dhe i vërtetë midis popujve të vetë shteteve anëtare. Deklarata në nenin 1 thekson se *“qeniet njerëzore kanë lindur të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe të drejta” duke i dhënë kështu një rëndësi dhe dimension universal konceptit të lirisë dhe barazisë të të drejtave të njeriut.*

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut është dokumenti ndërkombëtar bazë që shpall të drejta të pandashme dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore. Ajo rendit të drejta të shumta civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të cilat i gëzojnë njerëzit. Deklarata përmban nene të tjera, përveç preambulës, që nënvizojnë të drejtat e njeriut, ndër të cilat përfshihen të drejta të tilla themelore si: e drejta për jetën, lirinë dhe sigurinë personit, e drejta për arsim, e drejta për të marrë pjesë plotësisht në jetën kulturore, e drejta për të mos iu nënshtuar torturës, trajtimit cnjerezor apo ndëshkimi kriminal, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.²⁴

Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi²⁵ Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër. Asnjë dallim nuk do të bëhet në bazë të statusit politik, juridik ose ndërkombëtar të shtetit ose vendit të cilit i përket çdo njeri, qoftë kur shteti ose vendi është i pavarur, qoftë nën kujdestari, qoftë jo vetëqeverisës ose që gjendet në çfarëdo kushtesh të tjera të kufizimit të sovranitetit. Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm i cili t'i përgjigjet

²⁴ Shih nenin 1 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut

²⁵ Shih nenin 2 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut

shëndetit dhe jetës së përshtatshme si të atij personalisht, ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si edhe të drejtën për të qenë i siguar në rast sëmundjeje, papunësie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij. Nënata dhe fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të posaçme. Të gjithë fëmijët, të lindur brenda ose jashtë martese, gëzojnë të njëjtat mbrojtje sociale.²⁶

3.2.2. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës²⁷ e New York-t miratuar në 20.11.1989 dhe protokolle e saj shitesë

Hartimi i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut nga ana e Kombeteve të Bashkuara ishte një apel i fortë në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe njëkohësisht edhe hap i parë i rëndësishëm në lidhje me to. Në këtë akt u shpall që fëmijët kanë të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë. Por DUDNJ-ja nuk sanksionoi norma specifike të cilat do të trajtonin pozitën e të miturve ndaj drejtësisë penale dhe të gjendur në këto kushte por dhe të bindur se familja, si njësi bazë e shoqërisë duhet të gëzojnë mbrojtje dhe përkrahje të nevojshme që të mund të marrë përsipër plotësisht rolin e saj në bashkësi.²⁸

Shoqëria kishte filluar të sensibilizohej në lidhje me rëndësinë e fëmijëve si embrioni i saj dhe rëndësinë për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij. Nisur edhe nga fakti që në të gjitha vendet e botës ka fëmijë që jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira të cilat i shtynë ata të jenë pjesë e veprimtarive të ndryshme kriminale por edhe që është e nevojshme që këtyre fëmijëve t'u kushtohet një vëmendje e veçantë, vendosi krijimin e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me 20 nëntor 1989.

Konventa përbënë një nga aktet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare në të cilën janë parashikuar të drejtat dhe detyrimet në të gjitha fushat e jetës së fëmijës. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës në 27 shkurt 1992 duke e integruar si pjesë të legjislacionit të brendshëm nisur edhe nga gatishmëria për mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenies së fëmijës.

²⁶ Shih nenin 25 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut

²⁷ Konventa e OKB mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF) (1989) ratifikuar nga shteti shqiptar në 27 shkurt

²⁸ Shih preambulën e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës të vitit 1989.

Konventa është një instrument detyrues për të gjitha shtetet palë dhe parashikon parimet kryesore për mbrojtjen e të miturve në tërësi, por dhe standardet bazë për zbatimin e drejtësisë penale për të miturit, duke e shndërruar atë në një nga dokumentet kryesore të të Drejtave të Fëmijës në mbarë botën. Disa nga karakteristikat e kësaj Konvente janë:

- ✚ është instrument universal,
- ✚ është instrument ligjërish i zbatueshëm,
- ✚ mbron rolin e familjes në jetën e fëmijës,
- ✚ ngarkon përgjegjësi të qarta për të gjitha palët,
- ✚ krijon një vizion për fëmijën

Kuadri ligjor i Konventës ka një qasje të thelluar në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. (Save the Children, 2012,29). Konventa përbehet nga 54 nene dhe përmban një përmbledhje të rregullave dhe parimeve që udhëheqin shtetet nënshkruese për të zhvilluar një kuadër të plotë dhe koherent në përcaktimin e të drejtave të fëmijëve. Mesazhi social që përcjell ky akt është i fortë dhe e trajton fëmijën si një qenie në zhvillim e sipër, me mundësi për t'u rehabilituar dhe terapitë që sistemi do të përdorë për "shërimin" duhet të jenë të ndryshme dhe të veçanta prej atyre të të rriturve. Mbrojtja e veçantë e të miturve dhe mirëqenia e tyre janë esenciale në një shoqëri demokratike, sepse standardet sociale të së ardhmes varen nga ndërgjegjësimi dhe edukimi, edukimi, mbrojtja dhe arsimimi i të miturve sot. (UNICEF,2010,16).

Konventa për të Drejtat e Fëmijës ka sjellë disa risi në lidhje me trajtimin juridik dhe social të fëmijëve. Kështu ajo riafirmon të drejtat që i gëzojnë të gjitha qeniet njerëzore, avancon disa të drejta bazë të njeriut duke marrë në konsideratë edhe nevojat speciale të fëmijëve si dhe vendos standarde të veçanta në fusha që janë specifike që u përkasin fëmijëve. (Hysi, 2002,152) Zbatimi i Konventës nga ana e palëve nënshkruese mbikëqyret nga një organ i krijuar nga vetë konventa që është Komitetit mbi të Drejtat e Fëmijëve. Në nenet 37 , 39 dhe 40 trajtohen çështjet që lidhen me drejtësinë për të miturit. Por duhen zbatuar në kontekst të konventës , kjo sepse të gjitha dispozitat e saj janë të ndërruar nga njëra tjetra dhe formojnë një të tërë. (Sufaj,2011,68)

Në nenin 37 të Konventës ndalohet ushtrimi i torturës dhe trajtimeve apo dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese si dhe dënimi me vdekje apo burgim të

përjetshëm nuk mund të jepet ndaj personave nën 18 vjeç²⁹. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të bëhet në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër. Privimi nga liria duhet të trajtohet në mënyrë njerëzore pa cenuar dinjitetin e tij, duhet të mbahet i veçuar nga të rriturit, të ketë të drejtën e takimeve me familjarët dhe të vizitave. Fëmijët e privuar nga liria kanë të drejtën e asistencës juridike si dhe të drejtën për të kundërshtuar vendimin e heqjes së lirisë përpara një gjykatë dhe marrjen e një vendimi sa më të shpejtë.

Neni 39 i Konventës proklamon të drejtën e rehabilitimit dhe riintegrit social të fëmijëve që janë viktimë të pakujdesisë, shfrytëzimit dhe keqtrajtimit.³⁰ Konventa mbulon në mënyrë më specifike të gjitha të drejtat e të gjithë fëmijëve të akuzuar për shkelje të legjislacionit. Ky nen i Konventës kërkon që fëmijës së akuzuar apo të dyshuar për kryerjen e një veprë penale t'i respektohen dinjiteti dhe vlerat e tij personale.³¹ Neni 40 duhet interpretuar me parimet e përgjithshme të parashtruara

²⁹ Shih nenin 37 të e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës të vitit 1989. ku përcaktohet se Shtetet Palë sigurojnë që: (a) Asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. As dënimi me vdekje, as burgimi i përjetshëm nuk duhet të jepen për shkelje të ligjit; të kryera nga persona nën 18 vjeç; (b) Asnjë fëmije të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër. (c) Çdo fëmijë i privuar nga liria të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që i takon dinjitetit të njeriut dhe në mënyrë të tillë; që të kihen parasysh nevojat e personave të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në interesin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget dhe ai të ketë të drejtën të mbajë lidhje me familjen me korrespondencë dhe vizita, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme; (d) Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të ketë të drejtën që t'i jepet menjëherë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër e përshtatshme, si dhe të drejtën të kundërshtojë vendimin për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm si dhe për një vendim të shpejtë për çdo rast të tillë.”

³⁰ Shih nenin 39 të e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës të vitit 1989. Ku përcaktohet se “Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të lehtësuar riaftësimin fizik e psikologjik dhe riintegrimin në shoqëri të çdo fëmije që është viktimë: e çdo forme pakujdesie, shfrytëzimi ose keqtrajtimi, torture ose çdo forme tjetër të një trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor e poshtërues ose konflikti të armatosur. Ky riaftësim dhe ky riintegrim duhet të bëhen në kushtet e një mjedisi, që ndihmon shëndetin, personalitetin dhe dinjitetin e fëmijës.”

³¹ Shih nenin 39 të e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës të vitit 1989 ku përcaktohet se: 1. Shtetet Palë i njohin çdo fëmije të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj. 2. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare, Shtetet Palë kujdesen në veçanti që: (a) Asnjë fëmijë të mos jetë i dyshuar, i akuzuar ose i cilësuar për shkelje të ligjit penal për arsye të veprimeve ose mosveprimeve që nuk kanë qenë të ndaluara nga e drejta e brendshme ose ndërkombëtare në momentin kur ato janë kryer; (b) Çdo fëmijë i dyshuar ose i akuzuar për shkelje të ligjit penal të ketë të paktën garancitë që vijojnë: (i) Të prezumohet i pafajtshëm derisa të provohet pafajësia ligjërisht; (ii) Të informohet menjëherë dhe drejtpërdrejt për akuzat e ngritura kundër tij, nëse është e përshtatshme, me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjorë, dhe të ketë ndihmë juridike ose nga çdo ndihmë tjetër

lidhur me fëmijët kryesisht me nenin 2,3,6,12. Në nenin 2 të KDF- së theksohet se të gjitha të drejtat u njihen të gjithë fëmijëve pa asnjë përjashtim kurse në nenin 3 kjo konventë parashikon që në trajtimin e fëmijëve të merret parasysh interesi më i lartë i fëmijës.³² E drejta e fëmijës që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, si drejtpërdrejt ashtu dhe nëpërmjet një përfaqësuesi apo një organi të përshtatshëm në sinkron me rregullat procedurale të legjislacionit ndërkombëtar.³³

Këto parime janë udhërrëfyese për veprimet e të gjithë aktorëve të interesuar, përfshirë edhe vetë fëmijët, në funksion të realizimit të të drejtave të tyre për mbrojtje. Pra, çdo veprim apo iniciativë për mbrojtjen e fëmijëve të bëhet në përputhje me standartët e vendosura nga kjo Konventë dhe nga organet kompetentë. Konventa përcakton detyrimet e shteteve nënshkruese (pra edhe Shqipërinë) për të mbrojtur fëmijët nga keqtrajtimet dhe format e abuzimit. (Hysi, 2002:157)

Neni 40 i KDF përcakton edhe një listë me minimumin e garancive për një fëmijë që akuzohet për një vepër penale. Këto garanci përfshijnë: prezumimin e pafajësisë, të drejtën e informimit, shqyrtimin pa vonesë, etj. Një ndër rekomandimet e Komitetit për të drejtat e fëmijëve për Shqipërinë është pikërisht siguri i një zbatimi të plotë të standarteve të përcaktuara në dokumentet e sipërpërmendura e veçanërisht të neneve 37,39 dhe 40 të KDF-së, si dhe në Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturin (Rregullat e Pekinit, 1985).

të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij; (iii) Çështja e tij të shqyrtohet pa vonesë nga një autoritet ose instancë gjyqësore kompetente, e pavarur dhe e paanshme, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme, dhe, kur gjykohej se kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, në prani të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë. (iv) Të mos detyrohet të dëshmojë ose të pohojë veten fajtor; të pyeten ose të bëjë të pyeten dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij, në kushte të barabarta. (v) Në qoftë se vendoset se ka shkelur ligjin penal, të bëjë ankim kundër këtij vendimi si dhe çdo masë të marrë si pasojë, para një autoriteti ose një instance gjyqësore kompetente më të lartë, të pavarur dhe të paanshme, në përputhje me ligjin. (vi) Të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret. (vii) Të respektohet plotësisht jeta e tij private në të gjitha fazat e procedurës. 3. Shtetet Palë përpiqen të nxisin krijimin e ligjeve, procedurave, organeve dhe institucioneve të posaçme për fëmijët që dyshohen, akuzohen ose që vlerësohen se kanë kryer shkelje të ligjit penal dhe në veçanti: (a) Përcaktojnë një moshe minimale, nën të cilën fëmijët prezumohen të paaftë për të shkelur ligjin penal; (b) Marrin masa, sa herë është e nevojshme dhe e dëshirueshme, për t'i trajtuar këta fëmijë pa iu drejtuar procedurës gjyqësore, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e njeriut dhe mbrojtja ligjore. 4. Parashikohen dispozita të ndryshme, siç janë kujdesi, orientimi dhe kontrolli; këshillat; periudha e provës; kujdesi në familje; programet e edukimit të përgjithshëm dhe profesional dhe zgjidhje të tjera, veç atyre institucionale, për t'u siguruar fëmijëve një trajtim në përputhje me mirëqenien e tyre dhe në raport me gjendjen e tyre dhe me shkeljen e ligjit.

³² Shih nenin 3 të e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës të vitit 1989.

³³ Shih nenin 12 të e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës të vitit 1989.

Pjesë e rekomandimeve të komitetit janë edhe Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Rinjve (Udhëzimet e Riadit,1990), Rregullat e Kombeve të Bashkuara për të Rinjtë të cilëve u është hequr liria. (Rregullat e Havanës,1990), Udhëzimet e Vjenës lidhur me Veprimin për Fëmijët në Sistemin e Drejtësisë Penale dhe duke pasur parasysh ditën e diskutimit të Komitetit në vitin 1995 mbi administrimin e drejtësisë për të rinjtë. (OSBE, 2010)

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve vendosi standarde, garanci dhe detyrime të pashmangshme për shtetet palë ndër të cilat spikatin:

1. Standardi i trajtimit të veçantë e dinjitoz të çdo fëmije të dyshuar apo akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer një shkelje të ligjit penal me qëllim që të zhvillohet ndjenja e dinjitetit dhe e vlerës së personit; të respektohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut duke mbajtur parasysh moshën e fëmijës dhe detyrimin për reintegrimin e tij në shoqëri në mënyrë që ai të ketë një rol konstruktiv në gjirin e saj.(neni 40 i KDF)
2. Standardi i mungesës së fuqisë prapavepruese. Asnjë fëmijë nuk mund të jetë i akuzuar për shkelje të ligjit penal për arsye të veprimeve apo mosveprimeve që nuk kanë qenë të ndaluara nga e drejta e brendshme ose ndërkombëtare në momentin kur ato janë kryer. (neni 40/1 i KDF)
3. Garancitë procedurale në procesin penal për fëmijët e dyshuar ose të akuzuar për shkelje të ligjit ku përfshihen prezumimi i pafajësisë derisa fajësia të provohet ligjërisht³⁴; e drejta e informimit të menjëhershëm e të drejtpërdrejtë për akuzat e ngritura nëse është e përshtatshme me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjorë dhe të ketë ndihmë ligjore ose çdo lloj ndihme tjetër të nevojshme për paraqitjen e mbrojtjes³⁵ ; shqyrtimi pa vonesë i çështjes nga ana e autoriteteve ose instancat gjyqësore kompetente të pavarura e të paanshme, sipas një procedure të drejtë ligjore në praninë e një ndihme të përshtatshme juridike, ose çfarëdo lloj ndihme tjetër, kur gjykohet se kjo është e përshtatshme dhe në interesin më të lartë të fëmijës sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, në prani të prindërve ose përfaqësuesve ligjorë; trajtimi i të miturve në përputhje me mirëqenien e tyre dhe në raport të drejtë me gjendjen e tyre aktuale dhe me

³⁴ Shih nenin 30 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

³⁵ Shih nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

shkeljen e ligjit të mos detyrohet të dëshmojë ose të pohojë veten fajtor; të pyesë ose të kërkojë që të pyeten dëshmitarët e akuzës etj.

Konventa parashikon një sërë të drejtash të tjera si e drejta për një përkthyes falas, e drejta për respektimin e jetës private, shmangia nga procesi gjyqësor dhe procedura etj. Ratifikimi i kësaj Konvente nga vendi ynë ka zgjuar një interes të fortë publik për mbrojtjen e veçantë të të miturve, pasi interesi parësor dhe mirëqenia e tyre janë thelbësore.

3.2.3. Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore Ose Poshtëruese ratifikuar me ligjin nr. 7727 datë 30.6.1993.

Konventa është hartuar në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara si njohja e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë pjesëtarëve të familjes njerëzore si themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë. Por edhe duke dëshiruar që luftën kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese ta bëjnë sa më efektive në botë.³⁶ Në hartimin e kësaj Konvente u morën në konsideratë edhe disa akte të rëndësishme ndërkombëtare si Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut³⁷, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike³⁸ etj.

Konventa përcakton në nenin 2 të saj se: "1. Çdo shtet palë merr masa efektive legjislative, administrative, gjyqësore, ose masa të tjera për të parandaluar veprimet e torturës në cilindo territor nën juridiksionin e tij. 2. Asnjë rrethanë e jashtëzakonshme, e çfarëdo lloji, qoftë gjendje e luftës ose kërcënim nga lufta, paqëndrueshmëri e brendshme politike apo çdo gjendje tjetër e jashtëzakonshme, nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën. 3. Urdhri i dhënë nga një epror ose autoritet publik nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën." Neni 3 i Konventës e mbron të miturin nga dëbimi dhe ekstradimi në një shtet tjetër ku ka dyshime të bazuara që ai mund t'i nënshtrohet torturës.³⁹ Në paragrafin e dytë të këtij neni përcaktohet detyrimi i autoriteteve që të

³⁶ Shih preambulën e Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore Ose Poshtëruese.

³⁷ Shih nenin 5 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

³⁸ Shih nenin 7 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

³⁹ Shih nenin 3 paragrafi 1 të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore Ose Poshtëruese ku përcaktohet se: "Asnjë shtet palë nuk do të dëbojë, nuk do të prapësojë, e

marrin parasysh të gjitha rrethanat përkatëse duke përfshirë, kudo që është e zbatueshme, ekzistencën e një numër dhunimesh sistematike, të rënda, flagrante ose masive të të drejtave të njeriut në një shtet përkatës.⁴⁰ Në nenin 4 të Konventës del në pah karakteri detyrues i saj, ku përcakton se shtete duhet të përcaktojnë në legjislacionin e tyre të brendshëm veprimet e karakterit torturues, duke mundësuar një panoramim më të qartë të tyre.⁴¹

Konventa është e detyrueshme për zbatim dhe ka një organ që mbikëqyr zbatimin nga shtetet anëtare të dispozitave të saj i cili është Komiteti Kundër Torturës. Shtetet palë i paraqesin Komitetit, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, raportet lidhur me masat që kanë marrë për zbatimin e detyrimeve të marra përsipër sipas kësaj Konvente, brenda një viti pas hyrjes së kësaj Konventë në fuqi për çdo shtet palë të interesuar. Përveç kësaj, shtetet palë paraqesin raporte plotësuese, çdo katër vite, për të gjitha masat e reja që kanë marrë, dhe raporte të tjera të cilat mund t'i kërkojë Komiteti.

3.2.4. Rregullat standard minimum të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit)⁴²

Rregullat standard minimum të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të miturit janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dhe kanë si qëllim kryesor që të sigurojnë minimizimin e efekteve negative e të dëmshme në trajtimin e të miturve nga hallkat e sistemit të drejtësisë duke parandaluar shtimin e kriminalitetit dhe duke e përsosur sistemin e drejtësisë për të miturit në nivel kombëtar.(Leskoviku,2010,15) Rregullat e Pekinit theksojnë që sistemi i drejtësisë të fokusohet në mirëqenien e të miturit dhe të sigurojë se çdo reagim ndaj shkelësve të mitur të ligjit duhet të jetë në përpjesëtim me rrethanat e shkeljes dhe autorit të shkeljes. Gjithashtu këto rregulla theksojnë se përpjekjet e shumta për të vendosur në

as nuk do të ekstradojë një person në një shtet tjetër ku ka arsye serioze për të besuar sa ai rrezikon t'i nënshtrohet torturës.”

⁴⁰ Shih nenin 3 paragrafi 2 të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore Ose Poshtëruese

⁴¹ Shih nenin 4 paragrafi 1 të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore Ose Poshtëruese ku përcaktohet se “Çdo shtet palë siguron që të gjitha veprimet e torturës të konsiderohen vepra penale nga ligji i tij penal. E njëjta gjë vlen për tëntim ushtrimin e torturës dhe për çdo veprim tjetër të kryer nga çdo person si pjesëmarrës në torturë apo në bashkëveprim.”

⁴² Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 29 Nëntor 1985.

çdo legjislacion kombëtar disa ligje, rregulla dhe dispozita të aplikueshme në mënyrë të veçantë për të miturit dhe institucione të caktuara për funksionimin e administrimit të drejtësisë për të miturit. (Save the Children,2012,15)

Në lidhje me moshën për përgjegjësinë penale Rregullat e Pekinit përcaktojnë që mosha për përgjegjësinë penale të mos përcaktohet shumë e ulët, duke marrë në konsideratë maturinë emocionale, mentale dhe intelektuale të një fëmije. Rregullat e Pekinit vendosin krijimin e një sistemi të specializuar të drejtësisë për të miturit dhe krijimin e një kuadri ligjor të veçantë, ku mund të përmendim:

1. Përfshirja e të miturve nga dënimi kapital dhe ndëshkimet trupore.
2. Trajtimi i paanshëm dhe njerëzor.
3. Marrjen parasysh të opinionit të të miturve.
4. Heqja e lirisë së të miturve të jetë mundësia e fundit për dënimin e tyre si dhe nëse është e domosdoshme të jetë sa më e shkurtër.
5. Heqja e lirisë të jetë vetëm kur rastet e veprave penale janë shumë të rënda.
6. Vendimet në lidhje me të miturit të jepen sa më shpejt.
7. Të specializohen struktura të posaçme të sistemit të drejtësisë vetëm për drejtësinë e të miturve.
8. Të hartohen strategji për ririntëgrimin e të miturve në konflikt me ligjin penal.

Në rregullin Nr. 6 të Rregullave të Pekinit vendoset theksi të përgjegjshmëria që duhet të disponojnë nëpunësit dhe zyrtarët për të ushtruar në diskrecion punën e tyre. Po kështu vendoset theksi të trajnimit në mënyrën e duhur të punonjësve të policisë të cilët do të merren me rastet e kriminalitetit ndaj të miturve.⁴³ Rregullat e Pekinit parashikojnë edhe gjykimin nga ana e autoriteteve kompetente për të miturit, procedim ky që i shërben interesit më të mirë të fëmijës dhe duhet të kryhen në një atmosferë mirëkuptimi. Shkelësi me moshë të re të ligjit duhet që të inkurajohet të marrë pjesë. Po kështu, edhe aksesit në mbrojtje ligjore është pjesë e rëndësishme e Rregullave të Pekinit.

⁴³ Shih rregullin 12 të Rregullave standard minimum të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të miturit që përcakton se personeli policor që ka të bëjë me shkelësit me moshë të re të ligjit duhet të jetë veçanërisht i trajnuar, dhe se në qytete e mëdha njësi të posaçme policore duhet të krijohen për këtë qëllim.

3.2.5. Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës 1990)

Rregullat e Havanës janë miratuar nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara në 14 dhjetor 1990 dhe përmbajnë parimet kryesore të të drejtave të fëmijëve. Këto rregulla kanë në fokusin e tyre pozitën e të miturit në paraburgim, duke specifikuar reintegrimin e të miturit si një objektiv, si dhe të drejtën e tij për trajtim adekuat dhe kontaktet me familjen e tij. (Leskoviku,2010,14) Ato trajtojnë edhe pozitën ligjore të fëmijëve që ndalohen gjatë fazës së paraburgimit dhe gjatë fazës së gjykimit, si dhe ata që ndalohen me vendim gjyqësor me burgim.

Sipas rregullave të Havanës përgjegjësia penale tek të miturit duhet të fillojë në moshën 18 vjeç, pra personat që nuk kanë mbushur këtë moshë nuk duhet të privohen nga liria përveç rasteve kur ajo është masa e fundit që mund të merret kundrejt tyre. Në raste të ndalimit dhe të privimit të lirisë i mituri duhet të trajtohet në përputhje me rregullat e Havanës dhe të normave të të drejtave të fëmijës në përgjithësi. Në përmbajtjen e këtij instrumenti theksohen disa nga parimet themelore në mbrojtje të të rinjve të cilëve u është hequr liria ku ndër të tjera nënvizojmë:

1. Heqjen e lirisë si masë e fundit dhe vetëm për një kohë të kufizuar
2. Heqjen e lirisë të të miturve vetëm për një motiv të fortë juridik
3. Krijimin e institucioneve të hapura për vuajtjen e dënimit
4. Riintegrimin e të rinjve që u është hequr liria duke i përgatitur për rikthimin në jetën në komunitet nëpërmjet masave edukuese
5. Rivendosja dhe mbajtja e kontakteve me familjen
6. Trajnimi dhe specializimi i personelit të qendrave që merren me të rinjtë që u është hequr liria

Ky akt e vendos theksin në riintegrimin e fëmijëve në shoqëri. Pra, rehabilitimi i tyre dhe rikthimi në shoqëri që nga momenti që ata hyjnë në institucionin e vuajtjes së dënimeve penale duhet të jetë primare në trajtimin e legjislacioneve dhe marrjen e masave për zbatimin e tyre. Nuk duhet dëmtuar individi i pjesë esenciale e shoqërisë.

3.2.6. Rregullat Standard Minimum të Kombeve të Bashkuara lidhur me masat e mos-arrestimit (Rregullat e Tokios 1990)

Rregullat e Tokios⁴⁴ vendosin parimet themelore për promovimin dhe përdorimin e masave alternative të dënimit dhe garancitë minimale për të personat që u nënshtrohen alternativave të dënimit me burgim. Rregullat theksojnë domosdoshmërinë e përfshirjes së komunitetit në menaxhimin e drejtësisë penale. Këto rregulla duhet të zbatohen duke mbajtur parasysh kushtet politike, sociale dhe ekonomike të çdo vendi dhe qëllimet e objektivat e sistemit të drejtësisë penale për secilin shtet. Për zbatimin e këtyre rregullave shtete anëtare duhet të përpiqen të sigurojnë balancën e duhur mes të drejtave individuale të autorëve, të drejtave të viktimave dhe shqetësimit të shoqërisë për sigurinë publike dhe parandalimin e krimit. Shtetet anëtare duhet të hartojnë masa alternative në sistemet e tyre të brendshme ligjore me qëllim reduktimin e përdorimit të masës së dënimit me burgim duke pasur parasysh respektimin e të drejtave të njeriut dhe mundësitë e rehabilitimit të të rinjve në konflikt me ligjin.

Dispozitat e kësaj rregullore do të zbatohen për të gjithë personat që i nënshtrohen gjykimit, që janë nën hetim apo që vuajnë dënimin, pra, në të gjitha fazat e drejtësisë penale. Rregullat do të zbatohen pa asnjë dallim dhe diskriminim. Në këtë dokument personat në konflikt me ligjin janë quajtur “shkelës” pavarësisht nëse janë të akuzuar apo të dënuar. Në zbatim të këtyre rregullave, shtetet anëtare duhet të hartojnë e të ofrojnë një gamë të gjerë masash alternative në mënyrë që të sigurojnë fleksibilitet në përputhje me natyrën e veprës me personalitetin e autorit, dhe me nevojat e shoqërisë për të shmangur heqjen e pa nevojshme të lirisë së autorit. Hartimi dhe zbatimi i masave alternative duhet të inkurajohet e të monitorohet nga agjencitë përkatëse duke mbajtur parasysh që masat alternative duhet të përdoren në përputhje me parimin e ndërhyrjes minimale.

3.2.7. Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e kriminalitetit të të rinjve (Udhëzimet e Riadit 1990)

Udhëzimet e Riadit fokusohen tek parandalimi i kriminalitetit tek të miturit duke u bazuar tek disa nga parimet themelore si parandalimi i kriminalitetit të të miturve nëpërmjet përfshirjes së tyre në aktivitete të ligjshme e të dobishme, parandalimi i kriminalitetit tek të miturit kërkon përpjekje nga e gjithë shoqëria për të siguruar zhvillimin harmonik të të miturve duke respektuar personalitetin e tyre. Në interpretim

⁴⁴ Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1990.

të Udhëzimeve të Riadit në sistemet e brendshme kombëtare ndiqet politika e vendosjes së fëmijës në fokus të vëmendjes ligjore dhe shoqërore.

Të rinjtë duhet të kenë një rol aktiv në gjirin e shoqërisë. Në zbatim të këtyre Udhëzimeve. Sistemet kombëtare duhet të kenë në fokus programet parandaluese për kriminalitetin e të miturve. Detyrimin e shteteve që të njohin nevojat dhe rëndësinë e politikave të parandalimit progresiv të kriminalitetit tek të miturit, duke shmangur inkriminimin dhe penalizmin e fëmijës për sjellje që nuk sjellin dëme të rëndësishme për shoqërinë. Këto politika duhet të përfshijnë veçanërisht:

- a. sigurimin e nevojave edukative të të rinjve që shërbejnë si një kuadër mbështetës në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve veçanërisht të atyre që janë të ekspozuar ndaj rrezikut dhe kanë nevojë për përkujdesje e mbështetje të veçantë.
- b. Mënyra të veçanta dhe afatgjata për parandalimin e kriminalitetit tek të miturit bazuar në ligje të posaçme të mbështetura nga institucione të specializuara me qëllim reduktimin e nevojave apo situatave që çojnë të rinjtë drejt kriminalitetit.
- c. Ruajtjen e mirëqenies, të drejtave dhe interesave të të rinjve.
- d. Faktin që njeriu është qenie në evoluim të përhershëm dhe që zakonisht sjelljet antagoniste zhduken tek të rinjtë me kalimin e moshës.
- e. Ndërgjegjësimi i opinionit që jo gjithmonë përcaktimi i të rinjve si devijantë duhet të bëhet nisur nga një karakteristikë e padëshirueshme e sjelljes së tyre.
- f. Futjen e shërbimeve të bazuara në komunitet për parandalimin e kriminalitetit të të miturve veçanërisht aty ku mungojnë agjencitë mbështetëse.

Një ndihmesë e madhe janë edhe fondet e mjaftueshme që duhet të sigurohen për shërbimet shëndetësore, ushqimin, strehimin, këshillimin dhe parandalimin e abuzimit.

3.3. Mbrojtja të drejtave të të miturve në aktet juridike të Këshillit të Europës

Institucionet dhe aktet më të rëndësishme datojnë pas Luftës së Dytë Botërore. Kështu, Këshilli i Evropës u themelua në vitin 1949 si një institucione i cili do të themelonte ndërtimin evropian mbi bazën e vlerave të respektimit të qenies njerëzore dhe të demokracisë.

Këshilli i Evropës kishte si synim primar të tij krijimin e një hapësirë demokratike e juridike të përbashkët për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Të drejtat e fëmijëve anë qenë dhe vazhdojnë të jenë një prioriteti politikave ligjore të KE-

së. Në funksion të mbrojtjeve të të drejtave të njeriut në përgjithësi por edhe të të drejtave të fëmijëve si pjesë e tyre, Këshilli i Evropës ka hartuar një sërë aktesh ligjore më fuqi detyruese. Aktet që do të jenë në fokus të analizës sonë janë :

1. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut⁴⁵
2. Karta Sociale Evropiane (E Rishikuar)⁴⁶
3. Konventa Evropiane mbi Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve
4. Konventa Evropiane “Për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve dhe Trajtimeve Çnjerëzore apo Degraduese”
5. Konventa Evropiane “Për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht” ratifikuar me Ligjin nr. 8724 datë 26.12.2000
6. Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar” e ratifikuar me Ligjin nr. 8499, datë 10.6.1999
7. Konventa e Këshillit të Evropës “Për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 8498, datë 10.6.1999
8. Konventa e Këshillit Të Evropës “Për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjyqimeve Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 9068, datë 15.5.2003
9. Konventa e Këshillit të Evropës “Për Transferimin e Procedimeve në Çështjet Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 8497, datë 10.6.1999
10. Rekomandimi CM/Rec 2008 (11) i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Rregullat Evropiane, për të dënuarit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve ose masave.

Në vijimësi të punimit tonë doktoral do të trajtojmë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe raportet e tyre me ligjin penal.

3.3.1. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet Shtesë

⁴⁵ Konventë e miratuar më 1950, sipas të cilës shtetet anëtare të Këshillit të Evropës zotohen të respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, të drejtat qytetare e politike

⁴⁶ Karta Sociale Evropiane Manual, Karta u miratua më 1961, Botim i Këshillit të Evropës

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut u miratua në vitin 1950 dhe hyri në fuqi konventa hyri në fuqi më 3 Shtator 1953. KEDNJ –ja përfaqëson aktin e parë të Këshillit të Evropës që merret me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në varësi të ndryshimeve sociale dhe shoqërore Konventa i është nënshtruar disa ndryshimeve dhe amendimeve të cilat kanë synuar të jenë përherë një hap përpara situatave të shkeljes së të drejtave të njeriut. (Musaraj, 2010:2) Çdo person, i cili ndjen se të drejtat e tij ose të saj janë shkelur, në bazë të Konventës nga një shtet palë, mund ta çojë atë në Gjykatë. Vendimet për shkeljet e gjetura janë të detyrueshme për shtetet në fjalë dhe ato janë të detyruara t'i ekzekutojnë ato. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës monitoron ekzekutimin e vendimeve, veçanërisht për të siguruar pagesën e shumave dhënë aplikantëve si kompensim nga Gjykata për dëmin që ata kanë pësuar. Krijimi i një Gjykate për mbrojtjen e individëve nga shkelja e të drejtave të njeriut është një tipar i ri për një konventë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, pasi i jep individit një rol aktiv në arenën ndërkombëtare (tradicionalisht, vetëm shtetet janë konsideruar si aktorë në të drejtën ndërkombëtare).

Konventa Evropiane është e vetmja marrëveshje ndërkombëtare e të drejtave të njeriut që parashikon një shkallë të tillë të lartë të mbrojtjes individuale. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashikon një set të drejtash për çdo individ po nuk lë mënjanë dhe të drejtat e fëmijëve. Kështu në nenin 5 të saj parashikohet⁴⁷ e drejta e

⁴⁷ Shih nenin 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ku përcaktohet se ‘Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj: a) kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetentë; b) kur arrestohet ose burgoset ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji; (Titull i shtuar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11) c) kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj; d) kur një i mitur ndalohet ligjërisht, për qëllim edukimi të mbikëqyrur, ose për ndalimin e tij të ligjshëm, me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent ligjor; e) kur individët ndalohen ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve; f) kur një person arrestohet ose ndalohet ligjërisht, me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose për një person kundër të cilit është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi 2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet. 3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij Neni, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatesi ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet nga garanci për t'u paraqitur para gjykatës. 4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo

lirisë dhe e sigurisë personale të individëve në përgjithësi. Ky nen shërben si etalon për të gjithë individët duke parashikuar këtu edhe fëmijët.

Po kështu, në nenin 6 të KEDNJ ku parashikohet e drejta për një proces të rregullt⁴⁸ gjyqësor, si një nga të drejtat kryesore të Konventës i cili ka krijuar një praktikë të pasur gjyqësore. Në funksion të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve janë edhe disa nene të tjera të rëndësishme të KEDNJ-së. Kështu, në lidhje me standardet minimum për çdo individ që vendoset përpara një akuze serioze duhet të merren në konsideratë nenet e mëposhtme. Të miturit gëzojnë të drejtën e informimit mbi akuzën në gjuhë që ata kuptojnë⁴⁹, të drejtën për të përgatitur mbrojtjen, të drejtën e ndihmës ligjore, të drejtën të marrë në pyetje ose të kërkojë marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe të drejtën për të patur ndihmën e një përkthyesi falas.⁵⁰ Këto garanci zbatohen si për të rriturit edhe për të miturit. Gjithsesi, jurisprudenca e GJEDNJ i ka dhënë një peshë të vecantë të drejtës për pjesëmarrje efektive dhe të drejtës për të patur një mbrojtës.

Në protokollin 7 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të amenduar me Protokollin Nr. 11 parashikohet mbrojtje e posaçme nga shteti për fëmijët. Në nenin 5 të Protokollit Nr. 11 parashikon se bashkëshortët gëzojnë

e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm. 5. Çdo person, që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij Neni, ka të drejtën e zbatueshme të dëmshpërblimit.

⁴⁸ Shih nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ku përcaktohet se “çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë. 2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. 3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij; b) t’i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes; c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjetë të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë; d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të këtë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës; e) të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

⁴⁹ Shih nenin 6 paragrafi 3 pika a të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ku përcaktohet se

⁵⁰ Shih nenin 6 paragrafi 3 pika e të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ku përcaktohet se

barazinë e të drejtave dhe të përgjegjësiave me karakter civil midis tyre, si dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe gjatë zgjidhjes së saj. Ky nën nuk i pengon Shtetet që të marrin masat e nevojshme në interes të fëmijëve.

3.3.2. Karta Sociale Evropiane (E Rishikuar)

Karta Sociale Evropiane⁵¹ është një nga instrumentet më të rëndësishme të miratuar nga Këshilli i Evropës që daton në vitin 1961. Karta ka si qëllim dhe mbrojtje të drejtat shoqërore dhe ekonomike, themelore dhe plotëson Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në fushën e mbrojtjes shoqërore si vlera të mbrojtjes së të drejtave të njeriut janë KEDNJ-ja dhe Karta Sociale Evropiane (e Rishikuar) Shtetet nënshkruese të Kartës pranojnë se do të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme si të karakterit kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Karta Sociale Evropiane përbëhet nga 6 pjesë dhe në pjesën e parë të Kartës përcaktohen të drejtat e individëve.

Karta ofron një trajtim të veçantë për fëmijët duke i sanksionuar të drejtat e tyre në nene specifike. Kështu në pikën 7 të KEE-së përcaktohet se *“Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për mbrojtje të veçantë ndaj rreziqeve fizike dhe morale ndaj të cilave ata ekspozohen.”* Në pikën 17 të KEE-së përcaktohet se fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për mbrojtje të përshtatshme ekonomike, juridike dhe sociale. Pra, ky akt sanksionon në mënyrë të qartë që të miturit për shkak të pozitës së tyre meritojnë një mbrojtje të veçantë juridike dhe jo vetëm. Në pjesën e dytë të Kartës përcaktohen të drejtat me karakter detyrues. Kështu, në nenin 7 përcaktohet e drejta e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje. Në këtë dispozitë përcaktohen angazhimet që ndërmarrin palët nënshkruese të Kartës për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje. Kështu, Karta sanksionon dhe moshën minimale të punësimit moshën 15 vjeç. Po kështu, në nenin 7 paragrafi 2 të KEE-së përcaktohet se *“shtetet duhet të marrin masa që mosha minimale për pranim në punësim të jetë 18 vjeç përse u përket 19 punëve të përcaktuara që konsiderohen të rrezikshme ose të pashëndetshme;”* Pra, Karta e konsideron si të paligjshme punësimin e fëmijëve nën moshën 18 vjeç.

⁵¹ Karta Sociale Evropiane Manual, Karta u miratua më 1961, Botim i Këshillit të Evropës

Në nenin 17 të KEE-së përcaktohet e drejta e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje ekonomike, ligjore dhe sociale. Në këto nene i kushtohet një rëndësi e veçantë rritjes së fëmijëve në një mjedis i cili inkurajon zhvillimin e plotë të personalitetit të tyre dhe të aftësive të tyre mendore dhe fizike. Në paragrafin 1 të nenit 17 Karta i detyron palët nënshkruese që *“të mbrojnë fëmijët dhe të rinjtë nga neglizhenca, dhuna dhe shfrytëzimi.”* Karta ofron edhe një sërë të drejtash të tjera si e drejta për orientim profesional⁵², e drejta për arsim fillestar dhe të mesëm falas⁵³ etj. Këto të drejta ndihmojnë fëmijët që të qëndrojnë larg kriminalitetit dhe shërbejnë si politika sociale efektive për mbrojtjen e të rinjve nga faktorët kriminalë.

3.3.3. Konventa Europiane mbi Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve

Këshilli i Europës duke qenë se kishte si synim mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave më të mira të fëmijëve miratoi në 25 janar të vitit 1996 Konventën Europiane mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve⁵⁴. Fusha e veprimit dhe objekti i konventës ishte te fëmijët që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç.⁵⁵ Objekti i Konventës përcaktohet në nenin 1 paragrafi 2 ku më konkretisht thuhet se *“Objekti i kësaj konvente është, në interesat më të mira të fëmijëve, që të promovojë të drejtat e tyre, t’u japë atyre të drejta procedurale dhe të lehtësojë ushtrimin e këtyre të drejtave, duke siguruar që fëmijët, vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, të informohen dhe të lejohen për të marrë pjesë në procedime që ndikojnë tek ata para një autoriteti gjyqësor”* Për qëllime të kësaj konvente, procedimet para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë fëmijët janë procedimet familjare, në veçanti ato që përfshijnë ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, si vendbanimi dhe aksesit të fëmijët.⁵⁶

Konventa proklamon të drejtën për t’u informuar dhe për të shprehur pikëpamjet e tij ose të saj në procedim. Kështu, në nenin 3 të saj përcaktohet se *“Një fëmijë, që sipas ligjit të brendshëm konsiderohet se ka arsyetim të mjaftueshëm, në rast të*

⁵² Shih nenin 9 të Kartës Sociale Evropiane të vitit 1961.

⁵³ Shih nenin 17 paragrafi 2 i Kartës Sociale Evropiane të vitit 1961.

⁵⁴ Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën me ligjin nr. 10425, datë 2.6.2011, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 77, datë 14 Qershor 2011, Faqe 3216. Ky ligj ka hyre në fuqi më dt. 1 Shkurt 2012.

⁵⁵ Shih nenin 1 paragrafi 1 të Konventës Europiane mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve të vitit 1996

⁵⁶ Shih nenin 1 paragrafi 3 të Konventës Europiane mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve të vitit 1996

procedimeve para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë tek ai/ajo, i jepet dhe ka të drejtë të kërkojë të drejtat e mëposhtme: a) të marrë të gjithë informacionin përkatës; b) të konsultohet dhe të shprehë pikëpamjet e tij ose të saj; c) të informohet për pasojat e mundshme të përputhshmërisë me këto pikëpamje dhe pasojat e mundshme të çdo vendimi.” Konventa ofron një mbrojtje specifike dhe të detajuar të të miturve në lidhje e me procedimet që mund të ndikojnë në jetën e tyre. Kështu në nenin 7 të saj Konventa i akordon fëmijve të drejtën të kërkojë, personalisht ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, një përfaqësues të posaçëm në procedimet para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë të fëmija, ku ligji i brendshëm përjashton mbajtësit e përgjegjësive prindërore nga përfaqësimi i fëmijës si rezultat i konfliktit të interesit me këtë të fundit. Shtetet janë të lira të kufizojnë të drejtën në paragrafin 1, të fëmijëve të cilët sipas ligjit të brendshëm, konsiderohen se kanë arsyetim të mjaftueshëm.

Në procedimet që ndikojnë tek fëmija, para se të marrë një vendim, autoriteti gjyqësor: shqyrton nëse ka informacione të mjaftueshme në dispozicion, me qëllim që të marrë një vendim në interesat më të mira të fëmijës dhe, kur është e nevojshme, të marrë informacione të mëtejshme, në veçanti nga mbajtësit e përgjegjësive prindërore; në rastin kur fëmija, sipas ligjit të brendshëm, konsiderohet të këtë arsyetim të mjaftueshëm: - garanton që fëmija ka marrë të gjithë informacionin përkatës; - këshillohet me fëmijën drejtpërdrejt në raste të caktuara, nëse është e nevojshme privatisht, vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, në një mënyrë që përshtatet me arsyetimin e tij ose të saj, nëse kjo do të ishte haptazi në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës; - lejon fëmijën të shprehë pikëpamjet e tij ose të saj; c) i jep rëndësinë e duhur pikëpamjeve të shprehura nga fëmija.⁵⁷

Në procedimet që ndikojnë te një fëmijë, autoriteti gjyqësor vepron shpejt për të shmangur çdo vonesë të panevojshme dhe vihen në dispozicion procedura për të garantuar që vendimet e tij të zbatohen me shpejtësi. Në raste urgjente, sipas rastit, autoriteti gjyqësor ka kompetencën për të marrë vendime, të cilat janë menjëherë të zbatueshme. Detyrimi për të vetëvepruar sipas kërkesës së vet përcaktohet nga ligji i brendshëm, kur mirëqenia e një fëmije është në rrezik serioz.

⁵⁷ Shih nenin 10 të Konventës Europiane mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve të vitit 1996.

3.3.4. Konventa Europiane “Për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve dhe Trajtimeve Çnjerëzore apo Poshtëruese”

Mbrojtja e individëve ndaj akteve me karakter barbar dhe degradues ishte një masë tejet e rëndësishme për shëndetin e tyre fizik, moral edhe mendor. E gjendur në kushte të akteve vandaliste dhe barbare pas Luftës së Dytë Botërore Europa ndjeu nevojën e hartimit të një akti që do të mbronte të drejtat e individëve nga këto akte. Kështu, Këshilli i Europës, me Konventën e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, e 4 nëntorit 1950, arriti rezultate të rëndësishme dhe mbi parimet e saj hartoi Konventën Europiane “Për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve dhe Trajtimeve Çnjerëzore apo Poshtëruese. Tortura dhe dënimet ose trajtimet çnjerëzore ose poshtëruese dënohen nga legjislacionet kombëtare dhe nga disa instrumente ndërkombëtarë. Megjithatë, eksperiencia tregoi nevojën e masave ndërkombëtare më të gjera dhe më efikase, sidomos për forcimin e sigurisë së personave të privuar nga liria. Duket se ky sistem, i cili bazohet mbi ankesa të bëra nga individë ose Shtete duke iu referuar shkeljeve të të drejtave të njeriut, mund të plotësohet në mënyrë të dobishme me një mekanizëm jo gjyqësor me karakter parandalues i cili do të kishte për detyrë të shqyrtonte trajtimin e personave të privuar nga liria me qëllim forcimin, nëse nevojitet, mbrojtjen e tyre kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese. Për këto arsye kjo Konventë krijoi një komitet të aftë për të vizituar çdo vend që i përket juridiksionit të Palëve ku personat janë të provuara nga liria nga ana e një autoriteti publik.

Komiteti ka si funksion të kryejë vizita dhe, nëse nevojitet, të sugjerojë përmirësime për të mbrojtur më mirë personat e privuar nga liria kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese. Nuk i përket komitetit të marrë përsipër funksione gjyqësore; ai nuk ka pra për detyrë të shprehet mbi shkeljet e mundshme të instrumenteve ndërkombëtarë të zbatueshëm. Si rrjedhim, ai nuk duhet të shprehë mendimin e tij lidhur me interpretimin e këtyre instrumenteve, qoftë në mënyrë abstrakte, qoftë në lidhje me rastet konkretë. Në momentin e marrjes së vendimit për hartimin e rekomandimeve, sigurisht që komiteti duhet të vlerësojë faktet e konstatuara gjatë vizitave të tij. Duke mos qenë kompetent për dëgjimin e dëshmitarëve në

përputhje me parimet e përgjithshme të procedurës gjyqësore, ai nuk ka bazë të mjaftueshme për të hartuar rekomandime në rast se faktet nuk janë të qarta dhe kur nevojitet një hetim i mëtejshëm. Në këtë rast, ai mund të njoftojë Shtetin e interesuar, t'i sugjerojë një hetim të mëtejshëm në nivel shtetëror dhe t'i kërkojë informim për rezultatet. Komiteti nuk ka aftësi të dënojë Shtetet por, në një frymë bashkëpunimi dhe me anë të këshillave, mund të përmirësojë, në rast se është e nevojshme, mbrojtjen e personave të privuar nga liria.

Ndalimi i torturës dhe i dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese është një normë ndërkombëtare e përgjithshme e cila, edhe pse e formuluar ndryshe, haset në instrumente të ndryshme ndërkombëtare, si nenin 3 i Konventës europianë të të Drejtave të Njeriut. Jurisprudenca e Gjykatës dhe e Komisionit Europian të të Drejtave të Njeriut në lidhje me nenin 3 ofron një guidë për komitetin. Megjithatë, aktivitetet e këtij orientohen nga parandalimi dhe jo nga zbatimi i kërkesave juridike në situata konkrete. Komiteti nuk duhet të kërkojë të ndërhyjë në interpretimin dhe zbatimin e nenit 3. Me këtë dispozitë, Palët në konventë pranojnë të autorizojnë vizitat në çdo vend që ndodhet nën juridiksionin e tyre ku një ose disa persona janë të privuar nga liria nga ana e një autoriteti publik. Fakti që privimi nga liria rrjedh ose jo nga një vendim formal është, në këtë kontekst, pa pasoja.

Konventa zbatohet jo vetëm në kohë paqeje por dhe në kohë luftë ose në rast të çdo rreziku tjetër publik. Konventa zbatohet pra, për shembull, në vendet ku personat mbahen në paraburgim të përkohshëm, të burgosur pasi të jenë gjetur fajtorë për shkelje, të mbajtur në ndalim administrativ ose të internuar për arsye mjekësore, ose në vendet ku të miturit mbahen nga një autoritet publik. Ajo zbatohet dhe në arrestimin nga autoritet ushtarakë. Vizita e vendeve ku personat janë të privuar nga liria për arsye të gjendjes së tyre mendore duhet të përgatitet dhe drejtohet me kujdes, sidomos në lidhje me, për shembull, cilësimet dhe eksperiencën e personave të zgjedhur për vizitën si dhe kushtet në të cilat ajo zhvillohet. Për më tepër, duke proceduar me vizitat e tij, komiteti do të dojë me siguri të marrë parasysh rekomandimet përkatëse të miratuara nga Komiteti i Ministrave.

3.3.5. Konventa Evropiane “Për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht” ratifikuar me Ligjin nr. 8724 datë 26.12.2000

Ky është një instrument i rëndësishëm në kontekstin e lirimimit me kusht si edhe të mbikëqyrjes së personave të dënuar. Nga vetë emërtimi i këtij instrumenti, del i qartë ridimensionimi i drejtësisë penale në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Konventa evidenton rëndësinë që ka rehabilitimi social i autorëve të veprave penale të dënuar apo të liruar me kusht, si edhe nga ana tjetër vënia në ekzekutim e sanksioneve të vendosura nga gjykata në rastin kur kushtet e parashikuara prej saj nuk janë përmbushur. Përmes këtij instrumenti nënvizohet edhe një herë rëndësia e bashkëpunimit në luftën kundër kriminalitetit si edhe qëllimi unik sa i përket respektimit të vendimeve (përfundimtare dhe të ekzekutueshme) të ndërmarra nga autoritetet gjyqësore qoftë edhe në njërin prej shteteve anëtare dhe kur përmbushja e tyre bëhet në territorin e një shteti tjetër.

Konventa është e ndarë në pesë tituj. Në titullin e parë trajton parime themelore dhe termat e referencës si keqbërës dhe dënim. Konventa është e aplikueshme vetëm për vendime të cilat janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme, si edhe kur bëhet fjalë për vepra penale të cilat janë të dënueshme nga legjislacioni i të dy shteteve që bashkëpunojnë në këtë drejtim. Në këtë instrument janë renditur të gjitha modalitetet e paraqitjes së kërkesës (prej shtetit që ka dhënë vendimin e dënimit) e të përmbajtjes së saj dhe të reagimit ose mënyrave të pranimit të kësaj kërkesë (prej shtetit në territorin e të cilit “keqbërësi” ka vendbanimin e zakonshëm).

Konventa parashikon gjithashtu detyrimin për refuzim si edhe mundësinë e refuzimit të mbikëqyrjes, ekzekutimit ose zbatimit të plotë. Shteti kërkuar dhe shteti i kërkuar informojnë, kur është e nevojshme, reciprokisht njëri-tjetrin për çdo rrethanë që ka të bëjë me përmbushjen e masave të mbikëqyrjes në territorin e shtetit të kërkuar ose vënien në ekzekutim të dënimit në këtë shtet. Në titullin e dytë trajtohen çështje që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen. Shteti kërkuar i bën të njohur shtetit zbatues kushtet që i janë caktuar keqbërësit dhe, kur është rasti, masat e mbikëqyrjes, të cilave ky është i detyruar t’u nënshtrohet gjatë periudhës së provës. Në këtë rast, shteti zbatues ka diskrecion që mbikëqyrjen ta përshtatë me legjislacionin e vet duke mos rënduar asnjë masë qoftë në drejtim të llojit qoftë në drejtim të kohëzgjatjes.

Konventa i kushton një rëndësi të veçantë rregullave lidhur me komunikimin ndërmjet shteteve në çdo fazë të mbikëqyrjes dhe bërjen transparente të çdo veprimi nga ana e shtetit zbatues, kjo sepse është në kompetencë të shtetit kërkues nëse “keqbërësi” ka përmbushur kushtet. Titulli i III trajton çështje që lidhen me ekzekutimin e dënimeve. Edhe në këtë aspekt, vënia në lëvizje e shtetit zbatues varet nga shteti kërkues. Ekzekutimi behet në përputhje me ligjin e shtetit të kërkuar por duke respektuar sa më shumë të jetë e mundur parimin e analogjisë në kuptimin e llojit dhe masës së dënimit, etj. Shteti zbatues është kompetent në çështje të lirimit me kusht. Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kësaj Konventë është Ministria e Drejtësisë.

3.3.6. Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar” e ratifikuar me Ligjin nr. 8499, datë 10.6.1999

Qëllimi i Këshillit të Evropës ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë arritja e unitetit dhe zhvillimi i një bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e së drejtës penale, çuarja më tej e qëllimeve të drejtësisë dhe rehabilitimi shoqëror i personave të dënuar, mundësia që të huajve të dënuar me heqje lirie, duke i transferuar në vendet e tyre, t’u jepet mundësia të vuajnë dënimin në shoqërinë e tyre. Për të realizuar këto objektiva KE-ja hartoi Konventën “Për transferimin e personave të dënuar” të cilën shteti shqiptar e ka ratifikuar me Ligjin nr. 8499, datë 10.6.1999.

Në këtë instrument do të gjejmë në mënyrë më të detajuar rregulla lidhur me kushtet për transferim⁵⁸, detyrimin për të dhënë informacion ose detyrimin për respektimin e të drejtës së informimit të të dënuarit; rregullat lidhur me kërkesat dhe përgjigjet ndërmjet shteteve në rastet e transferimit të të dënuarve; detyrimin për paraqitjen e dokumenteve shtesë dhe rregullat lidhur me to; rëndësinë për marrjen e pëlqimit të të dënuarit për transferim; efektet e transferimit, reciprokisht, për të dy shtetet parë si në këndvështrimin e atij dënues dhe atij zbatues. Kjo Konventë parashikon edhe rregullat lidhur me vazhdimin e ekzekutimit të dënimit në kuptimin që shteti zbatues është i detyruar t’i përmbahet natyrës ligjore dhe kohëzgjatjes së dënimit, siç është përcaktuar në shtetin dënues.

⁵⁸ Shih nenin 3 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar”.

Këtu përcaktohet se për nga natyra ose kohëzgjatja, ai nuk duhet të rëndojë sanksionin e dhënë nga shteti dënues dhe nuk duhet të kalojë maksimumin e parashikuar nga shteti zbatues. Gjithashtu në Konventë gjejmë norma lidhur me konvertimin e dënimit ku ndër të tjera gjejmë disa rregulla si: ndalimin e rëndimit të dënimit, nuk mund të konvertohet një dënim me burgim në një dënim me gjobë etj.⁵⁹ Gjithashtu, Konventa parashikon të drejtën e faljes, amnistisë e zëvendësimit si një të drejtë të çdo shteti dhe të rishikimit të vendimit si e drejtë vetëm e shtetit dënues i cili ka të drejtën për të vendosur mbi çdo kërkesë për rishikimin e vendimit. Sa i përket përfundimit të ekzekutimit, shteti zbatues përfundon ekzekutimin e dënimit menjëherë sapo të informohet nga shteti dënues për çdo vendim ose masë si rezultat i të cilit dënimi duhet të përfundojë. Gjithashtu, Konventa ka parashikuar rregullime edhe lidhur me kalimin tranzit të personave të transferuar, duke përfshirë në këtë mënyrë një rregullim gjithëpërfshirës.

3.3.7 Konventa e Këshillit të Evropës “Për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 8498, datë 10.6.1999

Konventa e Këshillit të Evropës “Për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale” është e ndarë në tetë tituj. Në titullin e parë trajtohen çështje të përgjithshme duke përfshirë këtu angazhimin për bashkëpunimin gjyqësor dhe mos zbatimin e konventës gjatë ekzekutimit të masës së arrestit dhe të dënimeve, si edhe për krimet ushtarake që nuk përbëjnë krime të së drejtës së përgjithshme. Konventa rendit rastet e refuzimit të ndihmës juridike: rastet e krimeve politike ose krimeve që lidhen me krime politike ose krimet fiskale, në rastet kur çmohet se ekzekutimi i kërkesës mund të sjellë cenim të sovranitetit, të sigurisë, të rendit publik ose të interesave esenciale të vendit përkatës.

Në titullin e dytë gjen vend normimi i çështjes së letërporosisë. Në titullin e tretë trajtohet pranimi i akteve procedurale dhe të masave paraprake gjyqësore, dalja e dëshmitarëve, ekspertëve dhe personave që i nënshtrohen procesit penal. Në vijim (titulli 4) trajtohen çështje që kanë të bëjnë me gjendjen gjyqësore; titulli 5 ndalet në procedurën e rasteve të ndihmës juridike; titulli 6 në denoncimet me qëllim procedimi

⁵⁹ Shih nenin 11 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënur.

penal. Protokolli shtesë i Konventës së Këshillit të Evropës për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale (ETS Nr. 99) në nenin 3/b nënvizon se Konventa zbatohet për masën që rregullojnë pezullimin e shpalljes së një dënimi ose ekzekutimin e tij, lirimin me kusht, shtyrjen e e fillimit të ekzekutimit të dënimit ose pezullimin e tij.⁶⁰

3.3.8. Konventa e Këshillit të Evropës “Për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 9068, datë 15.5.2003

Konventa nënvizon nevojën e ndjekjes së një politike penale të përbashkët në nivel evropian me qëllim mbrojtjen e shoqërisë dhe ndërmarrjen e përdorimin e mënyrave moderne dhe efikase në luftën kundër kriminalitetit duke respektuar mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe nxitjen e rehabilitimit të autorëve të veprave penale.

Konventa është e përbërë nga disa kapituj ku ndër të cilët do të theksojnë se në Kapitullin 1 Konventa i përmban kufizimet. Në Kapitullin 2 kjo Konventë trajton ekzekutimin e vendimeve penale europiane. Kështu në nenin 5/b përcakton se “Shteti dënues mund t’i kërkojë një shteti tjetër palë të ekzekutojë sanksionin vetëm nëse është përmbushur “se ekzekutimi i sanksionit në shtetin tjetër duket se do të sjellë shtimin e mundësive për rehabilitimin social të personit të dënuar”. Pasojat e transferimit të ekzekutimit; Dispozita të ndryshme lidhur me tranzitimin, shpenzimet, etj. Po këtu, trajtohet me detaje kërkesa për ekzekutim në aspektin formal dhe substancial dhe të autoritetit përgjegjës; gjykimet në mungesë dhe vendimet penale; masat e përkohshme. Në Kapitulli 3 Konventa trajton pasojat ndërkombëtare të gjykimeve penale europiane.

3.3.9. Konventa e Këshillit të Evropës “Për Transferimin e Procedimeve në Çështjet Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 8497, datë 10.6.1999

Konventë kishte si qëllim arritjen e një uniteti më të madh midis anëtarëve si edhe sigurimin, me frymën e një mirëbesimi reciprok të organizimit të procedimeve penale në nivel ndërkombëtar e në veçanti duke shmangur disavantazhet që rezultojnë nga konfliktet e kompetencave si edhe synimin e arritjes së sanksioneve më të drejta dhe më frytdhënëse. Konventa është e organizuar në pesë pjesë.

⁶⁰ Shih nenin 3/b të Konventës e Këshillit të Evropës “Për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale”

Në pjesën e parë jepen termat e referencës ose përkufizimet e termave të përdorura prej saj. Pjesa e dytë trajton çështje të kompetencës duke nënvizuar se çdo shtet kontraktues në pajtim me një kërkesë për procedime të paraqitura nga një shtet tjetër kontraktues do të këtë kompetencën të ndjekë penalisht sipas ligjit të tij penal çdo vepër penale ndaj së cilës është i zbatueshëm ligji i një shteti tjetër kontraktues. Këtu gjithashtu zënë vend çështje të heqjes dorë nga ndjekja penale ose ndërprerja e procedimit deri në një vendim përfundimtar në shtetin tjetër kontraktues; mos kufizimit të kompetencës që i jepet një shtet të kërkuar prej ligjit të brendshëm për sa i përket ndjekjes penale. Pjesa e tretë⁶¹ trajton gjithë problematikën e transferimit të procedimeve të realizuar në pesë seksione.

3.3.10. Rekomandimi Cm/Rec 2008 (11) i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Rregullat Evropiane, për të dënuarit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve ose masave

Qëllimi i rekomandimit është të rrisë unitetin midis shteteve anëtare duke harmonizuar ligjet mbi çështje të përbashkëta për një bashkëveprim në nivel evropian për të mbrojtur më mirë të drejtat dhe mirëqenien e të miturve që hyjnë në konflikt me ligjin si dhe për të zhvilluar sistemet e drejtësisë për të mitur në interes të të miturve. Shkelësit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve ose masave do të trajtohen duke respektuar të drejtat e tyre njerëzore. Sanksionet dhe masat që do të imponohen mbi të miturit si dhe mënyra e implementimit duhet të jenë të specifikuara në ligj dhe të bazohen në parimet e integritetit social, arsimimit dhe parandalimit të shkeljeve. Sanksionet dhe masat do të caktohen nga gjykata ose një autoritet tjetër i ligjshëm dhe do t'i nënshtrohen një gjykimi të shpejtë si dhe do të imponohen për periudha minimale dhe vetëm për qëllime legjitime.

Vendosja dhe zbatimi i sanksioneve ose masave do të bazohet në interesin më të lartë të fëmijëve, duke marrë parasysh veprën e kryer (*proporcionaliteti*) si dhe moshën e tyre, mirëqenien fizike dhe mendore, zhvillimin, kapacitetet dhe rrethanat personale (*parimi i individualizimit*), mbështetur në raporte psikologjike, psikiatrike dhe sociale.

⁶¹ Shih nenet 6-29 të Konventa e Këshillit të Evropës “Për Transferimin e Procedimeve në Çështjet Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 8497, datë 10.6.1999

Sanksionet dhe masat nuk do të jenë të tilla që të fyejnë ose të degradojnë të miturin subjekt të tyre. Sanksionet ose masat nuk do të zbatohen në mënyrë që të përkeqësojnë karakterin apo të vënë në rrezik shëndetin mendore fizik të fëmijës. Sanksionet ose masat do të zbatohen pa vonesë dhe deri në masën dhe periudhën e nevojshme (parimi i ndërhyrjes minimale). Privimi nga liria i të miturit do të jetë një masë e shkallës së fundit dhe do të imponohet dhe zbatohet për një periudhë sa më të shkurtër që të jetë e mundur. Përpjekje të mëdha duhen bërë për të shmangur paraburgimin. Sanksionet ose masat do të caktohen dhe zbatohen pa diskriminim të asnjë lloji për arsye gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, orientimi seksual, mendimi politik apo ndonjë statusi tjetër (parimi i mosdiskriminimit).

Ndërmjetësimi apo masat e tjera duhen inkurajuar në të gjitha fazat e procesit që kanë të bëjnë me të miturin si shkelës i ligjit. Çdo sistem drejtësie që ka të bëjë me të miturit duhet të sigurojë pjesëmarrjen e tyre efektive për sa i përket imponimit të masave ose sanksioneve. Të vegjlit nuk do të kenë më pak të drejta se të rriturit për mbrojtje ligjore, sipas Kodit të Procedurës Penale. Çdo sistem drejtësie që ka të bëjë me të miturit duhet të marrë parasysh të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve ose kujdestarëve ligjorë dhe, për aq sa është e mundur, duhet t'i përfshijë ata në procedurën e ekzekutimit të masave ose sanksioneve, përveç kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës. Çdo sistem drejtësie për të miturit duhet të ndjekë një qasje shumë disiplinore dhe të integrohet me iniciativat e shumta për vazhdimësinë e kujdesit për të miturit (Parimi i përfshirjes së komunitetit dhe i kujdesit të vazhdueshëm). E drejta e intimitetit do të respektohet plotësisht në të gjitha fazat e procedurës. Identiteti i të miturit dhe informacionet për të nuk do të publikohen.

3.4.Të drejtat e të miturve në instrumentet e Bashkimit Europian

Bashkimi European është krijuar mbi një marrëveshje ndërkombëtare shumëpalëshe ndërmjet shteteve anëtare duke gëzuar kështu një status ndërkombëtar të veçantë në krahasim me organizatat e tjera ndërkombëtare. Sistemi politik i BE-së është i veçantë dhe me procedura krejt të veçanta sa i takon vendimmarrjes. (Canaj - Bana. 2014:63). Integrimi European është sfida e BE-së dhe vendimmarrja realizohet nga institucionet e

saj, por shtetet anëtare ruajnë sovranitetin dhe ekskluzivitetin në disa fusha. Instrumentet dhe legjislacioni i BE-së është i detyrueshëm për zbatim vetëm në vendet anëtare të tij, dhe vendet jo anëtare të cilat synojnë të aderojnë në Bashkimin European janë të detyruara të përafrojnë e të përshtatin legjislacionin e tyre me atë të BE, nëse aspirojnë të anëtarësohen në të ardhmen. Aspirata e anëtarësimit në BE nuk sjell vetëm të drejta por sjell dhe një sërë detyrimesh për çdo shtet që aspiron të bëhet pjesë e Bashkimit. Për vendin tonë procesi i integritit sjell detyrime për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe e të miturve në veçanti.

Shqipëria synon të aderojë në Bashkimin European dhe një ndër detyrat primare është përafrimi i legjislacionit tonë me atë të BE-së. Në këto kushte vendi ynë ka hartuar një Plan Kombëtar për përafrimin e legjislacionit të saj me atë të BE-së dhe për zbatimin e MSA. Ky plan parashikon një sërë masash lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut. Veprimtaria e përshtatjes dhe përafrimit të legjislacionit të brendshëm me atë të BE do të jetë për një kohë të gjatë fokusi i punës së grupeve të punës që janë ngritur për këtë qëllim. Burimet kryesore të së drejtës komunitare janë traktatet dhe direktivat. Mekanizmi zbatues i së drejtës komunitare është Komisioni Evropian. Disa nga aktet kryesore të cilat trajtojnë të drejtat e të miturve në legjislacionin e Bashkimit evropian janë:

1. Traktatet e BE-së.
2. Karta e të drejtave themelore të BE-së.
3. Direktivat për drejtësinë për të miturit, Vjenë 1997.
4. Direktiva e Këshillit Ekonomik dhe Social (2005).

Më poshtë do të trajtojmë shkurtimisht këto akte duke nënvizuar rëndësinë e tyre në mbrojtjen e të drejtave të të miturve.

3.4.1. Traktati i Lisbonës

Traktati i Lisbonës përbën një nga arritjet më të mira dhe shënon një hap të rëndësishëm të rrugës së Bashkimit European drejt konsolidimit të mëtejshëm të vlerave të përbashkëta mbi të cilat është krijuar ai. Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës

më 1 dhjetor 2009,⁶² reformimi dhe modernizimi i institucioneve europiane bën të mundur promovimin e plotë të objektivave të BE-së në shërbim të qytetarëve dhe shteteve anëtare si dhe konsolidon urën lidhëse mes qytetarëve dhe projektit europian, të nisur në fillim të viteve 50 drejt “pajtimit” dhe “unifikimit” të kontinentit europian.⁶³ Traktati parashikon respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe të shtetit të së drejtës. Kështu, ai në nenin 3 paragrafi 3 të TBE-së përcakton se *“Bashkimi lufton përjashtimin social dhe diskriminimin, nxit drejtësinë dhe mbrojtjen sociale, barazinë midis grave dhe burrave, solidaritetin midis brezave si dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.”* Nëpërmjet këtij neni Traktati i Lisbonës rrit potencialin e BE-së për të përmirësuar normat ligjore për të drejtat e fëmijëve. Pra, nëpërmjet përcaktimit dhe trajtimit të të drejtave të fëmijëve në pjesën e përgjithme të tij, Traktati nxit mbrojtjen e këtyre të drejtave si një objektiv të përgjithshëm i BE-së.

Në nenin 3 paragrafi 5 të TBE-së përcaktohet se *“Në marrëdhëniet me botën, Bashkimi mban dhe nxit vlerat dhe interesat e veta si dhe jep kontribut në mbrojtjen e qytetarëve të tij. Ai kontribuon për paqen, sigurinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Tokës, solidaritetin dhe respektin e ndërsjellë midis popujve, tregtinë e lirë dhe të ndershme, zhdukjen e varfërisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sidomos të të drejtave të fëmijëve, si edhe zbatimin rigoroz dhe zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë edhe respektimin e parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara.”* Pra, del ne pah edhe karakteri bashkëpunues në politikën e jashtme të marrëdhënieve të BE-së në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Në lidhje me të drejtat e të miturve Traktati i Lisbonës i ka përfshirë në nenin 79 paragrafi 2 dhe neni 83 të TFBE-së. Kështu ka bërë të mundur që Bashkimi Europian të miratojë masa legjislative që synojnë luftën kundër shfrytëzimit seksual dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Në nenin 79 paragrafi 2 pika d përcaktohet se *“Për qëllimet e paragrafit 1, Parlamenti Europian dhe Këshilli miratojnë, sipas procedurës së zakonshme legjislative, masa në fushat e mëposhtme: d) lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në veçanti të grave dhe fëmijëve.”* Në nenin 83 paragrafi 1 përcaktohet se *“Parlamenti Europian dhe Këshilli, përmes direktivave të miratuara sipas procedurës së zakonshme legjislative, mund të vendosin rregulla minimale lidhur*

⁶² EU (2007), Treaty of Lisbon amending the Treaty on European Union and the Treaty establishing the European Community, signed at Lisbon, OJ 2007 C 306, pp. 1–271.

⁶³ Shih hyrjen e Traktatit të Lisbonës i datës 1 dhjetor 2009.

me përkufizimin e veprave penale dhe sanksionet në fushat e krimeve, veçanërisht të rënda me dimensione ndërkufitare, që rrjedhin nga natyra ose efekti i veprave të tilla penale ose nga një nevojë e veçantë për t'i luftuar këto vepra penale mbi një bazë të përbashkët. Këto fusha kriminaliteti janë: terrorizmi, trafikimi i qenieve njerëzore dhe shfrytëzimi seksual i grave dhe fëmijëve, trafikimi i paligjshëm i drogave, trafikimi i paligjshëm i armëve, pastrimi i parave, korrupsioni, falsifikimi i mjeteve të pagesës, krimi kompjuterik dhe krimi i organizuar.” Nisur nga dispozitat e mësipërme arrijmë në përfundimin se në Bashkimin Europian të drejtat e fëmijëve dhe raporti i tyre me ligjin është sanksionuar që në Traktatin e Lisbonës në përputhje me të cilin miratohen edhe direktivat dhe rregulloret specifike në varësi të fushave.

3.4.2. Karta e të drejtave themelore të BE-së

Karta e të drejtave themelore të BE ⁶⁴ u prezantua për herë të parë në Nisë në takimin e lartë të BE-së por nuk kishte fuqi detyruese për palët. Bashkimi Europian vendos individin në qendër të aktiviteteve të saj, duke krijuar shtetësinë e Bashkimit Europian dhe duke krijuar një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Bashkimi kontribuon në ruajtjen dhe zhvillimin e këtyre vlerave të përbashkëta duke respektuar diversitetin e kulturave dhe traditave të popujve të Europës, të identitetit kombëtar të Shteteve Anëtare dhe të organizimit të autoriteteve të tyre publike në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal; ajo kërkon të promovojë zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm dhe siguron lëvizjen e lirë të personave, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, duke i bërë ato më të dukshme në Kartë, për të forcuar mbrojtjen e të drejtave themelore drita e ndryshimeve në shoqëri, progresin social dhe zhvillimet shkencore dhe teknologjike.⁶⁵

Si një akt i cili ka si qëllim kryesor mbrojtjen e të drejtave të njeriut Karta përmban rregullime për të drejtat e fëmijëve. Kështu të drejtat e fëmijëve trajtohen në nenin 24 të Kartës ku përcaktohet se “1. Fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre. ata mund lirisht të shprehin mendimet e tyre; kjo është marrë parasysh në çështjet të cilat ata duhet në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre. 2. Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, nëse të marra nga autoritetet publike ose institucione private, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë

⁶⁴ EU (2012), Charter of Fundamental Rights of the European Union, OJ 2012 C 326.

⁶⁵ Shih preambulën e Kartes së të drejtave themelore të BE-së.

konsiderata mbizotëruese.” Pra, në këtë nen përcaktohet e drejta e shprehjes së mendimeve nga të miturit dhe e drejta vendimmarjes duke pasur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës.

3.4.3. Direktiva e Këshillit Ekonomik dhe Social (2005)

Është një nga direktivat më të rëndësishme lidhur me drejtësinë për fëmijët, viktimat dhe dëshmitarë të akteve kriminale. Në përmbajtjen e saj gjejmë disa të drejta si: E drejta për tu trajtuar me dinjitet dhe dhembshuri; mbrojtja nga diskriminimi; e drejta e informimit; e drejta për tu dëgjuar; e drejta për ndihmë efikase; e drejta e jetës private; mbrojtja nga paragjykimet në procesin e drejtësisë; e drejta për siguri; e drejta për tu riedukuar; përfitimi prej masave parandaluese. Sistemi i drejtësisë për të miturit është rregulluar nga ligjet, normat dhe referencat ndërkombëtare. Instrumentet ndërkombëtare formojnë një pikë referimi të përgjithshëm ligjor për vendosjen e një sistemi efikas të drejtësisë për të miturit.

Në të drejtën europiane ekziston një korpus i madh normash juridike që adresojnë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijës në sfera të ndryshme të marrëdhënieve që lindin dhe zhvillohen, si ato me karakter juridiko-penal, civil, familjar, të punës etj. Në mënyrë të përmbledhur dokumentet e sipërpërmendura e vendosin theksin mbi: mirëqenien e të miturit duke siguruar që çdo reagim ndaj të miturit të dënuar të jetë gjithmonë në përputhje me rrethanat e të dënuarit dhe të veprës penale; nxisin riintegrimin e të miturit dhe rifitim të një roli konstruktiv në shoqëri; zhvillojnë alternativat ndaj trajtimit me burgim ose institucional ose të kujdesit (edhe në rastet kur çështja është në gjykim e sipër) për të parandaluar kryerjen dhe përsëritjen e krimit dhe që të dënuarit e mitur të trajtohen sipas të drejtave që gëzojnë; Sigurojnë që të miturit të trajtohen në komunitetin e tyre sa më shumë të jetë e mundur. Në rastet kur ata mbahen në paraburgim, të miturit duhet të veçohen nga të rriturit; duhet të ndërmerren të gjitha masat dhe mjetet për të siguruar që ata të mbajnë lidhje me familjet e tyre; duhet të merren të gjitha masat për të përgatitur riintegrimin e tyre dhe kur ata të rikthen në komunitetin e tyre t'u sigurohet ndihma dhe përkrahja e duhur; Domosdoshmërinë e një stafi të kualifikuar dhe të trajnuar në të gjitha pjesët dhe komponentët e sistemit; Nënvizojnë se parandalimi i kriminalitetit tek të miturit kërkon

përpjekje nga e tërë shoqëria (familja dhe komuniteti). Mirëqenia e të rinjve që nga fëmijëria e tyre e hershme duhet të jetë në vëmendjen e çdo programi parandalimi. Duhet të hartohen programe dhe shërbime të orientuara drejt komunitetit për të parandaluar kriminalitetin tek të miturit.

3.5. Kuadri ligjor shqiptar për garantimin e të drejtave të fëmijëve

Pas viteve 90 Shqipëria doli nga një sistem tërësisht totalitar i cili kishte krijuar një legjislacion tejet të varfër dhe në kundërshtim me normat e të drejtës ndërkombëtare në lidhje me respektin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kështu, zhvillimet ekonomike, sociale, krijimi i marrëdhënieve ndërkombëtare krijojnë nevojën për ndryshimin dhe pasurimin e legjislacionit të brendshëm. Pra duhet të përputhej legjislacioni i brendshëm me atë ndërkombëtar në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të të miturve.

Shqipëria ratifikoi disa nga aktet më të rëndësishme ndërkombëtare dhe evropiane në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve duke i bërë ato pjesë të legjislacionit të brendshëm. Marrëveshjet ndërkombëtare kanë fuqi detyruese në vendin tone, në këto kushte hartimi i tyre ka detyruar legjislatorin që të marri të gjitha masat e duhura ligjore për të zbatuar këto kate. Të drejtat e të miturve përcaktohen në disa prej akteve më të rëndësishme të Republikës së Shqipërisë si Kushtetuta Kodi Penal, Kodi procedural penal dhe Ligji nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”. Këto akte do të jenë pjesë e analizës së mëposhtme.

3.5.1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kushtetuta është akti themeltar i Republikës së Shqipërisë i përbërë nga 183 nene. Të drejtat e fëmijëve janë të parashikuara në pjesën e dytë të Kushtetutës i cili trajton në kontekst të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Në nenin 54 paragrafi 3 përcaktohet se “Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij

normal.” Të drejtat e përcaktuar nga Kushtetuta nuk kanë një ndarje midis të rriturve dhe të miturve, çka do të thotë që parimet kryesore të drejtësisë penale dhe garancitë procedurale të të pandehurit të cilat nënkuptojnë shtrirjen e tyre edhe për të miturit në procesin penal. Kështu disa nga parimet më të rëndësishme janë

1. Presumimin e pafajësisë⁶⁶
2. Të drejtën për një proces të rregullt ligjor⁶⁷
3. E drejta për integritet moral e fizik⁶⁸
4. Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues.
5. Mos cenimi dhe mos kufizimi i lirisë⁶⁹ etj.

Neni 27 në lidhje me të miturit gjen zbatim vetëm për mbikëqyrjen e tij për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent. Në nenin 116 parashikohet se “*Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: 26 a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave. 2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.*” Pra, Kushtetuta ka përcaktuar vendin që kanë instrumentet ndërkombëtare në sistemin e brendshëm si edhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Marrëveshjet ndërkombëtare zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetë-zbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ato kanë epërsi ndaj ligjeve të vendit.

3.5.2. Ligji nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”

Ligji nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës” është miratuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë si një nismë ligjore e cila synon dhe

⁶⁶ Shih nenin 30 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë “Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”.

⁶⁷ Shih nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

⁶⁸ Shih nenin 25 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

⁶⁹ Shih nenin 27 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

ka për qëllim “a) mbrojtjen e veçantë të të drejtave të fëmijës nëpërmjet realizimit të një kuadri të plotë ligjor dhe institucional, në zbatim të Kushtetutës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi; b) marrjen e masave për t’i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij; c) marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës; ç) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës.”⁷⁰

Objekt i ligjit janë vetëm të drejtat e fëmijëve dhe përkujdesja e posaçme për ta.⁷¹ Ligji në nenin 3 pika d përcakton termin “fëmijë”. Kështu, sipas pikës d të këtij neni “Fëmijë” është çdo person i lindur gjallë, deri në moshën 18 vjeç. Në rastin kur moshë e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është fëmijë, ky person konsiderohet fëmijë dhe përfiton nga ky ligj derisa moshë e tij të jetë përcaktuar plotësisht.” Ligji nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës” disponon një fushë zbatimit për fëmijët që ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe për fëmijët me shtetësi shqiptare që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.⁷²

Në nenin 5 të këtij ligji përcaktohen të gjitha parimet e përgjithshme si interesi më i lartë i fëmijës, barazia pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo lloj opinionin tjetër, origjina kombëtare, etnike apo shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare a çdo gjendje tjetër e fëmijës ose e prindërve/përfaqësuesve ligjorë të tij, eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit ose të ndëshkimit të fëmijës, për shkak të pozitës, të veprimtarive, të opinionëve të shprehura apo të bindjeve të prindërve/përfaqësuesve ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij etj.⁷³ Në nenin 25 të këtij ligji përcaktohet se fëmija mbrohet dhe nuk lejohet që të

⁷⁰Shih Neni 2 i Ligji nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”.

⁷¹Shih neni 2 i Ligji nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës” Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës, që garantojnë realizimin me efektivitet të mbrojtjes së këtyre të drejtave, si dhe përkujdesjen e posaçme për fëmijën.”

⁷² Shih Neni 4 të i Ligji nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”.

⁷³ Shih Neni 5 të i Ligji nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës

përfshihet në një konflikt të armatosur. Në këto nene del në pah karakteri parandalues dhe mbrojtës i fëmijës.⁷⁴

Në paragrafin 2 dhe 3 të nenin 25 përcaktohet se “Në rast konflikti të armatosur, fëmijës i garantohet një respekt i veçantë dhe mbrojtje nga çdo formë sulmi të paligjshëm. Gjatë konfliktit fëmijës i sigurohet kujdes e ndihmë e veçantë, në përputhje me moshën dhe për çdo arsye tjetër. 3. Nëse arrestohet ose ndalohet për arsye, që lidhen me konfliktin e armatosur, fëmija do të mbahet në mjedise të veçanta nga të rriturit, përveç rasteve kur është ndaluar me familjen e tij.” Institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve janë të ndara në nivel qendror dhe në nivel vendor. Institucionet në nivel qendror janë:

1. Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës;
2. Ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
3. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.⁷⁵

Institucionet në nivel vendor janë: a) Njësia për të drejtat e fëmijës në këshillin e qarkut; b) Njësia për mbrojtjen fëmijës në bashki/komunë.⁷⁶

3.5.3. Kodi i munguar i të drejtave të fëmijëve

Nisur nga fakti që në vitet e fundit kemi një trend gjithnjë e në rritje të përfshirjes së të miturve në aktivitete kriminale është të parë e domosdoshme krijimi i një sistemi ligjor më kompakt që të jetë në koherencë me kohën. Kuadri ligjor shqiptar në lidhje me trajnimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut paraqitet i copëzuar dhe sektorial. Përwsonalisht gjykoj se legjislacioni brendshëm ka nevojë për hartimin e një Kodi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve i cili do të përcaktonte në mënyrë të detajuar edhe pozitën e tyre juridike në raport me drejtësinë penale. Hartimi i një Kodi për të drejtat e fëmijëve do të ofronte një mbrojtje më të lartë të fëmijës, integrim social,

⁷⁴ Shih Neni 55 të i Ligji nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës “Fëmija nuk lejohet të përfshihet drejtpërdrejt dhe tërthorazi në një konflikt të armatosur.”

⁷⁵ Shih Neni 32 paragrafi 2 të i Ligji nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës

⁷⁶ Shih Neni 32 paragrafi 3 të i Ligji nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës

rehabilitim të fëmijëve në konflikt me ligjin dhe parandalim në kryerjen e veprës penale. Duhet të theksojmë që në sistemin tonë të drejtësisë drejtësia miqësore për fëmijët është inekzistente. Për këtë arsye janë hedhura hapa pozitiv drejt përqasjes së legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtare të garantuara në aktet ndërkombëtare.

Krijimi i një Kodi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (KDF) do të sillte edhe një sistem drejtësie më miqësore me fëmijët, sistem ky i cili garanton respektimin dhe zbatimin e të gjithë të drejtave të fëmijëve, në nivelin më të lartë. Aktualisht janë bërë hapa konkret për miratimin e këtij akti i cili do të parashikojë norma specifike procedurale për organet përgjegjëse gjatë procedurës së administrimit të drejtësisë; norma specifike procedurale që duhet të respektohen në proceset penale që afektojnë fëmijët si dhe rregulla të posaçme për ekzekutimin e vendimeve dhe masave të tjera.

Hartimi i KDF-së do të bënte një reformim të sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive të drejtave të tyre procedural. Pra, do të kishim një kuadër të ri ligjor të specializuar për drejtësinë për të mitur në Shqipëri duke implementuar standardet ndërkombëtare në të drejtën kombëtare. Do të kishim një akt i cili do të ndante dispozitat për të miturit nga Kodi Penal dhe ai Procedural Penal duke përcaktuar kështu dënime alternative më të larmishme se ato aktuale. Do të krijoheshin struktura të specializuara në institucionet e drejtësisë penale, të pajisura me kapacitetet, infrastrukturën si dhe burimeve e nevojshme (financiare ashtu edhe njerëzore) përgjegjëse për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin si dhe do të zhvilloheshin trajnime për përfaqësuesit e institucioneve të sistemit të drejtësisë penale në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin. Krijimi i një legjislacioni adekuat do t'i jepte fund zvarritjes së procedimeve penale ku përfshiheshin fëmijët dhe çështjet e të miturve do të trajtoheshin nga perona të specializuar për të drejtat e të miturve. Do të krijoheshin institucione të mirëfillta që do të administronin drejtësinë e të miturve me një staf të specializuar. Po kështu, Kodi do të rregullonte edhe krijimin e një dhome për të miturit në lidhje me rastet e ndërmjetësimit. Mendoj që një ndër aspektet më pozitive i KDF-së do të ishte procesi i rehabilitimi i të miturve në konflikt me ligjin.

Rehabilitimi është procesi më i rëndësishëm i cili kërkon edhe një impenjim të lartë si nga ana e institucioneve ligjvënëse edhe ligjzbatuese por edhe nga ana e shoqërisë. Të miturit janë embrioni i shoqërisë dhe procesi i rehabilitimit të miturve është tejet delikat dhe i rëndësishëm sepse ai edukon të ardhmen e shoqërisë. Hartimi i KDF-së do të çonte në krijimin e institucioneve riedukuese më vete dhe të ndara nga të rriturit me qëllim rehabilitimin e të miturve që janë përfshirë në krinimalitet.

3.6. Përafrimi i legjislacionit vendas me *acquis communautaire*

Procesi i integritetit është një rrugë e cila imponon detyrimisht përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë për të miturit. Megjithëse instrumentet e BE-së janë të lidhura vetëm me shtetet anëtare, vendet evropiane jo-anëtare siç është rasti i vendit tonë, që dëshiron të aplikojnë për anëtarësim duhet të harmonizojnë legjislacionin me standardet e BE-së. Plani Kombëtar për përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së dhe zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) parashikon një sërë masash legislative lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë që një kuadër i tërë ligjor do të jetë në një proces analize për t'u harmonizuar me standardet e BE-së. Në këtë drejtim, në kuadër të Bashkimit Evropian një instrument i rëndësishëm për t'u përmendur është Vendimi i Këshillit të BE-së 2008/947/JHA, datë 27 nëntor 2008 “Për zbatimin e parimit të njohjes reciproke të gjyqimeve dhe vendimeve për vënien në provë me qëllim mbikëqyrjen e masave për vënien në provë dhe sanksioneve alternative”.

Për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me atë të *acquis communautaire* vendi ynë ka marrë në konsideratë aktet më të rëndësishme që trajtojnë të drejtat e fëmijëve. Kështu, legjislacioni ynë është në përputhje me *acquis communautaire*. Në lidhje me legjislacionin parësor të BE-së mund të themi që Shqipëria ka inkorporuar nenin 24 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) i cili trajton të drejtat e fëmijëve. Kështu, në hartimin e legjislacionit të brendshëm është marrë në konsideratë neni 24 TFBE-së i cili përcakton se “1. Fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes dhe kujdesit të nevojshëm për mirëqenien e tyre. Ata mund t'i shprehin lirisht pikëpamjet e tyre. Pikëpamje të tilla merren në konsideratë për çështje me interes për ta, në përputhje me

moshën dhe pjekurinë e tyre. 2. Në të gjitha veprimet që ndërmerren në lidhje me fëmijët si nga autoritetet publike qoftë dhe nga institucionet private, interesat më të larta të fëmijës gëzojnë vëmendje parësore. 3. Çdo fëmijë ka të drejtën që të ketë një marrëdhënie personale sistematike dhe kontakt të drejtpërdrejtë me të dy prindërit e tij ose të saj, përveçse kur kjo bie ndesh me interesat e tij ose të saj.”

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian është një ndër aktet e tjera të rëndësishme që është marrë në konsideratë në hartimin e legjislacionit ton të brendshëm. Neni 47 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian parashikon se “E drejta për zgjidhje ligjore të efektshme dhe gjykim të drejtë. Kushdo , të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara nga e drejta e Bashkimit, ka të drejtën për të marrë zgjidhje ligjore të efektshme para gjykatës në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë nen. Kushdo ka të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati kohor të arsyeshëm para një gjykate të pavarur dhe të paanshme të krijuar më parë me ligj. Çdokujt i jepet mundësia që të këshillohet, të mbrohet dhe të përfaqësohet. Është e detyrueshme që ndihma juridike t’u ofrohet atyre të cilëve u mungojnë burimet e mjaftueshme deri në masën që kërkohet për të siguruar mundësi të efektshme përdorimi të sistemit të drejtësisë.” Pra, nëpërmjet këtij neni në legjislacionin e brendshëm përcaktohet si e detyrueshme ndihma ligjore për personat që në momentin e duhur nuk kanë mundësi që të kenë një ndihmë të tillë.

Po kështu, në nenin 49 të Kartës përcaktohen edhe parimet e legjitimitetit dhe proporcionalitetit për veprat penale dhe dënimet të cilat janë inkorporuar në legjislacionin e brendshëm. Në hartimin e akteve dhe ligjeve që kanë në qendër mbrojtjen e të drejtave të të miturve është marrë në konsideratë edhe legjislacioni dytësor i BE-së. Ky legjislacion përbëhet nga

1. Direktiva 2010/64/BE⁷⁷
2. Direktiva 2011/92/BE⁷⁸
3. Direktiva 2012/29/BE⁷⁹

⁷⁷ Miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli në vitin 2010 parashikon të drejtën për përkthyes dhe përkthimin në procedimet penale

⁷⁸ Miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli në vitin 2011. Kjo direktiv trajton luftën ndaj abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë

⁷⁹ Miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli në vitin 2012, përcakton standardet bazë për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit;

4. Direktiva 2012/13/BE⁸⁰

5. Direktiva 2013/48/BE⁸¹etj.

Prezumimi i pafajësisë dhe e drejta për mbrojtje është një na të drejtat që zë një vend të rëndësishëm në legjislacionin tonë të brendshëm dhe që sanksionohet në nenin 48 të kartës.⁸²

⁸⁰ Miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli në vitin 2012, përcakton të drejtën për informim në një procedim penal.

⁸¹ Miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli në vitin 2013 që përcakton standardet bazë për aksesin për një avokat në një procedim penal

⁸² Shih neni 48 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian ku përcaktohet se “Prezumimi i pafajësisë dhe e drejta për mbrojtje 1. Kushdo ndaj të cilit është ngritur akuzë, prezumohet i pafajshëm deri sa të provohet se është fajtor sipas ligjit.2. Garantohet respektimi i të drejtave të mbrojtjes të kujtudo ndaj të cilit është ngritur një akuzë.”

KREU IV: PËRGJEGJËSIA PENALE. FAKTORËT QË NDIKOJNË NË KRIMINALITET. INSTITUCIONET QË ADMINISTROJNË DREJTËSINË E TË MITURVE

4.1.Përcaktimi ligjor i termit “fëmijë”, mosha për përgjegjësi penale sipas legjislacionit shqiptar

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve është instrumenti më i rëndësishëm në fushën e përcaktimit dhe mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve. Në Konvente gjejmë një përkufizim ligjor të termit fëmijë. Kështu, në nenin 1 të Konventës përcaktohet se “*Me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara*”. Nga interpretimi i këtij neni mund të kuptojmë që nga mosha e përcaktuar nga Konventa mund të ketë edhe përjashtime ligjore të përcaktuara nga legjislacionet kombëtare.

Konventa, në nenin 40 paragrafi 3 pika a përcakton se “*Shtetet Palë përcaktojnë një moshë minimale, nën të cilën fëmijët prezumohen të paaftë për të shkelur ligjin penal*” por kufiri i moshës, nën të cilin nuk duhet lejuar heqja e lirisë një fëmije duhet përcaktuar me ligj. Sipas rregullave të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të cilëve u është hequr liria, i mitur është një fëmijë ose një i ri i cili, sipas sistemeve ligjore përkatëse trajtohet për një shkelje ligjore të ligjit në mënyrë të ndryshme nga një i rritur. Në Rregullat e Pekinit përcaktohet se në sistemet ligjore që pranojnë konceptin e moshës për përgjegjësi penale për të miturit, fillimi i kësaj moshe nuk duhet të caktohet në një nivel shumë të ulët, duke pasur parasysh faktet e pjekurisë emocionale, mendore dhe intelektuale⁸³. Në tabelën Nr. 1 trajtohet mosha për përgjegjësi penale në vendet e BE.

Një nga parimet më të rëndësishme në përcaktimin e kufirit të moshës së miturisë e për rrjedhojë të moshës për përgjegjësi penale është parimi i interesit më të lartë të fëmijës. Sipas Kushtetutës tonë, edhe pse nuk ka një nen të veçantë lidhur me interesin më të lartë të fëmijës, ajo i ofron mbrojtje të veçantë që ka për qëllim të tregojë dhe një status të një kujdesi më të madh për fëmijët, i cili duhet të reflektohet jo vetëm në legjislacion por edhe në të gjithë veprimtarinë e organeve shtetërore dhe subjekteve në kontakt me të miturit.

⁸³ Shih rregullin 4 të Rregullave të Pekinit.

Përcaktimi i moshës për përgjegjësi penale lidhet ngushtë me detyrimin e shteteve në krijimin e një sistemi efektiv të drejtësisë penale për të miturit, si dhe masave mbrojtëse që të reagojë si ndaj fëmijëve që kanë arritur këtë nivel moshe, ashtu edhe ndaj atyre që ndonëse nuk kanë arritur moshën për përgjegjësi penale, janë përfshirë në sjellje kriminale. (Xhafo 2013,75). Pra, mosha për përgjegjësi penale është konsideruar mosha për të cilën një person mund të konsiderohet përgjegjës për një veprë penale dhe mund t'i nënshtrohet procedurave penale. Mosha për përgjegjësi penale ndryshon nga një vend në tjetrin në bazë të zhvillimit shoqëror dhe kulturore të një vendi. Pjesa më e madhe e legjislacioneve kanë të përcaktuar moshën 18 vjeç si kufirin e moshës që e bën individin të vetë përgjegjshëm për sjelljet dhe veprimet e veta. (Leskoviku, 2010, 36). Një person në moshën tetëmbëdhjetë vjeç gëzon të drejtën aktive dhe pasive të votimit, ka të drejtë të lidhë martesë, kontrata etj. (Unicef,2010,28).

Në legjislacion gjejmë të sanksionuar moshën për përgjegjësi penale, verifikimit të saj dhe pushimit të procedimit në raste se personi nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale. Kështu, në nenin 12 të Kodit Penal përcaktohet se *“Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç. “.* Pra, në këtë nen është sanksionuar mosha për përgjegjësi penale për veprat penale dhe kundërvajtjet penale, duke përcaktuar si moshën minimale atë katërmëdhjetë vjeçare.

Në nenin 41 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet verifikimi i moshës së të pandehurit në të cilin thuhet se: *“Në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, kur ka arsye për të besuar se i pandehuri është i mitur, organi procedues bën verifikimet e nevojshme dhe kur është rasti urdhëron ekspertimin. Kur, edhe pas verifikimeve dhe ekspertimit, mbeten dyshime për moshën e të pandehurit, prezumohet se ai është i mitur”*. Rrethanat të cilat nuk lejojnë fillimin e procedimit janë të shprehura qartë në nenin 290 paragrafi 1 i KPP ku sanksionohet se *“Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit kur: b) personi nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale”*

Fëmijët deri në moshën katërmëdhjetë vjeç janë të përjashtuar nga sanksionet penale si dënime dhe çdo lloj mase edukuese. (Hajdari, 2002, 18) Pra, personi nuk

konsiderohet penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën katërmëdhjetë vjeç. Ky përkufizim nuk është në përputhje me normat ndërkombëtare të cilat operojnë vetëm me nocionin fëmijë si sinonim i çdo të mituri nën moshën e pjekurisë.(Kombovski, 2007, 604). Pavarësisht se mosha për përgjegjësi penale është e ndryshme në bazë të legjislacionit të brendshëm në pjesën më të madhe të shteteve, qëllimi është që t'i mbrojnë fëmijët duke mos i ekspozuar përballë ligjit penal pa ezauruar mundësitë e tjera për të ndryshuar sjelljet e tyre devijante, duke pasur si qëllim interesin më të lartë të fëmijës.

Një rol të rëndësishëm për sa i përket moshës për përgjegjësi penale ka pasur dhe KDF, e cila pavarësisht se nuk ka vendosur një limit në lidhje me kufirin e moshës për përgjegjësi penale ajo shprehet se *“shtetet palë duhet të përcaktojnë një moshë minimale, nën të cilën fëmijët prezumohen të paaftë të shkelin ligjin penal”*.⁸⁴ Konventa ka një fuqi detyruese dhe për këtë arsye detyrimi në lidhje me përcaktimin e moshës për përgjegjësi penale është për të gjitha shtetet palë. Përcaktimi i moshës për përgjegjësi penale duhet të jetë i tillë që të respektojë parimin e mosdiskriminimit të personave nën 18 vjeç⁸⁵ dhe interesin më të lartë të të miturve⁸⁶.

4.2. Struktura e kriminalitetit tek të miturit dhe veprat penale më të përhapura

Studimi i dinamikës së kriminalitetit për të miturit realizohet për periudha mujore, tremujore, gjashtëmujore ose për periudha të gjata. Periudhat e studimit për nga qëllimi që ndjekin kanë ndryshime thelbësore. Kështu ndërsa studimi për periudha të shkurtra ka më tepër karakter orientues lidhur me detyrat që u dalin organeve përkatëse në goditjen e veprimtarisë kriminale, si ai për periudha të gjata bën të mundur të përpunojë plane të programuara komplekse të punës profilaktike. (Zanka, 1989, 101) Po siç është e njohur , *“ecuria e një dukurie kriminale mund të vlerësohet më mirë, po qe se ajo vështrohet për një periudhë të gjatë kohore”* . Kjo për shkak se në pajtim me “ligjin e numrave të mëdhenj”rezultatet e fituara nga kundrimi i një periudhe më të gjatë janë më të sakta, përkatësisht më të afërta me gjendjen reale të një dukurie të caktuar, për

⁸⁴ Shih nenin 40 paragrafi 5 pika a të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

⁸⁵ Shih nenin 2 paragrafi 1 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

⁸⁶ Shih nenin 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

Carsye Random, si periudha studimi merren periudhat prej pesë deri në njëzet vite. (Halili,1987,87)

Në studimin e kriminalitetit për këto moshë, njohja e këtij treguesi, është kërkesa themelore për të përcaktuar vëllimin dhe përmasat që kriminaliteti paraqet. (Zanka, 1989,99) Sa i përgjigjet realitetit respektivisht sa është i afërt me gjendjen e vërtetë, vëllimi i kësaj forme të kriminalitetit me të dhënat statistikore që ekzistojnë varet nga shumë faktorë. Kjo varet nga përkufizimi i kësaj forme të kriminalitetit, nga gjerësia e evidentimit, nga niveli i rregullsisë së evidencave, nga shkalla e numrit të errët, nga ndërrimet në legjislacionin penal etj. (Hajdari,2004,82) Pra të gjithë këto faktorë duhet të merren në konsideratë për përcaktim real të gjendjes së kriminalitetit të të miturve në një kohë dhe periudhë të caktuar. Kjo do të thotë se vetëm një studim në një periudhë të gjatë kohore dhe njohja e këtyre faktorëve na mundëson të njohim më mirë e në thellësi gjendjen reale të kriminalitetit po ashtu dhe llojet e veprave penale të kryera nga këta të fundit.

Bazuar në të dhënat statistikore kriminaliteti i të miturve është një fenomen në rritje jo vetëm në vendet e zhvilluara por gjithashtu edhe në vendet që gjenden në zhvillim të shpejtë ekonomik dhe në ato të prapambetura. Sipas të dhënave të siguruara nga Ministria e Drejtësisë në vitin 2007 janë evidentuar 21 krime të kryera nga të miturit, nga të cilët 198 të dënuar për krime dhe 13 të dënuar për kundërvajtje penale, në vitin 2008 u evidentuan 407 (356 për krime dhe 51 për kundërvajtje, në vitin 2009 u evidentuan 411 (262 për krime dhe 49 për kundërvajtje) në vitin 2010 u evidentuan 636 (594 për krime dhe 62 për kundërvajtje), në vitin 2011 u evidentuan 683 (610 për krime dhe 73 për kundërvajtje), në vitin 2012 u evidentuan 883 (626 për krime dhe 57 për kundërvajtje) dhe në vitin 2013 janë evidentuar 680 si të tilla (589 për krime dhe 91 për kundërvajtje) Në Tabelën Nr 2 është pasqyruar raporti statistikor të dënuar të mitur 2007-2013

Krahasuar me numrin e krime të regjistruara në këto vite rezulton, se veprat penale të kryera nga të miturit kanë shënuar një rritje nga 2007 deri në 2012 dhe në vitin 2013 kriminaliteti i të miturve ka pësuar një rënie të dukshme por pavarësisht kësaj ky

fenomen vazhdon të mbetet shqetësues për vendin tonë.⁸⁷ Veçori dalluese nga studimi ynë është se në vitin 2003, 87% e të dënuarve të mitur janë për krime. Ashtu siç vërehet edhe në tabelën statistikore mund të thuhet se në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012 numri i të dënuarve të mitur ka pësuar një ulje prej 237 të dënuarish. Duke pasur parasysh raportin mbi numrin total të dënuarve të mitur (680 të dënuar) me numrin e të dënuarve të mitur për krime (589 të dënuar) për vitin 2013 në krahasim me raportin total të numrit të dënuarve të mitur (883 të dënuar) me numrin e të dënuarve të mitur për krime (826 të dënuar) në vitin 2012, konkludohet se numri i të dënuarve për krime ka pësuar një ulje nga 94% në vitin 2012 në 87% në vitin 2013). Për sa i përket kundërvajtjeve penale krahasuar po me këtë vit, numri i të dënuarve është në rritje. Duke u krahasuar me të dënuarit në shkallë (8,577), të dënuarit e mitur janë 8% e tyre. Në Tabelën Nr 4 është pasqyruar grafiku i të dënuarve të mitur 2007-2013 (Vjetari Statistikor MD, 2014, 85)

Në të dhënat e Tabelës Nr 5 japin një pasqyre të plotë të kundërvajtjeve të kryera nga të miturit. Siç vërehet dhe nga tabela ato nuk përbejnë një numër të konsiderueshëm krahasuar me veprat e Tabelës Nr 3. Por nga ana tjetër kjo tregon se numrat janë në rritje dhe kjo përbën një problem shqetësues për faktin se kundërvajtjet penale janë një tregues i mirë i përfshirjes së të miturve në vepra penale me të renda. (Unicef, 2007) Për sa i përket të miturve të dënuar për kundërvajtje penale ashtu siç vërehet edhe nga tabela kemi një rritje gjatë këtyre viteve. Në vitin 2008 kemi një rritje me 3.92 % të të dënuarve për kundërvajtje. Në vitin 2009 kemi një zbritje me 96% të të dënuarve për kundërvajtje penale. Në 2010 një rritje me 26.5 % të të dënuarve për kundërvajtje penale. Në 2011 një rritje 17.74 % në 2012 një zbritje me 78% të të dënuarve për kundërvajtjet penale. Në 2013 vërehet një rritje me 59.6 % të të dënuarve të mitur për kundërvajtjet penale.

⁸⁷ Kështu veprat penale (Krime) kryera nga të miturit e shprehur në përqindje është si vijon: Për viti 2008 veprat penale të të miturve shënojnë një rritje me 79%. Për vitin 2009 veprat penale të të miturve shënojnë një rritje me 1.7%.. Për vitin 2010 veprat penale të të miturve shënojnë një rritje me 64%. Për vitin 2011 veprat penale të të miturve shënojnë një rritje me 0.26%. Për vitin 2012 veprat penale të të miturve shënojnë një rritje me 35.4% Për vitin 2013 veprat penale të të miturve shënojnë një ulje 71% Për vepra penale (kundërvajtje penale) Të kryer nga të miturit është si vijon: Në vitin 2008 kemi një rritje me 3.92% të të dënuarve të mitur për kundërvajtje penale Në vitin 2009 kemi një ulje me 96% të të dënuarve të mitur për kundërvajtje penale. Në vitin 2010 kemi një rritje me 26.5% të të dënuarve të mitur për kundërvajtje penale Në vitin 2011 kemi një rritje me 17.74% të të dënuarve të mitur për kundërvajtje penale Në vitin 2012 kemi një ulje me 78% të të dënuarve për kundërvajtje penale Në 2013 kemi një rritje me 59.6% të të dënuarve për kundërvajtje penale.

Përfshirja e të miturve dhe të rinjve në vepra penale ka ardhur duke u rritur nga viti në vit. Nga të dhënat statistikore vërehen dy tendenca kryesore. Së pari vërehet një rritje e numrit të dënimeve me burgim si për krime ashtu dhe për kundërvajtje penale. Ashtu siç vërehet nga të dyja tabelat e vëzhguara ku duket qartë se ka një tendencë nga sistemi i drejtësisë në Shqipëri të dënoje të miturit që kryejnë vepra penale ose kundërvajtje. Duhet theksuar se kjo tendencë është e lidhur edhe me faktin se Kodi Penal pavarësisht se parashikon një sërë masash alternative, ai nuk ka parashikuar një mekanizëm të kontrollit të zbatimit të kësaj mase. Pra Kodi Penal nuk parashikon zbatimin e masave alternative për ato vepra penale që paraqesin rrezikshmëri të ulët dhe duke u bazuar në kriteret ndërkombëtare duke pasur në qendër të vëmendjes interesin më të lartë të fëmijës.

Krimet për të miturit janë shqetësuese për çdo shoqëri, kjo sepse sa më shumë të inkriminuar të këtë në radhët e të miturve, aq më e errët bëhet perspektiva e shoqërisë njerëzore. Ky është dhe shkak që krimeve për të miturit u kushtohet një vëmendje e veçantë dhe kriminologjia është e interesuar edhe për këtë pjesë të veprimeve dhe të sjelljeve kriminale. (Gjoncaj, 2014,96)

Bazuar në studimet e realizuara në lidhje me të miturit e përfshirë në sjellje kriminale është evidentuar se ekziston mundësi të vazhdojnë përfshirjen e tyre në vepra penale. Fëmijët në konflikt me ligjin janë dy deri në tre herë me shumë të rrezikuar për t'u përfshirë në vepra penale serioze, të dhunshme dhe kronike krahasuar me individët që përfshihen në vepra penale në moshën e rritur. (Child delinquency,2003,1) Që të mund të vlerësojmë tendencën e lëvizjes së kriminalitetit të të miturve është e nevojshme që të përcjellim numrin e personave të mitur të dënuar për kryerjen e veprave penale nëpër vite.

Në vendin tonë vitet e fundit vërehet një rritje e numrit të të miturve të përfshirë në veprimtari kriminale. Paralelisht me shtimin e kriminalitetit të të miturve shtohet dhe numri i veprave penale të kryera nga të miturit. Dikur krimet kundër pronës ose vjedhjet konsideroheshin si veprat më të shpeshta penale të kryera nga të miturit dhe të rinjtë (UNICEF, 2007,8) kurse vitet e fundit vihet re se po ndryshon struktura tradicionale e krimeve të të miturve.

Aktualisht llojet e veprave penale në të cilat gjejmë të përfshirë edhe të miturit janë Në këtë strukturë janë pengmarrja, pjesëmarrja në krimin e organizuar, qarkullimi i

lëndëve narkotike, mashtrimet valutore, tregtia e armëve, krimet kompjuterike etje. (Gjoncaj,2014,95) Kjo tregon për rrezikshmërinë e veprave penale të kryera prej tyre. Analizimi i të dhënave statistikore ka një rëndësi të veçantë sepse vetëm kështu ne mund të njohim më mirë natyrën dhe karakterin e veprës penale, mund të përcaktojmë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore si të veprave penale po ashtu dhe të personave të mitur që i kanë kryer këto vepra penale, dhe në këtë mënyrë mund të arrihet një organizim më i mirë kundër veprimtarisë kriminale në përgjithësi dhe të miturve në veçanti.

Nga të dhënat statistikore rezulton se numri i të miturve të dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i kodit penal “vrasja me dashje” është tre të mitur. Të tre kanë qenë me arsim dy prej të cilëve janë dënuar me dy vjet burgim dhe njëri prej tyre me 1 vit burgim.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 79/ dh i kodit penal “vrasje në rrethana cilësuese kundër dy ose me shumë personave” është dënuar një person i cili rezulton me arsim dhe ka marrë dënim 5-10 vjet burgim. Për veprën penale të parashikuar nga neni 85 i kodit penal “kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik” rezulton i dënuar një person, me arsim me masën e dënimit dy vjet burgim. Sipas nenit 88 të kodit penal “Plagosja e rëndë me dashje” janë dënuar 10 persona , 1 është shpallur i pafajshëm, të 11 me arsim, të dhjetë janë dënuar me dy vjet burgim. Për veprën penale 88/a “plagosja e rëndë por në gjendje se tronditjes se fortë psikike” kemi 2 të dënuar , me nga dy vjet burgim Për veprën penale 100/1 “kanosja e marrëdhënieve seksuale” janë tre të dënuar të tre me arsim 2 prej të cilëve janë dënuar me 2-5 vjet burgim dhe 1 është dënuar me 5-10 vjet burgim. Për veprën penale sipas nenit 108 “vepra të turpshme” janë dënuar dy të mitur me arsim me masën e dënimit dy vjet burgim Për veprën penale sipas nenit 110/2 “heqja e paligjshme e lirisë” është dënuar një i mitur me arsim me masën e dënimit 5-10 vjet burgim etj.⁸⁸

⁸⁸ Për veprën penale sipas nenit 113’’ prostitucioni’ është dënuar një person rezulton pa arsim. Për veprën penale sipas nenit 130/a “dhuna në familje” janë dënuar dy persona të dy me arsim me masën e dënimit dy vjet burgim. Për veprën penale sipas nenit 134/1 “vjedhja e pasurisë” janë dënuar 140 të mitur,i është shpallur i pafajshëm 1, është pushuar, për sa i përket arsimit pa arsim 131 me arsim 7 janë dënuar me masën e dënimit me gjobë, 131 janë dënuar me dy vjet burgim, 2 prej tyre me 2-5 vjet burgim. Për të njëjtën vepër penale po kur është kryer në bashkëpunim me shumë se njëherë janë dënuar 308 persona, 11 çështje të pushuara, për sa i përket arsimit 12 kanë qenë pa arsim dhe 307 me arsim. 7 prej tyre kanë marrë masën e dënimit me gjobë dhe 131 janë dënuar me masën e dënimit deri në dy vjet. Po ashtu për të njëjtën vepër po kur kjo ka sjellë pasojë të rënda është dënuar një person i cili ka qenë me arsim dhe ka

Të mituri janë përfshirë në vepra penale të ndryshme, saqë tani nuk mund të flasim për një diferencim veprash penale të kryera nga të mitur apo të rritur. Kundërvajtjet e tyre janë në rritje dhe kjo është një tregues shqetësues për faktin se ato janë shenjat që tregojnë për përfshirjen e tyre në vepra penale më të rënda.

4.3. Faktorët e brendshëm që ndikojnë dhe prodhojnë kriminalitet tek të miturit.

Kriminaliteti i të miturve është një çështje që ka një shtrirje kohore paralele me krijimin e njerëzimit. Kështu edhe pse në masë të vogël kemi studime të kriminalitetit të të miturve në kohët më të lashta, duke filluar që nga filozofët grekë, pastaj juristët dhe letrarët romakë, në mesjetë e deri tek plejada e tërë e mendimtarëve, filozofëve dhe e reformave të epokës së re. (Latifi,1982,63)

Me ndryshimet e shumta kulturore, sociale dhe ekonomike përfshirja e të rinjve në veprimtari kriminale ka ardhur gjithnjë e në rritje. Kështu sot sjelljet devijante dhe krimet nga të miturit janë të pranishme jo vetëm në shoqërinë shqiptare por edhe në vende të ndryshme. Shumë studime shkencore, kujdesin e tyre ia kanë kushtuar kriminalitetit të të miturve, duke u përpjekur që t'i shpjegojnë kryesisht shkaqet e kësaj dukurie me qëllim që të përcaktojnë dhe trajtimin e delinkuentëve të mitur (Veseli, 1982,59) Duke analizuar dhe kuptuar shkaqet e këtij fenomeni mund të përcaktohet trajtimi i duhur për këtë kategori personash. Studimi i shkaqeve të kriminalitetit të të miturve ka një rëndësi të veçantë teorike dhe praktike, pa njohjen e të cilave do të ishte i pamundur zbatimi i masave parandaluese. (Kriminologji, 104)

marrë dënimin me dy vjet burgim. Për veprën penale sipas nenit 139 “vjedhja me dhunë” janë dënuar 13 persona, 3 çështje të pushuara, të 16-të kanë qenë me arsim, përs a i përket masës së dënimit për veprën e kryer njëri prej tyre është dënuar me gjobë, 5 me deri në dy vjet burg, 6 me 2-5 vjet burg dhe 1 me 5-10 vjet burgim. Për veprën penale sipas nenit 140 “vjedhja me armë” janë dënuar 5 persona të 5-të me arsim, nga ku 3 prej tyre janë dënuar me 2-5 vjet burgim dhe 2 me 5-10 vjet burgim. Për veprën penale sipas nenit 143 “mashtrimi” janë dënuar 3 persona të tre me arsim, 2 prej tyre janë dënuar me gjobë dhe 1 me dy vjet burg. Për veprën penale sipas nenit 150 “shkatërrimi i pronës” janë dënuar 5 persona me arsim ku njëri prej të cilëve është dënuar me gjobë dhe 4 prej tyre kanë marrë masën e dënimit me dy vjet burg. Për veprën penale sipas nenit 151 “shkatërrimi i pronës me zjarr” kemi 1 të dënuar me arsim i cili ka marrë masën e dënimit me dy vjet burgim.

Faktorët e brendshëm janë të rëndësishëm për t'u analizuar sepse kanë të bëjnë pikërisht me personalitetin e të miturit që kryen vepër penale. Kur flasim për faktorë të brendshëm nënkuptojmë individin. Ne nuk mund ta dallojmë nëse individ ka prirje delinkuente nëse nuk njohim personalitetin e tij. Karakteri dhe temperament i tij janë veti që lidhen me sjelljen dhe reagimet e njeriut ndaj fenomeneve shoqërore. Vetitë biologjike dhe psikike janë shumë të rëndësishme pasi luajnë një rol vendimtar në zhvillimin e njeriut dhe nëse këto veti janë zhvilluar normalisht atëherë kemi të bëjmë me një individ me sjellje të mirë në shoqëri, në të kundërt kur kemi shenja anomalie atëherë ka një probabilitet shumë të madh që këta individë të përfshihen në veprimtari kriminale. Si faktor të brendshëm janë:

4.3.1. Personaliteti i të miturit

Kriminalitetin e të miturve mund ta karakterizojmë si një lloj të veçantë kriminaliteti që dallohet nga veçoritë e treguesve sasiorë dhe cilësorë të gjendjes dhe rritjes së tij që kushtëzohet para se gjithash nga personaliteti i kriminelit, në qendër të së cilës qëndrojnë motivet egocentriste dhe psikike të pastabilizuara (Gjoncaj 2013). Në formimin e personalitetit të të miturit ka shumë rëndësi mosha me të cilën lidhen ndryshimet e shumta psikologjike dhe psikike të të miturit. Personaliteti i individit ka shumë rëndësi sidomos për mënyrën se si është zhvilluar dhe formuar qysh në fazën fillestare të jetës që në foshnjë, pasi ka një ndikim të madhe në sjelljet dhe veprimet e tij. Në shumë raste disa veprime dhe sjellje të individëve, nuk mund të kuptohen në shikim të parë. Ato nuk mund të ndriçohen pa u analizuar vetë personaliteti, vetë struktura e tij psikike.

Kjo nuk do të thotë se veprimet dhe sjelljet e individëve janë të përcaktuara kryesisht nga bota shpirtërore dhe psikike. (Ragip H 2002) Shumë sjellje dhe veprime të individit kanë të bëjnë me botën e tij psikike dhe botën e brendshme faktorë këto që kur shfaqin probleme çojnë në sjellje negative deri në sjellje kriminale. Janë të shumta rastet kur rreziku mund të jetë krijuar nga faktorët që kanë të bëjnë me shëndetin mendor të fëmijës (Kombovski 2007,626). Personaliteti përfshin gjithë botën e brendshme, karakterin, ndjenjat, emocionet, aftësinë për të kuptuar, studiuar e shprehur mendimet si këto dhe shumë komponentë të tjerë që kanë të bëjnë me personalitetin. Është e

rëndësishme të theksojmë faktin se kriminaliteti i të miturve në mënyrë mjaft të veçantë përcaktohet nga personaliteti i fëmijës.

4.3.2. Karakteri i të miturit

Karakteri është një veti shumë e rëndësishme sepse është pikërisht në karakterin e të miturit ku vërehen sjelljet pozitive apo negative të tij. Sipas mendimit që mbizotëron sot në psikologjinë bashkëkohore, si cilësi të personalitetit me karakter duhet të konsiderohen ato veti që lidhen me disa parime etike që vlejnë në një shoqëri, parime të cilat vlerësohen si të domosdoshme, normale, të lejuara, të drejta, të dobishme dhe të moralshme (Ragip H 2002)

Karakteri i fëmijëve që përfshihen në veprimtari kriminale mund të quhet një karakter i dobët. Këta fëmijë kanë një vetëvlerësim të dobët shpesh janë impulsivë ndaj sjelljeve të jashtme, nuk janë të shoqërueshëm me bashkëmoshatarët. Shpesh këta fëmijë ndihen të përbuzur nga ambienti që i rrethon. Papërgjegjshmëria i bën ata të kenë si qëllim realizimin e kënaqësive momentale. Duhet ta themi që jo rrallë këto veti si personaliteti apo karakteri janë të trashëguara pra gjenden në ADN dhe kjo është e vërtetuar nga studime të shumta.

4.4. Faktorët e jashtëm që ndikojnë në rritjen e kriminalitet tek të miturit

Faktorët e jashtëm kanë një ndikim tejet të lartë në formimin, motivimin dhe realizimin e krimit nga të miturit. Disa nga faktorët e jashtëm më të rëndësishëm që do të jenë pjesë e analizës sonë janë familja, mjedisi shkollor, shoqëria lëvizjet nga zonat rurale në ato urbane , mjetet e komunikimit si këto dhe shumë faktorë të tjerë kanë një ndikim të madh tek i mituri duke i influencuar në sjellje devijante (Gjoncaj,2013). Faktorët e brendshëm ndërveprojnë me faktorët e jashtëm pasi nga ata varen sjelljet e individit se si i përballojnë kontaktet me mjedisin që i rrethon.

4.4.1 Mjedisi familjar

Familja si njësi shoqërore është ambienti më i mirë për rritjen dhe mbrojtjen e fëmijës, e cila përveç funksionit biologjik dhe ekonomik, ka edhe funksionin edukativ. (Veseli, 1982,69). Ajo luan një rol mjaft të rëndësishëm në jetën e njeriut sepse është pikërisht në ambientin familjar ku njeriu merr formimin që nga momenti i lindjes e në vazhdimësi, është pikërisht në këtë ambient ku njeriu formon personalitetin e tij.

Familja është baza ku fëmija merr edukimin e tij dhe mëson normat e mirësjelljes. Është familja ajo që mbron dhe orienton fëmijën. Lidhur me rëndësinë dhe rolin e familjes në formimin e personalitetit të njeriut dhe zhvillimin normal dhe harmonik të tij, që nga koha e fëmijërisë, e deri në moshën madhore, në literaturë shpeshherë përmendet një mendim, sentencë e shkrimtarit të madh, Leon Tolstoit, nga romani i tij Ana Karenina: *“të gjitha familjet fatlume i ngjajnë njëra-tjetrës, ndërsa familjet fatkeqe janë të tilla në mënyrën e vet”*. (Ragip 2002) Në këtë mënyrë kuptojmë që nëse në një familje janë krijuar raporte të mira prindër fëmijë, mundësi të mira ekonomike, atëherë kjo familje ndikon pozitivisht në formimin e drejtë të fëmijëve duke i orientuar ata drejt sjelljeve pozitive.

Edukimi i fëmijëve është përgjegjësi familjare që shpeshherë realizohet në mënyrën dhe format e gatuara. Familjet dhe ambientet familjare të një niveli të ulët dhe degradues bëhen faktorë nxitës në sjellje kriminale të të miturve. Këto familje karakterizohen kryesisht nga probleme nga më të ndryshmet si varfëria, konfliktet midis prindërve, divorci. Nëse një familje karakterizohet nga këto probleme atëherë ajo shndërrohet në faktor nxitës fillimisht për sjellje negative të fëmijëve. Fillimisht shfaqet fenomeni i largimit nga shtëpia deri në përfshirjen në veprimtari kriminale. Jo vetëm faktorët e sipërpërmendur por edhe antivlerat ose sjelljet negative të prindërve kryesisht të babait bëhen shkak për elementët kriminogjen në familje. Kështu faktor si alkooli, bixhozi e çojnë familjen drejt prishjes ose degradim (Jani P, Mustafaj). Numri i faktorëve të riskut brenda familjes dhe koha gjatë të cilës fëmija ekspozohet gjatë tyre është e rëndësishme. Disa nga karakteristikat e familjes që mund të kontribuojnë në kriminalitetin e hershëm të fëmijës janë:

- Prindër me sjellje antisociale
- Prindër me eksperiencë të abuzimit të substancave
- Prindër me probleme të theksuara të shëndetit mendor

- Praktika të varfra prindërimi që karakterizohen nga mungesa e kujdesit të nevojshëm apo mungesa e përforcimeve pozitive në sjelljen e fëmijës.
- Histori të dhunës në familje
- Familje me përmasa të mëdha me shumë anëtarë, ku mungon vëmendja për anëtarët e rinj të familjes. (UNICEF,2007,22)

Familja dhe raportet familjare janë shumë të rëndësishëm në edukimin, formimin dhe zhvillimin e individit që nga fëmijëria e deri në fund të jetës, dhe kur këto raporte janë të ndërtuara mbi baza të shëndetshme, atëherë këto familje ndikojnë pozitivisht në një orientim të drejtë për fëmijët dhe për të ardhmen e tyre. Familjet në të cilat janë prezentë konfliktet, debatet, varfëria, mungesa e kontrollit tek fëmijët, morali i ulët, këto familje nuk janë në gjendje të kryejnë funksionet dhe detyrat e veta dhe bëhen çerdhe për fëmijë problematikë të orientuar drejt sjelljeve kriminale.

4.4.2. Mjedi shkollor

Pas mjedisit familjar, mjedi shkollor luan një rol të rëndësishëm në formimin e gjithanshëm të personalitetit të njeriut në edukimin e tij. Shkolla është institucioni ku fëmijët kalojnë pjesën më të madhe të kohës. Në shkollë fëmijët marrin njohuri të shumëllojshme morale, kulturore dhe profesionale. Në ambientet e shkollës fëmijët marrin njohuri, shprehi për normat pozitive të shoqërisë. Nëpërmjet orëve të hapura që zhvillohen nëpër këto ambiente ata kanë mundësi të diskutojnë të mirë informohen për problematika të ndryshme që mund të jenë shqetësuese për ta. Arsimimi dhe shkollimi i qytetarëve, e sidomos i fëmijëve dhe të rinjve, ka rëndësi të madhe për zhdukjen e injorancës, mosdijes, primitivizmit dhe dukurive negative tradicionale (Ragip 2002).

Janë këto ambiente ku të rinjtë marrin njohuritë mbi shumë aspekte të jetës. Me kalimi e viteve dhe kalimin nga një klasë e shkollës në një tjetër, fëmija krijon koncepte të drejta mbi mënyrën se si duhet të sillet. (Peza,1982) Në shkollë pavarësisht se ka mbizotëruar ideja dhe insistimi për fitimin e dijeve, mësuesit me sjelljen dhe me mënyrën e qëndrimit të tyre kanë ndikuar edhe me cilësitë e tyre njerëzore e jo vetëm me dituritë e tyre (Latifi ,1982,90) Aktualisht mjedi shkollor është shndërruar në

ambient të privilegjuar për sa i përket akteve të dhunshme nga të rinjtë. Zhvillimi i shpejtë shoqëror dhe pasojat e demokratizmit të shkollimit deri në universitet kanë bërë që dhuna në ambientet shkollore të rritet këto 20 vitet e fundit. (Robert Batintër 2009- ,12.).

Një problem tjetër është dhe pamundësia për të shkuar në shkollë pasi jo të gjithë të miturit dhe të rinjtë i kanë mundësitë të shkojnë në shkollë dhe të marrin njohuri dhe kjo për arsye nga më të ndryshmet si varfëria, mungesa e sigurisë, etj. Duke mos shkuar në shkollë të miturit nuk kanë mundësi të shkollohen. Në këto kushte, për disa prej tyre është me e lehtë të largohen prej shkollës dhe të merren me aktivitete që ndikojnë në përmirësimin e situatës familjare siç mund të jenë angazhimi me tokën, kujdesi për bagëtitë, shitja në tregun e zonës apo aktivitete të tjera larg zonës së banimit deri në përfshirje në aktivitete kriminale si vjedhje, grabitje, shpërndarje dhe transport të lëndëve narkotike, etj. (UNICEF) Duke qenë se ndonjëherë kushtet nuk janë në favor për të frekuentuar shkollën, të miturit zgjedhin rrugën e braktisjes së saj. Në disa zona ka shkolla në të cilat mungojnë mësuesit e kualifikuar, ku rënie të ndjeshme të kualiteti të mësimore dhe edukativ, gjë e cila ka çuar në rënie të rezultateve të mësimave shkak kjo nga niveli i ulët i kënaqësisë që marrin mësuesit për punën e tyre, motivimi i ulët për punën edukative me fëmijët (Unicef ,2007 ,23).

Nxënësit që nuk arrijnë rezultatet e dëshiruara janë larguar fare nga këto ambiente dhe një pjesë dërmuese e tyre orientohen drejt sjelljeve kriminale. Duhet pranuar fakti që në ato vende ku arsimimi është ende në zhvillim e sipër si fshatrat e thella duhet thënë se dashur padashur bëhen motiv për sjellje devijante, pasi fëmijët nuk e shohin si detyrim shkuarjen në shkollë. Sot fatkeqësisht është kthyer në moto ku të miturit braktisin orët e mësimi, por ka dhe raste që ata nxirren jashtë nga mësuesit kur tregojnë mungesë respekti ndaj tyre gjë që nuk duhet të ndodhë. Duke marrë parasysh ikjen e nxënësve nga shkolla, duke u marrë me sjellje delinkuentë si pirje e duhanit, akolit, substancave narkotike, sherret, rrahjet me bashkëmoshatarët gjatë orarit të mësimi, flitet për shkollën si faktor nxitës në sjellje kriminale.

Shkolla është institucioni ku individ i ushqehet me dije dhe është detyrë morale e mësuesve të motivohen më shumë për të ndihmuar fëmijët, të mundohen të zbulojnë ata

që shfaqin sjellje problematike, të konsultohen me prindërit e fëmijëve me qëllim që të parandalojnë përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale.

4.4.3. Mjedis shoqëror

Shoqëria luan një rol të rëndësishëm në jetën e individit. Fëmijët kryesisht kohën më të madhe e kalojnë në familje dhe në shkollë por një pjesë të mirë të saj e kalojnë jashtë këtyre ambienteve. Jashtë familjes fëmija ka mjedisin e vet shoqëror me të cilët krijojnë marrëdhënie të cilat janë pak të aksesueshme nga familja dhe shoqëria. Ashtu si familja dhe ambienti shoqëror ushtrojnë një influencë shumë të madhe në krijimin e koncepteve të drejta tek fëmijët dhe i ndihmojnë ata në mënyrë graduale, ta zgjerojnë horizontin e tyre për të bërë dallimin nëpërmjet sjelljeve të lejueshme dhe të palejueshme të ligjshme dhe të paligjshme. (Peza, 1982).

Disa ambiente shpeshherë kanë influencë negative pasi mund të jenë të aksesueshme nga individ problematik, me precedent penal ose individë të përfshirë në veprimtari kriminale, të rinj që merren me prostitucion, që përdorin substanca të ndryshme. Ky mjedis shoqëror mund të luajë në shumë raste rolin e nxitësit të të miturit drejt kriminalitetit (Azem H 2004). Kështu në vende të tilla banojnë personat e papunë, apo që kanë zënë punë përkohësisht, të ardhurat e të cilëve u mundësojnë njëfarë gjallërie, ku mbretëron dhënia pas pijes, prostitucionit dhe kriminalitetit. Në këto mjedise në aspektin social zor se dalin persona të shëndoshë social. (latifi,1982,82)

Të miturit përfshihen në këto mjedise nga emocionet dhe kënaqësia për të provuar eksperiencë të reja por këto nuk mund të arrihen pa shpenzime, dhe fillojnë t'i arrijnë ato në rrugë të gabuara dhe jo të ligjshme. Fëmijët janë në presion të vazhdueshëm në mjediset ku ata jetojnë dhe shumë prej tyre që kanë sjellje negative e kanë shumë të lehtë të kontaktojnë me persona problematikë dhe t'u drejtohen veprimtarive kriminale. Këta fëmijë më pas e kanë të vështirë të shkëputen nga kjo shoqëri edhe kur ata ndërgjegjësohen se veprimet e tyre janë të jashtëligjshme. Si përfundim duke qenë se i mituri kalon një kohë të konsiderueshme jashtë ambienteve të shtëpisë, prindërit e tyre duhet të rrisin kontrollin më shumë, të tregohen më të

vëmendshëm ndaj bashkëmoshatarëve apo personave të rritur që këta të fundit frekuentojnë, të informohen me tepër për sjelljet e personave që fëmijët e tyre shoqërohen në mënyrë që t'i shmangin dhe të evitojnë përfshirjen e të miturve në sjellje kriminale.

4.4.4. Migrimi i brendshëm

Pas periudhës së tranzicionit dhe më shumë në vitet e fundit vërehet një fluks i madh i zhvendosjes së popullsisë nga fshatrat drejt qyteteve të mëdha. Kjo zhvendosje ka pasur ndryshime të mëdha për sa i përket mënyrës së jetesës. Lëvizja e brendshme e popullsisë është nxitur kryesisht nga mungesa e burimeve të jetesës në vendlindjet e tyre. Varfëria ekstreme, papunësia e lartë, mungesa e shërbimeve për të gjetur dhe zhvilluar aktivitete jetike ushqyen këtë fenomen. (UNICEF,2007,9) Të ardhurit në qytet hasin probleme të shumta pasi ndeshen me një jetë më dinamike dhe kjo sjell ndryshime të shumta dhe në marrëdhëniet njerëzore.

Mënyra e të jetuarit në qytet ndryshon nga mënyra e të jetuarit në fshat dhe kjo çon në ndryshimin e komunikimit brenda familjes. Këta të rinj, në një masë të konsiderueshme gjenden në pozitë të vështirë. Para së gjithash ata bien në konflikt me shprehitë e vjetra të mjedisit, prej të cilit vijnë, me shprehitë e reja të qytetit të cilat ende nuk i kanë përvetësuar. Në këtë konflikt rol të rëndësishëm luan edhe fakti se në mjedisin e ri vërejnë atë që përbën figurën e jashtme dhe të ndritshme të qytetit, restorantet e bukura, malli luksoz, kafenetë, mënyra më e bukur dhe luksoze e veshjes dhe ushqimit, kinematë, teatrot, puna intensive, arsimi i lartë etje (Latifi, 1982,87) Kushtet jetësore të të rinjve të ardhur shpesh janë të këqija ku nuk mund të përmbushin dëshirat dhe ëndrrat e tyre. Nga dëshira e madhe për të përmbushur nevojat e tyre këta të rinj shpesh zgjedhin dhe rrugët e gabuara që i çojnë deri në veprimtari kriminale.

4.4.5. Mjetet e informimit

Mjetet e informimit si mediat dhe rrjetet sociale janë konsideruar si faktorë kriminogjen të kriminalitetit të të miturve (Latifi,1982,98). Qëllimi i këtyre mjeteve është informimi i publikut nëpërmjet media së shkruar dhe asaj vizive. Nëse informacione jepen brenda një kuadrati të caktuar dhe edukues atëherë të rinjtë marrin shumë njohuri dhe informacione pozitive që i ndihmojnë në zgjerimin e horizonteve të tyre. (Ragip H 2002) Në median e shkruar si gazeta, revista, televizione, informacionet shfaqen të ilustruara me pamje tronditëse dhe kjo ka një ndikim negativ tek të miturit. Për sa i përket filmave mund të themi që mund të luajnë një rol pozitiv nga njëra anë dhe negativ nga ana tjetër gjë kjo që varet nga tematika që ka filmi. Në rast se filmi ka një problematikë aktuale dhe i përpunuar ai mund t'i tërheqë fëmijët dhe mund të ndikojë pozitivisht të fëmija. Në rastet e një filmi me personazhe negative. shpesh filmat janë të shoqëruar me skena të dhunshme dhe kjo bën që të rinjtë dhe sidomos të miturit të influencohen në jetën reale.

Fëmijët sot kanë tendencën t'i imitojnë personazhet e filmave duke dashur të kenë të njëjtin personalitet dhe veprimet e tyre t'i zbatojnë në jetën e përditshme. Sot ne kemi shumë raste të krimit të organizuar që duken si skenar filmash. Po ashtu nuk duhet lenë pa përmendur roli i internet kafeve që gjithmonë e me shumë po behet një nga aktivitetet më të rëndësishme të të rinjve të cilët kalojnë një pjese të madhe të kohës së tyre aty. Interneti ka një potencial të rëndësishëm për t'u siguruar fëmijëve dhe të rinjve informacion edukativ dhe mund të konsiderohet një bibliotekë e madhe. Megjithatë kredibiliteti në lidhje me informacionet që ai përcjell mbetet shqetësim. Kureshtja për të parë diçka apo për të mësuar ndonjë të panjohur i bën të rinjtë të drejtohen në këto ambiente. Kjo i bën ata të largohen nga familja e të braktisin mësimin. Në këto ambiente ata zhvillohen shohin gjëra shpesh dhe të pakëndshme siç mund të jenë edhe filma apo lojëra me aksion, Koha e gjatë në këto ambiente mund t'i lodhë dhe ti çojë ata në sjellje agresive.

Për këtë arsye duhet një impenjim më i lartë na ana e prindërve në përmbushjen e rolit të tyre edhe si edukatorë për të bërë të mundur që fëmijët e tyre të përfitojnë efektet pozitive qoftë të filmave në televizion ashtu dhe të internetit. Gjithashtu nevojitet që të gjitha këto mjete të informimit publik të kontrollohen me shumë dhe mos ta shohin informacionin si një biznes fitimprurës por të orientohen më shumë në

aspektin e informimit pozitiv. Këtij problemi, sidomos internetit mund t'i kushtohet dhe një studim i veçantë pasi nga dita në ditë kjo dukuri po zë një vend të veçantë në jetën e të rinjve dhe në kushtëzimin e sjelljeve të tyre, që jo rrallë çojnë në sjellje devijante e deri në veprimtari kriminale.

4.4. Institucionet që administrojnë drejtësinë e të miturive në Shqipëri

4.5.1. Roli i Ministrisë së Drejtësisë në hartimin e politikave për të drejtat e të miturive në Shqipëri

Ministria e Drejtësisë është një nga institucionet më të rëndësishëm në nivel qendror, për monitorimin e sistemit të drejtësisë dhe jo vetëm. Ajo e ushtron funksionin e saj në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin nr. 8678, date 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”. Në nenin 5 paragrafi 1 të këtij ligji përcaktohet misioni i Ministrisë së Drejtësisë i cili konsiston në “*hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale a civile, sistemin e shërbimeve të lira juridikoprofesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.*”

Ky institucion ka si qëllim mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit. Në këtë aspekt mund të themi që ky institucion është përgjegjës edhe për mbrojtjen e të drejtave të të miturve. Kjo konkretizohet dhe del në pah në paragrafin 20 të nenit 6 të ligjit ku përcaktohet se një nga detyrat e Ministrisë së Drejtësisë është të “*Kujdeset për realizimin dhe bashkërendimin e veprimtarive në fushën e drejtësisë për të miturit, për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, edukimin ligjor dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit nga ana e tyre, si dhe për ushtrimin e shërbimeve ndaj*

*të miturve, nga strukturat përkatëse të sistemit të drejtësisë.”*⁸⁹ Në Ministrinë e Drejtësisë është krijuar drejtoria e Kodifikimit e cila është përgjegjëse për hartimin e ligjeve në fushën edukimit ligjor dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit nga të miturit.

Ministria e Drejtësisë ka përgatitur “Strategjinë e reformës në sistemin e drejtësisë për të miturit” ku ka trajtuar reformën e në sistemin e drejtësisë për të miturit. Kështu, ka kërkuar krijimin e seksioneve për të miturit në gjykatat në nivel qarku, pranë prokurorive, policisë gjyqësore etj. Ministria e Drejtësisë ka detyrimin e hartimit të një legjislacioni bashkëkohor për të miturit i cili t’i përgjigjet nevojave të kohës por që të jetë në përputhje edhe me aktet ndërkombëtare, në kuadër të detyrimeve dhe kushteve që evidentojnë marrëveshjet ndërkombëtare dhe MSA, për integrimin e Shqipërisë në strukturat e BE-së. Ky institucion ka luajtur një rol tejet aktiv dhe të rëndësishëm në legjislacionin e të drejtave të të miturve duke hartuar aktet nënligjore në lidhje me të drejtat e tyre por vazhdon ende të jetë një sfidë implementimi dhe zbatimi i këtij legjislacioni në strukturat përkatëse.

4.5.2. Institucioni i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

Miratimi i ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” kërkonte krijimin e strukturave të cilat do të monitoronin zbatimin e tij. Një ndër institucionet më të rëndësishme që u krijua nga ky ligj ishte dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.⁹⁰ Agjencia është person juridik në varësi të ministrisë që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, struktura dhe organika e saj miratohen nga Kryeministri.⁹¹

⁸⁹ Shih nenin 6 të ligjit nr. 8678, date 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”

⁹⁰ Shih nenin 34 të ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” ku përcaktohet se “1. Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, në përputhje me fushën e ushtrimit të veprimtarisë së tyre, janë në nivel qendror dhe vendor. 2. Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë janë: a) Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në nivel qendror; b) grupi teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative në nivel vendor. 3. Strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror janë: a) ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës; b) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;”

⁹¹ Shih nenin 40 të ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

Në nenin 40 të ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” përcaktohen Detyra e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në lidhje me ngritjen dhe mirëfunksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës⁹². Ndër detyrat kryesore të Agjencisë është organizimi i sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, monitorimi i zbatimit të ligjit nr. 10 347 datë 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” dhe garantimi i bashkëpunimit me autoritetet e tjera shtetërore përgjegjëse në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve i paraqet ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës propozime për politika dhe ndryshime ligjore e nënligjore në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës⁹³. Nisur nga fakti që Agjencia ka si detyrë monitorimin e ligjit për të drejtat e fëmijëve ajo ka përgjegjësin të krijoj politikat në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Kështu në nenin 43 të ligji trajtohen detyrat që ka Agjencia në lidhje me politikat dhe veprimtaritë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Kështu neni 43 përcakton se “1. *Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ka për detyrë të bashkëpunojë me strukturat shtetërore përgjegjëse në procesin e hartimit të propozimeve e të zbatimit të politikave integruese në Bashkimin Europian, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës. 2. Ndërton dhe realizon vetë apo në bashkëpunim me institucione të tjera veprimtari për edukimin, trajnimin, ndërgjegjësimin e qytetarëve, si*

⁹² Shih nenin 41 të ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” 1. Agjencia është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna. 2. Agjencia ka për detyrë t’u ofroj mbështetje të drejtpërdrejt strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, në lidhje me: a) koordinimin me agjenci të tjera shtetërore dhe private; b) zhvillimin e aktiviteteve profesionale, në lidhje me mbrojtjen e fëmijës; c) asistencën për menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të caktuara të fëmijës në nevojë për mbrojtje, si edhe supervizimin, në raste të caktuara; bashkërendim të punës për raste ndërshtetërore të mbrojtjes së fëmijës; ç) këshillimin e agjencive shtetërore qendrore dhe vendore, si dhe të punonjësve që punojnë në institucione publike e private për ndihmën e fëmijës në rrezik apo në nevojë për mbrojtje, për të cilën agjencia nxjerr një urdhër të brendshëm për mënyrën e funksionimit. 23 3. Agjencia ka për detyrë gjithashtu: a) të mbledhë të dhëna në nivel kombëtar për mbrojtjen e fëmijës dhe të menaxhojë regjistrin elektronik kombëtar për rastet e fëmijës në nevojë për mbrojtje; b) të analizojë nevojat për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe të mbështetjes së familjeve me një fokus të veçantë të parandalimi; c) të kontrollojë cilësinë e shërbimit të strukturave të mbrojtjes; ç) të koordinojë dhe të organizojë trajnime të edukimit vazhdues për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe profesionistëve të tjerë që punojnë me fëmijët në nevojë për mbrojtje; d) në zbatim të nenit 11, pika 6, e këtij ligji, të bashkëpunojë me autoritetet përgjegjëse për realizimin e procesit të mbrojtjes dhe marrjes së masave për menaxhimin e rasteve të fëmijës në situatë migrimi, në situatë ndërkufitare dhe në nevojë për mbrojtje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të fëmijës së pashoqëruar.

⁹³ Shih nenin 42 paragrafi 1 të ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

dhe të punonjësve e të funksionarëve të administratës publike e të sistemit të drejtësisë. 3. Koordinon ose realizon fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete konkrete për promovimin e pjesëmarrjes së fëmijës në të gjitha fushat. 4. Inicion dhe zbaton projekte pilot, në bashkëpunim me shoqërinë civile, dhe u jep mbështetje teknike organizatave jofitimprurëse, që punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës. 24 5. Organizon dhe bashkërendon kërkime shkencore në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës. 6. Realizon mbledhjen, analizën e të dhënave dhe raportimin e zbatimit të dokumenteve strategjike me fokus fëmijët, si dhe të situatës së të drejtave të fëmijës. 7. Zhvillon dhe mirëmban një sistem informacioni me fokus institucionet e specializuara për fëmijët, organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe të dhëna të tjera, që lidhen me mbrojtjen e fëmijës. 8. Bashkërendon veprimtarinë e saj me agjencitë homologe në vendet e tjera”. Procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, ndaj shkelësve të të drejtave të fëmijëve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Agjencia është përgjegjëse për monitorimin e Planit Kombëtar të Veprimit “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge 2015 – 2017. Ajo harton raporte 3 mujore ose vjetore në lidhje me nivelin e zbatimit të Planit dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

4.5.3. Të drejtat e të miturve në sistemin gjyqësor në Shqipëri

Sistemi gjyqësor i Republikës së Shqipërisë e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligjit Nr.8436/ 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”⁹⁴ Në pjesën e nëntë të Kushtetutës në nenin 135 paragrafi 1 përcaktohet se “Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.” Në paragrafin e dytë të këtij neni përcaktohet se “Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.” Nga interpretimi i paragrafit të dytë të nenin 135 të Kushtetutës

⁹⁴ I ndryshuar me 8546/5.11.1999, ndryshuar me 8656/31.7.2000 si dhe me ligjin nr.9111 datë 24.7.2003; KPP,

evidentohet dhe del në pah mundësia e krijimi të gjykatave të cilat do të kujdeseshin vetëm me gjykimin e të miturve të cilat i mungojnë aktualisht sistemit tonë gjyqësorë.

Sistemi gjyqësor në gjykimin e të miturve duhet të funksionojë në përdhje me nenin 40 paragrafi 2 të KDF-së i cili kërkon specifikisht që çështjet e të miturve duhet të gjykohen nga një autoritet gjyqësor kompetente, i pavarur dhe e paanshme dhe brenda afateve ligjore.⁹⁵ Po kështu, në gjykimin e të miturve gjykatat duhet të kenë prioritet interesin më të lartë të fëmijës dhe caktimi i masës së ndëshkimit duhet të jetë në proporcion me veprën e kryer.⁹⁶

Aktualisht gjykimi të miturve rregullohet nga Kodi i Procedurës Penale. Kështu në nenin 13 paragrafi 4 përcaktohet se “ *Gjykimi i të miturve bëhet nga seksionet përkatëse, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, të përcaktuara me dekret të Presidentit* “. KPP përcakton edhe si do të veprohet në rastet kur një person ka realizuar një vepër penale kur ka qenë i mitur por momenti i gjykimit të tij realizohet kur ai ka mbushur moshën madhore. Kështu sipas nenit 81 paragrafi 2 përcaktohet se “*Kur i pandehuri në kohën e gjykimit është madhor, por një ose disa vepra i ka kryer kur ka qenë i mitur, çështja gjykohet nga gjykata që shqyrton çështjet me të mitur.*”. Pra, Kodi i jep prioritet momenti të kryerjes së veprës penale dhe jo momentit të gjykimit të saj në rastin konkret.

Në vendin tonë aktualisht ekzistojnë gjashtë Seksioneve për gjykimin e të miturve pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore: Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë Korçë dhe Gjirokastrë.

Sistemi i drejtësisë në Shqipëri paraqet disa problemi në lidhje me zbatimin e legjislacionin për të miturit për shkak të mungesës së një

- a) kuadri ligjor dhe institucional të qartë
- b) ligji material dhe procedural nuk është në strandartet e duhura
- c) mungesa e profesionalizmit të gjyqtarëve në këtë fushë
- d) zvarritje të procesit gjyqësorë të cilat janë të dëmshme për të ardhmen e të miturve

⁹⁵ Shih nenin 40 paragrafi 2 i Kodit për të Drejtat e Fëmijëve

⁹⁶ Shih rregullin 5 të Rregullave të Pekinit

- e) nuk sigurohet një kujdes psikologjik dhe mjekësor në të gjitha fazat e procedimit
- f) mos zbatimi i parimit të proporcionalitetit

Problemet e evidentuara më sipër ndikojnë në procesin e të miturve duke dëmtuar rëndë të drejtat e tyre por edhe duke ndikuar negativisht në formonim dhe të ardhmen e tyre si individ të shoqërisë. Në këto kushte do të ishte me vend krijimi i një gjykate për të miturit i cili do të përbëhej nga një staf i trajtuar dhe i përgatitur për mbrojtjen e të drejtave dhe interesit më të lartë të fëmijëve. Krijimi i një ambienti të specializuar dhe të posaçëm për gjykimin e të miturve do të ndihmonte në mos dëmtimin dhe rikuperimin më të shpejtë të traumave psikologjike që mund ti shkaktohen të miturve gjatë procesit gjyqësor.

4.5.4. Roli i Prokurorisë në hetimin e të miturve në konflikt me ligjin penal

Prokuroria është institucioni përgjegjës i cili lufton kriminalitetin në Shqipëri në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Objekti i veprimtarisë së Prokurorisë përcaktohet në nenin 2 të ligjit për Prokurorinë nga ku në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij ligji thuhet se: “*Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit në gjyq, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj. 2. Prokuroria i ushtron funksionet nëpërmjet prokurorëve.*” Nga analiza që realizuam në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” vemi re që minojnë strukturat për të miturit pranë prokurorisë, po kështu vendi ynë nuk disponon prokuror të trajnuar në mënyrë specifike në lidhje me trajtimin dhe mbrojtjen e të miturve. Aktualisht janë realizuar vetëm disa trajnime nga Shkolla e Magjistraturës në lidhje me respektimin e të drejtave të të miturve por kjo është e pamjaftueshme për mbarëvajtjen e proceseve hetimore dhe gjyqësore në përputhje me standardet evropiane. Në këto aspekt do të sugjerohet krijimin e një seksioni për të miturit ose trajnimin në mënyrë konstante të disa prokurorëve të cilat do të trajtonin çështjet e të miturve.

4.5.5. Të miturit në raport me policinë e Shtetit dhe policinë gjyqësore

Policia e Shtetit dhe Policia gjyqësore janë dy institucione të rëndësishme në lidhje me evidentimin dhe kapjen e të miturve që janë të përfshirë në kriminalitet. Këto institucione dallojnë nga njëri – tjetri nga varësia dhe funksionet e tyre. Pra ato kanë role të ndryshme në trajtimin e të miturve.

Kështu Policia e Shtetit është një institucion me varësi të drejtpërdrejt nga Ministria e Brendshme që e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin nr. 108/2014 Për Policinë e Shtetit. Misioni i këtij institucioni përcaktohet në nenin 2 të ligjit ku përcaktohet se *“Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësishme veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.”*. Një ndër parimet e të rëndësishme mbi të cilën e ushtron veprimtarinë e saj Policia e Shtetit është parimi i respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut⁹⁷. Në nenin 18 të këtij ligji përcaktohet se *“Çdo punonjës i policisë gëzon atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me legjislacionin procedural penal dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.”*. Gjatë analizimit të ligjit të policisë së shtetit evidentuam se funksioni saj primar është parandalimi dhe luftimi i kriminalitetit dhe në nenin 101 paragrafi 2 trajtohen masat për mbrojtjen e rendit në rastet kur vepra penale është realizuar nga një i mitur. Kështu, në këtë paragraf parashikohet se *“Nëse cenimi i rendit dhe sigurisë publike ka ardhur si pasojë e veprimeve të një personi të mitur nën 14 vjeç, punonjësi i policisë merr masa për të ndërprerë veprimet e paligjshme dhe njofton prindin ose kujdestarin e të miturit.”*

Masat mbrojtëse ndaj të miturve përcaktohen në nenin 123. Kështu, në paragrafin 5 të nenin 123 parashikohet si masë mbrojtëse mbajtja e të miturve në ambientet e policisë jo më shumë se 10 orë⁹⁸ në kushte të përshtatshme për ta. Ligji nxjerr në pah karakterin bashkëpunues të punonjësve të policisë së shtetit me qendrat e përkujdesjes sociale për të miturit⁹⁹. Struktura e vetme për të mituri është Drejtoria Kundër Akteve Terroriste & Krimeve të Hapura, e cila ka në përbërjen e vet Sektorin

⁹⁷ Shih nenin 5 pika c të Ligjit “Për policinë e shtetit”

⁹⁸ Shih nenin 123 paragrafi 5 të Ligjit “Për policinë e shtetit”

⁹⁹ Shih nenin 123 paragrafi 6 të Ligjit “Për policinë e shtetit”

për Mbrojtjen e Fëmijëve. Mungesa e strukturave të përcaktuara në ligj dhe e trajnimit të punonjësve të policisë çon në mos respektimin e ligjeve dhe të rekomandimeve në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të miturve në konflikt me drejtësinë. Është e nevojshme krijimi në nivel vendor të një strukture për mbrojtjen e të miturve dhe trajnimi në nivel të përgjithshëm të të gjithë punonjësve të policisë së shtetit për mbrojtjen e tyre.

Policia gjyqësore e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit nr. 8677, datë 2.11.2000 “Për policinë gjyqësore”. Nuk kemi aktualisht një sektor të posaçëm në strukturat e policisë gjyqësore që të trajtoj çështjet për të miturit. Ligji “Për policinë gjyqësore” nuk disponon dispozita që të rregullojnë trajnimin e punonjësve të kësaj njësie për të drejtat e të miturve.

4.5.6. Rëndësia e ekzistencës së Avokatit të të miturve

Ndihma ligjore është një e drejtë që sanksionohet dhe garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë. E drejta e mbrojtjes garantohet në nenin 31 të Kushtetutës dhe në Kodin e procedurës Penale. Kështu në nenin 35 të KPP-së trajtohet ndihma që i jepet të pandehurit të mitur. Në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se *“Të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon.”* Pra e drejta për të pasur një avokat i cili dot mbroj të drejtat e të miturve përbënë një detyrim ligjor. Kjo përforcohet më shumë nëse do të analizojmë nenin 49 të KPP-së. Në paragrafin 2 të nenin 49 të KPP-së përcaktohet se *“Kur i pandehuri është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç ose me të meta fizike a psikike që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme”*. Pra mungesa e mbrojtësit do të bënte të pavlefshëm vendimin që autoriteti gjyqësor do të jepte në rastet çështjeve ndaj të miturve.

Në ligjin nr. 9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” Nuk gjejmë dispozita që mund të përcaktojnë ndihmën ndaj të miturve. Po kështu vërejmë që nuk ka dispozita të posaçme që të detyrojnë avokatët të marrin

trajnimi ose njohuri specifike që i referohen legjislacionit për të miturit. Kjo shtron problemin e kualifikimit të mjaftueshëm të tyre nga ana profesionale. Ligji nuk parashikon as masa disiplinore në rastet e mosparaqitjes së avokatëve në çështjet e të miturve si një kategori e cila kërkon një vëmendje dhe trajtim të veçantë. Në lidhje me këto probleme d të sugjeronim implementimin në këtë ligj të disa dispozitave të cilat do të parashikonin dhe përcaktonin pozicionin e avokatit në raport me mbrojtjen e të drejtave të të miturve. Do të sugjeronim po kështu edhe zgjedhjen nga ana e Dhomës Kombëtare të Avokatisë të disa avokatëve të cilët do të trajtonin heshtjet e të miturve dhe do të ishin të specializuar në këtë fushë. Koordinimi i mirë midis gjykatave dhe prokurorive nga njëra anë dhe dhomave vendore të avokatisë në rrethe nga ana tjetër do të rriste cilësinë e përfaqësimit dhe të mbrojtjes së të miturve.

4.5.7. *Institucionet me karakter ndëshkues dhe edukues të vuajtjes së dënimit*

Institucionet e paraburgimit dhe të burgjeve janë institucionet ku personat qëndrojnë gjatë periudhës së dënimit ose deri në pritjen e marrjes së vendimit nga ana e gjykatës. Ato e ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me Kodin Penal; Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin nr. 8328 / 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.¹⁰⁰ Këto institucione janë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Në nenin 5 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” përcaktohet se ‘ *Të miturit e paraburgosur dhe të dënuar trajtohen duke respektuar liritë dhe të drejtat themelore të tyre. Trajtimi mbështetet në interesin më të lartë të fëmijës, të integritetit shoqëror, edukimit dhe parandalimit të rifutjes në krim.*’ Të miturit e vuajnë dënimin në institucione të posaçme vetëm për to dhe në pamundësi, në seksione të veçanta të institucioneve të tjera sipas kriterëve të këtij ligji.¹⁰¹ Në këtë ligj nuk është parashikuar mundësia e trajnimit të personelit në lidhje me të drejtat e të miturve dhe ende ne vendin tonë mungojnë institucione riedukimi në lidhje me vuajtjen e dënimit nga të miturit.

¹⁰⁰ I ndryshuar me ligjin nr. 9071/ 22.5.2003 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”;

¹⁰¹ Shih nenin 17 paragrafi 1 të ligjit nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”

KREU V: ASPEKTET PROCEDURALE DHE MASAT QË PARASHIKOHEN NË LEGJISLACIONIN BASHKËKOHOR PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN PENAL

5.1.Aspektet procedurale që ofrojnë mbrojtje ndaj të miturve

Mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore është një nga parimet më të rëndësishme të shtetit shqiptar e sanksionuar qartë kjo në Kushtetutë, në Kodin Penal, në Kodin e Procedurës Penale dhe në të gjitha konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë dhe që janë të detyrueshme për zbatim. Mbrojtje e të drejtave të njeriut përbën edhe një detyrim moral edhe njerëzor në aspektin shoqëror, për faktin se të drejtat e një personi mbarojnë aty ku fillojnë të drejtat e një personi tjetër. Aktet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare u akordojnë të miturve një trajtim të veçantë në mënyrë që të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave në të gjitha fazat e procedimit penal si gjatë hetimit paraprak, gjyqimit në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor, dënimit dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, si dhe trajtimit në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe të edukimit. Duke marrë në konsideratë moshën e fëmijës, zhvillimin e tij fizik dhe mendor i cili është ende në proces duhet të themi që fëmija ka nevojë për një mbrojtje të veçantë jo vetëm nga familja por dhe nga institucionet shtetërore të përfshira në dhënien e drejtësisë për të miturit.

Aspekti procedural i trajtimit të një akti kriminal ku është përfshirë një i mitur ka një rëndësi esenciale që fillon në momentin e parë të ndalimit dhe vazhdon me të njëjtin intensitet deri në procesin gjyqësor. Kjo për faktin se një procedurë e papërshtatshme do të cënonte të drejtat dhe liritë themelore të miturit në veçanti dhe të çdo individi tjetër në përgjithësi. E drejta e lirisë dhe sigurisë së personit është një nga të drejtat themelore dhe më të rëndësishme të të drejtave të njeriut e cila vjen pas të drejtës së jetës, kjo pasi liria dhe siguria kanë të njëjtat vlera si dhe vetë jeta. Termat liri dhe siguri duhen interpretuar në sinkronizim me njëri – tjetrin sepse liria e personit nënkupton lirinë nga arrestimi dhe ndalimi kurse siguria e personit nënkupton mbrojtjen kundër ndërhyrjes arbitrare ndaj lirisë së tij. (Hasani,2015,13)

Legjislacioni penal në Republikën e Shqipërisë ashtu si çdo legjislacion tjetër penal bashkëkohor, bazohet në parimet demokratike të dhënies së drejtësisë, të cilat synojnë të sigurojnë një procedim penal të drejtë dhe të barabartë duke siguruar mbrojtjen e lirive themelore dhe interesave të ligjshme të individëve si dhe forcimin e rendit juridik e zbatimin e Kushtetutës e legjislacionit në tërësi. Legjislacioni ynë penal dallohet nga karakteri i pastër akuzator, me barazi të plotë të palëve në fazën e gjykimit të çështjes, duke i akorduar të drejta më të gjëra organit të ndjekjes penale gjatë hetimit paraprak, të drejta këto të cilat verifikohen, kontrollohen e miratohen nga ana e gjykatës për veprimet kryesore procedurale.

Veprimtaria e organeve proceduese penale ka si qëllim njohjen sa me mirë të kushteve dhe të rrethanave në të cilat ka ndodhur një vepër penale e caktuar si dhe në tërësi çdo fakt apo e dhënë që lidhet me të. Kjo në vetvete përbën atë që quhet njohje e cila realizohet nëpërmjet administrimit shqyrtimit dhe verifikimit të të gjithë fakteve dhe të dhënave që lidhen me veprën penale dhe autorin, pasojën dhe çdo element që lidhet me objektin e të provuarit. E vërteta në procesin penal zbulohet e provohet nëpërmjet fakteve dhe provave penale të cilat administrohen gjatë gjithë procesit penal nga ana e organeve proceduese dhe subjekteve procedurale. (Elezi,2015,166)

Në nenin 2 të Kodit të Procedurës Penale janë parashikuar rregulla për mënyrën e ndjekjes, hetimit dhe gjykimit të veprave penale si dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, rregulla këto të cilat janë të zbatueshme për subjektet e procedimit penal për organet shtetërore, personat juridik dhe shtetasit.¹⁰² Në kodin e procedurës penale janë parashikuar një sere dispozitash që gjejnë zbatim për të miturit.

5.1.1. Procedura e ndalimit dhe e arrestimit të të miturve

Në procedimin penal të të miturve përfshihen tërësia e akteve procedurale që ndërmerren ndaj çdo një personi që nga momenti i marrjes së tij si i pandehur e deri në momentin e marrjes së një vendimi të formës së prerë nga gjykata në ngarkim të tij. Në

¹⁰² Shih nenin 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se “Dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit.”

Kodin e Procedurës Penale nuk ka një kapitull të veçantë i cili do të na udhëzonte për mënyrën dhe trajtimin e të miturve të proceduar penalisht. Gjithashtu në KPP-në nuk janë parashikuar parimet e procedimit penal për të miturit dhe nuk gjen pasqyrim në mënyrë të shprehur, parimi i interesit më të lartë të fëmijës.

Procesi i drejtësisë për të mitur fillon me hetimin të realizuar nga oficeri i policisë si autoriteti përgjegjës për hetimin dhe identifikimin e një kundërvajtje gjatë momentit të kryerjes ose kur është e denoncuar. Në momentin e ndalimit ose arrestimit oficeri i policisë pasi analizon situatën duhet :

1. Lë të lire të miturin dhe e dërgon pranë prindërve të tij/saj me një vërejtje ose qortim
2. E liron të miturin dhe e çon pranë prindërve me kushtin që i mituri të futet në një program kumunitar
3. E mban të miturin në ruajtje dhe referon rastin në gjykatat për të miturit për procedim të mëtejshëm. (Save the children 2012,10)

Policia është organi ajo që merr kontaktin e parë me autorin e veprës penale. Detyra e saj është ta shoqërojë personin në rajonin e policisë në raste kur ka arsye të bazuara se personi ka kryer një vepër penale. Kodi i Procedurës Penale nuk ka parashikuar asgjë në ansnjë nga dispozitat nga 251 deri në 259 në lidhje me ndalimin apo arrestimin e të miturve në kreun e III të titullit V. Këto dispozita përmbajnë aspekte të përgjithshme procedural në lidhje me kushtet dhe procedurat e ndalimit dhe të arrestit në flagrancë të cilat zbatohen në mënyrë të përgjithshme, pa bërë përjashtim për ndonjë kategori të veçantë, përfshirë të miturit.

Në nenin 254 të K.Pr.P –së parashikohen kushtet e lejimit të ndalimit ose arrestimit në flagrancë ku përcaktohet se “ *Arrestimi ose ndalimi nuk lejohet kur nga rrethanat e faktit del se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyre ose gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme ose kur ekziston një shkak padënueshmërie.*” Me shkak padënueshmërie ndërmjet të tjerash kuptohet që personit të cilit i atribuohet vepra penale të ketë mbushur moshën 14 vjeç. Kështu në bazë të Kodit të Procedurës Penale për kryerjen e arrestimit në flagrancë kërkohet të ekzistojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të shoqëruara këto dhe me kriteret për caktimin e masave të sigurimit, të

ekzistojë gjendja e flagrancës, si dhe të jetë duke u kryer një vepër penale nga ato të parashikuara në nenin 251 të K.Pr.¹⁰³ Penale (Islami& Hoxha& Panda, 2010, 355) Në nenin 252 të K.Pr.P-së mbi flagrancën përcaktohet se *“është në gjendje flagrante ai që është kapur në kryerjen e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndihet nga policia gjyqësore , nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova materiale nga të cilat duket se ka kryer veprën penale”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite arrijmë në përfundimin se gjendja e flagrancës mund të konstatohet në tre raste:

1. është në gjendje flagrante personi i cili kapet në kryerje e sipër të veprës penale, pra e thënë ndryshe personi i cili kapet në dinamikë e sipër të konsumimit të veprës penale ;
2. është në gjendje flagrante personi i cili menjëherë pasi e ka kryer veprën penale, ndiqet nga ana e policisë gjyqësore, nga personi dëmtuar apo nga persona të tjerë;
3. është në gjendje flagrante personi i cili kapet me sende e prova materiale prej të cilave konstatohet se ky person ka kryer veprën penale.

Praktatika gjyqësore italiane në lidhje me tre rastet e gjendjes së flagrancës të sipërpërmendura arsyeton se “flagranca në kuptimin e përgjithshëm ndahet në dy nënkuptime të tjera të cilat mund të quhen si “flagranca e vërtetë” dhe “thujse flagrante”, Do të konsiderohet se është në gjendjen e “flagrancës së vërtetë” personi i cili kapet në kryerje e sipër të veprimeve të kundërligjshme, ndërsa do të jetë në gjendjen e “cuasi flagrancës” personi i cili menjëherë pas kryerjes së veprës penale

¹⁰³ Shih nenin 251 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se *“Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kryejnë detyrimisht arrestimin e cilitdo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet. 2. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet ose për një vepër penale të kryer nga pakujdesia, për të cilën ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dhjetë vjet. 3. Kur lind nevoja e domosdoshme, për shkak të rëndësisë së faktit ose të rrezikshmërisë së subjektit, e motivuar me akt të veçantë, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë, edhe kur nuk janë kushtet e pikës 2. 4. Në rastet e parashikuara nga paragrafi 1, çdo person është i autorizuar të kryejë arrestimin në flagrancë për krimet që ndiqen kryesisht. Ai që ka kryer arrestimin duhet të dorëzojë menjëherë të arrestuarit në policinë gjyqësore, e cila mban procesverbal për dorëzimin dhe i jep një kopje të tij.”*

ndiqet nga ana e oficerëve apo të agjentëve të policisë gjyqësore nga personi i dëmtuar ose persona të tjerë. (Skenderaj& Mëngjesi 2015, 243)

Në rastet e arresteve në flagrancë ose ndalimeve agjentët e policisë gjyqësore janë të detyruar të respektojnë disa rregulla të përgjithshme të cilat janë të vlefshme edhe për të miturit. (Xhafo,2012,101) që janë:

- ✚ Të njoftojë të ndaluarin apo të arrestuarin në gjuhen që kupton, në lidhje me shkaqet e masës dhe të akuzës që i bëhet;
- ✚ Të njoftojë prokurorin e vendit ku është bërë arrestimi ose ndalimi;
- ✚ Ti bëjë të ditur të drejtën për të zgjedhur mbrojtës dhe të njoftojë mbrojtësin e zgjedhur apo të caktuar nga prokurori;
- ✚ Të vënë të ndaluarin apo të arrestuarin në dispozicion në dhomat e paraburgimit, në një kohë sa me të shpejtë;
- ✚ T'i garantojë të drejtën e trajtimit njerëzor dhe respektimin e dinjitetit të tij.

Në rastet kur i ndaluari ose i arrestuari është i mitur zbatohen edhe disa rregulla të veçanta si;

- ✚ Të njoftojë menjëherë prindërit apo kujdestarin ¹⁰⁴
- ✚ Garantimi i mbrojtjes që në rastin e të miturve është e detyrueshme ¹⁰⁵
- ✚ Me urdhër të prokurorit, mbajtja në ruajtje në banesën e tij, ose çdo vend tjetër të ruajtur. ¹⁰⁶

Nëse do i referohemi legjislacioneve të huaja do të do të shikonim se parashikohen një tërësi masash të veçanta në rastet e ndalimit të cilat nuk gjejnë pasqyrim në legjislacionin tonë. Në Itali kemi seksione të posaçme të policisë gjyqësore për të miturit D.P.R.22-9-1988 n.448 ku përcaktohet që në çdo prokurori të Republikës Italiane procedurat e të miturve zhvillohen nga strukturat e specializuara të oficerëve të policisë gjyqësore të cilat janë trajnuar dhe specializuar me metoda specifike. (D.P.R. 22-9-1988.n.448 neni 5)

¹⁰⁴ Shih nenin 255 paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë

¹⁰⁵ Shih nenin 49 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë

¹⁰⁶ Shih nenin 255 paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë

Në nenin 28 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë “*Personit të cilit i është hequr liria sipas nenit 27/c pra kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes se saj duhet të dërgohet brenda 48 orësh përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij*”. Privimi i lirisë për më shumë se 48 orë duhet të jetë i autorizuar nga gjykata dhe të bëhet në mjediset e një institucioni të privimit të lirisë që ndodhet në autoritetin e Ministrisë së Drejtësisë. (Leskoviku, 2010, 43)

Në nenin 54 Kushtetuta sanksionon që “*Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatëzana dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti*” Të miturit shoqërohen në mjedise të veçanta nga ato të të rriturve. Në rastin e një të mituri duhet të njoftohet menjëherë prokurori, familja dhe avokati mbrojtës. Pasi personi ndalohet duhet të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t’i krijohet mundësia për të njoftuar familjen dhe të afërmit e tij¹⁰⁷ Ndërsa në KPP të Italisë oficerët e policisë gjyqësore, në rastet e tilla janë të detyruar të njoftojnë jo vetëm prokurorin dhe familjen por edhe shërbimet për të miturit.¹⁰⁸ Siç shihet KPP për të miturit në Itali sjell një shembull pozitiv në lidhje me aspektet procedurale në rastet e ndalimit apo arrestimit të personave të mitur. (Xhafo, 2012, 103)

Në KKP gjenden një sërë dispozitash procedurale, që sigurojnë një trajtim të veçantë për këtë kategori personash. Kështu në nenin 35 të kodit të procedurës penale përcaktohet se “*1. Të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon. 2. Organi procedues mund të kryejë veprime dhe të përpilojë akte, për të cilat kërkohet pjesëmarrja e të miturit, pa praninë e personave të treguar në paragrafin 1, vetëm kur një gjë e tillë është në interes të të miturit ose kur vonesa mund të dëmtojë rëndë procedimin, por gjithmonë në praninë e mbrojtësit.*”

Në Konventën për të Drejtat e Fëmijës përcaktohet se: *Fëmijës i jepet mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtpërdrejtë, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në*

¹⁰⁷ Shih nenin 31 paragrafi 1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë

¹⁰⁸ Shih nenin 18 të Kodit të Procedurës Penale Italiane

*përputhje me rregullat e procedurës të legjislacionit kombëtar*¹⁰⁹. Në këtë dispozitë ligji është shumë i qartë në lidhje me i ndihmë që i ofrohet të miturit qoftë ndihma e avokatit qoftë dhe pjesëmarrja e psikologut gjatë gjithë procedimit penal.

Një nga problemet me të cilin përballet policia është identifikimi i moshës së të miturit. Neni 41 i Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se “1. Në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, kur ka arsye për të besuar se i pandehuri është i mitur, organi procedues bën verifikimet e nevojshme dhe kur është rasti urdhëron ekspertimin. 2. Kur, edhe pas verifikimeve dhe ekspertimit, mbeten dyshime për moshën e të pandehurit, prezumohet se ai është i mitur.”

Ndërsa sipas kodit të procedurës penale italianë për sa i përket pasigurisë për moshën e të pandehurit thuhet se “1. Në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit kur ka arsye për të besuar se i pandehuri është minoren autoriteti gjyqësor i transmeton të dhënat prokurorit pranë gjykatës për minorenët.”

Në praktikë ndodhin shpesh herë abuzime me identifikimin e moshës së të miturit për shkak të frikës që ndiejnë të miturit ndaj oficerëve të policisë. Kështu të miturit refuzojnë të tregojnë moshën e tyre apo të dhëna të tjera të domosdoshme siç mund të jetë adresa e shtëpisë. Në një studim të bërë nga UNICEF thuhet: Ne kemi gjetur më shumë se një herë policë që përdorin dhunë kundër të miturve vetëm që të merrnin këtë informacion në kohë. (UNICEF,2005,32) Pra një çështje me një rëndësi të madhe gjatë procedimit policor është marrja në pyetje e të miturit . Aktet ndërkombëtare rekomandojnë që të veprohet me kujdes të posaçëm. (Dervisha, 2014j,3) Policia gjatë marrjes në pyetje duhet të ketë parasysh të mos përdorë dhunë mbi të miturit. Ndalohet përdorimi i dhunës në të gjitha format e shfaqjes së saj e shprehur kjo më qartë në nenin 25 të Kushtetutës së Shqipërisë ¹¹⁰si dhe në neni 3 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ku thuhet askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor e poshtërues. Komunikimi i oficerëve të policisë me të miturit është kryesisht asocial dhe jo në nivelin e kërkuar.

Një problematikë tjetër në lidhje me ndalimin e të miturve në ambientet e komisariatit të policisë dhe të paraburgimit është mungesa e një psikologu dhe e një

¹⁰⁹ Shih nenin 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës

¹¹⁰ Shih nenin 25 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

përkthyesi. I mituri gëzon të drejtë të pyetet në gjuhën e vet ashtu siç është e parashikuar edhe në kodin e procedurës penale në nenin 123 ku thuhet se i pandehuri që nuk njeh gjuhën shqipe ka të drejtë të ndihmohet falas nga një përkthyes për të kuptuar akuzën dhe për të ndjekur veprimet ku merr pjesë.¹¹¹ Kështu mund të themi që gjatë procedimit policor vërehen një sërë mangësish. Shpesh të miturit merren në pyetje në të njëjtin vend me të rriturit, ushtrohet forcë për të marrë informacionet e dëshiruara. Pra pavarësisht që dispozitat janë të qarta në lidhje me të miturit ka akoma shumë për t'u bërë me qëllim që të kihet parasysh interesi me i lartë i fëmijës.

5.1.2. Trajtimi ligjor i të miturve në rastet e paraburgimit

Paraburgimi si masë ndalimi duhet të autorizohet nga një gjykatë.¹¹² Në kodin e procedurës penale thuhet se paraburgimi mund të jepet vetëm kur çdo masë tjetër do të ishte e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veprës dhe të të akuzuarit. Në rastet e veçanta gjykatësi për të mitur mund të marrë vendim që ti caktojë paraburgim të miturit, vetëm nëse konstaton se me masën e vendosjes së përkohshme në një ent edukativ nuk mund të arrihet efekti i duhur (Arfi, 2011,112) Masat e sigurisë alternative përfshinë arrestin në shtëpi,¹¹³ depozitimin e një garancie dhe detyrimin për paraqitje periodike në polici apo t'i nënshtrohet detyrimit të qëndroje brenda një zonë të caktuar gjeografike (Leskoviku, 2011,44)

Kohëzgjatja dhe afatet e paraburgimit gjenden të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale ku përcaktohet se kohëzgjatja maksimale e paraburgimit është deri në dy vjet, por mund të ketë një shtyrje deri në tre vjet, kjo në rastet të veçanta nga natyra lloji dhe kompleksiteti i veprës, si në rastet kur procedohet për krime që dënohen jo më pak se dhjetë jetë burg ose me burgim të përjetshëm.¹¹⁴ Këto afate gjejnë zbatim si për të rriturit ashtu edhe për të miturit. Kur një i mitur është arrestuar dhe është në pritje të gjyqimit, prokurori duhet të njoftojë gjyqtarin për progresin në përgatitjen e çështjes çdo dy muaj. (Leskoviku, 2010,44)

¹¹¹ Shih nenin 123 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

¹¹² Shih nenin 238 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

¹¹³ Shih nenin 237 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

¹¹⁴ Shih nenin 250 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë

Legjislacioni italian aplikon si kriterë dhe kushte të cilat reflektojnë standarde ndërkombëtare duke u zbatuar në një kohë sa më të shkurtër. Në përgjithësi paraburgimi zbatohet vetëm në rastet e krimeve me rrezikshmëri të lartë.¹¹⁵ Në ligjin nr 4/ 2014 thuhet se të miturit e paraburgosur trajtohen duke respektuar liritë dhe të drejtat themelore të tyre. Trajtimi mbështetet në interesin me të lartë të fëmijës, të integritetit shoqëror, edukimit dhe parandalimit të futjes në rrugën e krimit. Ligji për ekzekutimin e vendimeve penale dhe ligji për trajtimin e të dënuarve me paraburgim dhe të paraburgosurve, parashikon mbajtjen e të miturve në institucione të veçanta ose në seksione të veçanta. Ligji Nr 8328, datë 6.04.1998, neni 75 mbi të drejtat e paraburgosurve parashikon që në institucionet e paraburgimit ndalohet mbajtja e të miturve në dhoma me të rriturit, ose vendosja e të miturve vajza në një dhomë me të miturit djem.

Të miturit vendosen në dhoma dhe seksione të veçuara, duke u krijuar mundësinë e një trajtimi të veçantë. Të miturat vajza mbahen nën mbikëqyrjen dhe kujdesin vetëm të një personeli femëror.¹¹⁶ Në këtë pjesë të legjislacionit ka një kontradiktë pasi nga ana legjislative dispozitat janë shumë të qarta në lidhje me vuajtjen e dënimit nga të miturit por nga ana institucionale lë mungojnë institucionet e posaçme për të miturit.

Në legjislacionin e vendit tonë kjo procedurë është e përcaktuar shumë qartë edhe pse ka raste përjashtimore siç mund të jetë Serbia ku i mituri gjatë qëndrimit të tij në paraburgim mund të jetë në një dhomë me të rriturin, por kjo mund të jetë vetëm në rastet e veçanta kur vendos gjykatësi për të miturin, por gjithmonë duhet të ketë parasysh që madhori që është në paraburgim me të miturin mos të ndikojë në aspektin negativ, por vetëm pozitiv. (Arifi, 2011, 112) Pavarësisht përcaktimit ligjor që masa e sigurisë arrest me burg duhet të përdoret kur të gjitha masat e tjera janë të papërshtatshme, në praktikën tonë vërehet një zbatim i shpeshtë i saj dhe një kohëzgjatje e madhe e paraburgimit. Për këtë qëllim duhet të bëhen ndryshime ligjore në KPP duke përcaktuar afate të veçanta të paraburgimit për të miturit dhe kriterë të veçanta për aplikimin e kësaj mase.

¹¹⁵ Shih nenin 23 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Italice

¹¹⁶ Shih Ligjin Nr 8328. datë 6,04,1998 “ për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”

5.1.3. Garancitë ligjore në procesin gjyqësor ndaj të miturve

Gjykimi është një nga momentet me të rëndësishme të procedimit penal dhe ka një rëndësi të veçantë për sa i përket respektimit të garancive procedurale dhe të interesit më të lartë të të miturve. Procedura e gjykimit fillimisht duhet të jetë në përputhje me standardet minimale të gjykimit, kryesisht ato që lidhen me parimin e procesit të rregullt ligjor. Këtu do t'i referoheshim KEDNJ e cila përcakton kriteret e një procesi të rregullt ligjor. Në nenin 6 të KEDNJ –së trajtohet e drejta për një proces të rregullt gjyqësor ku përcaktohet se “ *Çdo person ka drejtë që çështja e tij të dëgjohet, publikisht dhe brenda një afati kohor të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale*”

Bazuar në këtë nene mund të thuhet se sistemi ynë procedural ka krijuar garancitë e nevojshme për sa i përket garantimit të të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ky parim është sanksionuar në neni 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se : “*Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj*”

Kodi i Procedurës Penale në përputhje me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare parashikon një sërë garancish për sa i përket të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kështu në nenin 1 të K.Pr.P-së thuhet se : “*Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor*” Po ashtu duke ju referuar nenit 6 të KEDNJ në lidhje me pavarësinë e gjykatave, në nenit 3 të KPP penale parashikohet se : “*Gjykata është e pavarur dhe vepron në baze të ligjit*” Një nga aspektet thelbësore të standardeve ndërkombëtare është krijimi i strukturave të specializuara, që administrojnë çështjet për të miturit. Struktura më e rëndësishme në këtë drejtim është ajo e gjykatave për të miturit. Kërkesa për krijimin e gjykatave për të miturit është sanksionuar në aktet ndërkombëtare, bazuar në veçantitë e subjekteve për të miturit dhe nevojën e sanksionimit të garancive të veçanta procedurale që lidhen me gjykimin e të miturve. (Xhafo 2012,150)

Në Shqipëri nuk ekzistojnë gjykatat për të miturit. Në neni 13 të Kodit të Procedurës Penale thuhet që *“Gjykimi i të miturve bëhet nga seksionet përkatëse të krijuara nga gjykatat e rretheve gjyqësore, të përcaktuara me dekret të Presidentit të Republikës”* Krijimi i seksioneve të gjykatave për të miturit në gjashtë rrethet gjyqësore, ku janë vendosur dhe gjykatat e apelit ka qenë një hap i rëndësishëm në përmirësimin e drejtësisë penale. Secili seksion përbëhet nga një gjyqtar. Krimet e dënueshme me një dënim prej më shumë se 10 vjet burgim, duhet të gjykohen me një panel i përbërë prej tre gjyqtaresh. Bazuar në ligjin e sipërpërmendur, seksionet penale për gjykimin e të miturve krijohen në gjykatat e përcaktuara nga dekreti i presidentit.

Në Itali kemi gjykata të posaçme për të miturit të cilat janë themeluar në bazë të ligjit n 1404 20 korrik 1934. Gjykatat për të miturit u ndërtuan si gjykata autonome nga gjykatat e tjera penale apo civile, dhe të specializuara në lidhje me natyrën dhe gjendjen e fëmijës. (Arpinati,2012,19). Gjykatësi i hetimeve paraprake në Itali është organ monokratik ndërsa gjykata për vlerësimin paraprak është organ kolegjal dhe përbëhet nga një magjistrat dhe dy jo magjistratë.¹¹⁷ Gjykata e Apelit ka një seksion të veçantë për të miturit të përbërë nga tre magjistratë që asistohen nga dy ekspertë¹¹⁸. Ky është një shembull pozitiv jo vetëm i legjislacionit italian por edhe i shumë vendeve të tjera për sa i përket dhënies së drejtësisë për të miturit.

Në nenin 339 të K.Pr.P së trajtohet publiciteti i seancave gjyqësore ku përcaktohet se *“ Seancat gjyqësore janë publike ndryshe quhet e pavlefshme”* por në rastin e të miturve bëhen përjashtime, parashikuar kjo në nenin 340 pika ç) të Kodit të Procedurës Penale ku thuhet se *“Gjykata vendos që shqyrtimi gjyqësor ose disa veprime të tij të zhvillohen me dyer të mbyllura kur gjykohet e nevojshme në pyetjen e të miturve.”* Ky është një përjashtim që bëhet nga rregulli i përgjithshëm në të cilat seancat gjyqësore zhvillohen me dyer të hapura por kjo bëhet me qëllim që mos të ekspozohet i mituri. Siç e kemi përmendur dhe me sipër të miturit i sigurohet prezenca e një psikologu në çdo fazë të procedimit si në procedimin policor ashtu edhe në atë gjyqësor.

¹¹⁷ Shih nenin 50 të ligjit n 1404 20 korrik 1934

¹¹⁸ Shih nenin 52 paragrafi 4 germa 4 të ligjit n 1404 20 korrik 1934

Në lidhje me procedurën e marrjes në pyetje të të miturve Kodi i Procedurës Penale parashikon se “ *pyetja e dëshmitarëve të mitur mund të behet nga kryetari, mbi kërkesat dhe kundërshtitë e palëve*” . Kryetari mund të ndihmohet nga një familjar i të miturit ose nga një specialist i fushës së edukimit të fëmijës. Kur çmohet se pyetja e drejtpërdrejtë e të miturit nuk e dëmton gjendjen psikologjike të tij, kryetari urdhëron që pyetja të vazhdojë sipas dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2. Urdhri mund të revokohet gjatë pyetjes¹¹⁹. Këto janë rregulla të cilat duhet të respektohen jo vetëm në procesin gjyqësor por gjithashtu edhe në hetimet paraprake si nga prokurori ashtu edhe nga oficeri i policisë gjyqësore. Këta të fundit kur të marrin në pyetje një të mitur duhet të ndihmohen nga një familjar ose nga një psikolog.

Pyetja e të miturve është veprim hetimor me rëndësi të veçantë, i ndërlikuar dhe me shumë veçori nga pyetja e personave mbi 18 vjeç (Spiro,89, 57) Kjo për faktin se të miturit për shkak të moshës së tyre akoma nuk kanë arritur pjekurinë e duhur për të kuptuar mirë rëndësinë e çështjes. Gjykatësi para se ta marrë në pyetje të miturin duhet të jetë i informuar mbi arsimin, familjen, veset e tij që mund të kenë ndikuar te i mituri, kjo për dhënien e një gjykimi sa më të drejtë. Publikimi i gjeneraliteteve të të miturit është e ndaluar kjo e parashikuar në kodin e procedurës penale.

Garancitë minimale të të miturve në konflikt me ligjin janë të parashikuara qartë në nenin 406 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës ku thuhet “*procedura penale duhet të udhëhiqet pa u vonuar nga ana e organit kompetent, të paanshëm e të pavarur ose një trup gjykues me një dëgjim në pajtueshmëri me ligjin në prani të ndihmës juridike ose ndihmës tjetër adekuate përveç nëse konsiderohet se kjo nuk është në interes të fëmijës, posaçërisht duke e marrë parasysh gjendjen në të cilën ndodhet fëmija apo prindërit ose kujdestarët e tij*”. Legjislacioni është shumë i qartë në lidhje me pozitën e të miturve duke e trajtuar në mënyrën sa me humane të mundshme dhe duke e favorizuar këtë të fundit gjatë gjithë procesit penal por problemi real qëndron në aspektin institucional dhe profesional pasi pjesa më e madhe e aktorëve të përfshirë në dhënien e drejtësisë për të miturit nuk janë të trajnuar dhe specializuar. Një tjetër problematikë që haset në këtë fazë të procedimit janë edhe vonesat gjatë procedimit gjyqësor.

¹¹⁹ Shih nenin 361 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë

5.1.4. Procedura e marrjes në pyetje e të miturve

Marrja në pyetje e personave të mitur është një veprim hetimor me një rëndësi të veçantë dhe i ndërlëkuar krahasuar me marrjen në pyetje të të rriturve. Kjo për shkak të vetive të veçanta psikike që ata kanë. Kështu gjatë marrjes në pyetje të të miturve duhet treguar një kujdes i veçantë. Gjatë marrjes në pyetje në rastin e veprës penale dallojmë shumë specifika tek i pandehuri, i dëmtuari, te deklaratat e grave, personave të vjetër, madje edhe të fëmijët të mitur. (Latifi,1982,306)

Në momentin e marrjes në pyetje të të miturve duhet treguar një kujdes i veçantë për shkak të vetive të veçanta psikike të këtyre personave. Me këto veti kuptohet paaftësia e tyre për të kuptuar situatën për shkak të moszhvillimit psikik, mënyrën e të menduarit dhe konceptuarit të gjërave dhe situatave. Vetit e të miturve dallohen nga disa karakteristika:

- ❖ Të miturit shpeshherë e përcjellin gjendjen e vet subjektive me botën objektive,
- ❖ Ata nuk bëjnë dallime të dukshëm ndërmjet të verbëtës dhe gënjeshtres, nëpërmjet të menduarit dhe realitetit duke krijuar mendime bazuar në shkallën e inteligjencës.
- ❖ Fantazia luan një rol të rëndësishëm te fëmijët dhe të miturit, e cila nuk duhet të as të nënvlerësohet e as të paragjykohe. Kjo vlen në rastet e fëmijëve të prirur me fantazi dhe inteligjentë (Latifi,1982,307). Këta të mitur janë të prirur për fantazi dhe transformime imagjinare të realitetit të ngjarjes apo të rrethanave që kanë lidhje me çështjen penale.
- ❖ Negativisht në dhënien e informacioneve reale gjatë pyetjes ndikon edhe ndiejna e frikës dhe mbivlerësimi që mund t'i bëjë i mituri problemit për të cilin pyetet. (Spiro,48)

Përfshirja e të miturit në një proces penal kërkon në të njëjtën kohë dhe asistimin e tij nga psikologu, asistim që gjen bazën e tij ligjore në Kodin e Procedurës Penale, siç është rasti i i arrestimit dhe ndalimit të të miturit. Ky detyrim vjen si pasojë e sanksionimit të tij me ligj dhe në respektim e të drejtës që ka çdo i mitur për tu dëgjuar, kjo në varësi të moshës dhe zhvillimit intelektual.¹²⁰ Marrja në pyetje nga një gjykatës,

¹²⁰ Shih nenin 6 të Kodit të Familjes

prokuror, apo nga një oficer i policisë e të miturit është vlerësuar me rëndësi të veçantë për të ardhmen e tij nga ana e legjislatorit, prandaj është përkufizuar si një nga procedurat që kërkon praninë e ekspertit psikolog.

Prania e këtij eksperti i jep më shumë mundësi dhe aftësi organit të drejtësisë apo atij të hetimit të deshifrojë e të kuptojë të miturin, realitetin ku ky i mitur jeton dhe gjendjen në të cilën ai rritet dhe formohet.

KREU VI: MASAT LIGJORE QË PARASHIKOHEN NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN PENAL. EKSPERIENCA E DISA VENDEVE TË RAJONIT

6.1. Llojet e sanksioneve penale që parashikohen nga legjislacioni ndaj të miturve

Edhe pse të miturit janë një kategori e cila është e favorizuar për shkak pozitës së tyre, në rastet kua ata vërtetohet që ata janë autorë të veprave penale shteti aplikon sanksione penale ndaj tyre. Në aplikimin e sanksioneve duhet të merret në konsideratë nevoja për edukimin dhe mirëqenien e të miturit. Masat të cilat do të gjejnë trajtim janë dënimi me burgim, masat edukuese dhe alternativat e dënimit me burgim. Më poshtë do të trajtojmë në mënyrë të detajuar këto masa që kanë karakter ndëshkues dhe edukues për të miturit.

6.1.1. Dënimi me burgim

Dënimi me burgim është lloji më i rëndë i dënimit që mund të aplikohet ndaj të miturve dhe dihet të aplikohet përjashtimisht vetëm për llojet e veprave penale shume të rënda (Salihu,2008,635) Qëllimi i dënimit me burgim është që ndaj autorëve të mitur të veprave penale, të sigurohet edukimi dhe riedukimi i tyre, qëllim ky i cili nuk është i shprehur në legjislacionin tonë penal. Nëse do ti referoheshim legjislacioneve të huaja gjejmë dhe shembuj të sanksionimit me ligj të qëllimit të burgimit për të miturit. Kështu në nenin 32 të Kodit Penal të Kosovës thuhet: *“Qëllimi i burgimit për të miturit është që të kontribuojë në rehabilitimin dhe në zhvillimin e kryesit të mitur, veçanërisht në edukimin e të miturit, edukimin e specializuar, aftësitë profesionale, dhe në zhvillimin e duhur personal. Përveç kësaj, burgimi për të miturit duhet të ndikojë pozitivisht në të miturin, përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për të parandaluar recidivizmin”*. Po ashtu në Kodin Penal të Kosovës në lidhje me caktimin e dënimit si mjet i fundit duhet të plotësohen disa kushte të cilat janë parashikuar në mënyrë taksative në legjislacionin penal. Këto kushte janë paraqitur në neni 30 të ligjit penal ku thuhet se *“ nëse i mituri është i mitur, përkatësisht nëse në kohën e kryerjes se veprës penale i ka mbushur 16 vjeç por nuk i ka mbushur 18 vjeç.;nëse ka kryer vepër penale për të cilën është parashikuar dënimi me burgim mbi pesë vjet;nëse gjykata konstaton nivelin e*

caktuar të përgjegjesisë, nëse ajo konstaton se ka qenë penalisht i përgjegjshëm. nëse vepra penale ka shkaktuar pasoja shumë të rënda dhe për shkak të lartë të përgjegjesisë nuk do të ishte adekuate të jepen masa edukative.”

Në literaturën juridike rezulton se burgimi për të miturit është dënim i karakterit supsidiar dhe aplikimi i tij është gjithmonë fakultativ. (Salihu,2008,635) Mungesa e një neni të posaçëm, për kuptimin e qëllimit është konsideruar si një nga mangësitë primare të Kodit Penal Shqiptar. Por pavarësisht mungesës së një dispozite të veçantë për sa i përket qëllimit të dënimit me burgim i mituri në krahasim me të rriturin sipas legjislacionit shqiptar gëzon një mbrojtje të veçantë, mbrojtje e cila është e sanksionuar në dokumente të ndryshme ndërkombëtare të cilat shteti shqiptar i ka miratuar tashmë dhe gjejnë zbatim si në Kodin Penal dhe ligje të tjera.

Dënimi me burgim në varësi të elementëve të figurës së krimit përfshin një masë dënimi nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet. (UNICEF,2010,55) Për sa i përket kundërvajtjeve penale jepet nga pesë ditë deri në dy vjet. Por kur është fjala për të miturit Kodi i Procedurës Penale ka vendosur kritere të veçanta për aplikimin e masës arrest me burg. Sipas Kodit të Procedurës Penale masa e arrestit me burg duke u nisur nga fakti se është dënim me i rende që mund ti jepet të miturit, duhet të aplikohet si masë e fundit vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të autorit.¹²¹

Në nenin 29 të Kodit Penal në dënimet kryesore kemi dënimin me burg si për të rriturit ashtu dhe për të miturit. Nuk është se janë përcaktuar kritere të qarta për sa i përket zbatimit për të miturit.¹²² I vetmi kriter i qartë për sa i përket të miturve është në lidhje me kundërvajtjet penale ku në nenin 230 shprehimisht thuhet se nuk mund të zbatohet masa arrest në burg për të miturit që akuzohen për kundërvajtje penale.¹²³ Nga analiza e nenit 230 që përcakton kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg, mund të evidentojmë një mangësi. Për një kategori të caktuar subjektesh, si gra shtatzëna ose gra me fëmijë me gji, personat në gjendje shëndetësore e rëndë ose ata që kanë mbushur moshën 70 vjeç, si dhe ata toksikomanë ose të alkoolizuar, që u

¹²¹ Shih nenin 231 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale

¹²² Shih nenin 29 të Kodit Penal

¹²³ Shih nenin 230 paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale

nënshtrohen programeve terapeutike në institucione të posaçme, masa e arrestit mund të vendoset vetëm në raste të veçanta dhe për krime që dënohen jo më pak në maksimum se 10 vjet. Në këtë kategori nuk janë futur personat e mitur. (Xhafo.2013,111)

Në neni 51 të Kodit Penal përcaktohet se “Për të miturit, që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer.”. Dënimi maksimal që mund të jepet për vepra penale të kryera nga persona nën moshën 18 vjeç, është, dymbëdhjetë vjet e gjashtë muaj (Leskoviku, 2010, 46) Në këtë rast gjykata krijon një dispozitë të re në përfytyrimin e saj me sanksion të përgjysmuar të dënimit me burgim, brenda kufijve kur cakton dënimin e të miturit (Muci, 2012,324).

Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund të jepet ndaj personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç¹²⁴. E shpjeguar më saktë gjykata e pjesëton më dysh kufirin minimal dhe maksimal të veprës penale të kryer nga i mituri dhe më pas cakton masën e dënimit e cila kur bëhet fjalë për masën minimale nuk mund të jetë më e vogël se pesë ditë. Ajo çfarë mund të themi në lidhje me këtë konceptim është diçka e gabuar pasi duke qenë se dënimi ka karakter personal duhet të zbatohet vetëm ndaj personit konkret bazuar mbi karakteristikat e personalitetit të atij që kryen veprën penale dhe jo ndaj një personi të supozuar, sepse dënimi duhet dhënë mbi karakteristikat dhe personalitetin e personit. Kështu që për të miturit në moshën 14-18 vjeç, për shkak të zhvillimit të intelektit për të kuptuar rëndësinë e veprës penale, jo vetëm që nuk mund të zbatohet dënimi me burgim të përjetshëm por bëhet përjashtimi me ligj edhe për dënimin me burgim.

Legjislacioni shqiptar duke marrë në konsideratë përcaktimin ligjor që u bën të miturve në lidhje me masën e sigurisë arrest me burg, si masa e fundit kur të gjitha masat e tjera janë të papërshtatshme, tregon karakterin human të tij për dënimin e të miturve. Por praktika e vendit tonë ka treguar të kundërtën. Vërehet një tendencë nga ana e gjykatës për aplikimin e shpeshtë të kësaj mase ndaj subjekteve të mitur. Në procedimet që lidhen me fëmijët organet gjyqësore përpara se të marrin një vendim duhet të disponojnë informacion të mjaftueshëm duke marrë në konsideratë moshën e personit, personalitetin e tij dhe zhvillimin mendor të fëmijës nëse e ka kuptuar apo jo

¹²⁴ Shih nenin 31 të Kodit Penale

rëndësinë e veprës penale në mënyrë që vendimi të jetë në interesin e fëmijës. Duke qenë se dënimi me burgim shpeshherë ka ndikim negativ në riedukimin e të miturit gjykata duhet ta evitojë sa më shumë të jetë e mundur duke përdorur një nga dënimet alternative.

Në nenin 52 të Kodit Penal sanksionohet se : *“Gjykata, nisur nga rrezikshmëria e pakët e veprës penale, nga rrethanat konkrete të kryerjes së saj, nga sjellja e mëparshme e të miturit, mund ta përjashtojë atë nga dënimi”*. Sipas kësaj dispozite përjashtimi nga dënimi dhe dërgimi i të miturit në institucion ndëshkimor i takon pikërisht gjykatës. Kjo e fundit e zbaton këtë dispozitë kur konstaton si të nevojshme për edukimin dhe shmangien e veprimtarive kriminale të tjera të të miturit. Gjykata e zbaton këtë dispozitë në rastet dhe rrethanat e parashikuara në ligj të cilat janë:

- a) Rrezikshmëria e pakët e veprës penale
- b) Rrethanat konkrete të kryerjes së saj
- c) Sjellja e mëparshme e të miturit

Janë këto rastet kur gjykata pasi ka analizuar rrethanat në të cilat i mituri ka kryer veprën penale vendos ta përjashtojë atë nga dënimi me burgim dhe vendos ta çojë të miturin në një institucion riedukimi, të cilat fatkeqësisht në vendin tonë nuk ekzistojnë. Duhet theksuar se gjykata përjashtimin e të miturit nuk mund ta bëjë në çdo rast por vetëm në rastet kur ajo konstaton se mjedisi ku qëndron i mituri siç është familja, shkolla apo lagjja janë të përshtatshme për rehabilitimin e tij. Shpesh here, këto ambiente shihen dhe si ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në sjelljet kriminale të të miturit. Ashtu si në nenin 51 dhe në këtë dispozitë, vërehet sërish karakteri human i legjislacionit penal shqiptar kundrejt të miturit, ku qëllimi është mbrojtja dhe interesi më i lartë i fëmijës.

6.1.2. Dënimi me gjobë

Dënimi me gjobë është sanksionuar në nenin 34 të Kodit Penal ndryshuar me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001 dhe ndryshuar me ligjin. nr 9275, datë 16.9.2004. Ky ligj konsiston në pagimin në favor të shtetit të një shume të hollash brenda kufijve të parashikuara me ligj. Dënimi me gjobë jepet si për personat që kryejnë krime dhe për

personat që kryejnë kundërvajtje penale. Në këtë ligj është parashikuar dhe diferenca e shumës për personat që kryejnë krime dhe atyre që kryejnë kundërvajtje. Dispozita ka parashikuar që për personat të cilët kryejnë kundërvajtje, gjoba jepet nga 50 mijë deri në 3 milion lekë. Me ndryshimet që pësoi ky nen, përveç rritjes së gjobës u rrit dhe hapësira e zbatimit të tij. Tani gjoba mund të zbatohet edhe ndaj personave që kryejnë krime për motive të fitimit të pasurive ose të sigurimit të çdo përfitimi tjetër material, nëse dispozita parashikon vetëm dënimin me burgim, gjykata mund të japë edhe dënim me gjobë.

Gjykata pasi ka hetuar rreth aftësive paguese të personit, aftësi këto që varen nga gjendja personale dhe pasurore e personit e tij cakton afatin e kryerjes së pagesës. Gjykata duke marrë parasysh gjendjen ekonomike të personit mund të lejojë që gjoba të paguhet me këste. Një element tjetër i rëndësishëm është zëvendësimi i gjobës me burgim dhe kjo bëhet në rast se personi nuk kryen pagesën në afatin e caktuar të vendosur nga gjykata atëherë kjo e fundit ka të drejtë të vendosë zëvendësimin e gjobës me burgim. Kjo dispozitë has një sërë vështirësish për sa i përket zbatimit të saj kundrejt personave të mitur, pasi ajo nuk parashikon asnjë përjashtim diferencues në rastin e aplikimit të saj për personat e mitur. Një përvojë mjaft pozitive në këtë drejtim sjell ligji penal i Kosovës i cili duke u mbështetur në trendet bashkëkohore të trajtimit penalo-juridik të delinkuentëve të mitur në veçanti në Rregullat e Pekinit ky ligj parashikon dënimin me gjobë dhe kushtet që duhen përmbushur për dhënien e tij. (Salihu,2008,629) Kështu lidhur me moshën dhe personalitetin e të miturve, është përcaktuar se ky lloj dënimi i karakterit pasuror mund të sjepet vetëm ndaj të miturit të rritur i cili është penalisht përgjegjës. (Paragrafi 3 i nenit 6 të Ligjit penal për të miturit të Kosovës) Po ashtu një kusht tjetër që duhet plotësuar që gjykata të japë këtë lloj dënimi është parashikuar në nenin 27 të këtij ligji ku thuhet se: *“Gjykata mund të japë dënim me gjobë ndaj të miturit nëse i mituri ka mjete për të paguar gjobën. Me rastin e dhënies së dënimit me gjobë, gjykata shqyrton gjendjen financiare të të miturit dhe në veçanti lartësinë e të ardhurave të tij personale, të ardhurat tjera, pasurinë dhe detyrimet. Gjykata nuk e përcakton lartësinë e gjobës mbi lartësinë e mjeteve që posedon i mituri”*. Pra si kusht që duhet të plotësohet në lidhje me ekzekutimin e dënimit me gjobë është që i mituri të ketë mjetet e veta për të paguar gjobën dhe jo ndonjë person tjetër.

Gjithashtu ky ligj për dënimin me gjobë në dallim nga personat e mitur, minimumi dhe maksimumi i këtij dënimi për personat e mitur është më i ulët. Neni 27 paragrafi 2 të Ligjit Penal të Kosovës parashikon se minimumi i dënimit me gjobë është 25 euro dhe maksimumi 5.000 euro. Për sa i përket afatit kohor brenda të cilit duhet të paguhet gjoba ligji ka përcaktuar se nuk mund të jetë me i shkurtër se pesëmbëdhjetë ditë e as me i gjatë se tre muaj, por nëse për rrethana të arsyeshme i mituri nuk mund të paguajë menjëherë gjobën, gjykata lejon pagesën e gjobës me këste, jo me gjatë se dy vjet. (Paragrafi 3 i nenit 27 LMK) Gjithashtu ky ligj ka përcaktuar zgjedhje të posaçme për të miturit kur nuk munden ose nuk duan të paguajnë gjobën.

Në rastet kur i mituri nuk do apo nuk mundet ta paguaj gjobën, dënimin me gjobë nuk mund të zëvendësohet me dënim me burgim. Në këto raste gjykata e zëvendëson gjobën me punë në dobi të përgjithshme, pa penguar vijimin në shkollë apo aktivitetet e tjera të tij. (Paragrafi 4 i nenit 27 LMK) Në këtë mënyrë mund të thuhet se Ligji Penal për të mitur i Kosovës sjell një shembull mjaft pozitiv për sa i përket mënyrës së sanksionimit të dënimit me gjobë për të miturit duke i diferencuar nga të rriturit duke pasur si qëllim mirëqenien e fëmijës. Ky ligj dhe shumë ligje të tjera në Europë por jo vetëm duhet të shërbejnë si një pikë referimi për ndryshimin e Kodit tonë Penal

6.1.3. Masat mjekësore dhe edukuese

Masat mjekësore dhe edukuese kanë qenë të parashikuara edhe në legjislacionet e mëparshme dhe kanë qenë të një larmie më të madhe krahasuar me legjislacionin aktual. Sipas legjislacionit aktual penal në përputhje me nenin 46 të Kodit Penal masat mjekësore janë:

- a) Mjekimi i detyruar ambulator dhe
- b) Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor.

Masat të cilat kanë karakter edukuese janë :

- a) Vendosja e të miturit në një institucion edukimi.

Masat mjekësore paraqesin një lloj të veçantë të sanksioneve penale që kanë karakter parandalues në luftën kundër kriminalitetit dhe që zëvendësojnë shpesh dënimet e ashpra ndaj personave të papërgjegjshëm ose personave me çrregullime psikike të një shkalle të tillë që u kanë ulur aftësinë perceptuese ose vetëkontrolluese të veprimeve të tyre. Një risi në zbatimin e kësaj mase ka sjellë ligji penal i Kosovës. Ky ligj në nenin 26 të tij ka përcaktuar dërgimin në institucionin për kujdes të posaçëm. Sipas këtij neni gjykata mund ta shqiptojë masën e dërgimit në institucion për kujdes të posaçëm në vend të masës së dërgimit në institucion edukativ ose edukativo-korrektues me rekomandimin e ekspertit të mjekisë nëse të miturit i nevojitet përkujdesja e posaçme për shkak të çrregullimit mendor ose të metave fizike dhe kur kjo është në interesin më të lartë të të miturit.

Gjykata e cila e ka dhënë masën, çdo gjashtë muaj e rishikon për qëndrim të mëtejshëm në institucionin e kujdesit të posaçëm si dhe kur i mituri ka mbushur moshën 18 vjeç.¹²⁵ Nga kjo dispozitë rezulton se kjo masë mund t'u jepet atyre personave të mitur që kanë kryer vepra penale, të cilët janë me çrregullime apo të meta në zhvillimin fizik apo psikik, siç mund të jenë të shurdhët, të verbëritë, shurdhmemecët, invalidët neurotikë me të meta në zhvillimin psikik apo të cilët janë me çrregullime të theksuara psikike etj. (Salihu, 2008,619) Qëllimi i kësaj mase është të evitohen apo zbuten problemet psikike të të miturit. Nga përmbajtja e këtij neni gjykata ka për detyrë çdo gjashtë muaj të rishikojë nevojën për qëndrimin e mëtejshëm në këtë institucion. Në legjislacionin tonë afati kohor që duhet për tu rishikuar nga gjykata për qëndrimin në këto institucione është çdo një vit. Këto masa si në legjislacionin tonë ashtu dhe atë të Kosovës nuk kanë një afat kohor të përcaktuar kjo për faktin se nuk mund të parashikohet kohëzgjatja për trajtim mjekësor të të miturit. Por me qëllim që të mos keqpërdoret kjo masë nga ana e gjykatës dhe në pajtim me parimin e ligjshmërisë, disa ligje penale të shteteve bashkëkohore, shprehimisht parashikojnë se kjo masë mund të zgjasë jo më shumë se sa tre vjet. (Salihu, 2008, 619) Kështu siç rezulton nga përmbajtja e kësaj dispozite ndryshimi me legjislacionin tonë është fakti se kjo masë në legjislacionin Penal për të miturit nuk mund të zbatohet vetëm kundrejt atyre me të meta psikike por edhe ndaj të miturve me të meta fizike.

¹²⁵ Shih neni 26 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës

Nëse do ti referoheshim legjislacionit grek i cili në nenin 126 parashikon që për të miturit të cilët nuk kanë mbushur moshën 13 vjeç jepen vetëm masa mjekësore dhe edukuese. Masat edukuese ashtu si dhe masat mjekësore, janë një sanksion penal që ka një karakter parandalues, por masat edukative kanë si qëllim themelor jo vetëm parandalimin e kryerjes nga të miturit të veprave penale por dhe riedukimin dhe përgatitjen e tyre për jetën në vazhdimësi. Aktualisht këto masa janë të vendosura së bashku me masat mjekësore në neni 46 të kodit penal në të cilin thuhet se masat edukuese mund të jepen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale. Me masa edukimi kuptohet vendosja e të miturit në një institucion edukimi, të cilat aktualisht nuk ekzistojnë më pasi u mbyllën pas viteve 1990. (Leskoviku, 2010, 37) Deri në vitin 1988 në Shqipëri ka funksionuar një shkollë edukimi dhe një shkollë riedukimi, të cilat janë mbyllur në vitet 1993-1994. Masat edukuese kanë për qëllim edukimin e të miturit, riedukimin dhe zhvillimin e drejtë të tij. (Kombovski, 2007, 607)

Masat edukative ndaj të miturit duhet të zbatohen në program individual dhe ai patjetër duhet t'i përshtatet vetive dhe cilësive të personalitetit të të miturit. (Halil,2009, 258) Sipas teorisë të të drejtës penale, në çdo rast vendosja e të miturve në një institucion edukimi bëhet nëpërmjet një vendimi të arsyetuar dhe të mbështetur në tërësinë e rrethanave në të cilat është kryer vepra penale nga të miturit. (Elezi, Kacupi, Haxhia, 2009,231) Në lidhje me të miturit që përjashtohen nga dënimi, në KP janë përcaktuar në mënyrë të përgjithshme rrethanat në bazë të cilave i mituri mund të përjashtohet nga dënimi (KP neni 52) por një përcaktim i tillë mungon në lidhje me mundësinë e vendosjes se të miturit në një institucion edukimi. Po kështu edhe për sa u përket fëmijëve nën moshën minimale për përgjegjësi penale, Kodi penal nuk përmban ndonjë përcaktim konkret të kriterëve për caktimin e masës edukuese.

Në teorinë e së drejtës penale është shprehur mendimi se, në përgjithësi masat edukuese jepen në ato raste kur i mituri ka kryer veprime ose mosveprime që parashikohen si vepër penale dhe karakteri i veprës, sjelljet e mëparshme të tij dhe familja apo mjedisi që ndikon mbi të nuk garantojnë moskryerjen e veprave penale të tjera të rrezikshme dhe edukimin normal të të miturit. (Muci,,2007,262) Masat edukative ashtu si dhe dënimet penale janë masa ndëshkuese që shteti ndërmerr ndaj të

Këto masa kanë këto karakteristika:

- Pra masat edukuese të parashikuara nga kodi penal aktual edhe pse nuk janë dënime penal, ato në një farë mënyre e kufizojnë të miturin. Duke qenë se i mituri është i detyruar të qëndrojë në këto ambiente, të ketë orare të përcaktuara nga ky institucion, të largohet nga mjedisi i tij i mëparshme siç është familja dhe rrethi shoqëror, kjo mund të krijojë shqetësime psikologjike për të miturin. Në legjislacionin e mëparshëm, parashikoheshin disa lloje masash edukimi, si qortimi shoqëror, lenia për edukim shkollës a qendrës së punës ose caktimi i ndonjë dënimi plotësues si masë e tillë. Por sigurisht sot flasim për një shtet demokratik ku reforma solli dhe ndryshime të shumta në legjislacion siç janë dhe ndryshimi dhe zgjerimi i masave edukuese, ku gjykatës i jepet mundësia të vlerësojë rrezikshmërinë e veprës penale dhe të japë një gjykim sa më të drejtë kundrejt të miturit.

133

një larmishmëri më e madhe e llojeve të tyre. Kështu në legjislacionin penal francez janë parashikuar disa lloje të masave edukuese që gjejnë zbatim si:

- a. përjashtimi i të miturit nga dënimi, kur dëmi i shkaktuar është riparuar
- b. Lënia për edukim e të miturit, prindërve ose kujdestarit pra lënia e një personi të besueshëm
- c. vendosja nën mbrojtje për një periudhë jo më të gjatë se pesë vjet
- d. vendosja në një institucion edukimi publik ose privat për formim profesional, në një qendër mjekësore, në një konvikt s'ka rëndësi ku për të miturit më pak se trembëdhjetëvjeç.
- e. liria nën mbikëqyrje deri sa të arrijë moshën madhore.¹²⁶ (neni 122-8 i kodit penal francez, 1945)

Në shume shtete të rajonit si në Malin e Zi, në Kroaci, në Kosovë vihet re një larmishmëri e masave edukuese të cilat janë në epiqendër të të gjitha llojeve dhe dënime që mund të jepen ndaj të miturve që kryejnë vepra penale. Kjo arsyetohet nga fakti se me këto masa mundësohet rehabilitimi, mbrojtja, ndihma dhe edukimi i të miturve, madje në të shumtën e rasteve pa i izoluar nga mjedisi i deriatëhershëm familjar dhe shoqëror. Një shembull mjaft pozitiv në këtë drejtim ka parashikuar legjislacioni penal për të miturit i Kosovës i cili ka parashikuar një numër të larmishëm masash të cilat mund të aplikohen ndaj të miturve. Njëkohësisht ligji penal për të miturit ka parashikuar ka përcaktuar edhe kritere të përgjithshme, që gjykatat duhet të kenë parasysh në individualizimin e këtyre masave. Bazuar në neni 8/1 të ligjit penal për të miturit parashikohet se: *“Kur ndaj të miturit jepet ndonjë masë ose dënim, gjykata në radhe të parë, merr parasysh interesin me të mirë të të miturit. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh edhe këto rrethana: llojin dhe peshën e veprës penale, moshën e të miturit, nivelin e zhvillimit psikologjik, karakterin e tij dhe prirjet, motivet që nxitën atë të kryejë veprën penale, edukimin e tij në atë fazë, mjedisin dhe rrethanat e jetës, nëse është dhënë masë ose dënim me parë dhe rrethana të tjera që mund të ndikojnë në dhënien e masës apo dënimit”*.¹²⁷ Në këtë kontekst kriteri kryesor është interesi me i lartë i fëmijës, parim i cili nuk është sanksionuar në legjislacionin tonë penal. Në legjislacionin penal për të mitur të Kosovës janë parashikuar tetë lloje të masave

¹²⁶ Shih neni 222 paragrafi 8 të Kodit Penal të Francez.

¹²⁷ Shih neni 8 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës.

edukative, të cilat janë grupuar në tre kategori kryesore, të cilat konsistojnë në masa disiplinore, masa të mbikëqyrjes së shtuar, si dhe masat institucionale.

Masat disiplinore janë:

1. qortimi gjyqësor
2. dërgimi i të miturit në qendër disiplinore

Masat e mbikëqyrjes së shtuar janë:

1. mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindërit, prindërit adoptues, ose kujdestarit të të miturit
2. mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër dhe
3. mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë.

Masat institucionale janë:

1. dërgimi i të miturit në institucion edukativ
2. dërgimi i të miturit në institucion edukativ-korrektues dhe
3. dërgimi i të miturit në institucionin e kujdesit të posaçëm.

Dy grupet e para të masave edukative, ekzekutohen në liri. Ndërsa masat institucionale konsiderohen si masat më të rënda dhe ekzekutohen duke e veçuar të miturin nga mjedisi i tij i mëparshëm familjar dhe social, duke e vendosur në institucionet e caktuara edukative (Salihu,2008, 604) Kështu kodi penal për të mitur i Kosovës ka sanksionuar një shumëllojshmëri të veprave penale duke filluar nga me të lehtat deri të më të rëndat. Pjesa më e madhe e tyre nuk e izolon të miturin nga mjedisi familjar apo shoqëror. Në ndryshim nga kodi ynë penal, masat edukative janë të limituara në kohë.

Kohëzgjatja e tyre varjon nga lloji i masave edukative, por në çdo rast, masat edukative nuk mund të kalojnë afatin maksimal të parashikuar për veprën penale. (Salihi, i, vepër e cituar, f, 39). Masa edukative e dhënë zakonisht ekzekutohet kur vendimi i gjykatës bëhet i formës së prerë. Mirëpo mund të ndodhë që edhe pasi bëhet i formës së prerë, vendimi i gjykatës me të cilin është dhënë masa edukative, të mos fillojë ekzekutimi i saj. Shkaqet mund të jenë nga me të ndryshmet, p.sh . i mituri sëmuret, fshihet me qëllim që t'i shmanget ekzekutimit të masës, arratiset nga enti ku ka

qenë i vendosur etj. (Salihu, 2008, 625) . E njëjta kategori e masave edukative është sanksionuar edhe në kodin penal të Kroacisë e të Maqedonisë ¹²⁸ Larmishmëria ka dhe kodi penal grek të parashikuar për të miturit. Në neni 122 paragrafi 1 janë parashikuar masat edukative si vijojnë:

- a) Qortim i të miturit;
- b) Lënia në përkujdesje të prindërve apo kujdestarit;
- c) Lënia në përkujdesje të një familje, në të cilën i mituri do jetojë;
- d) Lënia në përkujdesje të një institucioni për përkrahjen e të miturit;
- e) Pajtimi me të dëmtuarin, duke i kërkuar falje për të evituar pasojat në rrugë gjyqësore;
- f) Dëmshtëpërblimi i të dëmtuarit;
- g) Ndjekja e programeve shoqërore dhe psikologjike në institucione shtetërore apo private;
- h) Ndjekja e studimeve në një shkollë profesionale apo marrja e një arsimit apo formimi tjetër;
- i) Vendosja e të miturit në një institucion të përshtatshëm riedukimi shtetëror ose privat.

Kështu nisur nga fakti se legjislacioni shqiptar ka vetëm një masë edukuese atë të mbylljes në një institucion rehabilitues kjo në praktikë nuk mund të zbatohet nga mungesa e këtyre institucioneve. Prandaj do ishte një domosdoshmëri ngritja e këtyre institucioneve në mënyrë që legjislacioni të gjejë zbatim dhe mos të jetë vetëm i shkruar në letër.

Parimet kushtetuese në përcaktimin dhe marrjen e masave mjekësore dhe edukuese mund të përmendim:

a. Parimi i ligjshmërisë

Ky parim buron nga neni 4 i Kushtetutës së RSH, sipas të cilit “*E drejta për të bërë bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit*” Ky parim është baza e veprimtarisë të të gjitha organeve dhe institucioneve jo vetëm për sanksionimin e kritereve e masave në legjislacion por edhe për dhënien e masave ndaj personave që kanë kryer vepra penale.

¹²⁸ Shih neni 74 të Kodit Penal të Maqedonisë

Sipas këtij parimi duhet të përcaktohet me ligj dhe jo të lihen në diskrecionin të gjykatësit kriteret për dhënien e masave të sigurisë apo masave edukuese. Shpesh herë gjykatësit ndodhen në vështirësi për dhënien e vendimeve. Në KP Shqiptare nuk janë përcaktuar shprehimisht kriteret për zbatimin e masës edukuese duke e lënë kështu në vlerësimin e gjykatës që rast pas rasti në baze të rrethanave konkrete të çmojë me vendim të arsyetuar nëse është e nevojshme apo jo marrja e një mase të tillë. (Turkeshi,2011,50)

Legjislatori duhet të kanalizojë kriteret mjaftueshmerisht të sigurta që do të përcaktonin shkallën e rrezikshmërisë shoqërore e për pasojë mbylljen në një institucion edukimi i të pandehurit që mund të kryejë veprë penale i ndikuar nga rrethanat, e jo për shkak të sëmundjes, prandaj është ligji ai që duhet të përcaktojë gjithashtu diagnozat të cilat bëjnë të domosdoshme mbylljen për mjekim të detyruar. Po ashtu kuvendi duhet të bëjë përmirësime dhe ndryshime për sa i përket nenit 46 të Kodit Penal duke vendosur kriteret të përcaktuara në dhënien e masave edukuese si dhe të parashikojë me ligj elementët efektivë simptomatike (shprehitë , sjelljet) që përcaktojnë nëse i mituri mund të kryejë krime. (KSHH,2014,21)

Në këndvështrimin e veprimtarisë ekzekutive parimi i ligjshmërisë dhe i shtetit të së drejtës kërkon që:

- Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e drejtësisë të hartojnë akte normative;
- Të hartojnë rregulloren për trajtimin dhe ruajtjen e personave të dënuar me masa mjekësore ;
- Ministria e Shëndetësisë të krijojë mjediset e përshtatshme për vendosjen e personave të dënuar me masat mjekësore ;
- Këshilli i Ministrave të krijojë institucione edukuese të posaçme në varësinë e Ministrisë së Arsimit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për masat edukuese;
- Drejtoria e përgjithshme e burgjeve të vendosë të dënuarit e mitur në seksione të veçanta për të garantuar një trajtim të veçantë nga të rriturit (KSHH,2014,22)

Parimi i ligjshmërisë kërkon gjithashtu që gjatë kohës së qëndrimit në për mjekim të detyruar apo në institucion edukues këtyre të dënuarve mos u kufizohen të drejtat

ato të drejta që parashikon ligji. Kufizimi i këtyre të drejtave mund të bëhet vetëm në raste të jashtëzakonshme por edhe në këto raste duhet të jetë e parashikuar me ligj.

b. Parimi i dinjitetit njerëzor (humanitetit)

Ky parim është i shprehur qartë në neni 28/5 të kushtetutës së RSH ku thuhet se “*Çdo person, të cilit i është hequr liria ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe respektimit të dinjitetit të tij*” Ky parim kërkon duke përfshirë këtu edhe të dënuarit ndaj të cilëve janë dhënë masa mjekësore dhe edukuese, të trajtohen në mënyrë që mos të cenohet personaliteti dhe dinjiteti i tyre duke respektuar vetitë njerëzore të tyre. Pavarësisht se një person ka kryer një vepër penale dhe ndaj tij janë marrë masa mjekësore ose edukuese kjo nuk do të thotë se ai është i zhveshur nga subjektiviteti i tij njerëzor dhe moral. Ai nuk mund të trajtohet gjithashtu sikur është i zhveshur nga disa veti të mira universale natyrore njerëzore, aq më tepër që në sistemet bashkëkohore moderne është pranuar e shpallur që qëllimi i dënimit nuk është hakmarrja apo shpagimi, por riedukimi dhe rikthimi i të dënuarve.

a. *Personat ndaj të cilëve mund të zbatohen masat edukuese*

Bazuar në nenin 46 të KP masat edukuese mund të zbatohen ndaj të miturve, të cilët:

- a. përjashtohen nga dënimi ose
- b. për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale

Sikurse dhe vihet re nga përmbajtja e këtij neni për të dy kategoritë e personave ndaj të cilëve mund të zbatohen masat edukuese të parashikuara është përdorur termi i mitur. Kuptimi i këtij termi, i cili është përdorur edhe në dispozita të tjera të KP, shpesh duke përfshirë edhe fëmijët nën moshën për përgjegjësi penale nuk është përcaktuar në këtë kod. (Turkeshi, 2011, 38) Megjithatë, në disa dispozita të tjera vihet si për shembull në nenet 100 dhe 101 të KP është përdorur termi “fëmijë të mitur” Por sipas teorisë të të drejtës penale në të drejtën penale shqiptare i mitur konsiderohet çdo pëson i grup-moshës 14-18 vjeç. (I, Elezi, S. Kacupi, M Haxhia, 2009, 100 Komentari I Kodit Penal Të Republikës së Shqipërisë)

b. Ekzekutimi i masave mjekësore

Rregullat për vënien në zbatim të masave mjekësore përcaktohen me ligjin Nr. 8331, datë, 21.4.1998” Për ekzekutimin e vendimeve penale” Ndryshuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008 neni 45 në të cilin thuhet:“ *Masat mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohet në institucionin mjekësor të specializuar sipas përcaktimit që bëmë Ministria e Shëndetësisë mbi kërkesën e prokurorit. Mbi urdhrin e ekzekutimit, dërgimi në institucion i të dënuarit të arrestuar bëhet nga organi ku është mbajtur i dënuari, dhe kur është i lirë, nga policia e shtetit. Masat mjekësore me mjekim të detyruar ambulator ekzekutohet në institucionet të vendbanimit të të detyruarit. Kur në to nuk ka specialistë përkatës shoqërohet në çdo rast në këto institucione në rrethin më të afërt ku ka të tillë. Kur në ekzekutimin e kësaj masë sillen pengesa nga i detyruari, prokurori urdhëron ekzekutimin e detyruar nga Policia e Shtetit dhe, kur është vendi, i paraqet kërkesë gjykatës për ndryshimin e masës në mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”*

Nga interpretimi i kësaj dispozitë del se mjekimi i detyruar në institucion mjekësor nënkupton shtrimin e detyruar në një institucion mjekësor neuropsikiatrik. Masa e mjekimit të detyruar në një institucion mjekësor zbatohet në institucione të specializuara dhe të përcaktuar nga ministria e shëndetësisë mbi bazën e kërkesës së prokurorit. Nëse personi të cilit i është shqiptuar kjo masë nuk paraqitet në këtë institucion atëherë ai shoqërohet nga policia e rendit ose nga organet ku gjendet ai pëson në ato momente

Mjekimi i detyruar ambulator nënkupton shtrimin e detyruar të personit në një institucion neuropsikiatrik për mjekim. Këtu personi i sëmur vendoset në një institucion ku shtrohen edhe persona të tjerë që nuk kanë kryer krime. Kjo do të thotë se ai nuk veçohet nga personat e tjerë. Përsa i përket zbatimit të masës mjekësore të mjekimit të detyruar ambulator, prokurori përgatit urdhrin e ekzekutimit i cili i dërgohet për ekzekutim institucionit mjekësor të vendbanimit të të detyruarit. Në rast se institucioni i vendbanimit nuk ka specialist, i detyruari shoqërohet në institucionin e rrethit më të afërt. Në lidhje ekzekutimin e kësaj masë mjekësore ka vërejtje dhe dyshime nëse mund të zbatohet me sukses.(Halili,2009,280) Sipas raportit të thuhet se: Organi i prokurorisë në shume raste është përballur me shume vështirësi në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që përmbajnë masa mjekësore të detyrueshme(neni 46 dhe 239 i kodit penal)

duke qenë se aktualisht mungon një institucion i specializuar mjekësor sipas kërkesave të nenit 28 të ligjit nr.44/2012 “ Për shëndetin mendor” .

Kështu për këtë arsye, personat e papërgjegjshëm që kanë kryer vepra të ndryshme penale, ndaj të cilëve gjykata ka vendosur mas mjekësore “ mjekim të detyruar” në një institucion mjekësor janë dërguar për ruajtje dhe trajtim mjekësor në spitalet e burgjeve. Për shkak të rrezikshmërisë shoqërore që paraqesin dhe nevojës në ambiente për kushte të posaçme sigurie dhe nga Policia e Shtetit, nuk garantohet ruajtja e tyre në spitalet psikiatrike.(Raporti vjetar “ për gjendjen e kriminalitetit” Prokuroria e Përgjithshme,2013,15,16)

c. Ekzekutimi i masave edukuese

Rregullat për vënien në ekzekutim të masave edukuese përcaktohen me ligjin Nr. 8331, datë 21.4.1998 “ Për ekzekutimin e vendimeve penale i ndryshuar neni 46 parashikohet se: “ *Masat edukuese ekzekutohen në institucionet e posaçme të edukimit të të miturve, dërguar në mënyrë vullnetare nga prindërit ose kujdestari, mbi urdhrin e ekzekutimit të prokurorit. Kur nuk behet ekzekutim vullnetar në datën e caktuar ose kur nuk ka prindër ose kujdestarë, ekzekutimi behet nga policia e shtetit*”. Nga përmbajtja e kësaj dispozitë vërehet se ligjvënësi i ka dhënë mundësi prindërve dhe kujdestarit ta zbatojnë vullnetarisht dhe vetëm në rastet kur ata bëjnë këtë atëherë zbatimi i kësaj masë do të behet nga policia e shtetit.

Këto rregulla në thelb synojnë që vënia në ekzekutimin e masë edukuese të jetë sa me pake “ traumatike” për fëmijën , duke mos parashikuar mundësin e shoqërimit të tij për në institucionin e posaçme të edukimit nga një individ me të cilin ai ka afërsi dhe familjaritet sikurse është figura e prindërit ose kujdestarit të tije nëse e ka një të tille.(Turkeshi,2011,52) Por që siç dihet sot për sot në Shqipëri nuk ekziston një institucion i tille, deri në vitin 1998, ka funksionuar një shkollë edukimi dhe një shkollë riedukimi ose si edhe të quajtur “ shkolla e vagabondëve”, që tani, fatkeqësisht janë mbyllur dhe momentalisht nuk ka institucione të pavarura dhe të specializuara duke e bërë të pamundur ekzekutimin e kësaj mase.(Hysi)

Të miturit këtë masë mbajnë që nga ajo kohë, të mbyllur në seksionet të veçanta pranë burgjeve të të rriturve që janë të dënuar me burg.(Papandile, 2000, 13-16) Kjo

pamundësi e zbatimit të masave edukuese të parashikuara në KP për shkak të mungesës së institucioneve çmohet se e bënë sistemin vetëm në “letër”, nuk garanton të drejtat e të miturve në procesin penal, behet shkak për një karakter më tepër ndëshkimor sesa edukues rehabilitues dhe riintegruues të sistemit të administrimit të drejtësisë për të miturit(CRCA,2007,60) Themelimi i institucioneve të edukimit në Shqipëri është një domosdoshmëri për edukimin dhe riedukimin e të miturve. Duke marrë në konsideratë që zbatimi i kësaj masë bazohet në parimin e interesat më të lartë të fëmijës, pasi zbatimi i kësaj të fundit do të sillte edukimin e të miturit dhe shmangien e sjelljeve të tjera kriminale në të ardhmen.

6.2. Disa nga alternativat e dënimit

Në kontekstin e standardëve të drejtësisë penale, për të miturit, një aspekt mjaftë i rëndësishëm janë dënimet alternative. Këto dënim anë të parashikuara në kreun e VII të Kodit të Procedurës Penale. Këto dispozita gjejnë zbatim njëloj si për të rriturit ashtu edhe për të miturit. Për shkelësit e mitur, dënimet alternative janë mundësia më e mirë për rehabilitimin dhe një zhvillim më të mirë, në përputhje me kërkesat e shoqërisë. Duke favorizuar aplikim të alternativave, në raport me dënimin me burgim, vihet në zbatim parimi i humanizmit të dënimit, si dhe qëllimi i riedukimit, si qëllimi parësor i dënimit. Thuhet se, ” Burgjet janë mënyra më e kushtueshme për të bërë ngërzit të këqij ” (Xhafo, 2014, 209)

Gjatë kohës së qëndrimit në burg, të dënuarit vihen në kontakt me shumë element të tjerë kriminel, prandaj thuhet se ata e thellojnë me shumë identitetin e tyre kriminal. Janë të shumta rastet kur dënimet e të miturit me burgim kanë pasur pasoja negative të ky i fundit duke influencuar me shumë sjelljet e tyre kriminale në një të ardhme. Shpesh herë jeta e vështirë në këto institucione ka krijuar ambiente për recidivizëm në të ardhmen. Në të kundërt alternativat e dënimit me burgim janë zgjedhja më e mirë duke pasur një ndikim pozitiv në integrimin e të miturit në shoqëri. Legjislacioni ynë në këtë drejtim ka pësuar zhvillime pozitive në përputhje me standardet ndërkombëtare duke pasur si qëllim interesin më të lartë të fëmijës. Kështu nëpërmjet reformës ligjore, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë ka pësuar ndryshime

duke rritur jo vetëm numrin e alternativave të dënimit por edhe përmbajtjen e tyre Kodi Penal pësoi ndryshime të ndjeshme përsa i përket alternativave të dënimit me burgim me ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008, “ Për disa shtesa dhe ndryshime me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995.

Ekzekutimi i i dënimeve alternative fillon pasi vendimi i gjykatës të këtë mare formën e prerë .(Halili, 2009,239) Dënimet alternative zbatohen në rastet kur gjykata vlerëson se rrezikshmëria e personit po ashtu dhe e veprës penale është e vogël po ashtu dhe në rastet kur gjykata mendon se nëpërmjet aplikimit të këtyre masave arrihet më mirë qëllimi i dënimit. Alternativat e dënimit përfshijnë vënë në provë dhe shërbimin në komunitet.(Leskoviku, 2010 ,47) Përmendim shprehimisht llojet e alternativave siç mund të jenë:(Papandile & Mandro ,2002, 157)

- a. Gjysme Liria
- b. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë.
- c. Qëndrimi në shtëpi
- d. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një punë në interes publik.
- e. Lirimi me kusht i dënimit me burgim

Një aspekt tjetër pozitiv, i ndryshimeve që Kodi Penal pësoi në fushën e dënimeve alternative, ishte vendimmarrja e gjykatës në rastit e mosplotësimit të detyrimeve që lidhen me dënimet alternative. Në përputhje me standardët ndërkombëtare , në rast të të shkeljes se detyrimeve nga i dënuari me ndryshimet ligjore, gjykata ka shume hapësirë për të ndryshuar detyrimet të tjera ose për të zëvendësuar dënimin alternative me një detyrim tjetër.(Xhafo, 2014, 211) Kjo është një risi pozitive kështu gjykata në rastet e e mosplotësimit të detyrimeve ajo nuk e e zëvendëson me dënim me burg por duke përzgjedhur një alternative tjetër.

Pavarësisht risive dhe ndryshimeve që ka që kanë pasur alternativat e dënimit me burgim ato zbatohen njëloj si për të rriturit ashtu dhe për të miturit. Pra për sa i takon aplikimit të tyre ndaj të miturit nuk ka pasur asnjë diferencim duke bërë dallimin bazuar në statusin si i mitur. Legjislacioni ynë duke qenë se nuk bënë diferencimin në alternativat e dënimit me burgim ai nuk parashikon sanksione me të buta për kategorinë e personave të mitur. Kështu për këtë arsye mund të thuhet që legjislacioni penal

Shqiptar duhet të jetë i pasur me alternativat e dënimit me burgim duke pasur në konsideratë rrethanat individuale të të miturit. Në një vështrim krahesuas me vendet e huaja në do të vërenim se tendenca e këtyre shteteve siç mund të jetë Itali, Francë, Greqi është të evitojnë dënimin me burg të të miturit duke përdorur dënimet alternative. Tendenca e sistemit tonë është dënimi me burgim dhe jo ato alternative. Vetëm duke evituar dënimin me burgim dhe aplikimin e masave alternative shoqëria shqiptare në përgjithësi dhe shteti shqiptar në veçanti do të arrijnë standardët nderkometare për sa i përket drejtësisë penale të të miturit.

6.2.1. Gjysëmliria

Gjysëmliria është forma e parë e alternativave të dënimit me burgim e parashikuar në nenin 58 të Kodit Penal, me ligjin e ri nr 10023, datë 27.11.2008. Ky ligj ndryshoi përmbajtjen e nenit 58 të Kodit Penal i cili parashikonte alternativën e copëzimit të dënimit me burgim sipas të cilit thuhet se : *“Për dënimin deri në një vit burgim, gjykata, për shkak të detyrimeve të personit të dënuar për punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësit thelbësore familjare apo për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor , mund të vendosë ekzekutimin e vendimit me burgim me gjysmëliri.”* Gjysëmliria nënkupton ndarjen e kohës ditore apo javore të të dënuarit me burgim midis qëndrimit në burg , për të vuajtur dënimin dhe lënies se tij të lire , për të përmbushur detyrimet që ka ndaj vetës , familjes dhe shoqërisë , të cilat i ka pasur para dhënies së vendimit të dënimit.(Muci,2012,358) Kur flasim për detyrime, është fjala jo për çdo lloj detyrimi, por vetëm për kategorinë e detyrimeve të cilat janë përcaktuar me ligj.

Personi i dënuar, që vuan dënimin me gjysmë liri, është i detyruar të kthehet në burg, pasi të këtë kryer detyrimet jashtë burgut, brenda periudhës kohore të përcaktuar nga gjykata.

Kur personi i dënuar nuk përmbush detyrimet, sipas këtij neni. Zbatohet neni 62 i këtij kodi.(KP, neni 58) Nisur nga kjo formë interpretimi arrijmë në përfundim se kjo formë e vuajtjes së dënimit aplikohet nga gjykata në rast se plotësohen këto dy kushte. Së pari: Në përfundim të shqyrtimit gjykata çmon se i pandehuri duhet të dënohet jo me shume se një vit burgim. Së dyti: gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se ekziston një nga rrethanat në vijim; i pandehuri ka detyrime për punën, arsimin kualifikimin ose

aftësimin profesional, përgjegjësi thelbësore familjare apo trajtim ose rehabilitim mjekësor.(OCSE, 2010, 44) Pra që gjykata të aplikojë këtë nën duhet të përmbushen këto dy kushte. Po ashtu është gjykata ajo e cila përcakton detyrimet e personit gjatë kohës që qëndron jashtë institucionit të vuajtjes së dënimit. Në rast se plotësohen kushtet atëherë personi e vuan dënimin në gjysmë liri, që do të thotë se ai qëndron jashtë institucioneve të vuajtjes së dënimit për një kohë të caktuar nga gjykata për përmbushjen e detyrimeve të sipërpërmendura, dhe ai është i detyruar të kthehet në burg brenda periudhës kohore të përcaktuara nga gjykata. Në rast se i dënuari nuk i përmbush detyrimet e gjykatës, kjo e fundit nuk bën revokimin e alternativës, por krijon mundësi të një alternative tjetër përpara rivendosjes së dënimit me burgim. Sipas doktrinës: “ me termin gjymeliri kuptohet se i dënuari, një pjesë të dënimit me burgim e vuan në institucionet së dënimit me burgim, një pjesë tjetër është i lire për arsyet e përmendura me ligj” (Komentari i KPRSH, vepër e cituar, 310) Kjo alternative e re solli disa risi duke zgjeruar numrin e rrethanave të cilat mund të aplikohet kjo e fundit, rrethana këto të përcaktuara me ligj.

Kjo lloj alternative mund të aplikohet edhe në rastet e të miturve që vuajnë nga problemet shëndetësore apo janë përdorues të substancave narkotike, për pasoje kanë nevojë për trajtim apo rehabilitim mjekësor. Në këtë mënyrë, mundësohet vazhdimësia e procesit edukativ, aftësimi profesional, si dhe rehabilitimi social dhe shoqëror, në përputhje me nevojat konkrete të të miturve.(Xhafo, 2012,219) zbatimi i kësaj dispoziti solli risi po hasen dhe disa problematika në zbatim. Risia e kësaj forme të ekzekutimit të dënimit është mbikëqyrja nga Shërbimi i Provës (VKM nr. 302, datë 25.03.2009, nenet 35 36) Një ndër problemet e kësaj dispozite është fakti se në këtë nën nuk është përcaktuar kohëzgjatja maksimale e kësaj dispozite. Në këtë mënyrë është gjyqtari ai që e vendos lirisht afatin e përmbushjeve të detyrimeve apo përgjegjësi të cilat mund të jenë ore apo ditë të tëra. Për këtë qëllim trajnimi i i prokurorëve dhe gjyqtarëve në drejtim të politikave penale drejt masave alternative do të ishte një domosdoshmëri sidomos zbatimit të tyre drejt të miturve duke qenë se përdorimi i kësaj alternative dërimi do të krijonte atyre mundësi për të përmbushur nevojat e tyre të edukimit apo çdo nevojë tjetër që do të mundësoj një jetë më të mirë.

6.2.2. Përzullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë

Kodi penal shqiptar në fuqi, ndryshe nga kodet e mëparshme që pranonin sistemin kontinental, pranon sistemin e përzier të dënimit me kusht. Ai në vend të titullit “ dënim me kusht”, përdor shprehjen “ pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim.(Muci, 2012, 362) instituti i dënimit me kusht rregullohet nga neni 59 i Kodit Penal ku thuhet se për shkak të rrezikshmërisë së paket të personit, të moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burgim deri në pese vjet, mund të urdhëroj që i dënuari të mbajë kontakt me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale. Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbush një apo më shumë detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij kodi. Afati i provës është 18 muaj deri në 5 vjet.

Nëse i dënuari nuk mban kontakt me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç është parashikuar nga gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikqyerjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit.(KP neni 59).

Ajo që duket shumë qartë në këtë ligj është fakti se nuk përmendet rrezikshmëria e veprës penale por ajo e personit. Në rastet kur gjykata vlerëson se personi ka shfaqur pendim të thell për veprën penale të kryer, verën një sinjeritet të autori i veprës në raste të tilla ajo mund të pezullojë vendimin e dënimit me burg dhe ta zëvendësojë atë me vënien në prove. Kështu për ta aplikuar sa me drejtë këtë ligj gjykata gjatë gjykimit ka për detyrë të identifikoj rrethanat e posaçme që ekzistojnë në jetën e përditshme të personave të pandehur. Nga një interpretim i dispozitave të ndryshuara në kodin penal , të cilat bëjnë fjale për interpretimin e alternativave të dënimit me burgim në harmoni me dispozitat e ligjit, 10 024, datë 27.11.2008 rezulton se gjykata në përmbushjen e detyrës se saj për identifikimin e rrethanave të posaçme e ka atë domosdoshme mendimin e specializuar të Zyrës Vendore Të Shërbimit të Provës.

Për rrjedhojë nëse gjatë gjykimit i pandehuri apo prokurori paraqet një kërkesë për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal gjykata është e detyruar (nëse një raport i tille nuk

është kryer nga Shërbimi i Provës gjatë fazës së hetimeve paraprake) që të thërras në gjykim një përfaqësues të Shërbimit të Provës dhe ti caktoj si detyrë kryerjen e raportit përkatës, i cili do të identifikojë në mënyrë të specializuar rrethanën e posaçme, të pretenduar nga palët.(OSCE, 2010,47) Ky detyrim duhet të jetë i përshtatshëm me një nga rrethanat e veçanta të cilat janë të përcaktuara me ligj. Dihet që dënimi me burgim shkakton pasoja të rënda për vetë personin dhe sigurisht për familjen e tij. Në këtë ligj ashtu si edhe të masat edukative vërehet shumë art parimi i humanizmit, sepse mbrohen shtresat e brishta, moshat e reja, zakonisht të miturit 14-18 vjeç që mund të edukohen dhe pa u izoluar nga shoqëria.(Muci, 2012 , 364) Tashme këto rrethana nuk lidhen vetëm me veprën penale por edhe me cilësitë personale dhe kushtet familjare, sociale, profesionale të të dënuarit. Me konkretisht, këto rrethana janë:

- a) Moshë e të dënuarit;
- b) Kushtet shëndetësore apo mendore;
- c) Mënyra e jetesës dhe nevojat, veçanërisht ato që lidhen me familjen, shkollimin ose punën;
- d) Rrethanat e kryerjes së veprës penale (Xhafo,2013,223)

Një element me mjaftë rëndësi në këtë aspekt është marrja në konsideratë të moshës së të dënuarit në pezullimin e ekzekutimit me burgim. Kështu për veprën penale deri në pesë vjet burg të kryer nga të miturit kemi pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien në provë në këtë mënyrë shmangen efektet negative të burgut. Kundrejt të miturve zbatimi i kësaj alternative do të sillte efekte pozitive në drejtim të riintegritimit, korrigjimit dhe edukimit të tyre(Unicef, 2007,58). Kështu praktika gjyqësore e gjykatave duhet të orientohet drejt zbatimit të kësaj alternative për sa u përket çështjeve të të miturve. Në praktik evidentohej raste kur gjykata ka mbajtur qëndrim favorizues në aplikimin e kësaj mase ndaj të miturve.

Në vendimin nr 3671, date 28.10.2015 të seksionit penal të rrethit gjyqësor Tiranë I në ngarkim të pandehurit R.M I akuzuar për veprën penale të ‘‘ Vjedhjes’’, të parashikuar nga neni 134/1 e Kodit Penal është dënuar me tre muaj burg. Këtë dënim i mituri nuk e ka vuajtur, pasi gjykata ka zbatuar ndaj tij dënimet alternative të parashikuara në nenin 59 të K.P kombinuar me nenin 60/9 të K.P, ka pezulluar ekzekutimin e vendimit me burgim duke e vënë të pandehurin në provë, për një periudhë prej 18 muaj me kusht që

gjatë kësaj kohe të ketë kontakt me Shërbimin e provës me ndalesat që gjatë kësaj kohe mos ë kryejë vepër tjetër penale dhe mos 6ë shoqërohet me persona të dënuar.(Vendimi nr.3671 date 28.10.2015) Vendime te ngjashme me këtë janë dhe vendime të tjera si Vendimi nr.2454 date, 2310.2014, Vendimi nr.504, 25.14.2013 Ku gjykata ka pezulluar dënimin me burgim duke I vënë të miturit në provë.

Këto janë raste që dëshmojnë interesin më të mirë të të miturve pasi dihet që qëndrimi në burg dhe izolimi nga mjedisi familjar apo shoqëror mund të këtë pasoja psikologjike të i mituri. Por gjykata para se të merrte vendimin në lidhje me pezullimin e dënimit dhe zëvendësimin e tij me vënien në provë duhet të sigurohet që i mituri i ka kushtet e përshtatshme për të zhvilluar edukimin e tij në ambientet e sipërpërmendura. Një rol të rëndësishëm në këtë aspekt ashtu siç e sipër përmendëm mund ta luajë Shërbimi i Provës, që e ndihmon gjykatën në identifikimin e ambientit social dhe familjar ku do të qëndroje i mituri gjatë kohës së provës. Nëse një i mitur jeton në një ambient familjare të shëndoshë, si dhe në një ambient social ku mungon mundësia e kontakteve me një mjedis kriminal, zbatimi i kësaj alternative do të sillte efekte pozitive.(Xhafo, 2013,223)

Në rast të kundërt kur i mituri jeton në një mjedis familjare të degraduar me prindër të inkriminuar, ose përdorues të lendeve narkotike atëherë pa diskutim kjo mas nuk do të ishte zgjidhje e përshtatshme për zhvillimin normal të fëmijës por do të ndikonte edhe me negativisht. Por sigurisht mund të vendosen kushte për pezullimin e vendimit me burg të cilave personi duhet tu nënshtrohet dhe ti respektoj duke i zbatuar. Kushtet janë të tilla si pjesëmarrja në trajnim profesional, punësimi dhe programet për trajtimin e abuzimit me substancat ose që shmangin frekuentimin e vendeve të caktuara apo shoqërimin e personave të caktuar.(Leskoviku, 2010, 48) Gjatë kohës së provës, i dënuari sipas nenit 61 të ndryshuar është i detyruar :

- a) të paraqitet rregullisht dhe të informoje në vazhdimësi Shërbimin e Provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata;
- b) të marrë e pëlqimin nga Shërbimi i Provës për ndryshimin e vendbanimit , qëndresë se punës apo për lëvizjet e shpeshta ;

Ekzekutimi i vendimit të gjykatës mbikëqyret nga Shërbimi i Provës , tek i cili i dënuari, i venë në prove është i detyruar të raportoj rregullisht.(Ligji nr. 10024, datë 27.11.2008 ndryshuar me ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998, neni 9)

Në rastet kur personi i shkel kushtet e sipërpërmendura dhe një sërë të tjerash siç mund të jetë qëndrimi në shtëpi në orare të caktuara atëherë shërbimi i provës ja raporton menjëherë prokurorit dhe në këto raste mund të bëhet zëvendësimi i dënimit me një tjetër. Sipas nenit 10 të ligjit nr. 10024, datë 27.11.2008 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.14.1998” Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i cili shton nenin 31/10 në ligjin ekzistues sipas këtij neni thuhet” Kur gjykata vendos ndryshimin ose revokimin e dënimit alternative, dënimi me burgim jepet në mungese të dënimeve alternative të tjera të përshtatshme, Në çdo raste gjykata merr parasysh mënyrën dhe shkallen e e mospërmbushjes se detyrimeve nga i dënuari” Që do të thotë në raste se i dënuari nuk i përmbush detyrimet e vendosura nga gjykata atëherë kjo nuk bën revokimin e menjëhershëm të dënimit me burgim por duhet të shohë mundësinë e aplikimit të një alternative tjetër. Dhe vetëm në rastet e se një dënimi tjetër të përshtatshëm alternative ajo mund të vendos për revokimin e dënimit me burgim. Por sigurisht këto bëhen në rastet kur gjykata vlerëson situatat të mos respektimit të kushteve nëse kanë qenë a jo reale.

Revokimi i vendimit të pezullimit ndodh kur personi gjatë kësaj kohë kryen një vepër tjetër penale nuk ka rëndësi nëse kjo vepër penal është po aq e rend apo edhe me e rend se e para. Përsa i përket shërbimit në komunitet shihet si një lloj dëmshpërblimi për dëmin që ka kryer autori i veprës penale. Përfundimisht kur vendimi i pezullimit nuk është revokuar nuk ka as dënim as pasoja juridike. Pra pasi të këtë përfunduar afati i provës personi nuk konsiderohet si një i dënuar dhe nuk ka asnjë pasoje juridike që mund ti shkaktojë atij problem të mëvonshme siç ndodh rëndom.

6.2.3. Qëndrimi në shtëpi

Qëndrimi në shtëpi është një alternative tjetër e dënimit me burgim një forme e re e cila nuk ka pas qënë e njohur me parë në vendin tonë. Kjo alternative është e parashikuar në nenin 59/a të Kodit penal e cila është shtuar në këtë kod në vitin 2008 me ligjin Nr.10023, datë 27.11.2008. Sipas nenit 59/a të kodit penal parashikohet se: “ Për

dënimet me burgim deri në dy vjet ose kur kjo kohë është pjese e mbetur e dënimit, sipas një vendimi për një përudh me të gjatë burgimi , gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhenë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit , në një shtëpi tjetër private apo në qendër të kujdesit dhe shëndetit publik kur ekzistojnë rrethanat e mëposhtme: a për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë , nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të. b për baballarët që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën , që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vendosur apo është e pa zonja për tu kujdesur për të, c Për persona , në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut., d për personat mbi 60 vjeçe, që janë të paaftë nga ana shëndetësore. Për të rinj, nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore të punës apo përgjegjësi familjare.

Gjykata mund të lejojë personat e dënuar me qëndrim në shtëpi të largohen nga vendbanimi, për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare., për tu angazhuar në veprimtari punë , edukimi apo arsimimi ose për programe rehabilitimi , për të cilat shërbimi i provës është dakord. Në këtë rast gjykata përcakton masat që duhet të marrë shërbimi i provës. Gjykata revokon qëndrimin në shtëpi dhe e zëvendëson atë me një ndëshkim tjetër, kur nuk ekzistojnë më kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni. Në qoftë se personi i dënuar largohet pa autorizimin e gjykatës nga vendbanimi apo shkel detyrimet e caktuara në vendimin e gjykatës , zbatohet neni 62 i këtij Kodi” Vuajtja e dënimit me burgim me qëndrim në shtëpi jepet nga gjykata, kur çmohet prej saj se janë përmbushur disa kushte: Se pari: Kur gjykata në përfundim të shqyrtimit gjyqësor çmon se i pandehuri duhet të dënohet jo me shume se dy vjet burgim.

1. Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se ekziston një nga rrethanat individuale të të dënuarit të cilat janë të përcaktuara në këtë dispozitë siç mund të jenë rrethanat familjare apo shëndetësore.
2. gjykata vendos për qëndrimin në shtëpi në kohën e dhënies së vendimit të dënimit, kurse në rastet e pjesës së mbetur merret vendim i veçantë gjatë fazës së vuajtjes së dënimit. Njëkohësisht ,gjykata cakton edhe masat që duhet të marrë shërbimi i provës për vuajtjen e këtij dënimi konform kërkesave ligjore.(Muci,2012, 369)

Siç shihet dhe nga përmbajtja kjo alternativë dënimi sjell një element të ri në Kodin tonë Penal. Për herë të parë përdoret termi “ i ri” dhe sigurohet një trajtim i favorizuar për moshën e të rinjve deri në 21 vjeç. Ky trajtim është në përputhje të plotë me standardët ndërkombëtare, që evidentojnë detyrimin për një mbrojtje të veçantë nga legjislacionet e brendshme të grup-moshave të të rinjve.(Xhafo,2012,230) Kjo dispozitë paraqet një element pozitiv për një mbrojtje sa më të veçantë për grup-moshën e të rinjve.

Kjo alternative për sa u përket të rinjve nën moshën 21 vjeç jepet kur gjykata çmon se përmbushen disa nevoja si shëndetësore, studimore, etje. Pra kjo alternative mund të përdoret kur një person ka problem shëndetësore, kur duhet të përmbush disa përgjegjësi siç mund të jetë p.sh.,kujdesi për prindërit apo për fëmijët e mitur, për tu angazhuar në veprimtari punë. Në rastin e të dënuarve të mitur kjo alternative mund të jepet në rastin e ndjekjes se studimeve apo kurseve profesionale. Gjithashtu kjo alternative mund të jepet për të ndjekur një veprimtari rehabilituese sidomos ndaj personave të dënuar që janë përdorues të lendeve narkotike. Po ashtu si alternativat e sipërpërmendura dhe kjo alternative dëshmon për karakterin human të legjislacionit shqiptarë, i cili ka për qëllim parandalimin e pasojave negative që mund tu shkaktoj jetesa brenda institucione penitënciare shtresave shoqërore të caktuara siç janë gratë shtatzëna, të miturit, të moshuarve apo personave të sëmurë.

6.2.4. Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik

Puna në interes publik është një masë dënimi alternative, që e detyron personin, ndaj të cilit aplikohet, të kryejë punë në favor të komunitetit. Mendohet se në Evropë është parashikuar për herë të parë në legjislacionin penal të Danimarkës në vitin 1974. Me pas është sanksionuar edhe në legjislacionet e shteteve të tjera të Evropës .(Xhafo, 2012,232) Kjo alternative tashme është pjesë përbërëse e alternativave të dënimit me burgim të parashikuara nga Kodi ynë penal. Kështu pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin për të kryer një punë në interes publik tashme është pjese përbërëse e alternativave të dënimit e parashikuar në nenin 63 të kodit tonë penal.(KP neni 63 ndryshuar me ligjin Nr. 10023, datë 27.11.2008) Sipas

këtij neni parashikohet se:“ Gjykata për shkak të rrezikshmërisë së paket të personit dhe të rrethanave të kryerjes se veprës penale, kur ka caktuar një dënim gjer në një vit burgim, mund të vendos pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbush një punë në interes publik.”

Puna me interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një punë, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesave publik apo shoqatës se caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga dyzetë deri në dyqind e dyzetë ore. Ky detyrim nuk mund të vendoset kur i dënuari refuzon pezullimin në séance gjyqësore. Puna në interes publik kryhet brenda afatit prej gjashtë muajsh. Në vendimin e saj gjykata përcakton numrin e orëve të punës dhe detyrimin që i dënuari të mbaj kontakte me shërbimin e provës. Shërbimi i provës vendos llojin e punës që do të kryhet, përcakton vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo, duke pasur parasysh, për aq sa është e mundur, punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare. Kohëzgjatja e punës me interes publik nuk i kalon tetë orë në ditë.

Nëse i dënuari nuk kryen punën me interes publik, nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera,të vendosura nga gjykata, prokurori informon menjëherë gjykatën. Gjykata, në këtë rast, vendos sipas nenit 62 të këtij Kodi se për të kryer këto veprime duhet me doemos një koordinim i veprimtarisë gjyqësore me ato të prokurorisë, organe të përparimit dhe pushtetit lokal. Dhe vepohet kur personi dhe rrethanat e kryerjes së krimit kanë rrezikshmëri të pakët

- Kur dënimi nuk është më shumë se një vit.
- Puna në interes publik do të jetë minimum 40 orë deri në maksimumi 240 orë, pa shpërblim me interes publik të komunitetit apo të ndonjë shoqate.
- Kjo punë duhet të përfundoj për një afat kohor 6 muajsh.
- Ky vendim mund të revokohet kur personi nuk zbaton kushtet që janë cituara në vendim të gjykatës.(Papandile, Mandro, 2002, 158)

Puna në interes publik ose në favor të një shoqatë nuk parashikohet në Kodin Penal as si dënim kryesor as si dënim plotësues. Në këtë vështrim gjykata nuk legjitimohet të caktojë ndaj fajtorit lloje dënimi që nuk përfshihen në sistemin e dënimeve të këtij kodi. Prandaj, puna në interes publik, edhe pse zëvendëson dënimin me burgim, nuk duhet

kuptuar si lloji i veçantë dënimi. Ajo përbën një alternative të vuajtjes së dënimit me burgim, plotësimi i së cilës e çliron të dënuarin nga vuajtja e këtij dënimi në kushtet e izolimit. (Muci, 2012, 371)

Veçantia e këtij dënimi është se nuk mund të jepet nga gjykata në rast se i pandehuri nuk dëshiron të punojë pa shpërblim dhe të respektojë kushtet dhe detyrimet e vendosura nga gjykata. Kështu, në rastet e të miturve kjo alternativë kërkon pëlqimin e të miturit, të prindërve apo kujdestarit të tij/saj, me kusht që një vendim i tillë për një rast të referuar të shqyrtohet nga një autoritet kompetent për zbatim. (Leskoviku, 2010, 17) Puna në interes në publik jepet për një periudhë kohore nga 40 deri në 240 orë dhe nuk mund të kalojë kohëzgjatjen më shumë se tetë orë në ditë dhe duhet të kryhet nga i dënuari brenda një afati kohor prej gjashtë muajsh. Mbikëqyrja e ekzekutimit të këtij dënimi bëhet nga Shërbimi i Provës në përputhje me nenet 48-55 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 302 datë 25. 03.2009. Kështu, shërbimi i provës vendos për vendin e punës, llojin e punës dhe ditët e javës kur do të kryejë i dënuari sigurisht duke marrë në konsideratë dhe detyrimet familjare të tij. Kjo alternative e dënimit të kryerjes se një punë në interes publik është mjaftë pozitive për sa i përket të miturve pasi do të edukonte ata me ndenjen e punës duke ju përkushtuar mjedisit në të cilën ata jetojnë.

Psikologët mendojnë se të miturit në disa raste kryejnë vepra penale të shtyre nga ndjenja e apatisë dhe zbrastisë, që vjen si pasojë e mungesës së angazhimit. (Xhafo, 2012, 234) Duke marrë në konsideratë faktin se të miturit nuk mund të vlerësojnë vlerën e punës kështu angazhimi i punëve në interes publike do të sillte ndryshime në sjelljen e tyre duke rritur me shumë ndërgjegjësimin dhe evituar përsëritjen e sjelljeve të tjera negative.

6.2.5. Lirimi me kusht

Lirimi konsiston në ekzekutimin e dënimit. Lirimi me kushte është i parashikuar në nenin 64 të Kodit Penal. Kjo dispozitë ka pësuar ndryshime në përmbajtjen e saj me ligjet nr. 8733, datë 24.01.2001 dhe nr 10 023, datë 23.11.2008. Ndryshe nga alternativat e tjera kjo alternative nuk i përket fazës së caktimit të dënimit nga gjykata, por asaj të ekzekutimit të tij. Në përmbajtjen e tij neni 64 i Kodit Penal parashikon:“ i

dënuari me burgim mund të lirohet me kusht , nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimi për edukimin e tij , si dhe të këtë vuajtur:-jo me pak se gjysmën e dënimit të dhenë për kundërvajtje;-jo me pak se dy të tretat e dënimit të dhëna për krime me masa dënimi gjer në dy vjet burgim;- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për me masa dënimi nga pesë gjer në njëzetë e pesë vjet burgim; Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfutur me amnisti ose falje. Nuk lejohet dënimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje. Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, po aq të rëndë ose më të rëndë se e para, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve”.

Kjo alternativë zbatohet sipas termit që përdor me ligj vetëm për arsye të veçanta. Ajo që është vënë re gjatë praktikës është pikërisht fakti se nocioni “arsye e veçantë” nuk mbahet parasysh në çdo rast. Studiuesit e së drejtës që nuk mbajnë parasysh këtë nocion mjaftohen vetëm me plotësimin e kushteve të tjera. Nga ana tjetër konstatohet se ka një grup tjetër studiuesish, të cilët mbajnë parasysh në analizat e tyre nocionin “arsye e veçantë”. Këta krahas të kësaj ideje i referohen interpretimit liberal të dispozitës nga ku rezulton se përcaktohet si një kusht *sinë qua non* (domosdoshmëri) nocioni arsye e veçantë, duke u përdorur terminologjia” vetëm për arsye të veçanta”. (OSCE, 2010,68) Nisur nga kjo arsye e veçanta nuk janë gjë tjetër veçse dy kriteret ligjore të mëposhtme të lirimimit me kusht:

- a) Sjellja dhe puna e të dënuarit që tregojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi i edukimit të tij dhe
- b) Afatet kohore të dënimit të vuajtur. (Muci, 2012, 373)

Përsa i përket sjelljes së të dënuarit ajo vlerësohet nga gjykata e cila gjykon sjelljen e tij në respektimin e rregullores së burgut, sjelljen e tij me punonjësit e këtyre institucioneve gjithashtu dhe marrëdhëniet e tij me personat e tjerë të dënuar. Puna që ka bërë në këto institucione është gjithashtu një faktorë tjetër që ndikon në gjykim. Në rastet që gjykata i vlerëson gjithë këta faktorë që kanë ndikuar pozitivisht në edukimin e tij ajo e shikon të panevojshme qëndrimin e personit në këtë institucion.

Në këto raste gjykata e pezullon ekzekutimin e dënimit me burgim po vetëm një pjesë të tij, pjesën e mbetur. Dënimi me kusht nuk mund të aplikohet për personat të cilët janë përsëritës në veprat penale, gjithashtu as për personat që janë dënuar me burgim të përjetshëm. Në nenin 65 të kodit penal thuhet që për të burgosurit të përjetshëm jepet vetëm në raste të jashtëzakonshme. (neni 65 Kodi penal) Mbasi gjykata ka shqiptuar dënimin me kusht është detyrë e shërbimit të provës të mbikëqyrë nëse përmbushen a jo detyrimet e dhëna dhe informon gjykatën për këtë: në mënyrë që ajo të ndërmarr vendime adekuatë në këtë drejtim. (Halil, 2009, 231) Pavarësisht ndryshimeve të bëra kjo dispozitë nuk solli asnjë të re në lidhje me përfitimin e lirimit me kusht për të miturit. Përsa i përket të miturve nuk është se ka një informacion të saktë mbi numrin e burgosurve të mitur të cilët përfitojnë nga lirimi me kusht. (Leskoviku, 2010,49)

Standardet ndërkombëtare kërkojnë që ndaj të miturve të aplikohen kushte me të favorshme për lirimin me kusht si një mënyrë për të shkurtuar kohëzgjatjen e tyre në burg (Rregullat e Pekinit, rregulli 28) Nëse do të referoheshim legjislacioneve të huaja do të vërejm shembuj pozitiv përse i përket zbatimit të kësaj alternative për të miturit. Sipas nenit 32/1 të kodit penal për të miturit thuhet se : *“Personi i dënuar me burgim për të miturit mund të lirohet me kusht, nëse ka vuajtur se paku një të tretën e dënimit që është caktuar”* Njëkohësisht një tjetër shembull mjaftë pozitiv në lidhje me aplikimin e lirimit me kusht ka sjell edhe Kodi Penal grek i cili ka parashikuar rregullime të veçanta për aplikimin e këtij institut ndaj të miturve.

Në neni 129/1 të kodit penal të Greqisë thuhet se: Lirimi me kusht për të miturit mund të aplikohet mbas vuajtjes së gjysmës së dënimit. Po në këtë nën paragrafi 3 thuhet se : Për arsye të rëndësishme, lirimi me kusht mund të jepet nga gjykata edhe para vuajtjes së gjysmës së dënimit të dhen , por me kusht që të jetë vuajtur një e treta e dënimit.¹²⁹ Si përfundim mund të themi se pavarësisht karakterit human që ka legjislacioni duhet krijuar sa më shumë programeve që të ndihmojnë në këshillimin e këtyre të miturve sidomos në ato ambiente që shfaqin problematika nga me të ndryshmet. Të liruarve me kusht mund t’u caktohen gjithashtu detyrime në lidhje me mënyrën e jetesës, edukimit apo ndjekjeve të programeve të ndryshme. Nga analizimi i

¹²⁹ Shih nenin 129 paragrafi 3 të Kodit Penal të Greqisë.

alternativave të dënimit me burgim mund të thuhet se sistemi i administrimit të drejtësisë për të mitur pavarësisht nga disa dispozita të kodit penal dhe kodit të procedurës penale të cilat janë shumë të kufizuara rezultojnë të këtij karakteri me tepër ndëshkimor se sa edukues, riintegruues duke pasur si objektiv interesin me të lartë të fëmijës.

6.3.Krahasim me legjislacionin dhe eksperiencën e disa vendeve të rajonit

6.3.1. Legjislacioni Francez

Ligji i 2 shkurtit 1945 (Ordonnance n° 45-174 du 2 février 1945 relative à l'enfance délinquante. Version consolidée au 28 février 2016) është instrumenti bazë që përcakton rregullat dhe parimet e zbatueshme për procedurat me të mitur në konflikt me ligjin penal. Memorandumi shpjegues i këtij ligji historik përcakton filozofinë që përshkon këtë ligj: "Franca nuk është vend aq i pasur me fëmijë saqë të lërë pas dore fëmijët të cilët kanë potencialin të bëhen qenie të shëndetshme. Lufta, turbullirat dhe kaosi moral që kanë shkaktuar ka rritur në përmasa alarmante kriminalitetin e të miturve. Çështja e të miturve keqbërës është një nga prioritetet më urgjente e kohës së sotme. Ky ligj vërtetoi se qeveria e përkohshme e Republikës Franceze synonte në mënyrë efektive për të mbrojtur të miturit, veçanërisht të miturit në konflikt me ligjin penal."

Arsyeja pse miturit janë të përjashtuar nga gjykatat penale të ligjit të zakonshëm është e qartë: të miturit e përfshirë në kriminalitet duhet njëkohësisht të ndëshkohen por dhe të mbrohen prandaj përmirësimi i gjendjes kërkon që trajtimi i të miturve t'i besohet gjyqtarëve dhe prokurorëve të specializuar si në fazën e hetimit ashtu dhe në atë të gjyqimit. Pas ligjit të 2 shkurtit 1945, në Francë për fëmijët nën dhe adoleshentët nën 18 vjeç aplikohet një drejtësi specifike që quhet drejtësia për të mitur. Rregullat dhe normat e kësaj drejtësie i shtohen rregullave dhe normave të së drejtës së përgjithshme dhe aplikohen në çdo juridiksion si në çështjet civile, familjare apo penale kur lidhen me të mitur. Drejtësia për të mitur ka dy fusha kryesore veprimi: a) të miturit në kriminalitet dhe b) fëmijëria në rrezik.

1. Të miturit në kriminalitet

Për shkak të moshës së tyre, të miturit që janë përfshirë në vepra penale, përfitojnë disa rregulla procedurale që cedojnë nga rregullimet e përgjithshme, kanë një juridiksion të specializuar, dhe një përgjegjësi penale të posaçme. Masat edukative kanë një pozicion të privilegjuar në krahasim me dënimet e parashikuara për veprën penale kur atë e kryen një i rritur. Legjislacioni francez ka parashikuar si moshë për përgjegjësi penale moshën 18 vjeç. Sipas këtij legjislacioni, i mituri nuk mund të gjykohet nga juridiksionet penale të zakonshme, por duhet të trajtohet para institucioneve të specializuara të cilat janë:

- a. Gjyqtari i fëmijëve – institucioni që gjykon një çështje ku marrin pjesë të miturit, dhe që aplikon masat e dënimit për ta.
- b. Gjykata e fëmijëve – që udhëhiqet nga gjyqtari i fëmijëve, i cili asistohet nga dy magjistratë të pa specializuar për drejtësinë e të miturve.
- c. Gjykata e të miturve- ku gjykohen krimet që kryhen nga të mitur 16 deri në 18 vjeç, sipas një procedure të veçantë që aplikohet vetëm për të miturit. ajo përbëhet nga tre magjistratë profesionistë dhe nga një juri popullore.

Këto juridiksione punojnë në bashkëpunim me prokurorin e Republikës, me shërbimet e mbrojtjes së të miturve dhe rinisë (PJJ) dhe me avokatët. Të miturit konsiderohen penalisht përgjegjës që në momentin kur janë të aftë për të gjykuar. Këto juridiksione punojnë në bashkëveprim me të prokurorinë, me shërbimet e mbrojtjes gjyqësore të të rinjve (PJJ) dhe me avokatët. I mituri konsiderohet penalisht përgjegjës në momentin që që ai është i tillë. Ligji francez rast përcakton moshën rreth 8-10 vjet si moshë në të cilën i mituri ka të ngjarë dënohet. Dënimet janë përshtatur për moshën e fëmijës në momentin e kryerjes së veprës: deri në 10 vjeç, nuk mund t'i jepet asnjë dënim, ai nuk është penalisht përgjegjës por mund t'i jepen vetëm masat e "mbrojtjes, mbështetjes, mbikëqyrjes dhe edukimit; nga 10 deri në 13 vjeç, masa e dënimit mund të jetë një masë edukuese siç mund të jetë konfiskimi i një objekti për shembull). Nëse i mituri nuk e zbaton masën, atëherë mund të vendoset në një shtëpi apo në një qendër specializuar për të mitur; për vepra penale të kryera nga mosha 13 deri 16 vjeç, i mituri mund të jetë subjekt i ndjekjes penale, dënimit me burgim është e mundur, por do të jetë më pak se gjysma e se shkaktuar nga alternativë e mundshme për më të rriturit, por vetëm kur kanë kryer krime; për vepra penale të kryera nga i mituri i moshës 16 deri në

18 vjeç mund të jetë mbahet në paraburgim, mbrojtja nëpërmjet elementit “i mitur” mund të përjashtohet.

Recidivizmi dhe përkeqësimi i situatës së kriminalitetit të miturve ka zhvendosur gradualisht vëmendjen e drejtësisë të të miturve drejt një përsheptim të procedurave dhe forcimit të kuadrit edukativ. Kështu, ligji nr. 1138 i datës 09. Shtator 2002 “Për orientimin dhe programimin e drejtësisë shënoi një përforsim të konsiderueshëm të përgjegjësisë penale kundrejt kriminalitetit të të miturve. Ligji thjeshtësoi kushtet e marrjes së masave edukative për të miturit e moshës 10 deri në 13 vjeç. Ky ligj gjithashtu bëri të mundur thjeshtimin e kushteve për vendosjen nën juridiksionin gjyqësor dhe ndalimin e të miturve 13-16 vjeç dhe "gjykimin në të ardhmen e afërt "për shkelësit përsëritës. Përveç kësaj për të riafirmuar parimin e përgjegjësisë penale të të miturve vetëm në momentin që bëhen të përgjegjshëm, ligji ka parashikuar krijimin e "qendrave të mbyllura arsimore" (CEF) për të miturit të moshës 13 deri 18 vjeç që i nënshtrohen një dënimi penal ose një dënimi me kusht. Ligji nr 2004-204 i datës 9 mars 2004 solli përshtatjen e sistemit të drejtësisë me zhvillimet e kriminalitetit në veçanti njohu dhe krijoi procedurën e marrëveshjes nëpërmjet e njohjes parapraket kajsisë, për veprat penale të dënueshme me një dënim maksimal prej pesë vjet burgim. Ky ligj ka përforsuar efektivitetin e alternativave të burgimit (duke bërë skema test, në bazë të vendosjes elektronike byzylyk, puna e komunitetit ...) dhe gjithashtu ka sanksionuar "shtetësisë në në stazh", si sanksion i ri penal i zbatueshëm ndaj të miturve nga 13 deri në 18 vjeç.

Ligji nr 2007-297 i datës 5 mars 2007 “mbi parandalimin e krimit” synon që ta bëjë Kryetarin e Bashkisë aktorin kryesor në politikën e parandalimit të krimit në rajonin e vet dhe forcimin e rolit të prokurorit. Ky ligj sjell një ndërthurje të masave shëndetësore dhe sociale që jepet në katër drejtime: ndjekja dhe mbështetja për familjet në nevojë, kërkesat e sigurisë në aspektin e strehimit dhe planifikimit urban, kujdesi ndaj njerëzve me çrregullime të rrezikshme mendore dhe mënyrat për ndëshkuar dhe trajtuar përdoruesit e drogës. Ky ligj futi një procedurë të "prezantimit të menjëhershme "për të miturit 16 deri në 18 vjet dhe krijoi" masën e aktivitetit ditor.

2. Hetimi i rasteve penale që përfshin një të mitur

Sipas parimit të specializimit që rregullohet nga ligji i 2 shkurtit 1945, hetimi i rasteve që përfshijnë pjesëmarrjen e të miturit si kryerës të veprës penale është e ndarë në mes të gjykatës për të mitur dhe gjyqtari hetues. Nëse ky i fundit është domosdoshmërisht kompetent për krimet e kryera nga të miturit, ai konkurren me kompetencën e gjykatës për të miturit për informacionin mbi krimet dhe kundravajtjet penale të shkallës së pestë. Pra, si një përjashtim nga parimi i ndarjes së autoriteteve të hetimit dhe të gjykimit, gjyqtari për të mitur mund të ndiqte si hetimin ashtu dhe gjykimin e krimeve dhe kundërvajtjeve në rastet që përfshiheshin të miturit. Këshilli Kushtetues me 8 korrik, 2011 është shprehur se ky unitet dhe bashkim funksionesh ishte kundërshtim me parimin e paanshmërisë, i cili kërkon pjesëmarrjen e dy magjistratëve të ndryshëm për të hetuar dhe dënuar të miturin.

Ky vendim nuk ia ka hequr të gjitha kompetencat Gjyqtarit për të miturit lidhur me udhëzimet materiale kështu mbështetur në kërkesën e prokurorit, ai pastaj ka kompetencat e zakonshme të hetimit të një hetuesi të zakonshëm. Informacioni i tij, megjithatë, duhet të përdoret për të identifikuar personalitetin e veçantë të të miturit. Pas hetimit, gjyqtari për të mitur mund ta referojë rastin para gjykatës hetues për hetime të mëtejshme, ose ia referohen çështjes gjykatës. Gjykatësi hetues mund të jetë njëloj kompetent për të siguruar informacion mbi rastet e veprave penale ku përfshihen të miturit : pranë çdo gjykatë rajonale me një seksion gjykimi për të mitur ekziston një gjyqtar i specializuar në veprat penale me të mitur.

Më në fund, gjykatësi i lirive dhe i paraburgimit është kompetent për të vendosur paraburgimin e të miturve. Sipas kërkesës së gjyqtarit për të mitur ose gjyqtarit hetues, JLD (gjykatësi i lirive dhe i paraburgimit) mund të vendosë në paraburgim të miturit mbi 16 vjeç dhe të miturit në mes 13 dhe 16 vjeç për vepra penale të rënda.

3. Gjykimi i të miturve autorë të veprave penale

Në Francë, ligji parashikon që të gjithë fëmijët të aftë për të gjykuar janë penalisht përgjegjës për veprat për të cilat ata janë shpallur fajtorë. Gjykimi i këtyre të miturve në konflikt me ligjin penal bëhet vetëm në gjykatat e specializuara posaçërisht për të miturit të cilat: gjyqtari për të miturit, gjykata e të miturve, gjykata penale për të miturit dhe Gjykata e krimeve të rënda për të miturit. Gjyqtari për të mitur është kompetent për

të shqyrtuar kundravajtjet penale të shkallës së pestë dhe krimet e dënueshme me një masë dënimi më të ulët se shtatë vjet burgim të kryera nga të miturit. Kompetenca e tij në fakt është fakultative, pasi ai gjithmonë mund të zgjedhë që të dërgojë të miturit në gjykatën e të miturve. Përndryshe, gjyqtari për të mitur mban një seancë të quajtur "firma"(de cabinet), në të cilën ai mund të prononcohet vetëm për masat edukative, për asistencën, monitorimin, apo vendosjen e të miturit në mbrojtje gjyqësore.

Gjykata për të miturit (tribunal pour les enfants TPE), përbëhet nga gjykatësit për të mitur dhe dy vlerësues, njohës të delikteve dhe të kundërvajtjeve apo vepra të vogla penale të të kategorisë së pestë të gjitha të kryera nga të miturit, si dhe krimet e kryera nga të miturit nën moshën 16 vjeç. Gjykata ka ndaj të miturit e tri llojeve të masave penale:

1. Masat edukuese mund të jepen pavarësisht nga mosha e fëmijës;
2. Sanksionet edukuese, të tilla si ndalimi i kontaktit me viktimën, mund të jepen ndaj të miturit i cili është të paktën 10 vjeç;

Për të miturit të moshës 13 deri në 16 mund të jepen dënime penale, të cilat duhet të justifikohen nga rrethanat dhe personaliteti i të miturit, dhe që merr parasysh parimin e zbutjes së përgjegjësisë (i cili zakonisht rezulton në reduktimin e gjysma së masës së dënimit të parashikuar). Në fund, TPE që për të miturit mbi 16 vjeç të mos zbatojë këtë parim për zbutjen e përgjegjësisë me vendim të arsyetuar. Në rast përsëritjeje, mundësia për të shkarkuar, ‘u përgjegjësinë dhe për t’u mbrojtur është rritur në masë të madhe nga ligji i 10 gushtit 2007. Për pjesën tjetër, procedurat para TPE janë në përputhje me parimet e ligjit të zakonshëm, përveç se seanca nuk është publike.

- Gjykata penale për të miturit (Le tribunal correctionnel pour mineur - TCM), e krijuar nga Akti i 10 Gusht 2011, është formacion i specializuar i Gjykatës Penale, i kryesuar nga një gjyqtar për të mitur kompetent për të gjykuar të miturit mbi 16 vjeç që janë përsëritës për krime që dënohen me më shumë se 3 vjet burgim. TCM është gjithashtu kompetente për gjykimin e veprave të kryera nga të rriturit që shtyjnë të miturit në krim.
- Gjykata e Krimeve të Rënda për të mitur, përbëhet nga tre gjyqtarë profesionistë dhe nëntë anëtarë të jurisë popullore të cilët zgjidhen me short. Kjo gjykatë gjykon

krimet e kryera nga të mitur 16deri në 18 vjeç dhe të bashkëpunëtorëve të tyre të rritur. Me përjashtim të një publiciteti të kufizuar, procedura është e njëjtë me atë të ndjekur në gjykatën e zakonshme penale.

6.3.2. Legjislacioni italian

Përshtatja e sistemit juridik italian me një sistem të ri të drejtësisë penale për të mitur, sic është paraqitur nga Dekreti Presidencial 448/88, është fryt i një procesi legjislativ të gjatë dhe kompleks të filluar që nga vitet '70. Fillimisht ligji i parë i cili bëri të mundur reformën e Kodit të Procedurës Penale nr. 108, datë 3 prill 1974 parashikonte vetëm dy dispozita që lidheshin me gjykimin e të miturve, përkatësisht "përjashtimin e lidhjes në rastin e të miturve" dhe "ushtrimi fakultativ të mundësisë për arrestimin e fëmijës të kapur në flagrancë gjatë kryerjes së një krimi të rëndë". Neni 1 i dekretit 448/1988 ka zbatuar parimet dhe kriteret e akteve ndërkombëtare duke bërë të mundur e duke urdhëruar që në procedura kundër të miturve zbatohen dispozitat e veçanta të përfshira në të njëjtin dekret, duke iu referuar dispozitave të përgjithshme të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale "për aq sa ato nuk bien ndesh", me respektimin e parimit të subsidiaritetit.

Dekreti 448/88, "Për miratimin e dispozitave mbi procedurën penale kundër të miturve", është i pari që në mënyrë sistematike reformoi procedurat penale me të mitur. Reforma e gjykimin të të miturve është vazhdimi i punës tashmë të filluar prej kohësh për këtë arsye dhe është në harmoni edhe me tendencat e mëparshme të të drejtave të fëmijëve në nivel kombëtar që ndjekin udhëzimet e përcaktuara nga standardet ndërkombëtare, të cilat kanë për qëllim futjen e një sistemi të ri në gjendje për të balancuar nevojën për të mbrojtur komunitetin me normat edukative dhe psikologjike këtyre të pandehurve të veçantë.

Procesi penal me fëmijë, pra, fokusohet jo vetëm në vlerësimin e fakteve dhe përgjegjësi, por kryesisht në njohuritë e personalitetit të fëmijës sjellja e të cilit ka çuar në shkelje të ligjeve dhe që përbën vepër penale. Ndryshe nga dispozitat për të rritur të akuzuar, në lidhje me të cilët Neni 220 i Kodit të Procedurës Penale ndalon hetimet mbi personalitetin jashtë hetimeve në lidhje me ekzistencën e një çrregullimi të plotë apo të pjesshëm mendor, ligji procedural për të mitur, nga ana tjetër, e lejon një

gjë të tillë në nenin 9 të Dekretit 448/88, me titull "Hetimet mbi personalitetin e të miturit," duke vendosur si detyrë prokurorit publik dhe gjykatësit për të kryer, përpara çdo hetimi tjetër, hetimet për personalitetin e fëmijës, për mardhëniet familjare dhe mjedisin shoqëror, për të vlerësuar, në dritën e tyre, rëndësinë shoqërore të veprës penale të kryer, shkallën e përgjegjësisë penale dhe masën më të përshtatshme të dhënë për të. Tashmë në Ligjin 81/1987, miratimi i Kodit të ri të Procedurës Penale iu kushtua një vëmendje e veçantë fëmijëve. Në këtë kod, në fakt, u tha se "procesi me të mitur", në krahasim me procesin e të rriturve, duhet të realizohet duke pasur parasysh ndryshimet dhe plotësimet e vendosura nga kushtet e veçanta psikologjike të fëmijës, si pjekurinë e tij dhe nevojat e tij për edukimit " dhe kjo duhet të aplikohet për çdo shkollë dhe ndërhyrje të planifikuar për fëmijën.

Prioritet i është dhënë rehabilitimit si rruga më e shkurtër që ka çuar detyrimisht në ndryshime të rëndësishme në operimin e institucioneve të përgjithshme dhe çoi në futjen e institucioneve krejtësisht të reja, të tilla si dhe mundësinë e mbylljes së hetimeve për shkak të rëndësisë së vogël të veprës, dhe pezullimin e procesit me vënien në provë, me qëllim për të shmangur turpin ose efektet kontradiktore e kontaktit me sistemin e Drejtësisë.

Disa nga dispozitat e Dekretit 448/88 janë vetëm një sqarim dhe zgjerim i parimeve tashmë të përfshira në legjislacionin e mëparshëm. Këto përfshijnë keq funksionimin e lidhjes me bashkë të pandehurit e moshës rritur.; përjashtimi e seancave publike dhe detyrimin absolut konfidencialiteti; parashikimi i rasteve në të cilat nevoja të veçanta arsimore këshillohej plotësimi i dokumenteve të caktuara procedurale në mungesë të të akuzuarit; parashikimi i rregullave strikte, në çdo rast, arrestimi në flagrancë dhe, kthimi në paraburgim vetëm për krimet më të rënda; një shkurtim për periudhën maksimale të dënimit me burgim.

Dispozitat e tjera janë, një hap shumë i avancuar jo vetëm në krahasim me legjislacionin e mëparshëm, por edhe për Kodin e ri të Procedurës Penale. Midis tyre mund të përmendim rregullat të cilat futën papranueshmërinë e palëve civile; detyrimin e gjykatës për të shpjeguar përmbajtjen e akuzave të vogla për arsye etike dhe sociale të gjykimit; detyra e vlerësimit të personalitetit, me qëllim që të vlerësohen rezultatet e

ndërhyrjeve, duke ushtruar dhe apelimin për pezullimin e procesit; zgjerimi i mundësive për të përdorur dënimitet alternative.

Në bazë të kriterëve të përshkruara në nenin 3 të ligjit, pas miratimit të kodit penal për të mitur, paraqitet një kornizë ligjore e cila karakterizohet nga një kujdes i veçantë për personalitetin e të akuzuarit të mitur në lidhje me procedurat penale në mënyrë që të minimizohet dëmi që mund të vijë, si në aspektin e gjykimi social (për izolimin dhe stigmatizimit nga komuniteti) si nga pikëpamja e traumave psikike. Mbrojtja e të miturve është parashiuar që në fazën e parë të procedurës kur procesi kërkon që instrumentet procedural të jenë të përshtatura gjithmonë me cilësitë e autorit të kësaj moshe, privimin, problemet mjedisore, duke qenë se i mituri është një person i brishtë, shpesh dhe në gjendje për të kuptuar rëndësinë e ngjarjeve. Për këto arsye, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet këtyre elementeve gjatë miratimit të masave parandaluese në mënyrë që të shmanget sa më shumë të jetë e mundur rreziku i marrjes së masave shtrënguese të cilat do të rrezikojnë zhvillimin arsimor në vend që inkurajojnë integritetin e fëmijës në shoqëri me vonesë.

Gjithashtu janë parashikuar për të përdorur sanksione alternative me te gjera dhe për këtë qëllim gjyqtari, vendos masë të njëjtë me të cilën ka bindjen se në burg, ajo mund të konsiderohet si më e përshtatshme karshi vuajtjes së dënimit përmes formave kufizuese të lirisë të ndryshme nga burgu. Pavarësisht se procesi me të mitur për prokurorinë nuk rezulton i thjeshtë, për fëmijën mund të jetë një nxitje për një menaxhim të ri të jetës së tij, dhe për këtë arsye parlamenti Italian konsideroi të nevojshme të fuste një komponent shumë të fuqishëm për të rehabilituar të miturin në konflikt me ligjin penal, pikërisht përgjegjësinë e shërbimeve sociale, si dhe kualifikimit të organeve të drejtësisë për të miturit. Siç është theksuar në mënyrë korrekte, kjo risi është shprehje e qëllimit të legjislatorit italian për të krijuar një rrjet të fortë të bashkëveprimit të institucioneve që mbështesin fëmijën gjatë përvojës së rastit kur është në konflikt me ligjin penal dhe për të mundësuar rehabilitimin e tij duke identifikuar dhe shfrytëzuar burimet ekzistuese dhe praktike në rrjetin social (rrethi familjar, rrethi shoqëror, shkolla). Me reformën e gjyqimit penal për të miturit, legjislatori italian, për të siguruar futjen e instituteve krejtësisht të reja nga procedurat e mëparshme, ka droguar nga procedimi me të mitur disa nga rregullat e gjyqimit të

zakonshëm penal. Ndër këto përjashtime duket relevante këtu për t'u kujtuar neni 9 i Dekretit 448/88 dhe nenet 431 shkronja e), 236 dhe 511 paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale Italiane, në të cilat të gjitha informacionet e rëndësishme për vlerësimin e personalitetit të të akuzuarit vlerësohen në harmoni me të dhënat dhe provat që gjenden në dosjen e rastit përkatës. Ndryshe nga sa ndodh për të rriturit, për të cilët ne vend të sa më sipër, zbatohet parimi i përgjithshëm i formimit të testit të dëgjimit dhe, me referencë të veçantë ndaj raporteve të ekspertëve, gjatë ndalimit apo gjatë hetimit të përgjegjësisë penale për shkatërrimin e pranimi, ku ata janë të nevojshme për të përcaktuar përhershëm, profesionalizmi në krim, tendenca për të kryer një krim, karakterin dhe personalitetin e të akuzuarit dhe cilësitë e pavarur psikike shkakët patologjike.

Si parashikuar me lart, gjykimi do të mbahet në kamera (neni 33 paragrafi i parë CPPM, pavarësisht nga neni 471 paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale) dhe kur kjo është e nevojshme për arsye edukative, i akuzuari mund të largohet nga salla (pavarësisht siç është përcaktuar me nenin 475 Kodit të Procedurës Penale për procesin e zakonshëm).

Ligji parashikon dheshoqërimin e detyrueshëm në gjykatë për një dëgjim paraprak të të miturit nga gjykatësi me qëllim vlerësimin e personalitetit të tij (neni 31 c.p.p.m.). Gjithashtu të thuhet se ligji parashikon se në seancën përgatitore, gjykata duhet të dëgjojë të akuzuarin e mitur (neni 31 paragrafi 2 c.p.p.m.), ndërsa në procesin e zakonshëm gjykata vijon me shqyrtimin e të akuzuarit vetëm në kërkesën e tij të shprehur (Neni. 208 Kodi i Procedurës).

6.3.3. Legjislacioni kosovar

Sistemi i drejtësisë për të mitur në Kosovë ka një ligj specifik, ligjin Penal Për të Miturit, i cili synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale. Kryerësve të mitur u jepen masa dënimi të diversitetit sipas nevojës. Privimi i lirisë jepet vetëm si mjet i fundit dhe do të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Gjatë privimit të lirisë të shqiptuar si dënim, kryerësit të mitur i ofrohet edukim, ndihmë psikologjike, e sipas nevojës edhe ndihmë mjekësore për të lehtësuar rehabilitimin e tij.

Fëmijës që merr pjesë në procedurë penale i ofrohet mundësia që të shprehet lirisht. Çdo fëmijë i privuar lirie trajtohet me humanizëm për hir të dinjitetit të personalitetit të tij njerëzor, dhe me atë rast merren parasysh nevojat personale të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar lirie ndahet nga madhorët, përpos nëse konsiderohet se është në interes të fëmijës të mos ndahet, dhe gëzojnë të drejtën e mbajtjes së kontakteve me familjen e tij përmes korrespondencave dhe vizitave, përveç rrethanave të jashtëzakonshme të përcaktuara me ligj. Çdo fëmijë i privuar lirie ka të drejtë në qasje të menjëhershme në ndihmë ligjore dhe ndihmë tjetër adekuate, si dhe të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e privimit të tij nga liria pranë një gjykate të pavarur dhe të paanshme, si dhe në procedurë të menjëhershme. Për t'iu shmangur lëndimit për shkak të publicitetit të tepruar ose etiketimeve, e drejta e fëmijës për privatësi respektohet në të gjitha fazat. Në parim, nuk botohet asnjë informacion që shpie në identifikimin e kryerësit të mitur.

Masat dhe dënimet e zbatueshme ndaj të miturve (Neni 6) Masat që mund të jepen ndaj të miturve janë: masat e diversitetit dhe masat edukative. Dënimet që mund të jepen ndaj të miturve janë: gjoba, urdhri për punë në dobi të përgjithshme dhe burgimi për të mitur. Ndaj të miturve të cilët nuk e kanë mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç në kohën e kryerjes së veprës penale mund të jepen vetëm masat. Kohëzgjatja e çfarëdo mase apo dënimi të dhënë duhet të përcaktohet në vendimin e gjykatës në pajtim me Ligjin. Kur gjykata jep dënimin me burgim për të mitur deri në dy vjet ose masën e dërgimit në institucionin edukativ apo edukativo-korrektues deri në dy vjet, gjykata mund të japë dënimin me kusht në pajtim me Kodin e Përkohshëm Penal. Kur ndaj të miturit jepet ndonjë masë apo dënim, gjykata në radhë të parë merr parasysh interesin më të lartë të të miturit. Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe këto rrethana: llojin dhe peshën e veprës penale, moshën e të miturit, nivelin e zhvillimit psikologjik, karakterin e tij dhe prirjet, motivet që e nxitën atë të kryejë veprën penale, edukimin e tij në atë fazë, mjedisin dhe rrethanat e jetës së tij, nëse është dhënë masë apo dënim më përpara dhe rrethanat tjera që mund të ndikojnë në dhënien e masës apo dënimit. Para zgjedhjes së masës apo dënimit, gjykata mund të kërkojë nga shërbimi i provës anketën sociale, rekomandimin lidhur me zgjedhjen e masës apo dënimit.

Llojet e masave të diversitetit (Neni 15) që mund të jepen ndaj kryerësit të mitur janë: 1) Ndërmjetësimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkimin e faljes nga i mituri ndaj palës së dëmtuar; 2) Ndërmjetësimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij; 3) Kompensimi i dëmit palës së dëmtuar përmes marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet viktimës, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit; 4) Vijimi i rregullt në shkollë; 5) Pranimi i punësimit apo aftësimi në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij; 6) Kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. 7) Edukimi në rregullat e trafikut dhe 8) Këshillimi psikologjik. Llojet e masave edukative (Neni 17) që mund të jepen ndaj kryerësit të mitur janë a) masat disiplinore, b) masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe masat institucionale.

Masat disiplinore janë qortimi gjyqësor dhe dërgimi i të miturit në qendër disiplinore. Këto masa jepen ndaj kryerësit të mitur interesat e të cilit më së miri përfillen me një masë afatshkurtër, veçanërisht nëse vepra penale është kryer nga pamaturia apo pakujdesia.

Masat e mbikëqyrjes së shtuar janë mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, nga prindi adoptues ose kujdestarit të të miturit, mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër dhe mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë. Këto masa jepen ndaj të miturit interesat e të cilit nuk kërkojnë izolimin nga mjedisi i tij i mëparshëm dhe mbahen me masë afatgjate që të miturit i ofron mundësinë e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit. Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të jetë më e shkurtër se tre muaj apo më e gjatë se dy vjet.

Masat institucionale edukative janë dërgimi i të miturit në institucion edukues, dërgimi i të miturit në institucion edukues korrektues dhe dërgimi i kryerësit të mitur në institucionin e kujdesit të posaçëm. Këto masa shqiptohen ndaj të miturit interesat e të cilit më së miri përfillen me veçimin e tij nga mjedisi i mëparshëm dhe me masë afatgjate, që të miturit i ofron mundësinë e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit. Kohëzgjatja e masës edukative nuk mund të kalojë afatin maksimal të burgimit të parashikuar për veprën penale. Qortimi gjyqësor (Neni 18) Gjykata e jep masën e qortimit gjyqësor kur masa e tillë konsiderohet e mjaftueshme dhe në interes të të

miturit për të ndikuar pozitivisht në sjelljen e tij. I mituri, të cilit i jepet qortimi gjyqësor informohet se ai ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme e cila përbën vepër penale dhe i bëhet me dije se nëse përsëri kryen vepër të tillë, gjykata do t'i jap masë apo dënim më të rëndë.

Dërgimi në qendër disiplinore (Neni 19) Gjykata shqipton masën e dërgimit në qendër disiplinore kur masa e tillë konsiderohet e mjaftueshme dhe në interes më të mirë të të miturit për të ndikuar pozitivisht në sjelljen e tij. Gjykata mund ta dërgojë të miturin në qendër disiplinore: 1) Më së shumti një muaj, deri në katër orë në ditë ose 2) Më së shumti katër ditë gjatë festës shkollore apo publike, deri në tetë orë në ditë. Kur jepet kjo masë, gjykata kujdeset që ekzekutimi i saj të mos e pengojë shkollimin dhe punën e rregullt të të miturit. Në qendrën disiplinore i mituri angazhohet në aktivitete të dobishme. Aktivitetet përshtaten me moshën e tij, shkathhtësitë dhe interesat me qëllim të zhvillimit të ndjenjës së përgjegjësisë tek ai.

Dërgimi në institucionin edukativ (Neni 24) jepet kur të miturit i nevojitet mbikëqyrje e plotë nga edukatorët adekuat dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të fëmijës. Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të jetë më e shkurtër se tre muaj apo më e gjatë se dy vjet. Dërgimi në institucionin edukativo–korrektues (Neni 25) jepet kur i mituri i cili ka kryer vepër penale të dënueshme me burgim prej më shumë se tri vjet ka nevojë për edukim të specializuar dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të fëmijës. Kur gjykata vendos për dhënien e kësaj mase, ajo merr parasysh peshën dhe natyrën e veprës penale dhe nëse i mituri ka qenë më parë i dënuar me masë edukative ose me burgim për të mitur. Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të zgjasë më pak se një vit ose më shumë se pesë vjet.

Dërgimi në institucionin për kujdes të posaçëm (Neni 26) Gjykata mund të japë masën e dërgimit në një institucion për kujdes të posaçëm në vend të masës së dërgimit në institucion edukativ ose në institucion edukativo-korrektues me rekomandimin e ekspertit të mjekësisë kur të miturit i nevojitet përkujdesje e posaçme për shkak të çrregullimit mendor ose të metave fizike dhe kur kjo është në interesin më të mirë të të miturit. Gjykata e cila ka dhënë masën, çdo gjashtë muaj e rishikon nevojën për qëndrim të mëtejshëm në institucionin e kujdesit të posaçëm si dhe kur i mituri arrin moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

Gjykata mund të japë dënim me gjobë ndaj të miturit nëse i mituri ka mjete për ta paguar gjobën. Me rastin e dhënies së dënimit me gjobë, gjykata shqyrton gjendjen financiare të të miturit dhe në veçanti lartësinë e të ardhurave të tij personale, të ardhurat tjera, pasurinë dhe detyrimet. Gjykata nuk e cakton lartësinë e gjobës mbi lartësinë e mjeteve që posedon i mituri. Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se 25 euro ose më shumë se 5.000 EUR. Nëse i mituri përsëri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë gjobën, gjykata, me pëlqimin e personit të dënuar, mund ta zëvendësojë gjobën me urdhër për punë në dobi të përgjithshme që nuk pengon vijimin e rregullt në shkollë dhe aktivitetet tjera të punës.

Urdhri për punë në dobi të përgjithshme (Neni 28). Me pajtimin e të miturit, gjykata mund ta zëvendësojë masën edukative deri në tri vjet, burgimin e të miturit deri në dy vjet ose gjobën me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Kur e jep urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron të miturin që të kryejë punë në dobi të përgjithshme pa pagesë për një afat të caktuar prej tridhjetë (30) deri në njëqind e njëzet (120) orëve. Puna në dobi të përgjithshme kryhet brenda periudhës së caktuar nga gjykata, e cila nuk zgjat më shumë se një vit. Nëse pas kalimit të periudhës së caktuar i mituri nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme ose punën e tillë në dobi të përgjithshme e kryen vetëm pjesërisht, gjykata urdhëron ekzekutimin e masës institucionale edukative ose burgimin për të mitur në kohëzgjatje proporcionale, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e punës në dobi të përgjithshme që është kryer.

Dënimi me burgim për të miturit. Gjykata mund të japë dënimin me burgim për të mitur ndaj kryerësit të mitur i cili e ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe ka kryer veprë penale të dënueshme me burgim prej më shumë se pesë vitesh, në rastet kur dhënia e masës edukative nuk do të ishte adekuate për shkak të peshës së veprës penale, pasojave të saj dhe nivelit të përgjegjësisë. Kohëzgjatja e burgimit për të mitur (Neni 31) për të mitur nuk mund ta kalojë maksimumin e burgimit të parashikuar për veprën penale por mund të jetë më i ulët se minimumi i burgimit të parashikuar për veprën penale. Burgimi për të mitur nuk mund të jepet në kohëzgjatje më pak se gjashtë muaj as më shumë se pesë vjet. Maksimumi i burgimit për të mitur është dhjetë vjet për vepra të rënda penale të dënueshme me burgim afatgjatë, ose kur i mituri ka kryer së

paku dy vepra penale në bashkim, ku secila është e dënueshme me burgim prej më shumë se dhjetë vjet.

Trupi gjykues për të mitur në gjykatën e shkallës së parë dhe trupi gjykues për të mitur në gjykatën e shkallës së dytë, me përjashtim të kolegjeve në Gjykatën Supreme të Kosovës, përbëhet nga një gjyqtar për të mitur dhe dy gjyqtarë laikë. Gjyqtari për të mitur është kryetari i trupit gjykues. Gjyqtarët laikë në trupin gjykues për të mitur zgjedhe nga mesi i profesorëve, arsimtarëve, edukatorëve, punëtorëve socialë, psikologëve dhe personave të tjerë që kanë përvojë në edukimin e të miturve.

Avancimit të bazës ligjore në aspektin e mbrojtjes së fëmijëve, në Kosovë i ka paraprirë plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit të Shërbimeve Sociale e Familjare; draftimi dhe miratimi i Udhëzimeve Administrative, si: themelimin e komisionit për vendosjen e ankesave në shkallë të dytë për shërbime sociale e familjare; organizimin fushëveprimin e funksionimin e këshillit të përgjithshëm të shërbimeve sociale e familjare; themelimin e funksionimin e panelit për adoptim e strehim familja; themelimin e rregullimin e strehimit familjar në Kosovë; Mjetet dhe metodat bashkëkohore për planifikim familjar; për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryesit të dhunës në familje; për mënyrën e trajtimit të kryerësve të dhunës në familje ndaj të cilëve është shqiptuar masa mbrojtëse e trajtimit të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope.

KREU VII: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

7.1. KONKLUSIONET E STUDIMIT

Lufta ndaj kriminalitetit dhe mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës është në fokus të ligjvënësit sepse përfshirja e të miturve në strukturat kriminale ka ardhur duke u rritur. Në kuadër të luftës kundër kriminalitetit të të miturve janë bërë ndryshime të shumta legislative por vazhdon të jetë ende një sfidë realizimi i ndryshimeve institucionale të cilat do të çonin në zbatimin me efikasitet të normave ligjore. Në këtë pjesë të drejtësisë penale ndërthuren shumë struktura dhe shumë çështje që kanë të bëjë me legjislacionin mbi të miturit. Të tilla janë strukturat përgjegjëse për zbatimin e tij, strukturat e ndihmës mbështetëse të administratës publike, strukturat përgjegjëse për integrimin social të tyre, rehabilitimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktimë dhe strukturat përgjegjëse për parandalimin e kryerjes së veprës penale dhe sigurimi i rendit publik gjatë administrimit të drejtësisë. Të drejtat e të miturve dhe konfliktet e tyre me ligjin nuk janë fenomene aktuale. Ato kanë ekzistuar që në fazat embrionale të hartimit të legjislacioneve dhe në varësi të periudhave dhe të nevojave të momentin ato kanë pësuar ndryshime pozitive.

Kriminaliteti i të miturve i ka rrënjët që me krijimin e shoqërisë njerëzore. Në periudhën ku ende nuk mund të flitej për ligje dhe norma ligjore, fillimisht përgjegjësia e të miturve ka qenë objektive më vonë me hartimin e normave të para ligjore ajo u shndërrua në përgjegjësi penale. Të miturit kanë pasur një pozitë juridiko - penale më të lehtë dhe më të favorshme në krahasim me të rriturit për faktin se të miturit nuk kanë arritur pjekurinë e duhur biopsikike. Kështu në të drejtën romake përgjegjësia penale e fëmijëve ndahej në *infantil* ku bënin pjesë fëmijët që nuk kishin përgjegjësi penale, *infantiae proximus* ku bënin pjesë fëmijët afër fëmijërisë, dhe këta nuk kishin përgjegjësi penale dhe *pubertati proximus* bënin pjesë fëmijët të cilët ishin afër moshës për përgjegjësi penale. Pra në të drejtën romake fëmijët deri në moshën shtatë vjeçare janë konsideruar penalisht të papërgjegjshëm Kjo për faktin se në këtë moshë fëmija nuk ka arritur ende pjekurinë mendore dhe fizike dhe nuk mund të kuptojë pasojat e shkaktuara nga vepra penale e kryer.

Në periudhën e mesjetës nuk ka dispozita të veçanta që të trajtojnë të drejtat e të miturve dhe të rregullojnë në mënyrë specifike raportin e tyre me ligjin penal. Gjatë kësaj periudhe mund të themi që kemi një trajtim të përgjithshëm juridik të të miturve por nuk ka dispozita të posaçme për të miturit. Kodi penal i Toskanës i miratuar në vitin 1786 është akti i parë ligjor i hartuar nga Cesare Becdaria që përcaktoi disa kriteret të reja në lidhje me moshën për përgjegjësi penale të fëmijëve duke përjashtuar nga përgjegjësia penale fëmijët deri në moshën 12 vjeç. Kodi Penal i Napoleonit i konsideronte të mitur fëmijët deri në moshën 16 dhe parashikonte dënime në rastet kur këta persona ishin penalisht të përgjegjshëm, duke aplikuar masa ndëshkimore më të buta për shkak të moshës së tyre dhe papjekurisë mendore dhe fizike.

Në shekullin e XX kemi një ndikimin të shkollës sociologjike në hartimin e legjislacioneve penale. Në këtë periudhë u rrit rëndësia e përcaktimit të moshës për përgjegjësi penale të të miturve ku konsideroheshin *maxhorenë* personat që kishin mbushur moshën 18 vjeç dhe konsiderohen si penalisht të papërgjegjshëm fëmijët të cilat nuk kanë mbushur moshën 14 vjeçare në momentin e realizimit të një veprë penale. Në vitet tridhjetë të shekullit XX në shumicën e legjislacioneve penale u përqafuan masat edukuese, si lloje të posaçme të sanksioneve penale.

Në vendin tonë të drejtat e fëmijëve i gjejmë të sanksionuara në të drejtën zakonore e cila ka shërbyer për rregullimin e marrëdhënieve juridike dhe në pjesën e saj të kodifikuar përbëhet nga kanunet e ndryshme që kanë funksionuar në disa krahina të Shqipërisë si Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Labërisë etj. Kanunet nuk e përcaktonin moshën për përgjegjësi penale dhe përcaktonin se përgjegjësia për veprat e kryera nga të miturit i binte kryefamiljarit. Pas shpalljes së Shqipërisë mbretëri demokratike, parlamentare e trashëgueshme filloj puna për hartimi Kodit Penal i cili u ndërtua sipas modelit të kodeve penale të shteteve europiane dhe mund të themi që është i pari akt i mirëfilltë juridik i cili sanksiononte edhe raportin e të miturve me ligjin penal.

Në periudhën midis viteve 1952-1953 sistemi politik totalitar në Shqipëri pati një ndikim negativ në lidhje me përmirësimin e legjislacionit penal. Gjatë kësaj periudhe shteti totalitar e përdori drejtësinë penale për të mbrojtur pushtetin dhe për të goditur kundërshtarët politik dhe në këto kushte nuk ka progres në lidhje me

përmirësimin e normave ligjore ndaj të miturve dhe raportin e tyre me ligjin. Kodi Penal i hartuar mbi bazën e dispozitave të Kushtetutës së viti 76. përbente një kthesë regressive në legjislacionin shqiptar, duke zëvendësuar parimet kryesore të Kodit Penal të vitit 1952, të cilat përqendroheshin kryesisht të mbrojtja e pushtetit politik. Situata ndryshoj pas viteve 90 ku përmbysja e shtetit totalitar, kalimi në pluralizmin politik dhe zhvillimet politike, ekonomike, sociale, kulturore që shoqëruan shoqërinë shqiptare dhe shtetin shqiptar u reflektuan në mënyrë të drejtpërdrejtë në qëndrime institucionale të caktuara në lidhje me të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të miturve në veçanti. Kështu sistemi ligjor shqiptar pësojë një reformim që prekte konkretisht legjislacionin penal e procedural penal, organizimin e sistemit gjyqësor, të prokurorisë etj. Reforma në sistemin ligjorë në tërësi dhe ajo penale në veçanti solli ndryshime në trajtimin e të miturve duke u bazuar në standardët ndërkombëtare. Fillimi i kësaj reforme në kontekstin e temës sonë konkretizohet me miratimin e dispozitave kushtetuese dhe i paketës mbi të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve dhe ratifikimi i Konventës të OKB mbi të Drejtat e Fëmijës ë 27 shkurt me 1992.

Kodi i ri Penal në lidhje me të drejtat e të miturve dhe trajtimin e tyre penal është hartuar dukë marrë në konsideratë nenet e Konventës së OKB mbi të Drejtat e Fëmijës. Miratimi i Kodit Penal dhe i Kodit të Procedurës Penale shënoi një hap të rëndësishëm në drejtësinë shqiptare. Kodi solli disa ndryshime në lidhje me trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin. Kështu në lidhje me moshën për përgjegjësi penale, Kodi penal përcaktoi moshën 14 vjeç për vepra penale dhe 16 vjeç për kundravajtje penale. Kodi i ri Penal përfshinte krijimin e seksioneve të veçanta në gjykata që trajtonin çështjet e të miturve. Ndër aspektet e tjera të rëndësishme përse i përket trajtimit të të miturve në këtë kod penal është mbrojtja e detyruar ligjore për të pandehurin e mitur i cili nuk ka mbushur moshën 18 vjeç si dhe garantimin e asistencës juridike dhe psikologjike në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me qëllim mos ndërprerjen e procesit edukativ. Kodi i ri Penal kishte mangësi në lidhje me aspektin edukues të të miturve të përfshirë në vepra penale. Kështu krahasuar me kodet penale të mëparshme ku masat edukuese ishin më të shumta, kodi i ri penal ka vetëm një lloj mase edukuese, atë të vendosjes në një institucion edukimi e cila në praktikë nuk gjen zbatim për faktin se këto institucione nuk ekzistojnë në vendin tonë.

Instrumente të tjera ligjore të cilat ofrojnë mbrojtje ndaj të miturve janë Kodi i familjes, Ligji kundër Dhunës në Familje dhe Kodi Penal , Ligji Nr 8733, neni 128/b'' Mbi trafikimin e Fëmijëve, ligji nr 8328 datë 16.04.1998 "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve dhe të Paraburgosurve", Ligji 8331 datë 21.04.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", ligji nr 8677 datë 02.11.2000 "Për Policinë Gjyqësore", ligji 8678 datë 14.05.2011 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë" etj. Hartimi i këtyre ligjeve bëri që sistemi i drejtësisë për të miturit të ishte gjithmonë e më shumë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në kuadër të harmonizimit të legjislacionit për të miturit me standardet ndërkombëtare vendi ynë ka ratifikuar një mori Konventash ndërkombëtare që lidhen me të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti. Instrumentet ndërkombëtare ku aderon Shqipëria, janë një pikë referimi për ndërtimin e një sistemi ligjor efikas. Aktet ndërkombëtare ku bën pjesë dhe vendi ynë, kanë parashikuar një mori normash juridike që rregullojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në sfera të ndryshme të jetës dhe në marrëdhënie të ndryshme ku ata janë të përfshirë, qoftë në të drejtën penale, familjare, civile, të punës etj.

Instrumentet ndërkombëtar të ratifikuar kanë karakter të fortë detyrues por pavarësisht kësaj konstatohet se niveli i njohjes së këtyre instrumenteve, niveli zbatimit të tyre nga ligj zbatuesit në përgjithësi dhe nga gjyqtarët në veçanti është shumë i ulët. Për ligj zbatuesit, juristët, avokatët e gjyqtarët nuk mjafton vetëm dijenia dhe njohja me këto instrumente nëse kjo njohje nuk shoqërohet me zbatimin e tyre në punën e përditshme. Institucioni më i rëndësishëm i cili ka ofruar një kontribut të lartë në hartimin e disa prej akteve më të rëndësishme ndërkombëtarë është Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Dokumentet ndërkombëtarë që trajtojnë pozitën juridike të të miturve në raport me ligjin penal janë: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e Neë York-t miratuar në 20.11.1989 dhe protokolle e saj shtesë , Konventa Kundër Torturës dhe Vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, çnjerëzor a Degradues ratifikuar me ligjin nr. 7727 datë 30.6.1993. Rregullat standard minimum të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të miturit (1985), Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës 1990), Rregullat Standard Minimum të Kombeve

të Bashkuara lidhur me masat e mos-arrestimit (Rregullat e Tokios 1990), Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e kriminalitetit e të rinjve (Udhëzimet e Riadit 1990)

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës përbënë një nga aktet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare në të cilën janë parashikuar të drejtat dhe detyrimet në të gjitha fushat e jetës së fëmijës. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës në 27 shkurt 1992 duke e integruar si pjesë të legjislacionit të brendshëm nisur edhe nga gatishmëria për mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenies së fëmijës. Konventa është një instrument detyrues për të gjitha shtetet palë dhe parashikon parimet kryesore për mbrojtjen e të miturve në tërësi, por dhe standardet bazë për zbatimin e drejtësisë penale për të miturit, duke e shndërruar atë në një nga dokumentet kryesore të të Drejtave të Fëmijës në mbarë botën.

Në funksion të mbrojtjeve të të drejtave të njeriut në përgjithësi por edhe të të drejtave të fëmijëve si pjesë e tyre Këshillit të Evropës ka hartua një sërë aktesh ligjore më fuqi detyrues. Aktet që do të jenë në fokus të analizës sonë janë :Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Karta Sociale Evropiane (E Rishikuar), Konventa Evropiane mbi Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve, Konventa Evropiane “Për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve dhe Trajtimeve Çnjerëzore apo Degraduese”, Konventa Evropiane “Për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht” ratifikuar me Ligjin nr. 8724 datë 26.12.2000, Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar” e ratifikuar me Ligjin nr. 8499, datë 10.6.1999, Konventa e Këshillit të Evropës “Për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 8498, datë 10.6.1999) , Konventa E Këshillit Të Evropës “Për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 9068, datë 15.5.2003, Konventa e Këshillit të Evropës “Për Transferimin e Procedimeve në Çështjet Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 8497, datë 10.6.1999 , Rekomandimi Cm/Rec 2008 (11) i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Rregullat Evropiane, për të dënuarit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve ose masave. Po kështu edhe Bashkimi European ka hartuar Disa aktet kryesore të cilat trajtojnë të drejtat e të miturve në legjislacionin e Bashkimit Evropian, të cilët janë Traktatet e BE-së , Karta e të drejtave themelore të BE-së, Direktiva e Këshillit Ekonomik dhe Social (2005).

Shqipëria ka ratifikuar disa nga aktet më të rëndësishme ndërkombëtare dhe evropiane në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve duke i bërë ato pjesë të legjislacionit të brendshëm. Marrëveshjet ndërkombëtare kanë fuqi detyruese në vendin tone, në këto kushte hartimi i tyre ka detyruar legjislatorin që të marri të gjitha masat e duhura ligjore për të zbatuar këto kate. Të drejtat e të miturve përcaktohen në disa prej akteve më të rëndësishme të Republikës së Shqipërisë si Kushtetuta Kodi Penal , Kodi procedural penal dhe Ligji nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”. Këto akte do të jenë pjesë e analizës ton të mëposhtme. Ligji nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ka për qëllim mbrojtjen e veçantë të të drejtave të fëmijës nëpërmjet realizimit të një kuadri të plotë ligjor dhe institucional, në zbatim të Kushtetutës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi dhe marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij.

Procesi i integritetit është një rrugë e cila imponon detyrimisht përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë për të miturit. Në këto kushte vendet evropiane jo-anëtare që dëshirojnë të aplikojnë për anëtarësim duhet të harmonizojnë legjislacionin me standardet e BE-së. Për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me atë të *acquis communautaire* vendi ynë ka marrë në konsideratë aktet më të rëndësishme që trajtojnë të drejtat e fëmijëve. Kështu legjislacioni i vendit ton është në përputhje me *Acquis Communautaire*. Në lidhje me legjislacionin parësor i BE-së mund të themi që Shqipëria ka inkorporuar nenin 24 të Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) i cili trajton të drejtat e fëmijëve. Neni 47 i Kartës e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian është një ndër aktet e tjera të rëndësishme që është marrë në konsideratë në hartimin e legjislacionit ton të brendshëm Po kështu dhe neni 49 i Kartës ku përcaktohen parimet e legjitimitetit dhe proporcionalitetit për veprat penale dhe dënimet, janë inkorporuar në legjislacionin e brendshëm. Në hartimin e akteve dhe ligjeve që kanë në qendër mbrojtjen e të drejtave të të miturve është marrë në konsideratë edhe legjislacioni dytësor i BE-së i përbërë nga disa direktiva.

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve si instrumenti më i rëndësishëm në fushën e përcaktimit dhe mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve na jep një përkufizim ligjorë të termit fëmijë duke përcaktuar se *“Me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën*

18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara”. Nga interpretimi i këtij neni mund të kuptojmë që nga mosha e përcaktuar nga Konventa mund të ketë edhe përjashtime ligjore të përcaktuara nga legjislacionet kombëtare. Konventa në nenin 40 paragrafi 3 pika a përcakton se *“Shtetet Palë përcaktojnë një moshë minimale, nën të cilën fëmijët prezumohen të paaftë për të shkelur ligjin penal”* por kufiri i moshës, nën të cilin nuk duhet lejuar heqja lirisë një fëmije duhet përcaktuar me ligj.

Një nga parimet më të rëndësishëm në përcaktimin e kufirit të moshës së miturisë e për rrjedhojë të moshës për përgjegjësi penale është parimi i interesit më të lartë të fëmijës. Sipas Kushtetutës tonë, edhe pse nuk ka një nën të veçantë lidhur me interesin më të lartë të fëmijës, ajo i ofron mbrojtje të veçantë që ka për qëllim të tregojë dhe një status të një kujdesi më të madh për fëmijët, i cili duhet të reflektohet jo vetëm në legjislacion por edhe në të gjithë veprimtarinë e organeve shtetërore dhe subjekteve në kontakt me të miturit.

Po kështu edhe përcaktimi i moshës për përgjegjësi penale lidhet ngushtë me detyrimin e shteteve në krijimin e një sistemi efektiv të drejtësisë penale për të miturit. Mosha për përgjegjësi penale është konsideruar mosha për të cilën një person mund të konsiderohet përgjegjës për një vepër penale dhe mund t’i nënshtrohet procedurave penale. Mosha për përgjegjësi penale ndryshon nga një vend në tjetrin në bazë të zhvillimit shoqëror dhe kulturore të një vendi. Në legjislacionin tonë e gjejmë të sanksionuar moshën për përgjegjësi penale në nenin 12 të Kodit Penal ku përcaktohet se *“Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç. “.* Pra në këtë nenë është sanksionuar mosha për përgjegjësi penale për veprat penale dhe kundërvajtjet penale, duke përcaktuar si moshën minimale të katërmëdhjetë vjeçare.

Me ndryshimet e shumta kulturore, sociale dhe ekonomike përfshirja e të rinjve në veprimtari kriminale ka ardhur gjithnjë e në rritje. Duke analizuar dhe kuptuar shkaqet e këtij fenomeni mund të përcaktohet trajtimi i duhur për këtë kategori personash. Në rritjen e kriminalitetit ndikojnë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Në faktorët e brendshëm përfshihen personaliteti i të miturit dhe karakteri i të miturit.

Faktorët e brendshëm janë mjedisi familjar, mjedisi shkollor, mjedisi shoqëror, migrimi i brendshëm dhe mjetet e informimit. Një rolë të rëndësishëm në trajtimin të miturve në Shqipëri janë edhe institucionet përgjegjëse për administrimin e legjislacionit në lidhje me të miturit. Institucionet më të rëndësishme janë Ministria e Drejtësisë, Agjencia shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, sistemi gjyqësor, prokuroria, policia e shtetit dhe policia gjyqësore dhe institucionet e vuajtjes së dënimit. Këto institucione janë përgjegjëse për hartimin legjislacionit dhe marrjen e masave për parandalimin e kriminalitetit të të miturve, po kështu disa nga këto institucione kanë detyrimin që të marrin në mbikëqyrje të miturit pas dënimit të tyre nga institucionet përkatëse.

Aspekti procedural i trajtimit të një akti kriminal ku është përfshirë një i mitur ka një rëndësi esenciale që fillon në momentin e parë të ndalimit dhe vazhdon me të njëjtin intensitet deri në procesin gjyqësor. Kjo për faktin se një procedurë e papërshtatshme do të cënonte të drejtat dhe liritë themelore të miturit në veçanti dhe të çdo individi tjetër në përgjithësi. Në Kodit të Procedurës Penale janë parashikuar rregulla për mënyrën e ndjekjes, hetimit dhe gjykimit të veprave penale.

Të miturit janë një kategori personash të favorizuar për shkak të pozitës së tyre por edhe ndaj tyre kur vërtetohet se ata janë autorë të veprave penale shteti aplikon sanksione penale. Në aplikimin e sanksioneve duhet të merret në konsideratë nevoja për edukimin dhe mirëqenien e të miturit. Masat të cilat do të gjejnë trajtim janë dënimi me burgim, masat edukuese dhe alternativat e dënimit me burgim. Si alternativa të dënimit janë gjysëmliria, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë, qëndrimi në shtëpi, pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik dhe lirimi me kusht.

7.2. REKOMANDIME

Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës aktualisht përbënë një nga sfidat me të cilat përballlet shoqëria sepse përfshirja e të miturve në strukturat kriminale ka ardhur duke u rritur. Numri i veprave penale të kryera nga të miturit në Shqipëri vazhdon të jetë në rritje si pasojë e mungesës së masave ligjore, procedurave të qarta dhe të sanksionuara në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të të miturve në sistemin ligjor

kombëtar. Shfrytëzimi i të miturve për veprimtari të ndryshme kriminale ka sjellë në vëmendje emergjente krijimin e një legjislacioni të përshtatshëm për luftimin dhe parandalimin e këtij fenomeni. Të gjendur në këto kushte ne rekomandojmë që:

1. Të miratohet një kod për drejtësinë për të miturit duke u bazuar në eksperiencat më të mira ndërkombëtare dhe europiane.
2. Të plotësohet kuadri ligjor me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij, ku të përmbliidhen të gjitha parashikimet që lidhen me të miturit në konflikt me ligjin penal.
3. Të krijohet institucioni i avokatit të fëmijëve, si një garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të tyre.
4. Të ngrihen Gjykatat të veçanta për të miturit me gjyqtarë të specializuar në çështjet penale me të mitur.
5. Të krijohet një kuadër ligjor i cili do të evitonte vonesat në çdo fazë të procedimit gjyqësor.
6. Me plotësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të të miturve duhet të ndryshohen edhe Kodet përkatëse penale duke azhurnuar dhe shtuar dispozitat të cilat do të përcaktojnë pozitën e të miturve në raport me drejtësisë penale.
7. Duhet të pasurohen dënimet alternative për të për të miturit në mënyrë të përshkallëzuar, dhe të merren masa për krijimin e institucioneve mbështetëse.
8. Minimizimi i veprave penale për të cilat kuadri ligjor legjitimon dënimin me burgim të të miturve, kjo në varësi të llojit të veprës penale dhe rëndësisë së saj në komunitet.
9. Të parashikohet në ligj ndjekja e të miturit në gjendje të lirë për të mos penguar zhvillimin, edukimin dhe arsimimin e tyre.
10. Të përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin Penal pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut në çdo procedim me të mitur duke marrë parasysh nevojat e veçanta të të miturve për asistencë profesionale.
11. Të krijohen struktura të specializuara për të miturit në çdo prokurori, në polici.
12. Të krijohet një strukturë ndihmëse e shërbimit social në shërbim të të miturve në konflikt me drejtësinë penale e cila duhet të funksionojë si hallkë mbështetëse në polici, prokurori, në gjykatë, në burgje, dhe qendrat e riedukimit.

13. Të përmirësohet infrastruktura e institucioneve të vuajtjes së dënimit, paraburgimi
14. Të krijohen qendra të riedukimit ose burgje të hapura ose gjysmë të hapura, me qëllim mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.
15. Të forcohen masat parandaluese, me qëllim uljen e prirjes drejt rrugës së krimit tek fëmijët duke synuar edukimin që në bankat e shkollës me informacion të thjeshtuar ligjor.
16. Të krijohen strategji kombëtare për ngritjen e institucioneve të hapura dhe gjysmë të hapura dhe qendrat e riedukimit të të miturve, sipas përvojës së vendeve më të zhvilluara.
17. Të synohet në zgjidhjen alternative të konflikteve penale me të mitur duke zbatuar drejtësinë restauruese për rastet e të miturve viktimë dhe autorë veprave penale sepse parashikimet në ligjin aktual të ndërmjetësimit nuk mjaftojnë.

Tabele Nr 1: Moshë për përgjegjësi penale në vendet e BE është si vijon:

Austria 14	Belgika 16*/**18	Bullgaria 14
Qipro 7	Rep. Çeke 15	Danimarka 15
Estonia 14	Finlanda 15	Franca 10****/13
Gjermania 14	Greqia 8****/13	Hungaria 14
Irlanda 12	Italia 14	Lituania 14**/16
Letonia14	Luksenburg 10	Malta 9
Holanda 12	Polonia 13	Portugali 12****/16
Rumani14**/16	Sllovakia14/16	Sllovania14**/16
Spanja 14	Suedia 15	Britania e Madhe 10

(Save the Children,2012,13)

Tabela 2 - Të dënuarit e mitur, vepra penale për të cilën dënohen dhe masa e dënimit

(Juvenile convict, criminal offenses for which they are sentenced and the sentence term)

Neni (Article)	Denua Convicts)	Të Pa fajshëm (Not guilty)	Të Pa pushuar (Case closed)	Pa arsim (Uneducated)	Me arsim (With education)	Me gjobë (Fine)	Deri në 2-vjet (up to 2 years)	2-5 vjet (2-5 year)	5-10 vjet(5-10 years)	10-25 vjet (10-25 years)
76	3	0	0	0	3	0	2	1	0	0
79/dh	1	0	0	0	1	0	0	0	1	0
85	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0
88	10	1	0	0	11	0	10	0	0	0
88/a	2	0	0	0	2	0	2	1	0	0
100/1	3	0	0	0	3	0	0	2	1	0
108	2	0	0	0	2	0	2	0	0	0
110/2	1	0	0	0	1	0	0	0	1	0
113	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
130/a	2	0	0	0	2	0	2	0	0	0
134/1	140	1	1	1	131	7	131	2	0	0
134/2	308	0	11	12	307	2	302	4	0	0

134/3	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0
139	13	0	3	0	16	1	5	6	1	0
140	5	0	0	0	5	0	0	3	2	0
143	3	0	0	0	3	0	2	1	0	0
150	5	0	0	0	5	1	4	0	0	0
151	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0
156	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0
186	2	0	0	0	2	0	2	0	0	0
189	5	0	0	1	4	0	5	0	0	0
192/a	3	0	0	0	3	3	0	0	0	0
192/b	2	0	0	0	2	0	2	0	0	0
236/2	2	0	0	0	2	2	0	0	0	0
237	1	0	0	0	1	1	0	0	0	0
278/2	12	0	0	0	12	1	9	2	0	0
278/4	2	0	0	0	2	0	0	2	0	0
279	24	0	0	0	24	8	16	0	0	0
283/1	11	0	0	1	10	0	10	1	0	0
283/2	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0
284/1	2	0	0	0		1	1	0	0	0
					2					
287	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0

287/b	2	0	0	0	2	0	2	0	0	0
290	3	0	0	0	3	1	2	0	0	0
299	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0
300	4	0	1	1	4	1	3	0	0	0
301	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0
305	6	0	1	1	6	4	2	0	0	0
323	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0
Totali	589	2	17	28	580	33	525	25	6	0

Tabela Nr 3: Të dënuar të mitur 2007-2013 (Vjetari statistikor, MD)

Të dënuar të mitur (Juvenile De linquency)	Viti (Year) 2007	Viti (Year) 2008	Viti (Year) 2009	Viti (Year) 2010	Viti (Year) 2011	Viti (Year) 2012	Viti (Year) 2013
Për krime (Criminal offenses)	198	356	362	594	610	826	589
Për kundërvajtje (Contraventions)	13	51	49	62	73	57	91
Totali	211	407	411	636	683	883	680

Tabela Nr. 3 Grafiku i të dënuarve të mitur 2007-2013 (Vjetari statistikor MD, 2013)




Tabela Nr. 5 Tabela e kundravejtjeve penale

KUNDËRVAJTJE PENALE									
Neni (Articole)	Dënuar (Convicts)	Të Pa fajshëm (Not guilty)	Të pushuar (Cased)	Pa arsim (Un education)	Me arsim (With educatio n)	Me gjobë (Fine)	Deri në 2-vjet (up 2 years)	2-5 vjet (2-5 year)	5-10 vjet (5- 10years)

	guilty								
84	4	0	0	0	4	0	4	0	0
89	10	0	0	0	10	5	5	0	0
90	3	0	0	0	3	0	3	0	0
119	1	0	0	0	1	1	0	0	0
130	4	0	0	4	0	0	4	0	0
133	2	0	0	0	2	0	2	0	0
205	4	0	0	0	4	3	1	0	0
235/1	2	0	0	0	2	0	2	0	0
236/1	1	0	0	0	1	0	1	0	0
273	3	0	0	0	3	3	0	0	0
274	1	0	0	0	1	1	0	0	0
275	4	0	0	0	4	0	4	0	0
278/3	1	0	0	0	1	0	1	0	0
280	2	0	1	0	3	0	2	0	0
287/b	1	0	0	0	1	1	0	0	0
288/al	40	0	1	0	41	16	24	0	0
291	5	0	0	0	5	0	5	0	0
305/b1	2	0	0	0	2	0	2	0	0
Të tjera	1	0	0	0	1	1	0	0	0
Totali	91	0	2	4	89	64	60	0	0

Totali										
krime dhe kiundërvajtje	680	2	19	32	669	64	585	25	6	

Bibliografia

➤ BURIMET PARESORE

1. Kodi Penal Shqiptar, miratuar me dekretin nr.83-1,date 28.05.1927.
2. Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.1470, datë 23.05.1952.
3. Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.5591,date 15.06.1977.
4. Kodi i Procedurës Penale të Republikës Popullore të Shqipërisë, miratuar me ligjin nr., datë 30.03.1953
5. Kodi i Procedurës Penale i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.6069, datë 25.12.1979.
6. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, i ndryshuar
7. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7895 datë ,27.01.1995, i ndryshuar
8. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë miratuar në Nëntor 1998
9. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
10. Kodi i Procedurës Penale të Francës
11. Kodi i Procedurës Penale i Italisë
12. Kodi i Procedurës Penale i Greqisë
13. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)
14. .Karta Sociale Evropiane (E Rishikuar)
15. Konventa Europiane mbi Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve

16. Konventa Europiane “Për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve dhe Trajtimeve Çnjerëzore apo Degraduese”
17. Konventa Evropiane “Për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht” ratifikuar me Ligjin nr. 8724 datë 26.12.2000
18. Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar” e ratifikuar me Ligjin nr. 8499, datë 10.6.1999
19. Konventa e Këshillit të Evropës “Për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 8498, datë 10.6.1999)
20. Konventa E Këshillit Të Evropës “Për Vlefshmërinë Ndërkombëtare Të Gjykrimeve Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 9068, datë 15.5.2003
21. Konventa e Këshillit të Evropës “Për Transferimin e Procedimeve në Çështjet Penale” e ratifikuar me Ligjin nr. 8497, datë 10.6.1999
22. Rekomandimi Cm/Rec 2008 (11) i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Rregullat Evropiane, për të dënuarit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve ose masave
23. Traktati i Lisbonës
24. Karta e të drejtave themelore të BE-së
25. Direktivat për drejtësinë për të miturit, Vjenë 1997
26. Tërësia e rregullave minimale të Kombeve të Bashkuara për trajtimin e të dënuarve të privuar nga liria.
27. Rregullat Evropiane të burgjeve.
28. Opinioni i Komiteti European Ekonomik dhe Social” Mbi parandalimin e kriminalitetit të të miturve dhe roli i sistemit të drejtësisë për të miturit në Bashkimin Evropian”, adaptuar në 15 Mars 2006 në sesionin e 42-të (2006/C 110/13).

➤ **LIGJE TE TJERA PENALE**

1. Ligji nr. 599, datë 13.05.1946” Mbi dispozitat e përgjithshme penale”.
2. Ligji nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”
3. Ligji Nr.8331, datë 21.4.1998,” Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

4. Ligji Nr. 10024, datë 27.11.2008 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8331, datë 21.4.1998 “ Për ekzekutimin e vendimeve penale”.
5. Ligji nr. 9749, datë 04.06.2007 “ Për policin e shtetit”.
6. Ligji nr. 8328, datë 16.04.1998,” Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.
7. Ligji nr. 9888, datë 10.03.2008, Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998,” Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.
8. Ligji nr. 8454 datë 4.12.1999” Për avokatin e popullit”, i ndryshuar.
9. Ligji nr. 8737, datë 12.02,2001, “ Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
10. Ligji nr. 10385, datë 24.04.2011” Për ndërmjetësimin ne zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
11. Ligji nr. 9877, datë 18.02.2008,” Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
12. Ligji nr. 10347, datë 04.11.2010, “ Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.
13. VKM nr. 187, datë 17.3.2010 Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 303, datë 25.3.2009 të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”.
14. VKM nr. 327 datë 15.15.2003 “ Për kalimin e sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së drejtësisë”.
15. VKM nr. 302, datë 25.03.2009 Për miratimin e Rregullores “ Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës, dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”.
16. VKM nr. 303, datë 25.03.2009.”Për miratimin e e Rregullores së përgjithshme të Burgjeve”.
17. VKM nr. 368, datë 31.05.2005,” Për miratimin e Strategjisë kombëtare për fëmijët”.
18. Urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm nr.163, datë 01.10.2007 “ Për krijimin dhe caktimin e strukturës organike, funksionimin dhe kompetencat e seksioneve për të mitur në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore”.
19. Dekreti nr. 5351, datë 11.06.2007 “ Për krijimin e seksioneve të veçanta penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore”.

20. Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 625 datë 31.07.2009 “ Për miratimin e rregullores për bashkëpunimin e Shërbimit të provës me OJF-te dhe shërbimin e Ndërmjetësimit”.
21. Ligji italian nr. 1404, datë 20.07.1934,” Mbi krijimin dhe funksionimin e Gjykatave për të miturit”.
22. Dekreti i Presidentit të Republikës së Italisë nr. 448, datë 22.08.1988 “ Mbi aprovimin e dispozitave mbi procesin penal për të pandehurit e mitur”.
23. Ligji italian nr. 272, datë 28.11.1989 Mbi normat e zbatimit, koordinimit dhe ato transitore të DPR nr. 448, date 22.08.1988,” Mbi aprovimin e dispozitave mbi procesin penal për të pandehurit e mitur”

➤ **BURIMET DYTESORE**

Literature e huaj

24. Frederick. B., (1999),”Factorcs contributing to recidivizm among youth place with the New YORK state division for Youth New York.
25. Batiner. R., (2011) Les politiques publique face a la delinquence des mineurs. Quelle gouvernance pour quelle raison?.
26. Gombia, A., (2002), Babini da salvare, Edizioni Red, Novara:101
27. Giovagnoli.R.,(2008),” Studi di diritto penale” Parte Generale, Dott.A. Giufre Editore, Milano.
28. Minorenne e reato. Cenni storici e realtà attuale- S. Gallo, La Giustizia Penale Minorile, Roma, 2003.
29. F. Palomba, Il sistema del processo penale minorile, Giuffré, Milano 2002, p. 6.
30. A.C. Moro, op. cit.; S. Grasso, op.cit; F. Verdolina, op. cit.; Scivoletto, op. cit.
31. R. Ricciotti, Il Nuovo Processo Penale, in AA.VV.,
32. Contributi allo studio del nuovo processo penale, Seminario della Corte d'Appello di Bologna (novembre- dicembre1988), a cura di Melchionda, Rimini, 1989.
33. Vedi T. Bandini, U. Gatti, "Il concetto di immaturità",
34. F. Ferracuti (a cura di), Trattato di criminologia, medicina criminologica e psichiatria forense, Giuffré, Milano, 1989, vol. VI,

35. G.L. Ponti, P. Gallina Fiorentini, Imputabilità e immaturità nel procedimento penale minorile, in "Rivista italiana di medicina legale", 1983, 873;
36. G. De Leo, L'osservazione della personalità nel Processo Penale Minorile: limiti scientifici e prospettive d'intervento, in "Esperienze di rieducazione", 1978.
37. J. Pradel, Droit penal compare,(2008), Dalloz, 3e ed., nr 261
38. V.Andreoli, (2003), Dalla parte dei bambini. Per difenderi I nostril figli dalla violenza Edizioni superbur, Milano.
39. Pisani.M,(1972) “ Il tribunal per I minorenni in Italia
40. Justice Des Mineurs Orientations En Terme De Protection Et De Repression 1998-2008 Ministere De La Justice Service Des Affaires Europeennes Et Internationales Paris 2009
41. Loi fédérale sur la procédure pénale applicable aux mineurs (Procédure pénale applicable aux mineurs, PPMin) du 20 mars 2009

Literatura në shqip

42. Doc.Ela Elezi,(2013),” Efektiviteti i legjislacionit dhe sistemit të drejtësisë penale kundër kriminalitetit ne procesin e integritetit evropian”: 9
43. Doc. Marinela Sota,(2014),”Të dënuarit përsëritës në moshë të re: Faktorët e riskut dhe faktorët mbrojtës, niveli I trajtimit te marre gjate dënimit/nimeve të mëparshme”
44. Doc. Ferdinand Elezi, (2012) ,“ Provat penale dhe procesi i të provuarit”:2-24
45. DOC.Hasani. N.,(2015) ‘ ‘ Masat e Sigurimit. Tiranë: 13
46. Dr.Saliu.,I.,(2005),” E drejta penale për të mitur (me ligjin për të mitur)” Prishtine:14-424
47. Dr.Saliu, I .,(2008), “E drejta penale pjesa e përgjithshme, Universiteti Fama, Prishtine: 363-635
48. Dr.Saliu.I.,(2011), “ E drejta penale ndërkombëtare” ,Universiteti Fama, Prishtine
49. Elezi,I., Hysi,V.,(2006)” Politikat kriminale” , Pegi,Tirane
50. Hajdari,A.,(2004) ,”Kriminaliteti i të miturve në Kosovë gjatë periudhës 2001-2003” Prishtinë :37-42
51. Hysi, V., (2006)” Penologji” Pegi.

52. Muci, Sh (2012) E drejta penale pjesa e përgjithshme. Tirane:324-314
53. Papandile, J., Mandro I .,(2002)” Kriminologji-penologji” , Ilare,Tiranë..
54. Cerekja. Ma. B(2013) “Ndërmjetësimi në veprat penale të të miturve” Tiranë.
55. Gjoncaj, L., Gjoncaj, G., (2013),” Kriminologji”,Tirane
56. Elezi.I.,Hysi, V.,(2006) “ Politikat kriminale”, Pegi, Tirane.
57. Dr.Saliu.I.,(2011), “ E drejta penale ndërkombëtare” ,Universiteti Fama, Prishtine.
58. Halili, R.,(2009) “ Penologji” Prishtinë
59. Halil, R., (2002) “ Kriminologji”, Prishtinë.
60. Islam, H, Hoxha, A Panda, I (2007) Komentari i kodit të procedurës penale, Botuar me mbështetjen e Danida dhe Soros, Tirane.
61. Elezi, I .,(2006) “Kriminologji”, Prishtinë.
62. Vesel, L., (1982) “Delinkuenca e të miturve në Kosovë’’,Prishtine. F 36-45
63. Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin ne Evrope Prezenca ne Shqipëri (OSCE) (2006), Analizë e sistemit te Drejtësisë penale ne Shqipëri,” Raporti i Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë”, Pegi, Tirane.
64. Komentari i Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut – UNESCO 2008
65. Elezi.I.,(2002) E drejta penale. Pjesa e posaçme. Shblu. Tiranë
66. Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda Procedura penale. Komentari. Tiranë 2003
67. Gjoleka,A & Shoshi. E.,(1999) “Komente mbi masat e sigurimit personal.” Tiranë
68. Raporti Fillestar dhe i Parë Periodik i Shteteve Palë; Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (Crc) Shqipëria
69. Politikat e Përfshirjes Sociale për Fëmijët dhe Financimi i Tyre në Shqipëri
70. Dr, Sufaj, F., Sota, M.& Gjoka, R., (2012)Manual Trajnimi për Profesionistët që Punojnë me Fëmijët në Sistemin Penitenciar. Tiranë
71. Cela.A.,Gjika.G.& Zanko,A.,(1989) Kriminologjia. Tirane: 87

➤ **BURIME NGA INTERNETI**

1. MD(2014)” Vjetari statistikor. Ministria e Drejtësisë, Marrë nga:<http://www.drejtësia.gov.al/al/dokumente/statistika>,(parë në 03.05.2013)
2. CRCA (2010)Drejtësia për të mitur në Shqipëri. Një analizë e sistemit të administrimit për të miturit dhe gjendjes së të miturve në konflikt me ligjin. Marrë nga: [www.crca.al/site/default/files/publication/ Drejtësia për te mitur. Pdf](http://www.crca.al/site/default/files/publication/Drejtësia_për_të_mitur.Pdf),(parë në 03.02.2013)
3. CRCA.(2007) Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri. Analizë e shkaqeve dhe faktorëve të kriminalitetit tek të miturve në Shqipëri. Marrë në: [www.crca.al/site/default/files/publications/ Kriminaliteti I te miturve ne Shqipëri .pdf](http://www.crca.al/site/default/files/publications/Kriminaliteti_I_të_miturve_ne_Shqipëri.pdf) (parë në 02.04.2013)
4. Beqo. A& Doci.B(2015) Të Miturit në Konflikt me Ligjin, Marrë nga: [www.dpbsh.gov.al/skedaret/1450093768-Faktoret e kriminalitetit tek te miturit-studim.pdf](http://www.dpbsh.gov.al/skedaret/1450093768-Faktoret_e_kriminalitetit_tek_të_miturit-studim.pdf), (parë në 06.07.2013)
5. Lecon nr 4 la justice des mineurs,Marre nga: <http://espacehgfauthoux.emonsite.com/medias/files/lecon-n-4-la-justice-des-mineurs.pdf> ,(parë në 06.01.2016)
6. Minorenne e Reato Cenni Ctorici e Realta Attuale, Marrë nga:<http://www.altrodiritto.unifi.it/ricerche/minori/basilio/cap3.htm> ,(parë në 06.01.2016)
7. IN ITALIA Breve Storia Della Juisticie Minorile In Italia, Marre nga:http://www.ristretti.it/areestudio/cultura/libri/storia_giustizia_minorile.pdf,([parë](#) në 05,07,2014)
8. L'imputabilita' Minorile e Gli Apporti delle,la Neuroscienza ,Marre nga:http://www.psicologiagiuridica.com/pub/docs/anno%20XIII%20n_1/Imputabilita'%20minorile%20e%20neuroscienze.pdf, ([parë](#) ne 02,,03.2015)
9. Ordonance n^o 45-174 du 2 fevrier 1945 relative a l'enfance delinquante, Marre nga:<https://www.legifrance.gouv.fr/affichTexte.do?cidTexte=LEGITEXT000006069158>,([parë](#) në 21.04.2014)
10. La Justice Des Mineurs: Marrë nga:<http://www.justice.gouv.fr/justice-des-mineurs-10042>,/([parë](#) në 02.09.2014)

11. La loi n^o 49-956 du 14 juillet sur les publication destinees a la jeunesse.-Article 14, Marrë nga:<https://www.legifrance.gouv.fr/affichTexteArticle.do?idArticle=LEGIARTI000006421436&cidTexte=JORFTEXT000000878175>, (parë në 03.07.2015)
12. Disaddati E Delinquenti Non Si Nase Ma Si Divente, Marrë nga:
<http://www.gruppoabele.org/ëp-content/uploads/2015/06/DB-1973-Disadattati-e-delinquenti-non-si-nasce.pdf>, (parë në 02.08.2015)